Plani Vendor për Emergjencat Civile Bashkia Durrës

ALBAdapt – Programi për një Zhvillim Urban Rezistent ndaj Ndryshimeve Klimatike në Shqipëri

Grupet e punës dhe falënderime

Ky material u përgatit nga Bashkia Durrës me mbështetjen teknike të METROPOLIS SH.P.K dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit.

Projekti "Hartimi i Planeve Strategjike për Reduktimin e Riskut të Fatkeqësive në Bashkitë e Qarkut Durrës" zbatohet në kuadër të ALBAdapt, Programi për një Zhvillim Urban Rezistent ndaj Ndryshimeve Klimatike në Shqipëri, i financuar nga Fondi i Gjelbër për Klimën (GCF) dhe qeveritë e Shqipërisë, Gjermanisë dhe Zvicrës, zbatuar nga GIZ dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, në partneritet me Ministrinë e Mjedisit.

Falënderime

Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë, Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Plani Vendor për Emergjencat Civile u hartuan si një paketë e vetme, mbi të njëjtat të dhëna dhe skenarë. Falënderojmë Komisionin e Mbrojtjes Civile në Bashki, që shërbeu si grup pune, dhe Drejtorinë e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile, drejtori më vete e bashkisë për emergjencat civile, që koordinoi punën nëpërmjet Sektorit të Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, si dhe drejtoritë e tjera, administratorët e njësive administrative dhe MZSH-në.

Falënderojmë Prefekturën e Qarkut Durrës, AKMC-në dhe ekipin e ALBAdapt në GIZ, si dhe pjesëmarrësit në takimet e punës, në vlerësimin pjesëmarrës dhe në stërvitjen për përmbytjet të 13 tetorit 2026, të organizuar me AKMC-në, GIZ-in, Kryqin e Kuq Shqiptar dhe Vodafone Foundation.

Grupi i punës Bashkia Durrës

Komisioni i Mbrojtjes Civile në Bashki, me përfaqësues të Drejtorisë së Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile (Sektori i Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, sektori i bujqësisë dhe sektori i pyjeve), të drejtorive të planifikimit të territorit, projekteve dhe infrastrukturës, financës, shërbimeve sociale, arsimit e kulturës dhe informatikës, si dhe të njësive administrative.

Nën koordinimin e Ornela Markut; Drejtorisë së Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile; Andri Cerrit, Përgjegjës për Mbrojtjen Civile dhe Rudina Trikshiqi, përgjegjëse e Sektorit të Mjedisit dhe Energjisë në Bashkinë Durrës

Grupi i punës METROPOLIS SH.P.K & Co-PLAN

Dukate Dodaj; Dr. Kejt Dhrami; Dr. Ledio Allkja

Grupi i punës ALBAdapt GIZ

Rrezearta Ago; Paola Zhamo

Shënim: Ky dokument është pronësi intelektuale e Bashkisë Durrës dhe përdorimi i të dhënave në përmbajtje të këtij dokumenti duhet të kryhet gjithnjë duke cituar burimin e informacionit dhe duke vendosur referencat përkatëse.

Përmbajtja

Përmbajtja 4
Hyrje 9
Kapitulli 1. Qëllimi, synimet, fusha e zbatimit dhe objektivat 9
1.1 Qëllimi i planit 9
1.2 Synimet: 9
1.3 Fusha territoriale dhe institucionale 10
1.4 Objektivat e përgjithshme dhe specifike 10
1.5 Supozimet dhe kufizimet e planifikimit 11
1.5.1 Supozimet e planifikimit 11
1.5.2 Kufizimet e planifikimit 11
Kapitulli 2. Kuadri ligjor strategjik dhe parimet 12
2.1 Kuadri kombëtar ligjor dhe strategjik 12
2.1.1 Kuadri ligjor 12
2.1.2 Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SKZRF) 2023–2030 12
2.1.3 Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror (VRFNQ) 13
2.1.4 Plani Kombëtar për Emergjencat Civile 13
2.2 Kuadri vendor 15
2.2.1 Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë - bashkia Durrës 15
2.2.2 Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut (SVZR) 16
2.3 Parimet e menaxhimit të emergjencave civile/fatkeqësive 17
2.3.1 Parashikimi 17
2.3.2 Gatishmëria 17
2.3.3 Vendimmarrja 17
2.3.4 Udhëheqja 18
2.3.5 Informacioni 18
2.3.6 Integrimi 18
2.3.7 Bashkëpunimi 18
2.3.8 Vazhdimësia 18
2.4 Kuadri Sendai Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm dhe përshtatja klimatike 19
Kapitulli 3. Profili i Bashkisë Durrës 20
3.1 Territori dhe njësitë administrative 20
3.2 Popullsia dhe dinamika sezonale 21
3.3 Grupet që kërkojnë asistencë 22
3.4 Infrastruktura dhe shërbimet kritike 23
Kapitulli 4. Profili multi risk dhe prioritetet 25

4.1 Metodologjia dhe klasifikimi i riskut 25
4.2 Përmbledhje e rreziqeve – gjetjet kryesore 26
4.3 Ekspozimi territorial sipas njësive administrative 27
4.4 Prioritetet sipas njësive administrative dhe kërkesat operative 30
4.5 Kufizimet e të dhënave 31
Kapitulli 5. Organizimi vendor i mbrojtjes civile 31
5.1 Kryetari i Bashkisë 32
5.2 Komisioni i Mbrojtjes (KMCB) Civile në Bashki 32
5.2.1 Përbërja 33
5.2.2 Detyrat e KMCB-së 33
5.2.3 Rregullorja e funksionimit të Komisionit të Mbrojtjes Civile 33
5.3 Drejtuesi i Operacionit në Bashki (DOB) 34
5.4 Qendra Operacionale e Emergjencave Civile në Bashki (QOECB) 35
5.4.1 Aktivizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe organizimi i QOECB 35
5.4.2 Bashkërendimi dhe komunikimi në QOECB 36
5.4.3 Mbledhja e informacionit dhe raportimi 36
5.4.4 Raportimi i situatës 37
5.4.5 Kërkesat për burime 37
5.4.6 Informacioni i përgjithshëm 37
5.4.7 Informacioni publik 38
5.4.8 Marrëdhëniet me median 38
5.4.9 Vendndodhja e QOECB 39
5.5 Struktura e përhershme e mbrojtjes civile 40
5.6 Njësitë administrative dhe strukturat operacionale 41
5.6.1 Njësitë administrative 41
5.6.2 Strukturat e decentralizuara të institucioneve dhe strukturave qendrore të mbrojtjes civile 42
5.6.3 Detyrat e Policisë së Shtetit (PSH) në nivel vendor 43
5.6.4 Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH së) në nivel bashkie 43
5.6.5 Shërbimet e Urgjencës Mjekësore (SHUM) dhe strukturat e tjera të kujdesit shëndetësor 44
5.6.6 Shërbimi Vullnetar i Mbrojtjes Civile në nivel vendor 44
5.7 Koordinimi me Prefektin AKMC dhe bashkitë fqinje 44
5.7.1 Kanalet e komunikimit 45
5.7.2 Raportimi 45
5.7.3 Parimi i subsidiaritetit dhe aktivizimi i kapaciteteve 45
5.7.4 Procedura për kërkesën dhe dhënien e mbështetjes 45
5.7.5 Bashkëpunimi me bashkitë fqinje 46
5.7.6 Koordinimi me Prefektin e Qarkut 46

Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MJEDISIT
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MBROJTJES

5.7.7 Koordinimi me AKMC-në 47
Kapitulli 6. Parandalimi dhe lehtësimi 47
6.1 Masat prioritare parandaluese strukturore dhe jostrukturore 48
6.2 Strukturat dhe institucionet, rolet dhe përgjegjësitë e tyre për parandalimin/lehtësimin - bashkia Durrës 51
Kapitulli 7. Gatishmëria 65
7.1 Informimi dhe ndërgjegjësimi publik 66
7.1.1 Komunikimi ndërinstitucional 66
7.1.2 Fushata ndërgjegjësuese 66
7.1.3 Komunikimi me publikun gjatë një emergjence 67
7.2 Monitorimi dhe paralajmërimi i hershëm 68
7.2.1 Monitorimi 68
7.2.2 Paralajmërimi (njoftimi) i hershëm 70
7.3 Trajnimet dhe ushtrimet 73
7.4 Gatishmëria e njësive administrative dhe komuniteteve 75
7.4.1 Gatishmëria e njësive administrative 75
7.4.2 Gatishmëria e komuniteteve 76
7.5 Strukturat dhe institucionet, rolet dhe përgjegjësitë e tyre për gatishmërinë –bashkia Durrës .. 76
Monitorimi dhe Administrimi i Burimeve 81
Kapitulli 8. Përgjigjja dhe funksionet operacionale 90
8.1 Qëllimet kryesore të përgjigjes 90
8.2 Marrja dhe verifikimi i informacionit 92
8.3 Aktivitetet e bashkisë në fazën e përgjigjes 93
8.3.1 Etapa I. Alarmi për rritjen e gatishmërisë 93
8.3.2 Etapa II Vendosja e gjendjes së gatishmërisë 93
8.3.3 Etapa III Aktivizimi 94
8.3.4 Etapa IV. Dalja nga situata 95
8.4 Strukturat dhe institucionet, përgjegjësitë e tyre për përgjigjen – bashkia Durrës 96
8.5 Funksionet operacionale 114
8.5.1 Drejtimi dhe koordinimi 114
8.5.3 Vlerësimi i shpejtë dhe tabloja e situatës 115
8.5.4 Kërkim shpëtimi 116
8.5.5 Rendi dhe siguria publike 116
8.5.6 Shëndetësia publike dhe ndihma mjekësore 117
8.5.7 Menaxhimi i trafikut dhe aksesit 117
8.5.8 Mbrojtja e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore 118
8.5.9 Menaxhimi i viktimave në masë dhe personave të humbur 119
Kapitulli 9. Evakuimi, pikat e grumbullimit (qendrat e pritjes) dhe strehimi 120

9.1 9.1 Vendimmarrja për evakuim, organizimi, koordinimi dhe procedurat e zbatimit....120
9.2 Rrugët dhe transporti....122
9.3 Pikat e grumbullimit (qendrat e pritjes)....123
9.4 Qendrat e strehimit....126
9.5 Evakuimi i asistuar....128
9.6 Regjistrimi dhe bashkimi familjar....129
9.7 Zonat prioritare për evakuim, pikat e grumbullimit dhe strehimet e propozuara....130
Kapitulli 10. Menaxhimi i burimeve dhe logjistika....131
10.1 Inventari i kapaciteteve....132
10.2 Mobilizimi dhe dislokimi....132
10.3 Furnizimi dhe mbështetja....134
10.4 Burimet private vullnetarët dhe marrëveshjet....135
10.5 Kërkesa për mbështetje....135
Kapitulli 11. Rimëkëmbja dhe rindërtimi më i sigurt....135
11.1 Parimet udhëzuese të rimëkëmbjes....136
11.2 Masat e rimëkëmbjes sipas periudhave kohore....136
11.2.1 Masat afatshkurtra (ditët e para pas fatkeqësisë)....136
11.2.2 Masat afatmesme (javët dhe muajt pas fatkeqësisë)....136
11.2.3 Masat afatgjata (muajt dhe vitet pas fatkeqësisë)....137
11.3 Zbatimi i masave të rimëkëmbjes....138
11.4 Monitorimi dhe koordinimi i masave të rimëkëmbjes....141
11.5 Financimi i sistemit të mbrojtjes civile në nivel bashkie....159
Kapitulli 12. Skenarët operacionalë....159
12.1 Skenari A: Përmbytja e lumit Erzen në Sukth dhe Katund i Ri....159
12.1.1 Analiza e kontekstit dhe e skenarit të riskut....159
12.1.2 Ndikimet e një përmbytjeje në territorin e Bashkisë Durrës....160
12.1.3 Nevojat humanitare të popullsisë së prekur....160
12.1.4 Funksionet operacionale për menaxhimin e emergjencës....161
12.1.5 Institucionet, strukturat dhe organizatat e përfshira në përgjigje....161
12.1.6 Kronologjia e veprimeve....162
12.2 Skenari B: Tërmet i fortë në qytetin e Durrësit....162
12.3 Skenari C: Aksident teknologjik në Porto Romano....163
Kapitulli 13. Referencat dhe anekset....163
Anekset operative....164
Aneks 1: Zonë e mbuluar për strehimin e popullsisë....165
Aneks 2: Zonë e hapur për strehimin e popullsisë....166
Aneks 3: Raportimi fillestar i emergjencës....167

Implemented by giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MJEDISIT
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MBROJTJES

Aneks 4: Formulari standard i kërkesës për mbështetje....170
I. TË DHËNAT E KËRKESËS....170
II. INSTITUCIONI KËRKUES....170
III. DREJTUAR....170
IV. PËRSHKRIMI I SITUATËS....170
V. VLERËSIMI I PASOJAVE DHE I NEVOJËS....170
VII. BOSHLLËKU I KAPACITETEVE....170
VIII. MBËSHTETJA E KËRKUAR....171
IX. AFATI DHE PRIORITETI....171
X. VENDI I MBËRRITJES DHE KOORDINIMIT....171
XI. DËRGIMI DHE REGJISTRIMI I KËRKESËS....171
Aneks 5: Model shkrese për kërkesë për mbështetje....172
Aneks 6: Skema e njoftimit dhe e lajmërimit në rast fatkeqësie....174
Aneks 7: Tabelat e kapaciteteve njerëzore dhe logjistike....177
Aneks 8: Pikat e grumbullimit dhe strehimet e propozuara....186
Aneks 9: Hartat operative....189

Hyrje

Plani Vendor për Emergjencat Civile përcakton organizimin, përgjegjësitë, masat e aktivitetet për parandalimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë sikurse kapacitetet, angazhimin dhe veprimin e organizuar në emergjenca për mbrojtjen e jetës së njerëzve, gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit.

Plani Vendor për Emergjencat Civile është dokumenti kryesor i bashkisë për menaxhimin e emergjencave civile dhe fatkeqësive në territorin administrativ të saj.

Plani është hartuar në kuadër të programit ALBAdapt – Programme for Climate Resilient Urban Development in Albania, i financuar nga GIZ. Procesi i hartimit të planit vendor të emergjencave civile u udhëhoq nga ekspertët e Co-Plan.

Ai mbështetet në kuadrin ligjor dhe strategjik kombëtar, strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, kapacitetet e mbrojtjes civile, gjetjet e reja të ekspertëve, si edhe në përvojat e fituara në menaxhimin e fatkeqësive.

Plani Vendor për Emergjencat civile merr në konsideratë trajtimin me prioritet të fëmijëve, të të moshuarve, të personave me aftësi të kufizuara, të shtresave në nevojë dhe grave.

Përveç bashkisë, në procesin e përgatitjes së planit u përfshinë edhe të gjithë aktorët e tjerë shtetëror dhe jo shtetëror në nivelin e bashkisë dhe të qarkut, në veçanti institucioni i Prefektit të qarkut Durrës dhe degët territoriale në qark. Për përgatitjen e planit u shfrytëzuan të gjitha dokumentet ekzistuese dhe përvojat e ekspertëve dhe grupeve të tjera të interesit.

Plani përfshin strukturat organizative dhe institucionale, përgjegjësitë, organizimin dhe bashkërendimin e nevojshëm për parandalimin dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë rritjen e gatishëmrisë, përgjigjen efektive dhe rimëkëmbjen ndaj emergjencave nën juridiksionin e bashkisë. Kontaktet, inventarët dhe procedurat përfshihen në anekset operative.

Kapitulli 1. Qëllimi, synimet, fusha e zbatimit dhe objektivat

1.1 Qëllimi i planit

Plani Vendor për Emergjencat Civile (PVEC) ka si qëllim kryesor të sigurojë organizimin në kohë dhe në mënyrë efektive të veprimtarive të bashkërenduara të autoriteteve shtetërore, strukturave të qeverisjes vendore, subjekteve private dhe organizatave jofitimprurëse që veprojnë në territorin e bashkisë, për parandalimin dhe zvogëlimin e riskut, gatishmërinë, përballimin dhe rimëkëmbjen nga emergjencat dhe fatkeqësitë, me synim mbrojtjen e jetës, të gjësë së gjallë, të pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, si dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve publike dhe funksioneve thelbësore në territorin e bashkisë.

1.2 Synimet:

Plani Vendor për Emergjencat Civile synon të:

1. Ndihmojë në parandalimin, përgatitjen, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga emergjencat dhe/ose fatkeqësitë që mund të prekin jetën dhe shëndetin e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, infrastrukturën, trashëgiminë kulturore, komunitetet dhe mjedisin në territorin e bashkisë.

2. Sigurojë kushtet për bashkinë, njësitë administrative, institucionet, subjektet ekonomike dhe popullsinë, për të kaluar nga kushtet normale të jetesës dhe punës në një situatë emergjente, me humbje minimale.

3. Mundësojë mobilizimin dhe koordinimin e burimeve vendore, njerëzore, materiale, teknike dhe financiare, me qëllim garantimin e sigurisë së popullsisë, mbrojtjen e pronës dhe infrastrukturës, si dhe vazhdimësinë e shërbimeve publike dhe të veprimtarisë ekonomike në territorin e bashkisë.

1.3 Fusha territoriale dhe institucionale

Plani Vendor për Emergjencat Civile shtrihet në të gjithë territorin administrativ të bashkisë dhe përfshin të gjitha strukturat, institucionet dhe subjektet që kanë përgjegjësi, kapacitete ose rol në parandalimin dhe menaxhimin e emergjencave civile.

Plani zbatohet për të gjitha llojet e emergjencave civile që mund të prekin territorin e bashkisë, duke marrë në konsideratë risqet e identifikuara, ekspozimin, cenueshmërinë dhe kapacitetet ekzistuese të territorit dhe komunitetit.

Fusha e zbatimit të Planit mbulon të gjitha fazat e menaxhimit të emergjencave civile, duke përfshirë parandalimin dhe zvogëlimin e riskut, gatishmërinë, përgjigjen ndaj emergjencës, si dhe rimëkëmbjen.

Lista e plotë e njësive administrative, strukturave bashkiake, institucioneve, operatorëve kritikë, subjekteve mbështetëse dhe partnerëve me të dhënat e kontaktit të tyre, paraqitet në anekset përkatëse të Planit dhe përditësohet periodikisht.

1.4 Objektivat e përgjithshme dhe specifike

Objektivi i përgjithshëm:

Mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve, e gjësë së gjallë, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit në territorin e Bashkisë Durrës, nëpërmjet parandalimit dhe zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë, rritjes së kapaciteteve dhe forcimit të gatishmërisë, sigurimit të një përgjigjeje të koordinuar dhe efektive ndaj emergjencave civile dhe fatkeqësive, si dhe garantimit të rimëkëmbjes së shpejtë dhe të qëndrueshme.

Objektiva specifike:

- Parandalimi dhe zvogëlimi i riskut të fatkeqësive, nëpërmjet përcaktimit dhe zbatimit të masave për zvogëlimin e ekspozimit dhe të cenueshmërisë së popullsisë, pronës, infrastrukturës dhe mjedisit.
- Rritja e gatishmërisë dhe përgatitjes së strukturave vendore**,** për menaxhimin e emergjencave civile dhe fatkeqësive.
- Përmirësimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm, me qëllim identifikimin dhe transmetimin në kohë të paralajmërimeve për risqet, për marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e popullsisë.
- Forcimi i komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit, duke siguruar informacion të saktë, në kohë dhe të koordinuar ndërmjet strukturave përgjegjëse, aktorëve të përfshirë dhe komunitetit, para, gjatë dhe pas emergjencave civile.
- Rritja e ndërgjegjësimit, edukimit dhe përgatitjes së komunitetit për gatishmërinë ndaj emergjencave dhe për veprimet që duhen ndërmarrë sipas llojeve të ndryshme të emergjencave përmes programeve dhe fushatave informuese.
- Mbrojtja e popullsisë dhe e grupeve më të cenueshme, përmes planifikimit dhe zbatimit të masave për evakuimin, shpëtimin, strehimin dhe asistencën e tyre.
- Minimizimi i humbjeve dhe dëmeve, ndaj jetës dhe shëndetit të njerëzve, gjësë së gjallë, pronës, infrastrukturës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit.
- Forcimi i koordinimit dhe përdorimi efektiv i burimeve, duke siguruar bashkëpunimin ndërmjet strukturave vendore, institucioneve dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në menaxhimin e emergjencave.
- Sigurimi i vazhdimësisë së shërbimeve dhe funksioneve thelbësore, gjatë dhe pas emergjencave civile, si dhe rikthimi sa më i shpejtë i tyre në rast ndërprerje.
- Sigurimi i një procesi të koordinuar të rimëkëmbjes, përmes vlerësimit të dëmeve dhe nevojave dhe zbatimit të masave prioritare për rikthimin e normalitetit.

1.5 Supozimet dhe kufizimet e planifikimit

Për të siguruar vlefshmërinë e planit, supozimet e planifikimit duhet të kenë një pritshmëri të arsyeshme për të qenë të sakta. Mbi këtë parim, ky dokument përcakton kornizën operacionale dhe kufizimet strukturore për territorin e Bashkisë Durrës.

1.5.1 Supozimet e planifikimit

Për qëllime të planifikimit, strukturat e mbrojtjes civile të Bashkisë Durrës mbështeten në supozimet bazë të mëposhtme:

Gatishmëria e burimeve njerëzore: Supozohet se në momentin e ndodhjes së emergjencës, personeli i MZSH-së Durrës, Policisë Bashkiake, Ndërmarrjes "Rruga", Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale dhe strukturave të tjera mbështetëse do të jenë në gatishmëri të plotë operacionale.

Kapaciteti Profesional: Supozohet se i gjithë personeli i angazhuar në strukturat e emergjencave zotëron njohuritë e nevojshme teknike dhe operacionale për të ndërhyrë sipas rolit në terren, përfshirë menaxhimin e situatave komplekse.

Përballimi i ngjarjes kryesore: Supozohet se planifikimi fillestar bazohet në menaxhimin e një fatkeqësie kryesore të vetme në territor (p.sh. një tërmet madhor apo një përmbytje në shkallë të gjerë), duke lejuar përqendrimin e resurseve në vatrën kryesore, pa përjashtuar risqet sekondare (si p.sh. zjarret pas tërmetit ose dëmtimet e rrjetit të infrastrukturës).

Mbështetja ndërinstitucionale: Supozohet se kur përmasa ose kohëzgjatja e emergjencës tejkalojnë kapacitetet e Bashkisë Durrës, Prefekti i Qarkut Durrës dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) do të aktivizojnë mekanizmat e mbështetjes kombëtare dhe asetet e Forcave të Armatosura brenda afateve standarde.

Qëndrueshmëria e koordinimit: Supozohet se strukturat kryesore drejtuese të menaxhimit të emergjencës të bashkisë, strukturat administrative dhe QOECB do të mbeten funksionale dhe të mbrojtura ose do të zhvendosen në një vend të të sigurt për të garantuar menaxhimin e emergjencës.

1.5.2 Kufizimet e planifikimit

Zbatimi i këtij Plani në terren kushtëzohet nga kufizimet strukturore, administrative dhe gjeografike të mëposhtme, të cilat reflektojnë problematikat specifike të territorit të Durrësit:

Kufizimet e aksesit dhe dendësisë urbane: Dendësia e lartë e ndërtimeve e shoqëruar me rrugë të ngushta apo të bllokuara nga mjetet e parkuara, kufizon dhe vështirëson lëvizjen e shpejtë të mjeteve të rënda zjarrfikëse dhe autoambulancave në rast evakuimi në masë.

Kufizimet e burimeve vendore për kërkim-shpëtim: Pavarësisht gatishmërisë, kapacitetet e MZSH Durrës janë të limituara në numër personeli dhe pajisjesh speciale për kërkim-shpëtim nën rrënoja duke e bërë të domosdoshme mbështetjen e menjëhershme nga niveli qendror në rast të një tërmeti të fortë.

Kufizimet e infrastrukturës dhe drenazhimit: Rrjeti ekzistues i kanalizimeve dhe stacionet e pompimit (hidrovorët) kanë kapacitet të kufizuar për të përballuar prurjet e menjëhershme nga reshjet intensive gjë që shkakton përmbytje të shpejta urbane dhe bllokim të akseve kryesore hyrëse/dalëse të qytetit.

Kufizimet e partneritetit me sektorin privat. Mungesa e marrëveshjeve të formalizuara paraprakisht me operatorët që zotërojnë mjete logjistike për përdorimin e menjëhershëm të aseteve të tyre në raste emergjencash komplekse.

Kapacitetet materiale dhe logjistike: Mungesa e mjeteve motorike dhe e pajisjeve të nevojshme për verifikime në terren dhe ndërhyrje emergjente kufizon gatishmërinë dhe reagimin ndaj fatkeqësive natyrore.

Kufizimet financiare: Orientimi i financimit kryesisht drejt kompensimit pas fatkeqësive kufizon mundësitë për investime të qëndrueshme në parandalim, përgatitje dhe zvogëlim të riskut.

Menaxhimi i të dhënave dhe përdorimi i GIS: Përdorimi i kufizuar i sistemeve GIS vështirësojnë analizën hapësinore të riskut, identifikimin e zonave vulnerabël dhe planifikimin e masave parandaluese.

Kufizimet sezonale: Rritja e fluksit të turistëve gjatë sezonit veror shton ndjeshëm ngarkesën mbi shërbimet e emergjencës civile dhe vështirëson menaxhimin e situatave emergjente.

Kapitulli 2. Kuadri ligjor strategjik dhe parimet

Ky kapitull paraqet kuadrin ligjor dhe strategjik që rregullon përgjegjësitë, detyrimet dhe procedurat konkrete të Bashkisë Durrës në fushën e mbrojtjes civile dhe menaxhimit të emergjencave.

2.1 Kuadri kombëtar ligjor dhe strategjik

2.1.1 Kuadri ligjor

Hartimi i Planit Vendor për Emergjencat Civile i bashkisë Durrës mbështetet në kuadrin ligjor, dhe strategjik në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në fushën e mbrojtjes civile dhe të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë.
Kuadri kryesor ligjor për mbrojtjen civile përcaktohet nga ligji nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile". Ky ligj synon zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe garantimin e mbrojtjes së jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të një sistemi të integruar dhe efikas të mbrojtjes civile.
Ligji përcakton organizimin dhe funksionimin e sistemit të mbrojtjes civile, si dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe strukturave të këtij sistemi. Gjithashtu, ai rregullon bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe subjekteve private, si dhe çështjet që lidhen me edukimin, trajnimin dhe inspektimin në fushën e mbrojtjes civile.

Në këtë kuadër, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) është institucioni qendror që përgjigjet për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në të gjithë territorin e vendit.

Në nivel vendor, sipas parashikimeve të **ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile"**, bashkitë janë përgjegjëse për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në territorin e tyre.
Hartimi i planit vendor për emergjencat civile është një ndër detyrimet ligjore për bashkitë.
Në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "Për mbrojtjen civile" parashikohet: "*Planet për emergjencat civile miratohen në nivel qendror, në nivel qarku dhe në nivel vendor dhe rishikohen jo më pak se një herë në çdo tre vjet".*
Gjithashtu sipas shkronjës "ç" të nenit 30 të ligjit parashikohet: *Bashkitë hartojnë, miratojnë dhe përditësojnë planin vendor për emergjencat civile dhe ia dërgojnë AKMC-së dhe prefektit të qarkut, për qëllime analizimi dhe planifikimi;*

Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", bashkitë ushtrojnë përgjegjësi në fusha të ndryshme që lidhen me menaxhimin e riskut dhe ofrimin e shërbimeve publike, përfshirë infrastrukturën, mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë publike.
Sipas nenit 29 të këtij ligji, bashkitë janë përgjegjëse për funksionet në fushën e sigurisë publike, duke përfshirë:

- mbrojtjen civile në nivel vendor dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- organizimin dhe funksionimin e shërbimit zjarrfikës.

Këto funksione lidhen drejtpërdrejt me organizimin e kapaciteteve vendore për parandalimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen ndaj emergjencave civile dhe përbëjnë një komponent të rëndësishëm të zbatimit të Planit Vendor për Emergjencat Civile.

2.1.2 Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SKZRF) 2023-2030

Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë është miratuar me VKM nr. 94, datë 22.02.2023 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023–2030 dhe Planit të Veprimit"

Strategjia është dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë që përcakton politikat e aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë
Strategjia promovon një qasje të integruar dhe shumësektoriale, e cila përfshin të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të fatkeqësive: **parandalimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen** nga gjashtë risqe kryesore: tërmetet, përmbytjet, rrëshqitjet e dheut, zjarret, aksidentet teknologjike dhe sëmundjet infektive. SKZRF përcakton në detaje rolet institucionale, kuadrin ligjor, vlerësimet e riskut, përfshirjen e komunitetit, shpërndarjen e burimeve dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

2.1.3 Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror (VRFNQ)

Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror (VRFNQ) miratuar me VKM Nr. 168, datë 24.03.2023 "Për miratimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror" paraqet një analizë të risqeve kryesore që kërcënojnë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe shërben si bazë për orientimin e masave të zvogëlimit të riskut dhe të planifikimit të mbrojtjes civile.

Vlerësimi i riskut përfshin gjashtë vlerësime specifike risku, duke përdorur një metodologji vlerësimi për të renditur nivelet relative të riskut për dymbëdhjetë qarqet për tetë kategori risku (tërmete, përmbytje, rrëshqitje dheu, zjarre masive, aksidente teknologjike, risqe biologjike, çarje digash dhe ortekë).

Sipas analizave të kryera në kuadër të VRFNQ, ndër kërcënimet me rëndësi të veçantë në nivel kombëtar identifikohen çarjet e digave, aksidentet teknologjike, përmbytjet dhe risqet biologjike. Në vlerësimin e përgjithshëm territorial, qarqet Tiranë, Vlorë dhe Shkodër janë evidentuar ndër zonat me nivel më të lartë risku. Kurse qarku i Durrësit rezulton me nivelin më të lartë risku për tërmetet, përmbytjet dhe fatkeqësitë teknologjike**.**

2.1.4 Plani Kombëtar për Emergjencat Civile

Plani Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC), i miratuar me VKM nr. 807, datë 28.12.2023, përcakton kuadrin e përgjithshëm për organizimin dhe menaxhimin e emergjencave civile dhe fatkeqësive në Republikën e Shqipërisë.

PKEC bazohet në një qasje të integruar dhe shumëinstitucionale dhe përcakton rolet, përgjegjësitë dhe marrëdhëniet e koordinimit ndërmjet institucioneve dhe strukturave qendrore dhe vendore.

Ndër elementet kryesore të PKEC përfshihen:

- përcaktimi i parimeve dhe mekanizmave të menaxhimit të emergjencave civile;
- përcaktimi i roleve dhe përgjegjësive të institucioneve përgjegjëse në fazat e parandalimit, gatishmërisë, përgjigjes dhe rimëkëmbjes;
- përcaktimi i procedurave për aktivizimin dhe shkallëzimin e përgjigjes ndaj emergjencave civile;
- përcaktimi i mekanizmave të komunikimit, koordinimit dhe shkëmbimit të informacionit;
- përcaktimi i mekanizmave për mobilizimin dhe koordinimin e burimeve duke përfshirë dhe asistencën ndërkombëtare, kur kapacitetet kombëtare nuk janë të mjaftueshme.

Në këtë sistem, AKMC luan një rol qendror në koordinimin e veprimeve të strukturave të mbrojtjes civile në nivel kombëtar, ndërsa njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë përgjegjësi të drejtpërdrejta për parandalimin, gatishmërinë dhe përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë në territorin e tyre.

PKEC përbën një dokument themelor referues për hartimin, zbatimin dhe përditësimin e **Planit Vendor për Emergjencat Civile të Bashkisë Durrës**, duke siguruar që organizimi vendor, procedurat e aktivizimit, strukturat e përgjigjes, mekanizmat e koordinimit dhe përdorimi i burimeve të jenë në përputhje me sistemin kombëtar të mbrojtjes civile.

Tabela e mëposhtme paraqet aktet kryesore ligjore dhe nënligjore në fushën e mbrojtjes civile që lidhen me menaxhimin e emergjencave civile, duke evidentuar rolin e tyre në planifikimin, parandalimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë.

Aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen Civile"	
VKM nr. 807, datë 28.12.2023, "Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile".	Përcakton kuadrin e përgjithshëm për organizimin dhe menaxhimin e emergjencave civile dhe fatkeqësive në Republikën e Shqipërisë.
VKM Nr. 533, datë 08.07.2020 Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore.	Strukturon procesin e vendimmarrjes dhe rolet institucionale gjatë emergjencave. Mundëson aktivizimin e mekanizmave të reagimit në nivel kombëtar dhe vendor. Mbështet analizën e kapaciteteve të reagimit dhe koordinimit institucional.
VKM nr. 53, datë 1.2.2023 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të akordimit të fondeve për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si edhe në veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile."	Rregullon kriteret dhe procedurat për akordimin e fondeve për masat parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, për infrastrukturën e dëmtuar dhe veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile**.**
Akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, i Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore". (miratuar me ligjin nr. 97/2019)	Akti rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe territoreve të prekura nga fatkeqësitë, si dhe zhvillimin e territoreve të reja. Përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve, programet dhe proceset e rindërtimit, funksionimin e Fondit të Rindërtimit dhe procedurat përkatëse.
VKM nr. 94, datë 22.02.2023 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 dhe Planit të Veprimit"	Përcakton objektivat strategjikë dhe prioritetet kombëtare për menaxhimin e riskut. Orienton politikat vendore dhe integrimin e riskut në zhvillim. Shërben si referencë për harmonizimin e analizës me kuadrin strategjik kombëtar.
VKM Nr. 159, datë 11.03.2021 Për përcaktimin e strukturës, organizimit dhe funksionimit të Sistemit Kombëtar të Monitorimit, Paralajmërimit të Hershëm dhe Alarmit.	Rregullon rrjedhën e informacionit dhe mekanizmat e njoftimit në kohë reale. Mbështet analizën e sistemeve të paralajmërimit dhe kapaciteteve për reduktimin e riskut. Kontribuon në vlerësimin e gatishmërisë institucionale dhe teknologjike.
VKM Nr. 414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile"	Rregullon shpërndarjen e burimeve financiare për parandalim, përgatitje dhe reagim. Mbështet analizën e kapaciteteve financiare dhe mekanizmave të financimit. Evidenton rolin e buxhetimit në zvogëlimin e Riskut.
VKM Nr. 808, datë 28.12.2023 "Për miratimin e rregullave për përdorimin e fondeve për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë".	Përcakton mekanizmat për rikuperimin dhe rindërtimin pas ngjarjeve. Mbështet analizën e fazës së rimëkëmbjes dhe qëndrueshmërisë afatgjatë. Lidhet me vlerësimin e kapaciteteve për rikuperim dhe rindërtim rezilient.
VKM nr. 290, datë 17.5.2023 "Për një ndryshim në VKM nr.414, datë .7.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile".	Përcakton procedura dhe kritere të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.
VKM nr. 775, datë 15.12.2021	Rregullon sinjalizimin dhe alarmimin e popullsisë në rastet e fatkeqësive. Ai përcakton llojet e sinjaleve të

"Për miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre në rastet e fatkeqësive."	alarmit, numrin e tyre dhe mënyrën e përdorimit të këtyre sinjaleve, në rastet e fatkeqësive.
VKM nr. 667, datë 10.11.2021 "Për trajtimin e vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit e të përballimit të fatkeqësive."	Ky vendim rregullon mënyrën e trajtimit të vullnetarëve që angazhohen në veprimtari të mbrojtjes civile ose në operacione për parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive.
VKM nr. 431, datë 15.07.2021, "Për përbërjen dhe detyrat e njësive organizative që kanë në kompetencë të tyre çështjet e mbrojtjes civile në ministritë e linjës"	Rregullon përbërjen, organizimin dhe detyrat e njësive organizative përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes civile në ministritë e linjës, si dhe përgjegjësitë e tyre për planifikimin, koordinimin dhe zbatimin e masave të mbrojtjes civile
VKM nr. 345, datë 26.05.2022, "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë."	Rregullon mënyrën e mbledhjes, regjistrimit, përpunimit dhe administrimit të të dhënave për humbjet e shkaktuara nga fatkeqësitë.
VKM Nr. 1162, datë 24.12.2020 procedurat për pajisjen me "Vërtetim Risku	Kërkon integrimin e analizës së riskut në lejet e ndërtimit dhe zhvillimit. Mbështet kontrollin e zhvillimit në zona me rrezik të lartë. Lidh drejtpërdrejt planifikimin territorial me menaxhimin e riskut.

Në tërësi, kuadri ligjor dhe strategjik i paraqitur në këtë kapitull përcakton bazën dhe referencën kryesore për hartimin e Planit Vendor për Emergjencat Civile të Bashkisë Durrës. Ligji për mbrojtjen civile, aktet nënligjore në zbatim të tij, dokumentet kombëtare strategjike, në vecanti Plani Kombëtar për Emergjencat Civile përbëjnë bazën mbi të cilat është mbështetur procesi i hartimit të Planit dhe përcaktimi i strukturës, përgjegjësive, masave dhe **mekanizmave për menaxhimin e emergjencave civile në nivel vendor.**

2.2 Kuadri vendor

Kuadri strategjik vendor për zvogëlimin e riskut dhe menaxhimin e emergjencave mbështetet në dokumentet kryesore të planifikimit dhe menaxhimit të riskut në nivel bashkie, vecanërisht në Strategjinë Vendore të Zvogëlimit të Riskut nga fatkeqësitë, në dokumentin e Vlerësimit të Riskut dhe Planin Vendor për Emergjencat Civile. Këto dokumente krijojnë lidhjen ndërmjet identifikimit dhe vlerësimit të risqeve, përcaktimit të prioriteteve për zvogëlimin e tyre dhe planifikimit të masave për përballimin e emergjencave.

2.2.1 Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë - bashkia Durrës

Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në nivel vendor (VRFNV) përbën bazën analitike për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në territor, duke marrë në konsideratë rreziqet, ekspozimin, cenueshmërinë dhe kapacitetet ekzistuese.

Sipas Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë (VRF, nëntor 2026), i cili analizon 19 skenarë për shtatë rreziqe, bashkia Durrës karakterizohet nga një profil kompleks dhe i ndërthurur risku, i ndikuar nga pozicioni bregdetar, relievi i ulët, dendësia urbane, zhvillimi i territorit, prania e portit dhe zonave industriale. Në këtë kuadër, vlerësimi i risqeve evidenton këto nivele kryesore:

Përmbytjet kanë prioritetin I dhe indeksin territorial më të lartë (IR 6.2). Skenarët PM-1 (përmbytje e përsëritur) dhe PM-2 (përmbytje e madhe e Erzenit dhe e Ishmit) kanë nivel të lartë; risku është i lartë në Katundin e Ri, Sukth, Durrës dhe Ishëm.

Tërmetet kanë prioritetin I (IR 6.1). Skenari SZ-2, një tërmet si ai i 26 nëntorit 2019, ka nivel të lartë; indeksi është më i lartë në NjA Durrës (6.6) dhe në Sukth (6.1).

Zjarret dhe rreziku gjeologjik kanë prioritetin II. Zjarret janë në klasë të lartë në Ishëm dhe Manëz, ndërsa rreziku gjeologjik vetëm në NjA Durrës (kodrat e Currilave dhe të Vollgës).

Rreziku teknologjik ka prioritetin II dhe klasë të lartë në NjA Durrës. Skenarët TK-1 (depozitat e Porto Romanos) dhe TK-3 (derdhje nafte në zonën portuale) kanë nivel të lartë.

Rreziku biologjik ka prioritetin II: epidemia respiratore e rëndë (BI-2) është i vetmi skenar me nivel ekstrem, ndërsa sezoni i rëndë i virusit West Nile (BI-4) ka nivel të lartë. Moti ekstrem ka prioritetin III, me përjashtim të valëve të nxehta (ME-2), që kanë nivel të lartë. Asnjë NjA nuk është në klasën "shumë i lartë".

Ekspozimi dhe cenueshmëria lidhen me popullsinë, fondin ndërtimor, infrastrukturën, shërbimet kritike, aktivitetin ekonomik dhe turistik dhe trashëgiminë kulturore. Në mënyrë të veçantë, kërkojnë vëmendje grupet vulnerabël, si të moshuarit, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, familjet në nevojë, komunitetet rome dhe egjiptiane, banorët e zonave informale dhe popullsia sezonale turistike. Ndër zonat më të cenueshme evidentohen **Ishëmi, qyteti i Durrësit, Sukthi dhe Katundi i Ri**.

Vlerësimi evidenton gjithashtu disa boshllëqe në kapacitetet institucionale dhe operacionale, veçanërisht në pajisjet e reagimit, komunikimin dhe menaxhimin e informacionit, paralajmërimin e hershëm, vullnetarizmin dhe financimin e masave parandaluese.

Gjetjet e Vlerësimit të Riskut në nivel bashkie përbëjnë bazën për përcaktimin e prioriteteve, skenarëve, kapaciteteve dhe masave të parashikuara në Planin Vendor për Emergjencat Civile.

2.2.2 Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut (SVZR)

Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë përbën bazën orientuese të Planit Vendor për Emergjencat Civile, pasi përcakton prioritetet, drejtimet e ndërhyrjes dhe masat për zvogëlimin e riskut, forcimin e gatishmërisë dhe rritjen e kapaciteteve të përgjigjes dhe rimëkëmbjes.

Strategjia **Vendore për Zvogëlimin e Riskut** e bashkisë Durrës synon kalimin nga një qasje reaguese ndaj fatkeqësive drejt një qasjeje të integruar të **parandalimit, zvogëlimit të riskut, gatishmërisë, përshtatjes klimatike dhe rimëkëmbjes**. Ajo synon të integrojë menaxhimin e riskut në planifikimin, programimin buxhetor dhe investimet e Bashkisë, duke u mbështetur në informacionin territorial dhe në identifikimin e zonave, infrastrukturës dhe komuniteteve më të ekspozuara.

Prioritetet strategjike përqendrohen në **forcimin e qeverisjes dhe informacionit për riskun, zhvillimin e infrastrukturës të qëndrueshme, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, menaxhimin e riskut teknologjik dhe mbrojtjen e grupeve vulnerabël**. Vëmendje e veçantë i kushtohet riskut nga përmbytjet në zonat e ekspozuara, problematikave të erozionit dhe rrëshqitjeve, riskut sizmik dhe riskut teknologjik në Porto Romano.

Drejtimet strategjike të Strategjisë synojnë forcimin e kapaciteteve institucionale përmes funksionalizimit të strukturave të mbrojtjes civile, zhvillimit të një **GIS multi-risk**, përmirësimit të sistemeve të paralajmërimit të hershëm, trajnimit dhe ushtrimeve periodike, si dhe sigurimit të burimeve financiare të dedikuara për masat parandaluese. Paralelisht, investimet në kullim, hidrovore, argjinatura, stabilizimin e shpateve, mbrojtjen e bregdetit dhe përforcimin e infrastrukturës kritike synojnë të ulin ekspozimin dhe dëmet potenciale.

Një komponent i rëndësishëm i strategjisë është **përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike**, përmes drenazhimit të qëndrueshëm urban, gjelbërimit, dhe zgjidhjeve natyrore për mbrojtjen e bregdetit. Në Porto Romano, strategjia kërkon një qasje të posaçme ndaj riskut teknologjik, duke përfshirë inventarizimin

e instalimeve, protokollet e emergjencës, ushtrimet me operatorët dhe përgatitjen për skenarë të ndotjes detare dhe aksidenteve të transportit.

Në të gjitha drejtimet, strategjia vendos **mbrojtjen e popullsisë dhe veçanërisht të grupeve vulnerabël** në qendër të masave të parandalimit, alarmimit, evakuimit, strehimit dhe rimëkëmbjes. Në këtë mënyrë, ajo synon krijimin e një sistemi vendor më të koordinuar dhe më të qëndrueshëm, ku **zvogëlimi i riskut kërkohet të integrohet në vendimmarrjen publike dhe në investimet e zhvillimit**, duke ulur ekspozimin dhe duke rritur kapacitetin e Bashkisë dhe komuniteteve për t'u përballur me emergjencat dhe fatkeqësitë.

Strategjia ka tri objektiva strategjikë, 12 projekte strategjike (PS1.1–PS3.6) dhe 26 projekte operative (P01–P26). Masat e gatishmërisë së këtij plani zbatohen kryesisht përmes P03 (qendra operacionale dhe pajisjet), P04 (paralajmërimi i hershëm dhe komunikimi), P05 (plani i emergjencave dhe bashkëpunimi ndërbashkiak), P07 (evakuimi dhe strehimi), P08 (vullnetarët) dhe P22 (siguria teknologjike në Porto Romano). Kodet e masave në kapitullin 6 janë ato të VRF-së, ndërsa kostot dhe afatet jepen në Strategji. Zbatimin e të tri dokumenteve e koordinon Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile, nëpërmjet Sektorit të Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile.

2.3 Parimet e menaxhimit të emergjencave civile/fatkeqësive

Referuar Planit Kombëtar të Emergjencave Civile ekzistojnë tetë parime udhëzuese që përbëjnë bazën e menaxhimit në çdo emergjencë apo fatkeqësi. Këto parime zbatohen në mënyrë të njëjtë në çdo nivel (në nivel bashkie, qarku dhe qendror).
Parimet udhëzuese janë: **Parashikimi, Gatishmëria, Vendimmarrja, Udhëheqja, Informacioni, Integrimi, Bashkëpunimi dhe Vazhdimësia**.

2.3.1 Parashikimi

Parashikimi është thelbësor si në fazën e para emergjencës, po ashtu dhe pas emergjencës Parashikimi është procesi i identifikimit, analizimit dhe vlerësimit paraprak të risqeve dhe emergjencave të mundshme, me qëllim përgatitjen e strukturave vendore për një përgjigje efektive. Ai përfshin vlerësimin e vazhdueshëm të risqeve, planifikimin, trajnimin dhe ushtrimet, si dhe marrjen në konsideratë të ndikimeve të mundshme gjatë dhe pas emergjencës. Një rëndësi e veçantë i kushtohet planifikimit të rimëkëmbjes që në fazat e para të emergjencës, duke siguruar koordinimin ndërmjet përgjigjes dhe rimëkëmbjes. Në rast të kapaciteteve të kufizuara, përparësi i jepet mbrojtjes së jetës dhe trajtimit të rreziqeve fillestare, përpara intensifikimit të masave të rimëkëmbjes.

2.3.2 Gatishmëria

Në nivel vendor, përgatitja nënkupton sigurimin që strukturat, institucionet, organizatat dhe personat që kanë rol në mbrojtjen civile të jenë të gatshëm për përballimin e emergjencave. Për këtë qëllim, ato duhet të njohin Planin Vendor për Emergjencat Civile, rolet dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe mënyrën e bashkëpunimit dhe koordinimit me strukturat e tjera. Përgatitja mbështetet në vlerësimin e risqeve në territorin vendor dhe përfshin planifikimin, trajnimin, ushtrimet dhe sigurimin e burimeve të nevojshme, me qëllim rritjen e gatishmërisë dhe garantimin e një reagimi të koordinuar dhe efektiv ndaj emergjencave.

2.3.3 Vendimmarrja

Vendimmarrja është një aftësi themelore në menaxhimin e emergjencave, e cila ndikon drejtpërdrejt në efektivitetin dhe sigurinë e reagimit. Në nivel vendor, strukturat përgjegjëse duhet të sigurojnë që drejtuesit dhe personeli i angazhuar në menaxhimin e emergjencave të kenë njohuritë dhe përgatitjen e nevojshme për marrjen e vendimeve të shpejta, të sakta dhe të përshtatshme me situatën. Zhvillimi i kësaj aftësie kërkon trajnim, ushtrime dhe praktikë të vazhdueshme, si dhe vlerësim të saktë të situatës dhe të elementeve përbërëse të emergjencës. Vendimmarrja e informuar dhe e koordinuar mundëson një menaxhim më efektiv, të sigurt dhe të besueshëm të emergjencave në nivel vendor.

2.3.4 Udhëheqja

Udhëheqja në menaxhimin e emergjencave nënkupton drejtimin, koordinimin e strukturave përgjegjëse gjatë fazës së përgjigjes dhe rimëkëmbjes. Në nivel vendor, drejtuesit duhet të përcaktojnë synime dhe objektiva të qarta, të vendosin prioritetet dhe të sigurojnë koordinimin ndërmjet institucioneve, strukturave operacionale, organizatave vullnetare, sektorit privat dhe komunitetit. Vendimmarrja dhe udhëheqja duhet të përshtaten me natyrën dhe përmasat e emergjencës, edhe në kushtet kur informacioni është i kufizuar ose i pasigurt. Prioritetet kryesore janë shpëtimi dhe mbrojtja e jetës, lehtësimi i vuajtjeve, kufizimi i përhapjes dhe ndikimeve të emergjencës, mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë, ruajtja e mjedisit dhe pronës, vazhdimësia e shërbimeve kritike dhe lehtësimi i rimëkëmbjes së komunitetit. Udhëheqja efektive siguron një përgjigje të koordinuar, përdorim të përshtatshëm të burimeve dhe bashkëpunim ndërinstitucional, si dhe mundëson vlerësimin e veprimeve dhe nxjerrjen e mësimeve për përmirësimin e menaxhimit të emergjencave.

2.3.5 Informacioni

Informacioni është thelbësor për menaxhimin efektiv të emergjencave, si gjatë fazës së përgjigjes, ashtu edhe gjatë rimëkëmbjes. Në nivel vendor, duhet të sigurohet mbledhja, verifikimi, vlerësimi dhe shpërndarja në kohë e informacionit ndërmjet strukturave përgjegjëse, institucioneve, partnerëve dhe publikut. Informacioni duhet të jetë i saktë, i qartë, i besueshëm, i aksesueshëm dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave. Strukturat vendore duhet të përdorin procedura dhe modele të unifikuara për menaxhimin dhe raportimin e informacionit, duke mundësuar krijimin e një tabloje të përbashkët të situatës dhe mbështetjen e vendimmarrjes. Për këtë qëllim, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve, organizatave vullnetare, sektorit privat dhe komunitetit duhet të planifikohet, trajnohet dhe testohet përmes ushtrimeve. Një menaxhim i mirë i informacionit mundëson marrjen e vendimeve të informuara, komunikimin e qartë me publikun, rritjen e aftësisë ripërtëritëse të komunitetit dhe një rimëkëmbje më të shpejtë pas emergjencës.

2.3.6 Integrimi

Integrimi nënkupton bashkërendimin dhe përfshirjen e të gjitha strukturave, institucioneve dhe organizatave që kanë rol në përgatitjen, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga emergjencat/fatkeqësitë. Në nivel vendor, strukturat përgjegjëse duhet të funksionojnë në mënyrë të koordinuar dhe të ndërveprojnë si një sistem i përbashkët, duke përcaktuar qartë rolet, përgjegjësitë dhe mënyrën e marrjes së vendimeve. Integrimi kërkon planifikim të kujdesshëm, bashkëpunim ndërinstitucional, si dhe trajnime dhe ushtrime periodike, me qëllim garantimin e një përgjigje të unifikuar dhe efektive. Duke qenë se emergjencat mund të tejkalojnë kufijtë administrativë vendorë, planifikimi duhet të parashikojë edhe bashkëpunimin dhe koordinimin me strukturat e nivelit të qarkut dhe qendror, sipas natyrës dhe përmasave të emergjencës.

2.3.7 Bashkëpunimi

Bashkëpunimi është një element thelbësor i mbrojtjes civile, pasi menaxhimi i emergjencave kërkon angazhimin dhe bashkërendimin e disa institucioneve dhe organizatave. Në nivel vendor, strukturat përgjegjëse duhet të bashkëpunojnë në mënyrë të koordinuar, duke respektuar rolet, përgjegjësitë, funksionet dhe kapacitetet e njëra-tjetrës. Vendimmarrja duhet të jetë sa më gjithëpërfshirëse dhe, kur është e mundur, të mbështetet në dakordësi të përbashkët. Besimi reciprok, komunikimi i hapur, transparenca dhe shkëmbimi i përgjegjshëm i informacionit janë të rëndësishme për arritjen e objektivave të përbashkëta. Informacioni konfidencial duhet të mbrohet dhe çdo veprim duhet të jetë i koordinuar, me qëllim shmangien e veprimeve të njëanshme dhe garantimin e efektivitetit operacional.

2.3.8 Vazhdimësia

Vazhdimësia nënkupton aftësinë e strukturave dhe institucioneve vendore për të vijuar funksionet dhe shërbimet e tyre thelbësore edhe gjatë një emergjence dhe pas saj. Masat për përgjigjen dhe rimëkëmbjen duhet, sa më shumë të jetë e mundur, të mbështeten në strukturat, burimet, ekspertizën dhe mënyrat e

punës që përdoren në veprimtarinë e përditshme, pasi ato janë të njohura dhe të testuara nga personeli. Në varësi të përmasave të emergjencës, mund të kërkohet riorganizimi ose rialokimi i stafit dhe burimeve, si dhe mbështetja nga struktura të tjera. Planifikimi, trajnimi dhe ushtrimet duhet të sigurojnë që funksionet kritike dhe shërbimet thelbësore të mund të vazhdojnë ose të rikthehen sa më shpejt të jetë e mundur.

2.4 Kuadri Sendai Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm dhe përshtatja klimatike

Plani Vendor për Emergjencat Civile (PVEC) i bashkisë Durrës është në përputhje të plotë me Kuadrin Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (ZRF) (2015-2030).[1] Kuadri Sendai specifikon shtatë objektiva globale për t'u arritur deri në vitin 2030, të tillë si: i) ulje të vdekshmërive nga fatkeqësitë në shkallë globale; ii) ulje e numrit të njerëzve të prekur nga fatkeqësitë; iii) zvogëlim i dëmeve ekonomike nga fatkeqësitë në raport me GDP-në; iv) zvogëlimin e dëmtimeve në infrastrukturën kritike dhe garantimin e ofrimit të shërbimeve bazë (si ato parësore shëndetësore dhe arsimore) përfshirë zhvillimin e aftësisë ripërtëritëse së tyre ndaj fatkeqësive; v) zhvillimin e strategjive kombëtare dhe vendore për zvogëlimin e riskut; vi) rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për ZRF; vii) rritje e aksesit në sistemet e paralajmërimit të hershëm për fatkeqësitë.

Paralelisht me objektivat, Kuadri Sendai parashikon edhe katër fusha prioritare për veprim të adresimit të sfidave në kuadër të ZRF-së, identifikimin e riskut nga fatkeqësitë, zhvillimin e politikave të ZRF dhe të menaxhimit të riskut, rritjen e investimeve për ZRF dhe fuqizimin e gatishmërisë për të ofruar përgjigje efektive ndaj fatkeqësive bazuar në parimin "Rindërto Më Mirë" (ang. *"BBB – Build Back Better"*) për rimëkëmbjen, rehabilitimin e rindërtimin pas fatkeqësive.

Mbështetur në këto fusha prioritare, PVEC i bashkisë Durrës është një instrument që synon të adresojë rritjen e kapaciteteve vendore, rritjen e koordinimit institucional dhe ndër-institucional në nivel bashkie, qarku dhe institucioneve të tjera vendore, me qëllim zvogëlimin e dëmeve në infrastrukturë, uljen e numrit të individëve të prekur, rritjen e aftësisë ripërtëritëse ndaj fatkeqësive dhe fuqizimin e politikave të menaxhimit të riskut në nivel vendor.

Disa masa që duhen mbajtur parasysh në nivel bashkie për t'u përshtatur me Kuadrin Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (2015-2030), Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-ve) dhe ndryshimet klimatike janë:

Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë në nivel vendor: Kryerja e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel vendor sipas parashikimeve ligjore jo më pak se një herë në çdo tre vjet, për të identifikuar risqet që lidhen me fatkeqësitë natyrore dhe ndryshimet klimatike.

Angazhimi dhe edukimi i komunitetit: Përfshirja e komunitetit në planifikimin e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe edukimi i tyre rreth praktikave të qëndrueshme dhe përshtatjes klimatike.

Zhvillimi i qëndrueshëm i infrastrukturës: Promovimi dhe investimi në infrastrukturë me qëllim që t'i rezistojë ndikimeve klimatike.

Përshtatja e bazuar në ekosistem: Zbatimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë si ripyllëzimi, restaurimi i ligatinave dhe mbrojtja e habitateve natyrore për të rritur aftësinë ripërtëritëse ekologjike ndaj ndikimeve klimatike.

Integrimi i politikave: Sigurimi që politikat vendore të përputhen me objektivat e Kuadrit Sendai, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm OZHQ-të dhe strategjitë e përshtatjes klimatike.

Ngritja e kapaciteteve: Zhvillimi i kapaciteteve vendore duke trajnuar personelin, drejtues të komunitetit dhe organizata që veprojnë në territor për menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë dhe strategjitë e përshtatjes klimatike.

[1] I miratuar nga shtetet-anëtare të OKB në vitin 2015, në Konferencën Botërore të OKB-së mbi Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.

Sistemi i paralajmërimit të hershëm: Krijimi dhe mbajtja e sistemit të fuqishëm të paralajmërimit të hershëm për të paralajmëruar shpejt komunitetet për fatkeqësitë e afërta, duke u mundësuar atyre të marrin masa proaktive për të minimizuar dëmin.

Promovimi i jetesës së qëndrueshme: Mbështetja e iniciativave që përmirësojnë jetesën e banorëve përmes praktikave të qëndrueshme bujqësore, bizneseve miqësore me mjedisin, duke përafruar aktivitetet ekonomike me ruajtjen e mjedisit.

Partneriteti dhe bashkëpunimi: Nxitja e partneriteteve me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, sektorët privatë dhe shoqërinë civile për të siguruar mbështetje dhe burime për zbatimin e masave të përshtatjes në nivel vendor dhe nivel qarku.

Monitorimi dhe vlerësimi: Monitorimi dhe vlerësimi rregullisht i efektivitetit të masave të zbatuara, duke përshtatur politikat, strategjitë sipas nevojës për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm dhe përshtatje ndaj sfidave në zhvillim.

Masat e mësipërme janë të harmonizuara me kuadrin ligjor të mbrojtjes civile dhe me Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë**.**

Kapitulli 3. Profili i Bashkisë Durrës

3.1 Territori dhe njësitë administrative

Bashkia Durrës shtrihet në pjesën perëndimore të Republikës së Shqipërisë, përgjatë bregdetit të Detit Adriatik, dhe është pjesë e Qarkut Durrës. Territori i saj shtrihet nga Kepi i Rodonit në veriperëndim deri te Përroi i Agait, në zonën pas Shkëmbit të Kavajës, në jugperëndim. Bashkia ka një sipërfaqe prej rreth 342 km² dhe një lartësi mesatare prej rreth 2-6 m mbi nivelin e detit.

Në aspektin territorial, Bashkia Durrës kufizohet në veri me Bashkinë Kurbin; në lindje me Bashkitë Krujë, Vorë dhe Shijak; ndërsa në jug dhe juglindje me Bashkitë Tiranë dhe Kavajë. Pozita e saj përgjatë bregdetit Adriatik dhe lidhjet e drejtpërdrejta me Tiranën, zonën e Kavajës dhe bashkitë e tjera përreth i japin territorit rëndësi të veçantë në aspektin e transportit, zhvillimit ekonomik, turizmit dhe shërbimeve.

Territori i Bashkisë Durrës përfshin zona urbane, periurbane, rurale dhe bregdetare, me karakteristika të ndryshme të relievit dhe të përdorimit të tokës. Qendra kryesore urbane është qyteti i Durrësit, ndërsa pjesa tjetër e territorit përfshin një numër të konsiderueshëm vendbanimesh urbane dhe rurale. Kjo larmishmëri territoriale kërkon që planifikimi i shërbimeve dhe kapaciteteve të përshtatet me karakteristikat dhe nevojat specifike të zonave të ndryshme.

Sipas Ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Bashkia Durrës ka gjashtë njësi administrative: Durrës, Rrashbull, Sukth, Katund i Ri, Manëz dhe Ishëm. Për administrimin e shërbimeve, qyteti i Durrësit ndahet në gjashtë njësi urbane, prandaj bashkia funksionon me 11 njësi gjithsej. Qyteti është i organizuar në 14 lagje, ndërsa territori i bashkisë përfshin 39 fshatra. Ky plan, si VRF-ja, përdor gjashtë NjA-të ligjore.

Për qëllime të vendimmarrjes dhe të planifikimit të emergjencave civile, struktura territoriale e bashkisë duhet të konsiderohet së bashku me shpërndarjen e popullsisë, vendndodhjen e vendbanimeve, korridoret kryesore të transportit, zonat bregdetare dhe aksesueshmërinë e njësive administrative. Këta faktorë ndikojnë drejtpërdrejt në organizimin e shërbimeve, kohën e përgjigjes ndaj emergjencave civile dhe shpërndarjen territoriale të kapaciteteve gjatë situatave emergjente.

Harta 3.1 paraqet përdorimin e tokës sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, njësitë administrative, portin, Porto Romanon dhe rrjetin kryesor rrugor.



Harta 3.1: Përdorimi i tokës sipas PPV, njësitë administrative dhe rrjeti kryesor rrugor

3.2 Popullsia dhe dinamika sezonale

Bashkia Durrës është një nga njësitë vendore me përqendrimin më të lartë të popullsisë në vend. Popullsia është e përqendruar kryesisht në qytetin e Durrësit, ndërsa pjesa tjetër shpërndahet në njësitë administrative Sukth, Ishëm, Katund i Ri, Rrashbull dhe Manëz. Kjo shpërndarje krijon ndryshime të rëndësishme në kërkesën për shërbime publike, infrastrukturë, transport, ujësjellës-kanalizime, shërbime shëndetësore dhe kapacitete të përgjigjes ndaj emergjencave

Sipas të dhënave të Gjendjes Civile të vitit 2024 bashkia Durrës ka **341,425 banorë**. Rreth **68% e popullsisë është urbane**, ndërsa densiteti mesatar i popullsisë, bazuar në këto të dhëna dhe në sipërfaqen e bashkisë, është rreth **1 009 banorë/km²**.

Sipas Censusit të Popullsisë dhe Banesave 2023 (INSTAT), popullsia rezidente e Bashkisë Durrës është 153,614 banorë. Diferenca me Regjistrin Civil pasqyron emigracionin dhe lëvizjet e brendshme. Për planifikimin e evakuimit, strehimit dhe furnizimeve përdoret si bazë popullsia rezidente sipas Censusit

Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MJEDISIT
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MBROJTJES

2023, ndërsa për planifikimin e kapaciteteve gjatë sezonit veror i shtohet fluksi i vizitorëve, i cili nuk është i matur në mënyrë sistematike.

Me popullsinë rezidente të Censusit 2023 dhe sipërfaqen prej rreth 342 km², dendësia mesatare është rreth 450 banorë/km².

Sipas të dhënave të Regjistrit të Gjendjes Civile të vitit 2024, shpërndarja e popullsisë paraqitet si më poshtë:

Njësia administrative	**Popullsia 2024**	**Pesha ndaj totalit**
Qyteti i Durrësit(6 njësi administrative)	234 737	68,8%
Rrashbull	36 951	10,8%
Sukth	30 836	9,0%
Manëz	15 035	4,4%
Katund i Ri	14 441	4,2%
Ishëm	9 425	2,8%
Totali	**341 425**	**100%**

Një karakteristikë e rëndësishme e Bashkisë Durrës është dinamika sezonale e popullsisë. Gjatë sezonit turistik veror, veçanërisht në zonat bregdetare dhe në qendrën urbane, numrit të banorëve rezidentë i shtohet një fluks i konsiderueshëm vizitorësh, turistësh dhe popullsie jo rezidente. Ky fluks rrit përkohësisht presionin mbi rrjetin rrugor, transportin, furnizimin me ujë, kanalizimet, menaxhimin e mbetjeve, shërbimet shëndetësore, hapësirat publike dhe kapacitetet e emergjencave civile.

Nga këndvështrimi i menaxhimit të të emergjencave, dinamika sezonale duhet të integrohet në planifikimin e kapaciteteve të përgjigjes. Gjatë muajve të sezonit turistik mund të rritet nevoja për kapacitete shtesë të shërbimeve të emergjencës, ndihmës së shpejtë, sigurisë në plazhe, menaxhimit të trafikut, furnizimit me ujë dhe menaxhimit të mbetjeve. Për këtë arsye, Plani Vendor për Emergjencat Civile i bashkisë Durrës merr në konsideratë jo vetëm numrin e banorëve rezidentë, por edhe përqendrimin territorial dhe ndryshimet e përkohshme të popullsisë gjatë vitit.

3.3 Grupet që kërkojnë asistencë

Në kuadër të Planit Vendor për Emergjencat Civile të Bashkisë Durrës, identifikimi i grupeve që kërkojnë asistencë të posaçme përbën një element të rëndësishëm për planifikimin e masave të mbrojtjes civile dhe garantimin e një reagimi gjithëpërfshirës gjatë emergjencave. Këto grupe mund të përballen me vështirësi më të mëdha në marrjen e informacionit, evakuimin, transportin, aksesin në shërbimet shëndetësore dhe përmbushjen e nevojave bazë gjatë dhe pas një fatkeqësie.

Në këtë kategori përfshihen persona me aftësi të kufizuara (PAK), fëmijë të identifikuar në rrezik, fëmijë jetimë /nën kujdestari, persona të moshuar në nevojë (65+), gjinia/viktimat e dhunës – raste të raportuara, familje me ndihmë ekonomike, persona të papunë të regjistruar, komunitetet rome dhe egjiptiane. Vëmendje e veçantë u kushtohet edhe personave që jetojnë vetëm, personave me sëmundje kronike dhe individëve që kanë vështirësi në lëvizje ose në përballimin e situatave emergjente.

Për mbrojtjen e këtyre grupeve, Bashkia Durrës parashikon:

- Identifikimin dhe vlerësimin paraprak të nevojave për asistencë gjatë emergjencave.
- Organizimin e njoftimit të hershëm përmes kanaleve të përshtatshme dhe të aksesueshme.
- Planifikimin e evakuimit të asistuar, transportit dhe strehimit të përshtatshëm.
- Bashkëpunim me strukturat shëndetësorë për sigurimin e aksesit në ndihmën mjekësore dhe medikamentet e domosdoshme.

- Përgatitjen e qendrave të strehimit sipas mundësive në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve dhe familjeve me fëmijë.
- Bashkërendimin me institucionet publike, shërbimet shëndetësore, organizatat humanitare dhe aktorët e tjerë mbështetës.
- Përfshirjen e nevojave të këtyre grupeve në trajnimet dhe ushtrimet për gatishmërinë dhe reagimin ndaj emergjencave.

Masat e parashikuara synojnë të garantojnë trajtim të barabartë, mbrojtje të jetës dhe shëndetit, akses në informacion dhe ndihmë të përshtatshme, si dhe zvogëlimin e pasojave sociale dhe ekonomike të fatkeqësive.

Treguesit kryesorë për kategoritë vulnerabël në Bashkinë Durrës

Kategoria Vulnerabël	2024
Familje me ndihmë ekonomike (NE)	**141 familje (maj 2024)**
Persona të papunë të regjistruar	**6,137 persona**
Persona me aftësi të kufizuara (PAK)	**4,458 persona**
Fëmijë të identifikuar në rrezik	**1,288 fëmijë**
Persona të moshuar në nevojë (65+)	**1,926 persona**
Viktimat e dhunës – raste të raportuara	**174 raste (2024)**
Fëmijë jetimë / nën kujdestari	**68 jetimë / 24 kujdestari**
PAK të përfshirë në skemën ndihmësi personal	**889 persona (~20%)**

Burimi: Bashkia Durrës, maj 2024; Plani Social Vendor 2025–2028;

Të dhënat e paraqitura evidentojnë kategori të ndryshme të popullsisë që mund të kërkojnë asistencë të posaçme gjatë emergjencave civile. Ato shërbejnë si bazë për identifikimin e nevojave, planifikimin e burimeve dhe përcaktimin e masave për mbrojtjen e popullsisë, veçanërisht në rastet kur kërkohet ndihmë për evakuim, transport, strehim ose akses në shërbime shëndetësore dhe sociale.

Për të garantuar një reagim gjithëpërfshirës ndaj emergjencave civile, Bashkia Durrës siguron përditësimin periodik dhe harmonizimin e informacionit për grupet që kërkojnë asistencë.

Identifikimi i personave që kanë nevojë për asistencë dhe përcaktimi i masave konkrete të mbështetjes realizohen në bashkëpunim ndërmjet strukturave sociale, shëndetësore, arsimore dhe të mbrojtjes civile, bazuar në vlerësimin e nevojave dhe kapaciteteve të disponueshme, duke garantuar konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

3.4 Infrastruktura dhe shërbimet kritike

Infrastruktura kritike përfshin strukturat fizike, rrjetet dhe pasuritë e tjera, të cilat janë të domosdoshme për funksionimin ekonomik dhe social të shoqërisë ose komunitetit. Dëmtimi ose ndërprerja e funksionimit të këtyre elementeve gjatë emergjencave civile mund të shkaktojë pasoja të drejtpërdrejta për jetën dhe shëndetin e njerëzve, si dhe të ndikojë në kapacitetet e përgjigjes, përballimit dhe rimëkëmbjes pas një fatkeqësie.

Në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", infrastruktura kritike përfshin sektorë të rëndësishëm për funksionimin e shoqërisë, ndër të cilët energjinë, gazin, naftën dhe produktet e saj, telekomunikacionin, furnizimin me ujë, bujqësinë dhe prodhimin e ushqimit, shëndetin publik, transportin, shërbimet financiare, si dhe shërbimet e sigurisë dhe të mbrojtjes.

Në Bashkinë Durrës, infrastruktura dhe shërbimet me rëndësi kritike për planifikimin e emergjencave civile përfshijnë sistemet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve, rrjetin e energjisë elektrike, institucionet shëndetësore, infrastrukturën rrugore, hekurudhore dhe detare, rrjetet e telekomunikacionit etj., Rëndësi të veçantë paraqesin edhe objektet dhe rrjetet që mbështesin funksionimin e institucioneve publike dhe përgjigjen ndaj emergjencave.

Ekspozimi i territorit ndaj rreziqeve natyrore dhe teknologjike, veçanërisht rrezikut sizmik, kërkon vëmendje të posaçme ndaj qëndrueshmërisë së këtyre sistemeve. Një ngjarje sizmike mund të shkaktojë ndërprerje të furnizimit me energji dhe ujë, dëmtim të rrjeteve të komunikimit, kufizim të aksesit rrugor dhe ulje të kapaciteteve të shërbimeve shëndetësore. Për më tepër, ndërvarësia ndërmjet sistemeve mund të prodhojë pasoja zinxhir, duke përforcuar ndikimin fillestar të fatkeqësisë.

Për vlerësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve kritike duhet të merren në konsideratë vendndodhja, kapaciteti funksional, gjendja teknike, ekspozimi ndaj rreziqeve, cenueshmëria, numri i përfituesve, varësia nga sistemet e tjera, mundësia e përdorimit të burimeve alternative dhe koha e nevojshme për rikthimin e funksionimit pas një ngjarjeje emergjente.

Në kuadër të përgjegjësive të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen civile, Bashkia Durrës, në bashkëpunim me institucionet publike dhe operatorët përgjegjës, bashkërendon masat për identifikimin e infrastrukturës kritike, zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve thelbësore.

Këto masa përfshijnë:

Identifikimin dhe evidentimin e infrastrukturës kritike: Mbledhjen, administrimin dhe përditësimin e informacionit për objektet, rrjetet dhe shërbimet me rëndësi për përballimin e emergjencave, në bashkëpunim me institucionet dhe operatorët që i administrojnë ato.

Planifikimin për vazhdimësinë e shërbimeve: Identifikimin e shërbimeve prioritare dhe të nevojave për burime alternative, në bashkëpunim me operatorët përkatës, me qëllim përfshirjen e masave të nevojshme në planet e emergjencës.

Vlerësimi i dëmtimeve të infrastrukturës kritike: Bashkëpunimi me institucionet dhe operatorët përgjegjës për evidentimin e dëmtimeve në infrastrukturën kritike, identifikimin e ndërprerjeve të shërbimeve thelbësore dhe përcaktimin e nevojave prioritare për ndërhyrje, me qëllim mbështetjen e përgjigjes ndaj emergjencave dhe rikthimin e funksionimit të shërbimeve.

Koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit: Bashkëpunimin me institucionet publike, operatorët e infrastrukturës, Prefektin e Qarkut dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e masave të mbrojtjes civile.

Monitorimi dhe përditësimi i informacionit: Përditësimi periodik i informacionit mbi gjendjen dhe funksionimin e infrastrukturës kritike, në bashkëpunim me institucionet dhe operatorët përgjegjës, me qëllim identifikimin e problemeve që mund të ndikojnë në vazhdimësinë e shërbimeve thelbësore.

Zbatimi i masave që lidhen me infrastrukturën e administruar nga institucione ose operatorë të tjerë realizohet nga subjektet përgjegjëse, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore. Bashkia Durrës kontribuon në koordinimin vendor dhe në përfshirjen e këtyre masave në planifikimin e emergjencave civile, me synim mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të popullsisë dhe rritjen e qëndrueshmërisë së territorit ndaj fatkeqësive.

Inventari i mëposhtëm paraqet objektet kritike të evidentuara në bazën GIS të planit. Ai shërben si pikënisje për regjistrin e infrastrukturës kritike që Bashkia duhet ta plotësojë dhe ta mbajë të përditësuar bashkë me operatorët përgjegjës.

Objektet kritike sipas njësive administrative (baza GIS)

NjA	Spital / maternitet	Qendër shëndetësore	Ambulancë	Objekte të tjera shëndetësore	Shkolla 9-vjeçare dhe të mesme	Ura dhe mbikalime
Durrës	2	5	2	3	28	6
Rrashbull	0	1	6	0	7	4
Sukth	0	1	4	0	10	2

NjA	Spital / maternitet	Qendër shëndetësore	Ambulancë	Objekte të tjera shëndetësore	Shkolla 9-vjeçare dhe të mesme	Ura dhe mbikalime
Katund i Ri	0	0	5	0	6	0
Manëz	0	0	5	0	6	0
Ishëm	0	0	1	0	8	0
Bashkia	**2**	**7**	**23**	**3**	**65**	**12**

Burimi: Baza GIS e paketës DRR (Qarku Durrës), ndërtesat DR, Census 2011 dhe 2023 (INSTAT); përpunim GIS, nëntor 2026.

Përveç objekteve të mësipërme, për vazhdimësinë e shërbimeve dhe për përgjigjen ndaj emergjencave kanë rëndësi të veçantë:

- **Porti i Durrësit dhe zona e Porto Romanos**, me 53 depozita hidrokarbureshdhe LPG dhe kapacitet magazinimi mbi 399 mijë m³; 4,871 ndërtesa, 37 shkolla dhe 8 objekte shëndetësore ndodhen në afërsi të tyre (VRF).
- **Spitali Rajonal i Durrësit**, i vetmi institucion spitalor publik në bashki, që mbulon edhe Shijakun dhe pjesë të Krujës.
- **Sistemi i kullimit**: hidrovorët, kolektori i Spitallës (8.8 km, që kullon rreth 2,100 ha në Durrës, Spitallë dhe Vrinas) dhe kanalet kulluese të ultësirës. Ndërprerja e energjisë në hidrovorë është një nga shkaqet e përmbytjeve të zgjatura.
- **Argjinaturat**: argjinatura e Erzenit (3.6 km, lartësi 3 m, mbron rreth 500 ha në zonën e Rrushkullit), argjinatura bregdetare e Erzenit (2.6 km) dhe argjinatura bregdetare e Bishtit të Pallës (2.5 km, zona Rinia).
- **Rrjeti rrugor dhe hekurudhor**: akset Durrës-Tiranë, Durrës-Porto Romano-autostradë dhe rruga bregdetare, si dhe 12 ura e mbikalime, ndër to Ura e Sallmonës, mbikalimet e Sukthit, të Shkozetit, të Dajlanit dhe të Plepave.
- **Furnizimi me ujë, energji dhe telekomunikim**: rrjeti i ujësjellësit, nënstacionet elektrike dhe antenat e operatorëve. Vendndodhja e tyre nuk është ende në bazën GIS të Bashkisë dhe duhet siguruar nga operatorët.

Kapitulli 4. Profili multi risk dhe prioritetet

Kapitulli përmbledh rezultatet e Vlerësimit Vendor të Riskut dhe i përkthen ato në prioritete planifikimi dhe kërkesa operative.

4.1 Metodologjia dhe klasifikimi i riskut

Ky kapitull përmbledh rezultatet e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë të Bashkisë Durrës (VRF, 2026) dhe i përkthen ato në prioritete planifikimi dhe kërkesa operative për këtë plan.

VRF kombinon dy nivele analize. Niveli i parë vlerëson 19 skenarë përfaqësues për shtatë rreziqe (përmbytje, tërmet, rrezik gjeologjik, zjarre, rrezik teknologjik, rrezik biologjik dhe mot ekstrem). Për secilin skenar vlerësohen gjasat e ndodhjes në shkallën 1-5 dhe pasojat në shkallën 1-5 për pesë dimensione: njerëzit, ekonominë, infrastrukturën, mjedisin dhe shoqërinë e trashëgiminë kulturore. Niveli i riskut përcaktohet nga gjasat dhe pasoja më e rëndë, sipas një matrice të përshtatur nga metodologjitë NERAG dhe AFAD.

Niveli i dytë krahason gjashtë njësitë administrative (NjA) përmes një indeksi sintetik territorial të riskut (IR, shkalla 1-10), që kombinon rrezikun, ekspozimin, cenueshmërinë dhe mungesën e kapacitetit përballues. Ekspozimi është matur me analizë GIS mbi 41,445 gjurmë ndërtesash, rrjetin rrugor, objektet publike, tokën bujqësore e pyjore dhe gjurmët e përmbytjeve të janarit 2026 të hartëzuara nga Copernicus (EMSR856). Ndryshimet klimatike trajtohen si faktor që rrit rreziqet e tjera dhe jo si rrezik më vete.

Matrica e riskut dhe pozicioni i 19 skenarëve (gjasat sipas rreshtave, pasojat sipas kolonave)

Gjasat / Pasojat	1 Të vogla	2 Të kufizuara	3 Të moderuara	4 Të mëdha	5 Katastrofike
5 Pothuajse e sigurt	Mesatar	Mesatar: GJ-1, BI-1, ME-1	I lartë: PM-1, ZJ-1	Ekstrem	Ekstrem

Gjasat / Pasojat	1 Të vogla	2 Të kufizuara	3 Të moderuara	4 Të mëdha	5 Katastrofike
4 E mundshme	I ulët	Mesatar: TK-2, BI-3	I lartë: ME-2, BI-4	Ekstrem	Ekstrem
3 Pak e mundshme	I ulët	I ulët	Mesatar: SZ-1, GJ-2, ZJ-2	I lartë: PM-2	Ekstrem: BI-2
2 E rrallë	I ulët	I ulët: ME-3	Mesatar	I lartë: TK-1, TK-3	I lartë: SZ-2
1 Shumë e rrallë	I ulët	I ulët	I ulët	Mesatar	I lartë: PM-3

Burimi: VRF Bashkia Durrës (2026, version i rishikuar).

Niveli i riskut përdoret në këtë plan si nivel planifikimi. Skenarët me nivel ekstrem ose të lartë kanë procedura dhe skenar operacional të dedikuar (kapitulli 12) dhe testohen me ushtrime. Skenarët me nivel mesatar menaxhohen me procedurat e përgjithshme të kapitujve 7, 8 dhe 9, ndërsa skenarët me nivel të ulët ndiqen përmes monitorimit.

4.2 Përmbledhje e rreziqeve – gjetjet kryesore

Nga 19 skenarët, një klasifikohet me nivel ekstrem (BI-2, epidemi respiratore e rëndë) dhe nëntë me nivel të lartë. Skenarët e shpeshtë me pasoja të moderuara (PM-1, ZJ-1, ME-2, BI-4) kërkojnë gatishmëri sezonale të vazhdueshme, ndërsa skenarët e rrallë me pasoja të mëdha ose katastrofike (PM-2, PM-3, SZ-2, TK-1, TK-3) kërkojnë procedura për ngjarje ekstreme, koordinim me Prefektin dhe AKMC-në dhe kërkesë të shpejtë për mbështetje.

Nivelet e riskut për skenarët përfaqësues të Bashkisë Durrës

Kodi	Rreziku	Skenari	Gjasat	Pasojat	Niveli
BI-2	Biologjik	Epidemi respiratore e rëndë me përhapje të gjerë	3	5	Ekstrem
PM-1	Përmbytje	Përmbytje e përsëritur pluviale dhe lumore në ultësirë (si në janar 2025 dhe janar 2026)	5	3	I lartë
ZJ-1	Zjarr	Zjarre sezonale në shkurre, pyje dhe kullota (Ishëm, Manëz, Rrashbull)	5	3	I lartë
PM-2	Përmbytje	Përmbytje e madhe e Erzenit dhe e Ishmit (rreth T=100 vjet), me tejkalim të argjinaturave	3	4	I lartë
ME-2	Mot ekstrem	Valë e nxehtë e zgjatur me efekt të ishullit urban të nxehtësisë	4	3	I lartë
SZ-2	Tërmet	Tërmet i krahasueshëm me atë të 26 nëntorit 2019 (Mw 6.4)	2	5	I lartë
TK-1	Teknologjik	Zjarr, shpërthim ose rrjedhje në depozitat e Porto Romanos	2	4	I lartë
TK-3	Teknologjik	Derdhje nafte në det në zonën portuale gjatë sezonit turistik	2	4	I lartë
PM-3	Përmbytje	Përmbytje bregdetare nga cunami pas një tërmeti në det	1	5	I lartë
BI-4	Biologjik	Sezon i rëndë i virusit West Nile me transmetim lokal (mushkonjat Culex)	4	3	I lartë
GJ-1	Gjeologjik	Rrëshqitje dhe erozion lokal pas reshjeve intensive	5	2	Mesatar
BI-1	Biologjik	Rritje sezonale e sëmundjeve gastrointestinale dhe ujore	5	2	Mesatar
ME-1	Mot ekstrem	Stuhi me erë të fortë dhe dallgëzim në bregdet dhe port	5	2	Mesatar
SZ-1	Tërmet	Tërmet me probabilitet tejkalimi 10% në 10 vjet (PGA 0.12-0.13 g)	3	3	Mesatar
GJ-2	Gjeologjik	Lëvizje masive në kodrat e Durrësit me dëmtim banesash dhe rrugësh	3	3	Mesatar
ZJ-2	Zjarr	Zjarr i madh në ndërfaqen pyll-urban gjatë sezonit turistik	3	3	Mesatar
TK-2	Teknologjik	Aksident me mallra të rrezikshme gjatë transportit	4	2	Mesatar
BI-3	Biologjik	Rishfaqje e fruthit për shkak të rënies së mbulesës vaksinale	4	2	Mesatar
ME-3	Mot ekstrem	Ngrica dhe dëborë e rrallë	2	2	I ulët

Burimi: VRF Bashkia Durrës (2026, version i rishikuar).

Përmbytjet janë rreziku më i shpeshtë dhe me ndikimin më të madh të përsëritur. Bashkia është prekur nga përmbytje në 2018, 2020, janar-shkurt 2025, shtator-nëntor 2025 dhe janar 2026. Në janar 2026 humbi jetën një person dhe rreth 543 banorë u evakuuan. Zonat e përmbytura dhe të modeluara mbulojnë rreth 33.1 km² dhe përfshijnë 1,542 ndërtesa, kryesisht në ish-Kënetë, Spitallë, Shkozet, Plazh, Sukth dhe Katund i Ri. Përmbytjet urbane lidhen me kapacitetin e kufizuar të kanalizimeve dhe hidrovorëve, ndërsa përmbytjet lumore me Erzenin dhe Ishmin.

Tërmetet kanë gjasa më të ulëta, por pasoja katastrofike. Tërmeti i 26 nëntorit 2019 (Mw 6.4) shkaktoi 25 viktima në Durrës, mijëra të pastrehë dhe dëme të rënda në fondin ndërtimor shumëkatësh. Indeksi i riskut

sizmik është më i lartë në NjA Durrës (6.6) dhe në Sukth (6.1), për shkak të dendësisë së ndërtimit, depozitimeve të buta bregdetare dhe potencialit për lëngëzim.

Rreziku gjeologjik është i lokalizuar në kodrat e Durrësit (Currila-Vollga), Rrashbull dhe Ishëm-Lalëz. VRF evidenton 88 rrëshqitje (32 në Ishëm, 31 në Rrashbull dhe 22 në NjA Durrës) dhe 383 ndërtesa brenda 50 m nga zonat e hartëzuara.

Zjarret kanë karakter sezonal (korrik-shtator) dhe indeksin më të lartë në Ishëm (6.9) dhe Manëz (6.3). Rreth 14.0 km² janë zona të prirura ndaj zjarrit, ndërsa 2,861 ndërtesa ndodhen brenda 100 m prej tyre, nga të cilat 1,569 në NjA Durrës. Në bazën GIS të planit janë të regjistruara 83 vatra zjarri, me përqendrim në Arapaj, Shetaj, Shënavlash dhe Sukth.

Rreziku teknologjik përqendrohet në portin e Durrësit dhe në Porto Romano. Skenarët TK-1 (zjarr ose shpërthim në depozita) dhe TK-3 (derdhje nafte në det) kanë nivel të lartë, ndërsa Bashkia nuk ka ende inventar të instalimeve dhe plane të përbashkëta me operatorët.

Rreziku biologjik lidhet me dendësinë e popullsisë, portin, turizmin dhe kushtet higjieno-sanitare në zonat me kanale të hapura. Në vitin 2025 u regjistruan 17,341 raste gastroenteriti, ndërsa mbulesa vaksinale FRP ra nga 94.7% (2020) në 79.8% (2024). Në vitin 2024 u konfirmuan raste të virusit West Nile në Durrës (106 raste lokale dhe 13 vdekje në nivel vendi); prandaj VRF-ja shtoi skenarin BI-4, me besueshmëri të ulët të të dhënave.

Moti ekstrem dhe bregdeti: stuhitë me erë të fortë dhe dallgëzim prekin portin, plazhet dhe rrjetin elektrik, ndërsa valët e nxehta (ME-2) kanë nivel të lartë për shkak të ishullit urban të nxehtësisë dhe numrit të lartë të të moshuarve. Brenda 500 m nga bregu ndodhen 3,291 ndërtesa dhe 1,702 ndërtesa janë nën 1 m lartësi mbi nivelin e detit.

Rreziqet ndërveprojnë dhe krijojnë efekte zinxhir, të cilat duhet të merren parasysh në aktivizimin e strukturave dhe në kërkesat për burime:

- Tërmet, lëngëzim i truallit, dëmtim i depozitave dhe zjarr ose ndotje në port dhe në Porto Romano (Natech).
- Tërmet në det dhe cunami, me përmbytje të zonës portuale dhe turistike brenda 10-20 minutash.
- Reshje intensive, tejmbushje kanalesh, ndërprerje e energjisë në hidrovorë dhe përmbytje e zgjatur e ish-Kënetës dhe e Sukthit.
- Përmbytje, ndotje e ujit të pijshëm dhe rritje e sëmundjeve gastrointestinale, sidomos në zonat me kanale të hapura.
- Zjarr, humbje e mbulesës bimore, erozion dhe rrëshqitje pas reshjeve të vjeshtës në kodrat e Ishmit dhe të Rrashbullit.
- Stuhi detare dhe ngritje e nivelit të detit, që pengojnë shkarkimin e ujërave të shiut dhe përkeqësojnë përmbytjet urbane.

4.3 Ekspozimi territorial sipas njësive administrative

Tabela e mëposhtme paraqet treguesit kryesorë të ekspozimit sipas NjA, të llogaritur me bazën GIS të këtij plani. Ato përdoren për planifikimin operacional (njoftimi, evakuimi, strehimi dhe shpërndarja e burimeve) dhe nuk zëvendësojnë treguesit e VRF-së.

Treguesit e ekspozimit sipas NjA (baza GIS e planit)

NjA	Sipërfaqja (km²)	Popullsia (Census 2011)	Ndërtesa	Ndërtesa në zonën e planifikimit të Erzenit	Zonë gjeologjike me rrezikshmëri të lartë (km²)	Ndërtesa brenda 50 m nga rrëshqitje/erozion	Vatra zjarri të regjistruara	PGA mbizotëruese (g)
Durrës	37.9	113,249	23,036	0	0.31	750	10	0.225
Rrashbull	58.7	24,081	6,725	0	0.91	45	23	0.225
Sukth	53.3	15,966	4,376	1,054	0.00	0	9	0.225
Katund i Ri	54.2	10,161	3,062	668	0.00	0	7	0.225
Manëz	43.3	6,652	2,023	0	0.03	19	15	0.225
Ishëm	91.0	5,001	2,257	12	5.66	12	19	0.225

Implemented by giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MJEDISIT
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MBROJTJES

NjA	Sipërfaqja (km²)	Popullsia (Census 2011)	Ndërtesa	Ndërtesa në zonën e planifikimit të Erzenit	Zonë gjeologjike me rrezikshmëri të lartë (km²)	Ndërtesa brenda 50 m nga rrëshqitje/erozion	Vatra zjarri të regjistruara	PGA mbizotëruese (g)
Bashkia	**338.4**	**175,110**	**41,479**	**1,734**	**6.91**	**826**	**83**	**0.200–0.250**

Burimi: Baza GIS e paketës DRR (Qarku Durrës), ndërtesat DR, Census 2011 dhe 2023 (INSTAT); përpunim GIS, nëntor 2026.

Sipërfaqet e tabelës janë llogaritur nga kufijtë GIS të NjA-ve (gjithsej 338.4 km²) dhe ndryshojnë pak nga sipërfaqja prej rreth 342 km² e përdorur në VRF dhe në kapitullin 3. Popullsia sipas NjA jepet nga Censusi 2011, i vetmi burim me ndarje sipas NjA në bazën GIS të planit; popullsia rezidente e bashkisë sipas Censusit 2023 është 153,614 banorë.

Zona e planifikimit të Erzenit është brezi 500 m nga segmentet e lumit me risk të lartë dhe të mesëm, i bashkuar me zonat zyrtare me rrezik të lartë përmbytjeje (RRP-N2). Në të ndodhen 1,734 ndërtesa dhe rreth 5,340 banorë (vlerësim mbi bazën e Censusit 2023), pothuajse të gjitha në Sukth dhe Katund i Ri. Kjo zonë përdoret për paralajmërimin dhe evakuimin parandalues, ndërsa përmbytjet urbane të qytetit menaxhohen sipas hartave të VRF-së.

Hartat 4.1 dhe 4.2 paraqesin ekspozimin në territor. Harta 4.1 tregon zonat e prirura ndaj zjarrit, ndërtesat në ndërfaqen pyll-vendbanim, rrëshqitjet dhe erozionin. Harta 4.2 tregon lumenjtë Erzen dhe Ishëm, rrjetin kullues, zonat RRP-N2, industrinë, zonat portuale dhe brezat rreth objekteve me risk teknologjik.



Harta 4.1: Zjarret dhe rreziku gjeologjik: zonat e prirura ndaj zjarrit, ndërfaqja pyll-vendbanim, rrëshqitjet dhe erozioni

Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MJEDISIT
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MBROJTJES



Harta 4.2: Ujërat, përmbytjet dhe rreziku teknologjik

4.4 Prioritetet sipas njësive administrative dhe kërkesat operative

Profilet e NjA-ve grupohen në katër tipologji: qyteti i Durrësit me profilin më kompleks; ultësira e Erzenit (Sukth, Katund i Ri), ku dominojnë përmbytjet; kodrat e Rrashbullit me profil të balancuar; dhe zona kodrinore e Ishmit dhe e Manzës, ku dominojnë zjarret. Tabela lidh rreziqet prioritare me kërkesat që ky plan duhet të plotësojë.

Prioritetet territoriale dhe kërkesat operative

NjA	Rreziqet prioritare	Kërkesat operative në PVEC
Durrës (qyteti)	Përmbytje urbane (ish-Këneta, Spitallë, Shkozet, Plazh); tërmet; rrezik teknologjik (porti, Porto Romano); rrëshqitje (Currila-Vollga); valë të nxehta; cunami	QOECB alternative jashtë zonës së përmbytjes; evakuim urban dhe bregdetar; protokoll Natech me operatorët; pikat e grumbullimit PG-01 deri PG-16; protokoll për valët e nxehta
Sukth	Përmbytje e Erzenit (Sukth i Ri, Vadardhë); PGA më e lartë (0.129 g) mbi trualle të buta	Paralajmërim hidrologjik dhe vrojtues në argjinaturë; evakuim parandalues i familjeve përgjatë lumit; energji rezervë në hidrovorë; strehime jashtë zonës së përmbytjes

NjA	Rreziqet prioritare	Kërkesat operative në PVEC
Katund i Ri	Përmbytje e Erzenit (Erzen, Katund i Ri, Sukth); kapacitet i ulët territorial	Regjistër i personave që kërkojnë evakuim të asistuar; varka dhe pompa në gatishmëri; rrugë alternative evakuimi; pika grumbullimi PG-29 deri PG-34
Rrashbull	Tërmet; rrëshqitje; rrezik teknologjik pranë zonave industriale; zjarre në ndërfaqen pyll-urban	Kontroll i ndërtimeve në shpate; plan zjarri për ndërfaqen pyll-urban; koordinim me operatorët industrialë
Manëz	Zjarre (IR 6.3); akses i kufizuar në zonat kodrinore	Plan sezonal i zjarreve, pika uji, breza zjarrndarës, grup vullnetarësh
Ishëm	Zjarre (IR 6.9); rrëshqitje; përmbytje në grykëderdhje; cenueshmëri e lartë sociale	Vullnetarë të trajnuar dhe pajisje bazë; rrugë alternative; paralajmërim derë më derë për fshatrat e izoluara

Burimi: VRF Bashkia Durrës (2026); përpunim për PVEC.

Në nivel bashkie, prioriteti I u jepet përmbytjeve dhe tërmeteve, prioriteti II zjarreve, rrezikut teknologjik, rrezikut biologjik dhe rrezikut gjeologjik, ndërsa moti ekstrem renditet në prioritetin III, me përjashtim të valëve të nxehta në qytet. Ndryshimet klimatike janë prioritet horizontal, sepse rrisin frekuencën dhe intensitetin e përmbytjeve, zjarreve dhe valëve të nxehta.

4.5 Kufizimet e të dhënave

- Nuk ka harta zyrtare të përmbytjes për periudha kthimi T=10, 50 dhe 100 vjet, as modelim hidraulik të thellësisë së ujit. Zonat e përdorura bazohen në ngjarjet e vëzhguara dhe në zonat RRP-N2.
- Nuk ka mikrozonim sizmik dhe inventar të tipologjisë së ndërtesave; vlerësimi i dëmeve të mundshme mbështetet në përvojën e vitit 2019.
- Nuk ka inventar të instalimeve me lëndë të rrezikshme dhe të planeve të emergjencës së operatorëve në Porto Romano dhe në port.
- Bashkia nuk ka regjistër të vetëm të ngjarjeve dhe të dëmeve me vendndodhje; të dhënat mbahen në Excel.
- Treguesit e këtij kapitulli dhe të anekseve operative janë llogaritur me bazën GIS të paketës DRR të Qarkut Durrës dhe mund të ndryshojnë pak nga ato të VRF-së. Ata duhet të verifikohen në terren gjatë përditësimit vjetor të planit.

Kapitulli 5. Organizimi vendor i mbrojtjes civile

Ligji nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile" dhe Plani Kombëtar për Emergjencat Civile, parashikojnë disa detyra të rëndësishme të bashkisë në Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (ZRF) dhe Mbrojtjen Civile (MC).

Detyrat kryesore përfshijnë:

- Kryejnë vlerësimin e risqeve në territorin e tyre, duke hartuar dhe miratuar dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, të cilin ia dërgojnë prefektit të qarkut dhe AKMC, për qëllime analizimi dhe planifikimi.
- Informojnë publikun dhe komunitetin e rrezikuar, bazuar në dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë.
- Hartojnë dhe rishikojnë strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.
- Hartojnë, miratojnë dhe përditësojnë planin vendor për emergjencat civile dhe ia dërgojnë AKMC dhe prefektit të qarkut, për qëllime analizimi dhe planifikimi.
- Organizojnë veprimtari trajnuese në fushën e mbrojtjes civile për punonjësit dhe banorët në territorin e tyre.
- Sigurojnë funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në territorin e tyre dhe informojnë në kohë komunitetin e rrezikuar, AKMC dhe prefektin e qarkut.
- Sigurojnë, administrojnë dhe përditësojnë të dhënat e nevojshme për shtetasit dhe për subjektet private, të mundshme për t'u planifikuar dhe angazhuar në parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive.

- Krijojnë bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë për territorin e bashkisë, të cilën e mirëmbajnë dhe e përditësojnë, si edhe shkëmbejnë informacione me prefektin e qarkut dhe AKMC.
- Kryejnë investime parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese nga fatkeqësitë dhe informojnë për këto investime në mënyrë të vazhdueshme prefektin e qarkut, si dhe AKMC.
- Caktojnë Drejtuesin e Operacionit në nivel bashkie për përballimin e fatkeqësisë në territorin e saj.
- Kryejnë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e tyre, vlerësimin e nevojave për përballimin e tyre, si dhe dëmshpërblejnë shtetasit për fatkeqësitë e ndodhura në territorin e tyre.
- Bashkëpunojnë me bashkitë fqinje në zbatim të detyrave që lidhen me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, me qëllim bashkimin e kapaciteteve të tyre për trajtimin e çështjeve të përbashkëta në këtë fushë.
- Mbajnë në gatishmëri sistemet e mbrojtjes nga zjarri, kalueshmërinë e pandërprerë të rrugëve rurale, vendet e strehimit, si dhe mbledhin dhe administrojnë rezervat ushqimore për njerëzit dhe gjënë e gjallë.
- Aktivizojnë kapacitetet e subjekteve publike e private brenda territorit administrativ të tyre,bashkëpunojnë dhe asistojnë bashkitë fqinje dhe marrin çdo masë tjetër të nevojshme për përballimin dhe lehtësimin e fatkeqësive.
- Mbajnë në gatishmëri infrastrukturën e ujitjes, të kullimit, të mbrojtjes nga përmbytja dhe digat e rezervuarëve në administrim të tyre.
- Në rastet e emergjencave të shkallës së lartë dhe për të cilat dilet në përfundimin se përmbushen kriteret e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, përgatitet raporti i vlerësimit paraprak të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia, sëbashku me argumentet përkatës dhe i dërgohet Prefektit të qarkut dhe AKMC, shoqëruar me kërkesë për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Strukturat e mbrojtjes civile në nivel bashkie.



Fig. 11. Institucionet dhe strukturat e mbrojtjes civile në nivel vendor

Burimi: *Plani Kombëtar për Emergjencave Civile*

5.1 Kryetari i Bashkisë

Kryetari i Bashkisë është autoriteti ekzekutiv i bashkisë dhe drejtuesi i Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel bashkie.

5.2 Komisioni i Mbrojtjes (KMCB) Civile në Bashki

Komisioni i Mbrojtjes Civile në Bashki (KMCB) është strukturë vendore e sistemit të mbrojtjes civile. Në çdo bashki ai krijohet dhe funksionon nën drejtimin e kryetarit të bashkisë. Ligji nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" përcakton se përbërja, funksionimi dhe detyrat e komisionit miratohen me urdhër të kryetarit të bashkisë:

5.2.1 Përbërja

Sipas Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, KMCB drejtohet nga kryetari i bashkisë dhe përfshin:

- kryetarin dhe përfaqësues të këshillit bashkiak;
- drejtorë dhe ekspertë të administratës së bashkisë;
- përfaqësues të Policisë së Shtetit;
- përfaqësues të Forcave të Armatosura, kur janë të pranishme në territor;
- drejtues të zyrave vendore të institucioneve qendrore;
- administratorët e njësive administrative;
- përfaqësues të OJF-ve që veprojnë në fushën e zvogëlimit të riskut dhe mbrojtjes civile;
- përfaqësues të OJF-ve të tjera me rëndësi për territorin
- etj

5.2.2 Detyrat e KMCB-së

- Detyrat kryesore të KMCB-së përfshijnë:
- Analizon çështjet e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të mbrojtjes civile në nivel bashkie, dhe përcakton prioritetet dhe nevojat në këtë fushë
- Planifikon, organizon, koordinon dhe kontrollon të gjitha masat për parandalimin/lehtësimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë në territorin e bashkisë
- Siguron bashkërendimin e të gjitha aktiviteteve të strukturave shtetërore dhe jo shtetërore në për menaxhimin e emergjencave.
- Shqyrton, analizon, situatën dhe nevojat e krijuara gjatë emergjencës dhe i propozon Kryetarit të Bashkisë masat përkatëse.
- Analizon kapacitetet dhe burimet në dispozicion të bashkisë.
- Shqyrton dhe analizon funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në territorin e bashkisë.
- Shqyrton, dhe rekomandon, programe edukimi dhe veprimtari trajnuese në fushën e mbrojtjes civile.
- Shqyrton, këshillon dhe rekomandon për hartimin, zbatimin, përditësimin dhe rishikimin e Planit Vendor për Emergjencat Civile;
- Bashkëpunom me Komisionin e Mbrojtjes Civile në nivel Qarku dhe komisionet përkatëse të bashkive fqinje.
- Bashkërendon veprimtaritë për organizimin dhe pajisjen e forcave të ndërhyrjes në rastet e fatkeqësive.
- Ndjekë dhe zbaton të gjitha detyrat e tjera në rastet e fatkeqësive, si në rastet e shpalljes dhe ato të mos shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

5.2.3 Rregullorja e funksionimit të Komisionit të Mbrojtjes Civile

Funksionimi i KMC-së rregullohet nëpërmjet rregullores së tij të brendshme, e cila përcakton mënyrën e organizimit dhe të zhvillimit të veprimtarisë së Komisionit, procedurat e mbledhjeve, vendimmarrjen, detyrat e Sekretarisë Teknike dhe mënyrën e ndjekjes së zbatimit të vendimeve.

Mënyra e thirrjes së mbledhjeve të KMCB -së.

Sipas rregullores në situata normale, KMCB-së mblidhet jo më pak se një herë në tre muaj. Mbledhjet thirren nga Kryetari i Bashkisë, i cili përcakton rendin e ditës. Mbledhja mund të thirret edhe me kërkesë të jo më pak se 30% të anëtarëve të Komisionit.

Mbledhjet e zakonshme janë të vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 50% + 1 e anëtarëve të Komisionit.

Në situata emergjente dhe në rastet e fatkeqësive, KMCB-së mblidhet menjëherë, pavarësisht nga numri i anëtarëve të pranishëm.

Njoftimi për mbledhjet e zakonshme bëhet të paktën 5 (pesë) ditë përpara zhvillimit të tyre, ndërsa për mbledhjet urgjente ose të paparashikuara njoftimi bëhet brenda një afati më të shkurtër, në varësi të situatës.

Vendimmarrja.

KMCB merr vendime me shumicë votash. Në rast të barazimit të votave, vendos vota e Kryetarit të Komisionit.

Vendimet dhe rekomandimet e KMCB-së përcaktojnë masat që duhet të ndërmerren, strukturat përgjegjëse dhe, sipas rastit, afatet për realizimin e tyre.

Dokumentimi dhe Sekretaria Teknike.

Struktura përgjegjëse për mbrojtjen civile në bashki ushtron funksionin e Sekretarisë Teknike të KMCB-së.

Sekretaria Teknike është përgjegjëse për:

organizimin dhe përgatitjen e mbledhjeve;

njoftimin e anëtarëve;

përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve;

mbajtjen e procesverbaleve;

administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit;

evidentimin e vendimeve dhe detyrave të përcaktuara;

ndjekjen dhe verifikimin e zbatimit të vendimeve dhe detyrave të Komisionit.

Veprimtaria e KMCB-së dokumentohet nëpërmjet rendit të ditës, listës së pjesëmarrësve, procesverbaleve, vendimeve, rekomandimeve, detyrave të përcaktuara dhe raporteve për zbatimin e tyre.

5.3 Drejtuesi i Operacionit në Bashki (DOB)

Drejtuesi i operacionit në nivel bashkie caktohet me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë dhe është pozicion operacional që ngrihet dhe funksionon në situatat e emergjencave civile. Sipas Planit Kombëtar për Emergjencat Civile DOB është përgjegjës për koordinimin e burimeve njerëzore dhe materiale të listuara në planet vendore për emergjencat civile dhe kryen këto detyra:

- Bashkërendon strukturat qendrore në nivel vendor, si dhe strukturat e tjera qendrore ose ndërkombëtare që vijnë në ndihmë dhe siguron drejtimin e përgjithshëm të operacionit/përgjigjes.
- Mban lidhje të rregullta dhe kontakte të vazhdueshme me drejtuesit e operacioneve të bashkive fqinje, informon dhe sipas rastit kërkon asistencë nga KMCB dhe Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel qarku (KMCQ).
- Merr dhe zbaton udhëzimet e përgjithshme nga Kryetari i Bashkisë dhe KMCB-së, mban lidhje të vazhdueshme, si dhe raporton përpara tyre.
- Zbaton planin vendor për emergjencat civile dhe/ose planin për emergjencat civile të qarkut kur drejtimin e merr Prefekti i Qarkut.
- Bashkëvepron me grupe vullnetarësh, të specializuar për përballimin e emergjencave dhe me banorë të përfshirë përkohësisht në strukturat operacionale të bashkisë.
- Sipas rastit, delegon autoritetin te drejtuesit e strukturave operacionale.
- Në rast se situata përkeqësohet dhe nëse me mundësitë dhe mjetet që zotëron, bashkia nuk mund ta përballojë situatën e krijuar, i propozon kryetarit të bashkisë të kërkojë mbështetje nga bashkitë fqinje dhe nga autoritetet më të larta shtetërore.

Mbështetja për DOB:

Për të realizuar detyrat e tij, DOB do të mbështetet nga Qendra Operacionale e Emergjencave Civile në Bashki (QOECB-së).

Në çdo rast, Kryetari i Bashkisë cakton edhe **Drejtues Operacioni Zëvendësues**, të cilit Drejtuesi i Operacionit i delegon përkohësisht detyrën në rastet kur operacioni zgjat mbi 12 orë.

5.4 Qendra Operacionale e Emergjencave Civile në Bashki (QOECB)

QOECB-së, është një strukturë bashkërendimi dhe komunikimi midis drejtuesve kryesorë dhe organizatave të përfshira në përgjigjen ndaj emergjencës, e cila lehtëson shkëmbimin e informacionit midis tyre.

QOECB-së është strukturë e përkohshme nën autoritetin e bashkisë, dhe është aktive dhe operacionale në të gjitha rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Ajo mund të aktivizohet gjithashtu në situata të tjera emergjente, në varësi të ashpërsisë së fatkeqësisë së pritshme ose të ndodhur dhe kapaciteteve të disponueshme për përballimin e saj. Ajo shërben edhe si një sekretari teknike që ndihmon punën për funksionimin e KMCB-së dhe Drejtuesit të Operacionit në bashki, në varësi të përmasave të emergjencave.

5.4.1 Aktivizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe organizimi i QOECB

Shkaqet e aktivizimit të QOECB-së:

- Është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore;
- Numër i konsiderueshëm i personave në rrezik.
- Shkallë e lartë e kërcënimit për njerëzit, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore ose mjedisin.
- Kërkesa për mbështetje në vend (aktivizimi afatgjatë, burime të kufizuara, etj.).
- Nevoja për koordinim të burimeve për shkak të burimeve të kufizuara vendore dhe/ose madhësisë dhe shtrirjes së emergjencës.
- Shqetësim i lartë i ngritur nga media ose publiku/palët e interesit.

Aktivizimi i QOECB-së

- Automatikisht në rastin e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në territorin e bashkisë.
- Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë në koordinim me Prefektin e Qarkut dhe me AKMC-në dhe pas konsultimit paraprak me KMCB në rastet e tjera. Për këtë qëllim: Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturës së përhershme të Mbrojtjes Civile në bashki, paraqet në KMCB një raport të argumentuar, bazuar në ashpërsinë e fatkeqësisë së pritshme/të ndodhur dhe kapacitetet përballuese në dispozicion.
- Pas marrjes së vendimit për aktivizimin e QOECB-së, Kryetari i bashkisë cakton një koordinator të veprimeve të QOECB-së dhe personel me përgjegjësi të përditshme përmenaxhimin e kësaj qendre. Elementët mbështetës të QOECB-së do të aktivizohen në rast se këtë e kërkon situata e emergjencës.

Funksionet kryesore të QOECB së:

- Bashkërendimi i punës së institucioneve, strukturave, të agjencive dhe të organizatave të ndryshme;
- Bashkërendimi i centralizuar i operacioneve emergjente, në mbështetje të KMCB-së në bashki dhe Drejtuesit Qendror të Operacionit (DOQ-së)/DOB-së.
- Mbledhja dhe ndarja e informacionit dhe raportimi zyrtar;

Përgjegjësitë e kryesore të QOECB-së :

- Mbledhja dhe ndarja e informacionit midis institucioneve, strukturave dhe organizatave të përfshira në përgjigjen ndaj emergjencës.
- Mobilizon me efikasitet personelin dhe burimet.
- Koordinimi i operacioneve emergjente në mbështetje të KMCB-së dhe DOB.
- Njoftimi dhe informimi i publikut për situatën emergjente.
- Menaxhimi i burimeve dhe logjistikës për reagimin ndaj emergjencave.

Përgjegjësitë e koordinatorit të QOECB-së.

Koordinatori i Qendrës Operacionale të Emergjencave Civile në Bashki (QOECB) është përgjegjës për organizimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së qendrës, sigurimin e komunikimit ndërmjet strukturave të përfshira dhe administrimin e informacionit gjatë situatave emergjente, në përputhje me detyrat e ngarkuara dhe udhëzimet e autoriteteve përgjegjëse.

Kryetari i bashkisë, duhet të caktojë një person me ekspertizën dhe autoritetin e duhur për të menaxhuar dhe për të bashkërenduar QOECB-së.

Sektorët e QOECB-së, detyrat:

- **Sektori i Planifikimit**
  - **Planifikimi dhe Vlerësimi:** Harton, përditëson dhe analizon planet e emergjencave dhe vlerësimin e dëmeve.
  - **Informimi Publik:** Koordinon komunikimin me publikun dhe median, duke siguruar informacion të saktë dhe të verifikuar.
  - **Dokumentimi dhe Raportimi:** Mban të dhëna për operacionet dhe përgatit raportime për ecurinë e emergjencës.
- **Sektori Operacional**
  - **Koordinimi dhe Zbatimi:** Ekzekuton urdhrat e DOB dhe koordinon operacionet në terren.
  - **Menaxhimi i Burimeve Njerëzore:** Koordinon personelin operacional dhe mbështetës për përgjigjen ndaj emergjencave.
  - **Ndërlidhja/Komunikimi:** Siguron funksionimin dhe gatishmërinë e rrjeteve të komunikimit ndërmjet ekipeve operacionale.
- **Sektori i Logjistikës**
  - **Menaxhimi i Burimeve:** Siguron dhe shpërndan pajisje, furnizime dhe ndihma emergjente.
  - **Siguria dhe Mbrojtja:** Siguron mbrojtjen e personelit dhe infrastrukturës kritike të emergjencës.
  - **Infrastruktura dhe Transporti:** Koordinon mbështetjen për energjinë, ujin, transportin dhe mirëmbajtjen e objekteve të emergjencës.

5.4.2 Bashkërendimi dhe komunikimi në QOECB

Pranë QOECB-së gjatë situatës së emergjencës ose fatkeqësisë mund të atashohen përfaqësues nga të gjitha agjencitë dhe organizatat e përfshira në përgjigje ndaj emergjencës ose mund të marrin pjesë në bashkërendimin dhe takimet e shpërndarjes së informacionit, të organizuara nga QOEB-së.

Takime Bashkërenduese. Në QOECB-së në varësi të situatës së emergjencës mund të zhvillohen takime bashkërenduese të strukturave të përfshira në menaxhimin e emergjencës. Këto takime kanë si ovjektiv:

- Përcaktimin dhe ndarjen e përgjegjësive ndërmjet strukturave të angazhuara.
- Shkëmbimin dhe verifikimin e informacionit mbi situatën emergjente, dëmet dhe nevojat e evidentuara.
- Bashkërendimin e veprimeve dhe përcaktimin e prioriteteve për përballimin e emergjencës.
- Evidentimin e burimeve dhe koordinimin e kërkesave për mbështetje.
- Bashkërendimin e transportit dhe shpërndarjes së ndihmave sipas nevojave të zonave të prekura.
- Koordinimin e informimit të publikut dhe komunikimit me median.
- Dokumentimin e detyrave të caktuara dhe ndjekjen e zbatimit të tyre nga strukturat përgjegjëse.

5.4.3 Mbledhja e informacionit dhe raportimi

QOEB-së ka një rol kryesor në administrimin e informacionit gjatë një situate emergjente. Ajo është përgjegjëse për grumbullimin, përpunimin, evidentimin dhe përcjelljen e të dhënave që lidhen me situatën e krijuar. Për këtë arsye, çdo informacion i marrë apo i transmetuar nga ana e QOEB-së duhet të kontrollohet dhe të administrohet në mënyrë të organizuar, të saktë dhe të besueshme.

Në kuadër të menaxhimit të emergjencave, informacioni që trajtohet nga ana e QOECB-së mund të grupohet në katër kategori kryesore:

- **Informacion mbi drejtimin dhe koordinimin**, që përfshin proceset e vendimmarrjes, përcaktimin e udhëzimeve dhe organizimin e veprimeve ndërmjet strukturave përgjegjëse;
- **Informacion mbi situatën në terren**, i cili pasqyron gjendjen aktuale, ecurinë e situatës emergjente, pasojat e shkaktuara, dëmet e konstatuara dhe nevojat që kërkojnë ndërhyrje;
- **Kërkesa për burime dhe kapacitete operacionale**, që lidhen me sigurimin e personelit, pajisjeve, automjeteve, materialeve dhe formave të tjera të mbështetjes së nevojshme për përballimin e emergjencës;
- **Informacion plotësues**, që përfshin të dhëna të tjera me rëndësi për shkëmbimin e informacionit, bashkërendimin e veprimtarisë së strukturave të përfshira dhe njoftimin e institucioneve apo personave përgjegjës.

5.4.4 Raportimi i situatës

Raportimi i situatës, është një nga proceset kryesore për pasqyrimin e gjendjes gjatë menaxhimit të një ngjarjeje, apo emergjence. Në QOEB-së, ky proces koordinohet kryesisht nga Sektori i Planifikimit, i cili mbledh dhe përpunon informacionin e ardhur nga strukturat dhe personeli i përfshirë në operacion.

Çdo strukturë e QOECB-së ka përgjegjësi për të përcjellë në kohë të dhënat që lidhen me situatën në terren. Për përgatitjen e Raportit të Situatës përdoren informacione nga burime të ndryshme, ndër të cilat përfshihen Sektori i Operacioneve, Sektori i Logjistikës dhe Zyrtari i Informacionit. Të dhënat mund të merren gjithashtu nga strukturat në nivele më të ulëta ose nga autoritetet në nivele më të larta të menaxhimit.

Pas grumbullimit, informacioni analizohet dhe konsolidohet nga Sektori i Planifikimit. Rezultati i këtij procesi shërben për të krijuar një pasqyrë të qartë të situatës dhe për të mbështetur procesin e vendimmarrjes operacionale.

Raporti i përgatitur i paraqitet Koordinatorit të QOECB-së për shqyrtim dhe miratim. Pas miratimit, dokumenti përcillet te Drejtuesi i Operacionit në bashki, i cili e shqyrton dhe e miraton përfundimisht përpara se të paraqitet pranë KMCB-së në bashki.

5.4.5 Kërkesat për burime

Gjatë përballimit të një situate emergjente, nevojat për burime mund të evidentohen nga reaguesit e parë dhe t'i përcillen QOECB-së. Këto kërkesa zakonisht adresohen pranë Sektorit të Operacioneve, i cili i administron dhe i koordinon sipas nevojave të situatës. Në raste të caktuara, kërkesa mund t'i paraqitet drejtpërdrejt edhe Koordinatorit të QOECB-së.

5.4.6 Informacioni i përgjithshëm

Informacioni që lidhet me situatën emergjente mund të shkëmbehet ndërmjet QOECB-së, Qendrës Operacionale të Emergjencave Civile (QOEC-së) pranë Institucionit të Prefektit të qarkut, Njësive Administrative dhe aktorëve të tjerë që veprojnë në territorin e bashkisë. Përpara marrjes së vendimeve apo ndërmarrjes së veprimeve, informacioni i marrë duhet, kur është e nevojshme, të verifikohet dhe të krahasohet me të dhënat e disponueshme në nivele të tjera të menaxhimit.

Të gjitha udhëzimet e dhëna masat e marra nga ana e QOECB-së duhet të dokumentohen. Po kështu, kërkesat për burime duhet të regjistrohen dhe të ndiqen deri në përfundimin e tyre, në mënyrë që të evidentohet kërkesa, përgjigjja e dhënë dhe niveli i përmbushjes së saj.

Në varësi të përmasave dhe intensitetit të emergjencës, secili sektor i QOECB-së duhet të mbajë një regjistër të përditësuar të informacionit dhe veprimeve të kryera gjatë ngjarjes. Ky dokumentim lehtëson ndjekjen e masave të ndërmarra dhe ndihmon në vlerësimin e efektivitetit të reagimit të bashkisë.

Dokumentimi është i rëndësishëm edhe për evidentimin e shpenzimeve dhe përllogaritjen e kostove të shkaktuara nga emergjenca. Të dhënat e regjistruara mund të shërbejnë si bazë për paraqitjen e kërkesave për mbështetje pranë Institucionit të Prefektit të qarkut ose për sigurimin e asistencës nga bashkitë fqinje.

Gjithashtu, informacioni i mbledhur gjatë procesit të vlerësimit të dëmeve dhe nevojave nga strukturat përgjegjëse përbën një bazë të rëndësishme për veprimtarinë e QOECB-së. Qendra siguron grumbullimin, sistemimin dhe përcjelljen e këtij informacioni, duke mbështetur koordinimin e veprimeve dhe komunikimin e kërkesave për ndihmë pranë Prefektit të Qarkut ose bashkive fqinje, në rastet kur kapacitetet vendore nuk janë të mjaftueshme për përballimin e situatës emergjente.

5.4.7 Informacioni publik

QOECB-ja ka përgjegjësi për sigurimin dhe përcjelljen në kohë të informacionit të nevojshëm për publikun dhe veçanërisht për personat që mund të jenë të ekspozuar ndaj rrezikut.

Informacioni i komunikuar duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i përshtatshëm për situatën, në mënyrë që qytetarët të mund të vlerësojnë nëse ndodhen në zonën e rrezikuar dhe të kuptojnë masat që duhet të ndërmarrin.

Komunikimi publik mund të përfshijë të dhëna mbi situatën emergjente, zonat e prekura, masat e sigurisë dhe shërbimet e ofruara, si pikat e shpërndarjes së ushqimit, qendrat e akomodimit ose strukturat e strehimit. Informacioni duhet të përditësohet në varësi të zhvillimit të situatës dhe të përcillet përmes kanaleve të përshtatshme të komunikimit.

5.4.8 Marrëdhëniet me median

Gjatë një situate emergjente, media ka një rol të rëndësishëm në informimin e qytetarëve. Për këtë arsye, QOECB-së duhet të ketë një mënyrë të përcaktuar dhe të koordinuar për komunikimin me mediat, në mënyrë që informacioni i përcjellë te publiku të jetë i saktë, i qartë dhe i njëtrajtshëm.

Për të shmangur përhapjen e informacioneve të pasakta ose kontradiktore, QOECB-së duhet të caktojë një person përgjegjës për informimin publik, i cili vepron si pikë zyrtare komunikimi ndërmjet bashkisë dhe medias.

Në Bashkinë Durrës, përgjegjësia për informimin e publikut gjatë situatave të emergjencave civile do të ushtrohet nga **Zëdhënësi i shtypit** i njëjti person i ngarkuar me këtë funksion edhe në kushte normale, duke garantuar vijimësinë e komunikimit zyrtar, shpërndarjen e informacionit të saktë dhe në kohë, si dhe informimin e qytetarëve mbi situatën emergjente dhe masat që duhet të ndërmerren.

Në varësi të situatës, përgjegjësi për informimin publik duhet të ketë parasysh:

- identifikimin e çështjeve kryesore që duhet t'u bëhen të ditura qytetarëve;
- përgatitjen e mesazheve të thjeshta dhe të kuptueshme për të gjitha grupet e popullsisë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara (PAK);
- përcaktimin e informacionit që duhet të komunikohet me përparësi;
- kontrollin e burimit dhe saktësisë së të dhënave përpara publikimit;
- komunikimin e informacionit përmes kanaleve më të përshtatshme dhe më të shpejta;
- marrjen dhe trajtimin e pyetjeve nga media, qytetarët dhe përfaqësuesit institucionalë;
- identifikimin dhe korrigjimin e informacionit të pasaktë ose thashethemeve që mund të krijojnë konfuzion.

Informacioni që kërkohet zakonisht nga media mund të lidhet me numrin dhe gjendjen e personave të prekur, dëmet materiale, masat e ndërmarra, ndihmën e ofruar, institucionet dhe organizatat e angazhuara, rreziqet e mundshme dhe zhvillimin e situatës.

Komunikimi me median duhet të përdoret gjithashtu si një mjet për të ndihmuar menaxhimin e emergjencës. Informacioni i verifikuar mbi masat e sigurisë, paralajmërimet, zonat e rrezikuara, qendrat e strehimit dhe shërbimet në dispozicion mund t'i ndihmojë qytetarët të marrin masat e nevojshme.

Gjatë emergjencës, Zëdhënësi i shtypit duhet të informojë periodikisht median për zhvillimet kryesore. Në varësi të nevojës, kjo mund të realizohet përmes konferencave për shtyp, deklaratave zyrtare, njoftimeve publike dhe kanaleve të tjera të komunikimit.

5.4.9 Vendndodhja e QOECB

Kriteret për përcaktimin e vendndodhjes.

QOECB-së duhet të vendoset në një ambient të përshtatshëm dhe të sigurt.

Përzgjedhja e vendndodhjes së QOECB-së duhet të marrë parasysh:

- Elementet strukturore të godinës.
- Karakteristikat gjeomorfologjike të zonës përreth.
- Përshtatshmërinë hidrogjeologjike.
- Kushtet e amplifikimit të lëkundjeve gjatë tërmeteve.
- Rrezikun nga rrëshqitjet dhe paqëndrueshmëria e shpateve.
- Rrezikun nga lëngëzimi i tokës.
- Rrezikun hidraulik.
- Rreziqet me origjinë antropike.

Në afërsi të godinës duhet të ketë hapësira të përshtatshme për parkimin dhe akomodimin e mjeteve.

Pajisjet dhe infrastruktura e nevojshme e QOECB-së:

- Sistemi i furnizimit me ujë.
- Furnizimi me energji elektrike.
- Sistemi i ngrohjes.
- Lidhja me internetin.
- Burimi alternativ i energjisë elektrike ose gjeneratori.
- Telefona fiks dhe celularë.
- Radio marrëse-dhënëse.
- Kompjuterë me programet bazë.
- Projektorë dhe videoprojektorë.
- Printer dhe faks.
- Aparat fotografik dhe videokamera.
- Materiale kancelarie.
- Harta të zonës që paraqesin elementet kryesore të planit të emergjencës.
- Etj.,

Të gjitha sistemet dhe pajisjet duhet të jenë funksionale dhe të gatshme për përdorim gjatë situatave emergjente.

Vendndodhjet e QOECB-së në Bashkinë Durrës

- Qendra operacionale kryesore: Salla e Mbledhjeve në godinën e Bashkisë Durrës.
- Qendra operacionale alternative: Pallati i Sportit "Ramazan Njala".

5.5 Struktura e përhershme e mbrojtjes civile

Bazuar në VKM nr. 923, datë 25.11.2020 "Për funksionimin e organizimin të Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe strukturave të sistemit të mbrojtjes civile" në pikën 16, të tij parashikon se Prefekti bashkërendon në bashkitë brenda territorit administrativ të tij për planifikimin pranë tyre të strukturave të përhershme të planifikimit e të mbrojtjes civile. Në këtë kuadër, bashkia duhet të ketë një strukturë të brendshme të përhershme për mbrojtjen civile.

Mbrojtja civile në Bashkinë Durrës ka drejtori më vete. Sipas strukturës së bashkisë, të ndryshuar me Vendimin nr. 01, datë 12.01.2026 "Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores së Bashkisë Durrës", emergjencat civile janë pjesë e Drejtorisë së Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile (DZHRBMC), e cila bashkon në një drejtori mbrojtjen civile me zhvillimin rural, bujqësinë, pyjet e kullotat dhe shërbimin veterinar. Drejtori i drejtorisë drejton dhe bashkërendon drejtpërdrejt sektorin e emergjencave civile. Ky organizim e lidh mbrojtjen civile me strukturat që administrojnë kanalet kulluese dhe ujitëse, fondin pyjor e kullosor dhe gjënë e gjallë, pra me territorin ku ndodhin shumica e përmbytjeve dhe e zjarreve. Drejtoria ka katër sektorë:

- Sektori i Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile: planifikimi i emergjencave, VRF, strategjia dhe PVEC, sekretariati i KMCB-së dhe QOECB, paralajmërimi, evakuimi, strehimi dhe raportimi te Prefekti dhe AKMC; një përgjegjës dhe shtatë inspektorë.
- Sektori i Politikave Bujqësore, Granteve, Ujitjes, Kullimit dhe Këshillimit Bujqësor: kanalet kulluese dhe ujitëse, dëmet në bujqësi dhe mbështetja e fermerëve pas fatkeqësive.
- Sektori i Zhvillimit Rural, Fondit Pyjor, Kullosor dhe Burimeve Natyrore: parandalimi i zjarreve në pyje e kullota, plani vjetor i masave kundër zjarrit dhe rehabilitimi i zonave të djegura, të gërryera ose të rrëshqitura.
- Sektori i Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Konsumatorit: shëndeti i kafshëve, asgjësimi i kafshëve të ngordhura dhe siguria ushqimore pas fatkeqësive.

Detyrat e strukturës së përhershme të mbrojtjes civile, të listuara më poshtë, kryhen nga Sektori i Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, në bashkëpunim me sektorët e tjerë të drejtorisë dhe me drejtoritë e tjera të bashkisë.

Detyrat kryesore të Sektorit të Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile:

- Identifikon, evidenton dhe vlerëson risqet nga fatkeqësitë në territorin administrativ të bashkisë dhe kontribuon në përditësimin e dokumentit të vlerësimit të riskut.
- Informon publikun dhe komunitetet e rrezikuara për risqet ekzistuese dhe masat e mbrojtjes me vëmendje të vecantë personat dhe grupet e popullsise më të cenueshme.
- Propozon masa parandaluese dhe prioritete për uljen e risqeve në territorin e bashkisë.
- Harton, rishikon, zbaton dhe mirëmban Planin Vendor për Emergjencat Civile.
- Bashkërendon veprimtari trajnuese, informuese dhe ushtrime praktike për punonjësit e bashkisë dhe komunitetin, me qëllim rritjen e gatishmërisë për përballimin e emergjencave.
- Verifikon dhe merr masa për funksionimin dhe gatishmërinë e sistemeve të monitorimit, paralajmërimit të hershëm, njoftimit dhe alarmit.
- Siguron marrjen, verifikimin dhe përcjelljen në kohë të informacionit për situatat e krijuara që mund të shkaktojnë emergjencë te strukturat drejtuese të bashkisë dhe institucionet përgjegjëse.
- Mban dhe përditëson evidencat për burimet njerëzore, mjetet, pajisjet, kapacitetet teknike dhe burimet e tjera që mund të angazhohen në përballimin e emergjencave.
- Mban dhe përditëson bazën e të dhënave për dëmet dhe humbjet e shkaktuara nga fatkeqësitë në territorin e bashkisë.
- Evidenton dhe ndjek gatishmërinë e vendeve të strehimit, kapaciteteve të evakuimit dhe strukturave të tjera të përcaktuara në Planin Vendor të Emergjencave Civile.
- Bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për garantimin e kalueshmërisë së rrugëve, veçanërisht të akseve me rëndësi për evakuimin dhe ndërhyrjen emergjente.
- Bashkëpunon me strukturat përkatëse për masat parandaluese dhe mbrojtëse ndaj zjarreve, rrëshqitjeve dhe fatkeqësive të tjera të evidentuara në territor.

- Ndjek gatishmërinë e infrastrukturës së ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmbytjet dhe digave apo rezervuarëve që janë në administrim të bashkisë, dhe mban evidencë për gjendjen, problematikat dhe nevojat për ndërhyrje
- Koordinon, sipas nevojës, aktivizimin e subjekteve publike dhe private, mjeteve dhe kapaciteteve të disponueshme në territor për përballimin e emergjencave/fatkeqësive dhe mban evidencat përkatëse.
- Bashkërendon mbështetjen për grupet e kërkim-shpëtimit dhe të vullnetarëve të angazhuara në përballimin e emergjencave.
- Bashkëpunon për sigurimin e kushteve higjieno-sanitare, furnizimin me energji elektrike dhe ujë, mirëmbajtjen e kanalizimeve dhe kujdesin për personat e prekur nga fatkeqësitë.
- Koordinon shpërndarjen e rezervave ushqimore për njerëzit dhe gjënë e gjallë dhe mban evidencat përkatëse.
- Koordinon dhe merr pjesë në evidentimin, vlerësimin dhe dokumentimin e dëmeve, humbjeve dhe nevojave të krijuara si pasojë e emergjencës/fatkeqësisë.
- Në bashkëpunim me strukturat e tjera të bashkisë kontribuon në evidentimin e nevojave për ndërhyrje urgjente dhe afatmesme për rikthimin e shërbimeve dhe funksioneve jetike.
- Bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për rikthimin në funksion të infrastrukturës dhe shërbimeve të dëmtuara.
- Raporton mbi dëmet, humbjet, masat e marra, burimet e përdorura dhe nevojat për mbështetje gjatë emergjencave civile/fatkeqësive.
- Bashkëpunon me bashkitë fqinje për shkëmbimin e informacionit, koordinimin e kapaciteteve dhe dhënien ose marrjen e asistencës gjatë situatave emergjente.

Në të gjitha fazat e menaxhimit të emergjencave civile, struktura e mbrojtjes civile e bashkisë bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë me:

- departamentet, drejtoritë, sektorët e bashkisë;
- Strukturën përgjegjëse për mbrojtjen civile pranë Prefektit të Qarkut
- Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;
- institucionet dhe strukturat publike përgjegjëse;
- strukturat e shërbimit zjarrfikës, shëndetësisë, policisë dhe strukturat e tjera të emergjencave;
- njësitë administrative të bashkisë;
- subjektet publike dhe private që disponojnë kapacitete të nevojshme;
- organizatat dhe strukturat e tjera që mund të kontribuojnë në përballimin e fatkeqësive;
- bashkitë fqinje, për shkëmbimin e informacionit dhe dhënien ose marrjen e asistencës.
- etj.

5.6 Njësitë administrative dhe strukturat operacionale

5.6.1 Njësitë administrative

Njësitë administrative, mbështesin bashkinë për marrjen e masave parandaluese dhe të zvogëlimit të riskut, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësië në territorin administrativ të njësisë së tyre.

Detyrat kryesore të Administratorit të Njësisë Administrative

1. Identifikimi i risqeve, parandalimi dhe informimi i komunitetit.

- Mbikëqyr territorin, evidenton risqet dhe problematikat që mund të shkaktojnë emergjenca ose fatkeqësi dhe informon në kohë strukturat përgjegjëse për mbrojtjen civile në bashki.
- Njofton menjëherë strukturën e mbrojtjes civile të bashkisë dhe, sipas rastit, strukturat e tjera përgjegjëse për konstatimin e një situate emergjente ose të një rreziku të menjëhershëm.
- Informon komunitetin për risqet e identifikuara dhe masat mbrojtëse ndaj tyre.

- Propozon masa parandaluese për uljen e risqeve që mund të shkaktojnë emergjenca ose fatkeqësi në territorin e njësisë administrative.

2. Evidentimi i burimeve dhe kapaciteteve për përballimin e emergjencave.

- Evidenton dhe përditëson të dhënat për burimet njerëzore, mjetet, materialet dhe kapacitetet e njësisë administrative, si dhe të subjekteve shtetërore e private, organizatave të shoqërisë civile dhe bizneseve që veprojnë në territor dhe mund të kontribuojnë në menaxhimin e emergjencave.

3. Gatishmëria dhe mbështetja për popullsinë e rrezikuar.

- Mbështet, sipas udhëzimeve të bashkisë, zbatimin e masave për njoftimin, evakuimin, strehimin dhe sistemimin e popullsisë së prekur ose të rrezikuar nga emergjencat civile, me vëmendje të veçantë ndaj grupeve vulnerabël.
- Mban dhe përditëson, në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, evidenca të nevojshme për identifikimin dhe asistimin e personave vulnerabël dhe personave që kanë nevojë për ndihmë të veçantë gjatë emergjencave, përfshirë vendbanimin dhe nevojat e tyre për asistencë.
- Në bashkëpunim me kryetarët e fshatrave dhe sipas udhëzimeve të strukturave përgjegjëse, organizon dhe bashkërendon ndihmën e komunitetit për personat vulnerabël, veçanërisht për evakuimin e tyre, deri në mbërritjen e strukturave përkatëse të emergjencës.

4. Bashkëpunimi dhe mbështetja gjatë situatave emergjente

- Merr pjesë, bashkëpunon dhe mbështet strukturat përgjegjëse gjatë veprimeve për përballimin e emergjencave në territorin e njësisë administrative.
- Evidenton dhe përcjell nevojat e komunitetit për ujë, ushqime, strehim, ndihma dhe shërbime të tjera bazë gjatë situatave emergjente.

5. Vlerësimi i dëmeve dhe organizimi i ndihmës emergjente

- Mbështet procesin e evidentimit, vlerësimit dhe dokumentimit të dëmeve, humbjeve dhe nevojave të shkaktuara nga emergjencat civile dhe fatkeqësitë.
- Mbështet, sipas udhëzimeve të bashkisë, organizimin dhe shpërndarjen e ndihmave emergjente në territorin e njësisë administrative dhe mban evidencat përkatëse.

6. Raportimi dhe përmbushja e detyrave të tjera

- Përgatit dhe përcjell te struktura përgjegjëse për mbrojtjen civile raporte dhe informacione periodike mbi gjendjen e gatishmërisë, risqet, problematikat, situatat emergjente, dëmet dhe nevojat në territorin e njësisë administrative.
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara në Planin Vendor për Emergjencat Civile ose të ngarkuara nga Kryetari i Bashkisë dhe strukturat përgjegjëse për mbrojtjen civile, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5.6.2 Strukturat e decentralizuara të institucioneve dhe strukturave qendrore të mbrojtjes civile

Në territorin e Bashkisë Durrës veprojnë struktura të decentralizuara të institucioneve dhe strukturave qendrore të mbrojtjes civile të cilat, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, kontribuojnë në monitorimin e risqeve, parandalimin, përgatitjen, përgjigjen dhe rimëkëmbjen ndaj emergjencave dhe fatkeqësive. Këto struktura angazhohen në përputhje me kompetencat e tyre ligjore, planet përkatëse dhe kërkesat e situatës. Bashkëpunimi me Bashkinë Durrës, Prefektin dhe strukturat e tjera të përgjigjes synon koordinimin e veprimeve dhe përdorimin sa më efektiv të kapaciteteve të disponueshme.

Në rast emergjence, strukturat përkatëse mund të angazhohen në:

- shkëmbimin dhe verifikimin e informacionit mbi situatën;

- vlerësimin e rrezikut dhe të nevojave në territor;
- mbështetjen me personel, mjete, pajisje dhe kapacitete të tjera, sipas kompetencave;
- pjesëmarrjen në grupet e përbashkëta të vlerësimit dhe verifikimit;
- koordinimin e veprimeve me strukturat vendore dhe rajonale;
- zbatimin e detyrave që rrjedhin nga planet dhe aktet përkatëse të mbrojtjes civile.

Drejtuesit e këtyre strukturave janë anëtarë të Komisionit të Mbrojtjes civile në nivel bashkie.

5.6.3 Detyrat e Policisë së Shtetit (PSH) në nivel vendor

Policia e Shtetit angazhohet në përballimin e emergjencave dhe fatkeqësive në përputhje me kompetencat e saj ligjore, planet përkatëse dhe nevojat e situatës. Në bashkëpunim me strukturat e tjera të përgjigjes, ajo kontribuon në garantimin e rendit dhe sigurisë publike dhe në krijimin e kushteve të nevojshme për zhvillimin e sigurt të operacioneve.

Në varësi të llojit dhe shkallës së emergjencës, detyrat kryesore të PSH përfshijnë:

- sigurimin dhe kontrollin e zonës së prekur nga emergjenca;
- ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike;
- menaxhimin e lëvizjes së personave dhe mjeteve, sipas nevojës;
- sigurimin e aksesit dhe të kushteve të nevojshme për strukturat e kërkim-shpëtimit dhe shërbimet e tjera të emergjencës;
- mbështetjen e evakuimit dhe largimit të popullsisë nga zonat e rrezikuara;
- identifikimin dhe administrimin e informacionit për personat e prekur, në përputhje me kompetencat ligjore;
- mbështetjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit dhe të ndërhyrjeve të tjera emergjente;
- kryerjen e detyrave të tjera që burojnë nga legjislacioni në fuqi dhe nga planet përkatëse.

Gjatë angazhimit në operacionet e përgjigjes, strukturat e Policisë së Shtetit veprojnë sipas strukturës së tyre të komandimit dhe bashkëpunojnë me strukturat drejtuese dhe koordinuese të operacionit, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara.

5.6.4 Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH së) në nivel bashkie

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit (MZSH-së) është strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme.

Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore dhe/ose të tjera. Në rastet kur shërbimi zjarrfikës merr pjesë në operacionet e shpëtimit dhe në raste të tjera të fatkeqësive, personeli i shërbimit zjarrfikës komandohet nga drejtuesit e tyre përkatës.

Detyrat kryesore të MZSH-së përfshijnë:

- ndërhyrjen për shuarjen dhe kufizimin e zjarreve;
- kërkimin dhe shpëtimin e personave të rrezikuar;
- ndërhyrjen në aksidente dhe ngjarje të tjera që kërkojnë kapacitete të specializuara;
- mbështetjen e operacioneve të evakuimit, kur kërkohet;
- marrjen e masave për kufizimin e përhapjes së zjarrit dhe të rreziqeve të lidhura me të;
- mbrojtjen e pronës dhe të mjedisit në zonat e prekura;
- bashkëpunimin me Policinë e Shtetit, shërbimet shëndetësore dhe strukturat e tjera të përgjigjes;
- kryerjen e detyrave të tjera të përcaktuara nga legjislacioni dhe planet operacionale.

Veprimtaria e MZSH zhvillohet në përputhje me përgjegjësitë dhe kompetencat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

5.6.5 Shërbimet e Urgjencës Mjekësore (SHUM) dhe strukturat e tjera të kujdesit shëndetësor

Shërbimet e Urgjencës Mjekësore dhe strukturat e tjera të kujdesit shëndetësor janë pjesë e kapaciteteve që angazhohen në përgjigje ndaj emergjencave që shoqërohen me dëmtime, të sëmurë ose rrezik për shëndetin e popullsisë.

Në varësi të natyrës dhe përmasave të ngjarjes, këto struktura sigurojnë ndihmën mjekësore urgjente, vlerësimin dhe stabilizimin fillestar të personave të dëmtuar, si dhe transportimin e tyre drejt strukturave të përshtatshme të kujdesit shëndetësor.

Në kuadër të përgjigjes, detyrat kryesore përfshijnë:

- ofrimin e ndihmës së parë dhe kujdesit mjekësor urgjent;
- vlerësimin dhe klasifikimin fillestar të personave të dëmtuar;
- stabilizimin e gjendjes së të lënduarve;
- transportimin e tyre drejt strukturave shëndetësore përkatëse;
- bashkëpunimin me strukturat e tjera të përgjigjes në zonën e emergjencës;
- marrjen e masave për parandalimin e rreziqeve shëndetësore të shkaktuara nga emergjenca;
- vazhdimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për popullsinë e prekur, sipas nevojave të situatës.

Veprimtaria e SHUM dhe e strukturave të tjera shëndetësore kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat përkatëse të sistemit të kujdesit shëndetësor.

5.6.6 Shërbimi Vullnetar i Mbrojtjes Civile në nivel vendor

Vullnetarët përbëjnë një kapacitet shtesë në mbështetje të strukturave të mbrojtjes civile dhe mund të angazhohen në aktivitetet e parandalimit, përgatitjes dhe përgjigjes ndaj emergjencave dhe fatkeqësive.

Angazhimi i tyre mund të realizohet në mënyrë individuale ose nëpërmjet grupeve dhe organizatave të organizuara, në varësi të nevojave të situatës dhe aftësive të disponueshme. Detyrat konkrete u caktohen nga strukturat kompetente të mbrojtjes civile, në përputhje me natyrën e emergjencës dhe nivelin e rrezikut.

Në varësi të situatës, vullnetarët mund të mbështesin:

- informimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit;
- shpërndarjen e informacionit dhe të ndihmave;
- mbështetjen logjistike të operacioneve;
- asistimin e popullsisë gjatë evakuimit;
- mbështetjen e personave dhe grupeve të cenueshme;
- aktivitete të tjera mbështetëse në përputhje me aftësitë dhe trajnimin e tyre.

Angazhimi i vullnetarëve në aktivitetet dhe operacionet e mbrojtjes civile kryhet në mënyrë të organizuar dhe duke garantuar mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe sigurisë së tyre gjatë ushtrimit të detyrave. Trajtimi i vullnetarëve të angazhuar në aktivitetet e mbrojtjes civile dhe në operacionet për parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe, ndër të tjera, me VKM nr. 667, datë 10.11.2021, "Për trajtimin e vullnetarëve për angazhimin e tyre në

5.7 Koordinimi me Prefektin AKMC dhe bashkitë fqinje

Koordinimi me Prefektin e Qarkut, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) dhe bashkitë fqinje në raste të emergjencave civile realizohet për të garantuar përgjigje të shpejtë, të bashkërenduar dhe efektive

ndaj emergjencave civile, si dhe për të siguruar mbështetje shtesë kur kapacitetet e bashkisë nuk janë të mjaftueshme.

5.7.1 Kanalet e komunikimit

Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet bashkisë dhe Prefektit të qarkut dhe AKMC-së realizohet kryesisht nëpërmjet QOECB-së kur ajo është aktivizuar kurse në rastet e tjera, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për mbrojtjen civile të bashkisë, duke përdorur kanalet zyrtare të komunikimit dhe mjetet e disponueshme të komunikimit, sipas situatës.

Informacioni regjistrohet dhe administrohet nga ana e QOECB-së kur ajo është e aktivizuar dhe struktura përgjegjëse për mbrojtjen civile e bashkisë, duke garantuar gjurmueshmërinë e njoftimeve, kërkesave dhe masave të ndërmarra.

5.7.2 Raportimi

Në rast emergjence, Bashkia siguron raportimin te Prefekti i Qarkut dhe tek AKMC-ja,

Raportimi përfshin, sipas rastit:

- llojin, vendndodhjen dhe shkallën e emergjencës;
- zonat dhe popullsinë e prekur ose të rrezikuar;
- viktimat, personat e dëmtuar dhe personat e evakuuar;
- dëmet e evidentuara në banesa, infrastrukturë dhe shërbime;
- strukturat dhe kapacitetet e angazhuara;
- masat e marra dhe veprimet në proces;
- kapacitetet dhe burimet shtesë të nevojshme.

Informacioni përditësohet dhe përcillet në mënyrë periodike gjatë gjithë kohës së përballimit të emergjencës

5.7.3 Parimi i subsidiaritetit dhe aktivizimi i kapaciteteve

Për përballimin e fatkeqësive, fillimisht përdoren kapacitetet e Bashkisë Durrë s, si njësia e vetëqeverisjes vendore e prekur nga fatkeqësia.

Kur kapacitetet e Bashkisë Durrë s janë të pamjaftueshme për përballimin e situatës së krijuar, kërkohen kapacitete shtesë nga bashkitë fqinje.

Kur kapacitetet e Bashkisë Durrë s dhe të bashkive fqinje janë të pamjaftueshme për përballimin e situatës, kërkohet angazhimi i kapaciteteve të tjera shtetërore, duke përfshirë Policinë e Shtetit dhe Forcat e Armatosura, nëpë rmjet Prefektit të qarkut Durrë s.

Prefekti i Qarkut Durrës, në ushtrim të kompetencave të tij ligjore, koordinon veprimtarinë e institucioneve dhe strukturave përgjegjëse për mbrojtjen civile në nivel qarku dhe bashkërendon angazhimin e kapaciteteve mbështetëse. Kur kapacitetet në nivel qarku janë të pamjaftueshme, kërkohet mbështetje nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, sipas procedurave dhe përgjegjësive të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Kërkesa për mbështetje mund të bëhet menjëherë kur nga vlerësimi fillestar rezulton se kapacitetet vendore nuk janë të mjaftueshme për përballimin e situatës.

5.7.4 Procedura për kërkesën dhe dhënien e mbështetjes

Për të identifikuar nevojat për mbështetje shtesë, bashkia:

- vlerëson kapacitetet në dispozicion dhe mungesat;
- përcakton llojin dhe sasinë e mbështetjes së nevojshme;
- përcakton vendin dhe kohën e nevojshme për mbërritjen e mbështetjes;
- paraqet kërkesën te Prefekti i qarkut nëpërmjet kanaleve zyrtare të komunikimit;
- cakton strukturën përgjegjëse për pritjen, orientimin dhe koordinimin e kapaciteteve të ardhura;
- regjistron kapacitetet dhe burimet e angazhuara.

Kërkesa për mbështetje duhet të përmbajë, sipas mundësisë, informacion mbi situatën, vendndodhjen, nevojat konkrete, kapacitetet e angazhuara dhe kapacitetet shtesë të kërkuara.

5.7.5 Bashkëpunimi me bashkitë fqinje

Bashkia bashkëpunon me bashkitë fqinje për përdorimin e përbashkët të kapaciteteve në përballimin e emergjencave, veçanërisht kur ngjarja prek territore të disa bashkive ose kërkon kapacitete që nuk janë të disponueshme në nivel bashkie.

Mbështetja reciproke mund të përfshijë:

- personel dhe ekipe operacionale;
- mjete dhe pajisje;
- mjete transporti dhe logjistike;
- kapacitete për kërkim-shpëtim dhe evakuim;
- ambiente për strehim të përkohshëm;
- materiale dhe furnizime të nevojshme;
- mbështetje teknike dhe ekspertizë.

Mbështetja ndërmjet bashkive dokumentohet nga struktura përgjegjëse e mbrojtjes civile e bashkisë dhe QOECB-së kur kjo e fundit është e aktivizuar.

5.7.6 Koordinimi me Prefektin e Qarkut

Bashkia bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë me Prefektin e Qarkut, në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen civile dhe në Planin Kombëtar për Emergjencat Civile.

Koordinimi realizohet si në rastet e shpalljes, ashtu edhe në rastet e mosshpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, sipas natyrës, shkallës dhe zhvillimit të situatës.

Në kuadër të këtij koordinimi, bashkia:

- informon në kohë Prefektin e Qarkut për fatkeqësitë në territorin e saj;
- përcjell informacion mbi situatën e krijuar, masat e marra dhe kapacitetet e angazhuara;
- përcjell informacion mbi dëmet, humbjet dhe nevojat e identifikuara për përballimin e fatkeqësisë;
- bashkëpunon me Prefektin e Qarkut për vlerësimin e dëmeve dhe të nevojave;
- shkëmben me Prefektin të dhënat dhe informacionet e nevojshme për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë;
- bashkëpunon për mobilizimin dhe përdorimin e kapaciteteve të disponueshme në nivel vendor dhe në nivel qarku;
- bashkëpunon me strukturat e nivelit të qarkut për marrjen dhe zbatimin e masave të nevojshme për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë;
- kur kapacitetet vendore dhe ato të bashkive fqinje nuk janë të mjaftueshme për përballimin e situatës, paraqet te Prefekti i Qarkut kërkesën për mbështetje;
- kur, pas ezaurimit të kapaciteteve në nivel qarku, kërkohet mbështetje e mëtejshme, Prefekti i Qarkut, sipas kërkesës së Bashkisë dhe në përputhje me kompetencat dhe procedurat në fuqi, i drejton kërkesë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC);

- vijon shkëmbimin e informacionit me Prefektin e Qarkut gjatë gjithë periudhës së përballimit të fatkeqësisë dhe gjatë fazës së rimëkëmbjes.

5.7.7 Koordinimi me AKMC-në

Bashkia bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen civile dhe Planin Kombëtar për Emergjencat Civile.

Në kuadër të këtij koordinimi, bashkia:

- informon në kohë AKMC-në për fatkeqësinë e ndodhur në territorin e saj;
- përcjell informacion mbi situatën, masat e marra, kapacitetet e angazhuara, dëmet dhe nevojat e identifikuara;
- shkëmben informacion me AKMC-në për humbjet nga fatkeqësitë;
- bashkëpunon me AKMC-në për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e masave, sipas kompetencave përkatëse;
- kur kapacitetet vendore dhe ato të nivelit të qarkut nuk janë të mjaftueshme për përballimin e situatës, paraqet kërkesë për mbështetje te Prefekti i Qarkut, i cili, sipas kërkesës së Bashkisë dhe në përputhje me kompetencat dhe procedurat në fuqi, i drejton kërkesë AKMC-së.

Kapitulli 6. Parandalimi dhe lehtësimi

Parandalimi/Lehtësimi është një nga katër fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave, miratuar në nivel kombëtar.

Koncepti i "parandalimit" i referohet një sërë aktivitetesh që mund të ndërmarrë **Bashkia Durrës** për të shmangur plotësisht risqet nga fatkeqësitë e pritshme, të identifikuara në bazë të Vlerësimit të Riskut, si dhe për të parandaluar risqet e reja që mund të shfaqen si rezultat i ngjarjeve të papritura natyrore apo aktiviteteve të shkaktuara nga njeriu, të cilat mund të kenë pasoja të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e njerëzve, mjedisin, infrastrukturën, pasuritë dhe veprimtarinë ekonomike e sociale në territorin e bashkisë.

Lehtësimi, nga ana tjetër, përfshin tërësinë e masave që synojnë zvogëlimin ose minimizimin e ndikimeve negative të një ngjarjeje të rrezikshme. Edhe pse disa risqe nga fatkeqësitë janë të pamundura për t'u eliminuar plotësisht, **Bashkia Durrës** synon, nëpërmjet këtij Plani Vendor për Emergjencat Civile (PVEC), të zvogëlojë cenueshmërinë dhe ekspozimin e komunitetit ndaj tyre, të rrisë kapacitetet vendore për përballimin e pasojave dhe të forcojë më tej sistemet e monitorimit dhe të paralajmërimit të hershëm.

Duke marrë në konsideratë pozicionin gjeografik dhe karakteristikat territoriale të Bashkisë Durrës, masat parandaluese dhe lehtësuese duhet të adresojnë një gamë të gjerë risqesh natyrore dhe të shkaktuara nga aktiviteti njerëzor. Ndër këto përfshihen risku nga përmbytjet, sizmik, zjarret, gjeologjik, teknologjik, biologjik, klimatik, si dhe risqe të tjera që mund të ndikojnë në popullsinë, infrastrukturën kritike, mjedisin dhe aktivitetet ekonomike të territorit.

Bazuar në Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë të Bashkisë Durrës (nëntor 2026), parashikohen një sërë masash parandaluese prioritare strukturore dhe jostrukturore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë në territorin e bashkisë Durrës. Këto masa të parashikuara janë jo vetëm në fushën e përgjegjësisë së bashkisë Durrës, por dhe të institucioneve dhe të strukturave të tjera që veprojnë në nivel vendor dhe të atyre në nivel qendror.

Kodet para emërtimit të masave (p.sh. PM-M1) janë kodet e kapitullit 5 të VRF-së. Kostot orientuese, afatet dhe përgjegjësit e zbatimit jepen në Strategjinë Vendore për ZRF, ku masat grupohen në projektet P01–P26.

6.1 Masat prioritare parandaluese strukturore dhe jostrukturore

- **Masa prioritare parandaluese strukturore**

Sipas përkufizimit të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" "*Masa strukturore" është çdo ndërtim fizik për të zvogëluar ose shmangur impaktet e mundshme të rreziqeve, ose aplikimi i teknikave a teknologjisë inxhinierike për të arritur rezistencën ndaj rrezikut dhe aftësinë ripërtëritëse në struktura ose sisteme.*

Bazuar dokumentit të Vlerësimit të Riskut në nivel vendor për bashkinë Durrës, masat prioritare parandaluese strukturore përfshijnë:

- **Risku nga përmbytjet.**

Masa Strukturore	Përshkrimi	Zona prioritare
PM-M1 Rehabilitimi dhe pastrimi periodik i kanaleve kullues.	Pastrim nga sedimentet, mbetjet dhe zëniet informale;	Ish-Këneta, Sukth, Plazh, Katund i Ri, zona pranë Erzenit
PM-M3 Forcimi dhe përmirësimi fizik i hidrovoreve dhe stacioneve të pompimit	Nëpërmjet realizimit të ndërhyrjeve fizike dhe inxhinierike për rritjen e kapacitetit, rezistencës dhe funksionalitetit të hidrovoreve dhe stacioneve të pompimit, përfshirë sigurimin e kapacitetit rezervë dhe instalimin e gjeneratorëve për furnizim emergjent me energji	Ish-Këneta, Sukth, zonat e ulëta bregdetare

- **Risku sizmik (tërmetet).**

Masa Strukturore	Përshkrimi	Zona prioritare
SZ-M3 Program përforcimi për ndërtesat kritike	Rehabilitim sizmik i objekteve me funksion publik dhe emergjent	Shkolla, spitale, objekte MC, ndërtesa administrative

- **Risku gjeologjik.**

Masa Strukturore	Përshkrimi	Zona prioritare
GJ-M3 Disiplinim i ujërave sipërfaqësore	Kanale drenazhimi, mure mbajtëse, stabilizim skarpatesh	Currila, Rrashbull, rrugë lokale
GJ-M5 Ripyllëzim dhe mbulesë bimore	Reduktim i erozionit dhe stabilizim natyror i shpateve	Ishëm, Rrashbull, Lalëz
GJ-M6 Mirëmbajtje e rrugëve të ekspozuara	Pastrim, sinjalistikë, ndërhyrje parandaluese në pika të rrëshqitjes	Currila, Ishëm, Lalëz

- **Risku nga zjarret.**

Masa Strukturore	Përshkrimi	Zona prioritare
ZJ-M3 Breza zjarrndarës dhe pastrim biomase	Pastrim i materialit të djegshëm, sidomos pranë rrugëve dhe banesave	Ishëm, Manëz, Rrashbull, Lalëz

- **Ndryshimet klimatike**

Masa strukturore	Përshkrimi	Zona prioritare
KL-M2 Gjelbërim urban dhe ulje e ishullit të nxehtësisë	Pemëzim, hijezim, parqe xhepi, materiale reflektuese dhe sipërfaqe të përshkueshme	Qyteti, Plazhi, ish-Këneta
KL-M3 Sisteme të qëndrueshme drenazhimi urban	Drenazhim natyror, basene vonuese, rrugë të përshkueshme, rigjenerim kanalesh	Qyteti, ish-Këneta, Plazhi
KL-M4 Mbrojtje bregdetare dhe restaurim natyror	Duna, ligatina, mbrojtje nga erozioni, monitorim i vijës bregdetare	Lalëz, Rinia, Plazh, grykëderdhje

Masat prioritare parandaluese jostrukturore.

Sipas përkufizimit të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" "Masat jostrukturore" janë masa që nuk përfshijnë ndërtime fizike, të cilat përdorin njohuritë, praktikën ose marrëveshje për të zvogëluar risqet dhe impaktet e fatkeqësive, veçanërisht përmes politikave dhe ligjeve, ngritjes së ndërgjegjësimit publik, trajnimit dhe edukimit.

Bazuar dokumentit të Vlerësimit të Riskut në nivel vendor për bashkinë Durrës, masat prioritare jostrukturore për parandalimin dhe zvogëlimin e risqeve përfshijnë:

- **Risku nga përmbytjet.**

Masa Jostrukturore	Përshkrimi	Zona prioritare
PM-M1 Hartëzimi i pikave kritike të rrjetit kullues	Identifikimi, hartëzimi i pikave kritike të bllokimit, zënieve informale dhe segmenteve që paraqesin problematika për funksionimin e rrjetit kullues.	Ish-Këneta, Sukth, Plazh, Katund i Ri dhe zona pranë Erzenit.
PM-M2 Përditësimi i standardeve të argjinaturave	Vlerësim teknik i argjinaturave të Erzenit dhe Ishmit kundrejt skenarëve 50, 100 dhe 200-vjeçarë	Erzen, Ishëm, Sukth, Katund i Ri
PM-M4 Hartëzim i detajuar i zonave të vërshimit	Harta T=10, T=50, T=100 dhe T=200/500 vjet, të lidhura me popullsinë, rrugët, objektet publike dhe bizneset	E gjithë bashkia, me fokus zonat e ulëta
PM-M7 Kontroll i zhvillimit në zonat e përmbytjes	Kufizim ndërtimi në zona të ulëta dhe zbatim i vërtetimit të riskut për lejet e zhvillimit	Ish-Këneta, Sukth, Plazh, zona pranë lumenjve

- **Risku sizmik (tërmetet).**

Masa Jostrukturore	Përshkrimi	Zona prioritare
SZ-M1 Mikrozonim sizmik dhe gjeoteknik	Hartëzim i truallit, amplifikimit, lëngëzimit dhe kushteve të themelimit, në bashkëpunim me IGJEO	Qyteti, Plazhi, ish-Këneta, zona bregdetare
SZ-M2 Vlerësim strukturor i objekteve publike	Kontroll i shkollave, kopshteve, qendrave shëndetësore, objekteve administrative dhe strehimeve emergjente	E gjithë bashkia
SZ-M4 Kontroll i ndërtesave me "kat të butë"	Identifikim dhe vlerësim i ndërtesave me përdhese tregtare ose parkim, në bashkëpunim me Institutin e Ndërtimit	Qendra urbane, Plazhi
SZ-M5 Integrim i mikrozonimit në lejet e ndërtimit	Kërkesë për studime gjeoteknike të detajuara në zona me truall të dobët	Qyteti, zona bregdetare, ish-Këneta
SZ-M7 Databazë GIS e ndërtesave dhe dëmeve	Regjistër i ndërtesave sipas tipologjisë, moshës, dëmtimeve dhe rëndësisë funksionale	E gjithë bashkia

- **Risku Gjeologjik.**

Masa Jostrukturore	Përshkrimi	Zona prioritare
GJ-M1 Inventar GIS i rrëshqitjeve dhe erozionit.	Hartëzim i zonave aktive, historikut të ngjarjeve, dëmeve dhe nivelit të riskut	Currila, Rrashbull, Ishëm, Lalëz
GJ-M4 Kontroll ndërtimi në shpate	Kërkesë për studime gjeologo-inxhinierike para lejeve në zona të ndjeshme	Kodrat e Durrësit, Rrashbull, Ishëm

- **Risku nga zjarret.**

Masa Jostrukturore	Përshkrimi	Zona prioritare
ZJ-M2 Hartë GIS e hot-spot-eve të zjarrit	Identifikim i zonave me risk të lartë, aksesit, pikave të ujit dhe ndërfaqes pyll-urban (WUI)	Ishëm, Lalëz, Kepi i Rodonit, Rrashbull, Sukth
ZJ-M7 Kontroll i tokave bujqësore të braktisura	Pastrim, menaxhim i biomasës dhe kontroll i djegieve të pakontrolluara	Periferitë, zonat kodrinore

- **Risku teknologjik.**

Masa Jostrukturore	Përshkrimi	Zona prioritare
TK-M1 Inventar GIS i instalimeve me risk	Operatorë, substanca, kapacitete, zona ndikimi, plane emergjence	Porto Romano, port, zona industrial

TK-M2 Protokoll i përbashkët emergjence me operatorët e Porto Romanos dhe Autoritetin Portual	Njoftimi i ndërsjellë, zonat e sigurisë (500 m dhe 1 km), strehimi në vend, evakuimi dhe komunikimi me publikun	Porto Romano, porti, zona industriale
TK-M3 Ushtrim i përbashkët Natech	Ushtrim në tavolinë me MZSH, Policinë, operatorët, AKMC-në dhe Prefektin për skenarin TK-1	Porto Romano
TK-M7 Rrugë të përcaktuara për mallrat e rrezikshme	Kufizime orari dhe itinerari për cisternat në zonat e banuara, në koordinim me Policinë	Aksi port-Porto Romano-autostradë

- **Risku epidemiologjik / biologjik**

Masa Jostrukturore	Përshkrimi	Zona / grupet prioritare
BI-M4 Rritje e mbulesës vaksinale	Fushata në shkolla, kopshte, komunitete me akses të ulët	Fëmijë, komunitete vulnerabël
BI-M8 Protokoll për ujin dhe higjienën pas përmbytjeve	Klorinim, kontroll i cilësisë së ujit dhe dezinfektim i puseve dhe ambienteve në zonat e përmbytura, me NjVKSH dhe Ujësjellësin	Ish-Këneta, Sukth, Katund i Ri
BI-M3 Plan sezonal shëndetësor për turizmin	Kontroll i ujit, ushqimit, higjienës dhe mbetjeve gjatë verës	Bregdeti, Plazhi
BI-M5 Inventar i objekteve për izolim	Objekte publike të përshtatshme për izolim dhe protokolle funksionimi në rast epidemie	Qyteti, NjA

- **Ndryshimet klimatike**

Masa Jostrukturore	Përshkrimi	Zona prioritare
KL-M1 Integrim i PVP 2024–2040 në Strategjinë e ZRF	Lidhje e masave klimatike me riskun nga përmbytjet, zjarret, nxehtësia dhe bregdeti	E gjithë bashkia
KL-M6 Standard klimatik për investimet publike	Çdo projekt rrugor, shkollor, kanalizimi ose hapësirë publike të marrë parasysh skenarët klimatikë	E gjithë bashkia

6.2 Strukturat dhe institucionet, rolet dhe përgjegjësitë e tyre për parandalimin/lehtësimin - bashkia Durrës

Emri i institucionit, strukturës, organizatës.	Rolet dhe përgjegjësitë kryesore në fazën e parandalimit/lehtësimit.
Institucione në nivel bashkie	
Bashkia Durrës Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile	**Nëpërmjet Sektorit të Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile**: • Koordinon planifikimin e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e riskut të fatkeqësive në nivel bashkie, në përputhje me dokumentin vendor të vlerësimit të riskut dhe strategjinë vendore të zvogëlimit të riskut. • Propozon masa organizative, teknike dhe infrastrukturore për shmangien e risqeve të reja.

	• Kontribuon në zhvillimin dhe përmirësimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm dhe të mekanizmave të njoftimit të komunitetit për risqet. • Monitoron zbatimin e masave të parandalimit dhe zvogëlimit të riskut dhe raporton problematikat, nevojat dhe masat që kërkojnë ndërhyrje. **Në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë:** • Merr masa për mbrojtjen e tokës bujqësore, infrastrukturës rurale, prodhimit bujqësor dhe blegtorisë ndaj fatkeqësive. • Identifikon nevojat dhe propozon ndërhyrje për mirëmbajtjen, përmirësimin dhe funksionalitetin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, me qëllim zvogëlimin e riskut nga përmbytjet, thatësirat dhe dëmtimet e tjera. • Promovon praktika bujqësore dhe blegtorale të qëndrueshme ndaj risqeve klimatike dhe fatkeqësive natyrore, si dhe monitoron risqet veterinare dhe sëmundjet e kafshëve. • Merr masa profilaktike dhe te mjekimit për kafshët që ndodhen në zonat peri urbane teë qytetit dhe mban në kontroll situaten epizootike. **Në fushën e pyjeve dhe kullotave**: • Merr masa për hapjen dhe pastrimin e brezave të ndarjes së zjarrit në zonat pyjore për të parandaluar përhapjen e zjarreve. • Merr masa për vendosjen e sinjalistikës treguese dhe tabelave paralajmëruese për rrezikun e zjarreve në pyje dhe zonat e rrezikuara. • Harton plane të menaxhimit të pyjeve dhe resurseve natyrore për të zvogëluar rreziqet e mundshme nga zjarret, dhe përmirësimi i gjendjes së mjedisit. • Zhvillon dhe implementon masa parandaluese për parandalimin e zjarreve në foragjerat, përfshirë ndalimin e aktiviteteve të pasigurta dhe edukimin e komunitetit mbi sigurinë nga zjarret. • Merr masa për orientimin e përdorimit të pyjeve në përputhje me kërkesat ligjore dhe planet e mbarështimit. • Krijon grupe të reagimit të shpejtë dhe kapacitete për shuarjen e zjarreve në pyje, si dhe mbështetje për mbrojtjen e pasurive natyrore nga zjarret e mëdha.
Bashkia Durrës Drejtoria e Turizmit	• Inkurajimi i praktikave të qëndrueshme turistike që respekton planifikimin e qëndrueshëm dhe zvogëlon ndikimin në zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore. • Koordinimi me aktorët turistikë dhe strukturat institucionale për masat parandaluese për rritjen e sigurisë turistike. • **Nëpërmjet Sektorit të Integrimit Evropian dhe ndihmës së huaj:** • Identifikimi dhe hartimi i projekteve për forcimin e kapaciteteve të mbojtjes civile, duke synuar aksesin në fonde të BE-së, IPA dhe organizata ndërkombëtare. Sigurimi që planet e përgatitjes për emergjencat civile të jenë gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme për të gjithë, me masa specifike për sfidat e lidhura me integrimin. • Përafrimi i procedurave të emergjencave civile me praktikat evropiane dhe përmirësimi i aksesit në informacion për popullatën, përfshirë përkthimin në gjuhë të ndryshme për komunitetet që nuk flasin shqip. • Angazhimi me institucione të ndryshme për të harmonizuar përpjekjet në nivel vendor me iniciativat dhe politikat Evropiane në fushën e ZRFdhe MC.

Bashkia Durrës Drejtoria e Burimeve Njerëzore	• Përcakton, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, rolet, detyrat dhe përgjegjësitë e personelit në situata emergjente. • Mban të përditësuara të dhënat e personelit dhe listat e kontakteve, për garantimin e komunikimit në raste emergjence. • Kontribuon në hartimin dhe përditësimin e procedurave të brendshme për funksionimin dhe vazhdimësinë e veprimtarisë së Bashkisë në situata emergjente. • Siguron ruajtjen, administrimin dhe mbrojtjen e dokumentacionit zyrtar dhe planifikon masat për garantimin e disponueshmërisë së tij në situata emergjente.
Bashkia Durrës Drejtoria e Informatikës dhe Dixhitalizimit	• Garanton sigurinë dhe mbrojtjen e sistemeve dhe të dhënave, duke zbatuar masat e nevojshme të sigurisë informatike dhe kibernetike. • Mirëmban dhe monitoron infrastrukturën IT, përfshirë serverat, rrjetet, pajisjet elektronike dhe sistemet e komunikimit. • Identifikon sistemet dhe shërbimet informatike kritike dhe përcakton masat për garantimin e vazhdimësisë së tyre gjatë emergjencave. • Hartojnë dhe përditëson procedurat teknike për mbrojtjen, rikuperimin dhe vazhdimësinë e sistemeve informatike në situata emergjente. • Siguron dokumentimin dhe ruajtjen e informacionit teknik për sistemet, pajisjet, konfigurimet dhe procedurat e rikuperimit. • Bashkëpunon me strukturat e tjera të Bashkisë dhe institucionet kompetente për forcimin e sigurisë, gatishmërisë dhe qëndrueshmërisë së infrastrukturës informatike.
Bashkia Durrës Drejtoria Ligjore	• Hartimi i akteve ligjore dhe udhëzimeve që rregullojnë procedurat dhe masat për parandalimin e emergjencave në nivel vendor. • Hartimi i kontratave për furnizimin me materiale, mjete dhe shërbime të nevojshme për reagimin ndaj emergjencave, si ushqime, pajisje për shuarjen e zjarreve, ndihma të shpejta, etj. • Përgatitja dhe mbështetje për nënshkrimin e marrëveshjeve dhe protokolleve me institucione të tjera, si autoritetet e qeverisjes qendrore, organizatat ndërkombëtare, ose organizatat joqeveritare për mbështetje dhe bashkëpunim në rast emergjencash. • Hartimi i kontratave të nevojshme për ndërtimin ose përmirësimin e infrastrukturës që mund të jetë e nevojshme për parandalimin e emergjencave. • Sigurimi që të gjitha procedurat ligjore të jenë të qarta për reagimin ndaj emergjencave, duke përfshirë procedurat e shpalljes së gjendjes së emergjencës, shpërndarjen e ndihmave, dhe organizimin e grupeve të reagimit të shpejtë.
Bashkia Durrës Drejtoria e Arsim Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare	• Evidenton dhe raporton problematikat infrastrukturore në institucionet arsimore, kulturore dhe sportive që mund të rrisin riskun nga fatkeqësitë. • Bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për identifikimin dhe propozimin e masave parandaluese për reduktimin e cenueshmërisë së këtyre institucioneve.

	• Nxit përfshirjen e masave për zvogëlimin e riskut në planifikimin e investimeve dhe mirëmbajtjen e objekteve arsimore, kulturore dhe sportive.
Bashkia Durrës Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit.	• Zbatimi i Vendimit nr. 1162, datë 24.12.2020: Sigurimi që të gjitha aplikimet për leje zhvillimi ose ndërtimi përmbushin kërkesën për pajisje me vertetim risku nga autoriteti kompetent. • Përcaktimi i zonave me risk të lartë: Hartimi dhe përditësimi i hartave të riskut (p.sh., për përmbytje, tërmete, rrëshqitje toke, risqe teknologjike) për të udhëhequr proceset e planifikimit territorial. • Integrimi i analizës së riskut në planet urbanistike: Përcaktimi i kritereve të ndërtimit bazuar në analizat e rrezikut për të minimizuar ekspozimin dhe cenueshmërinë e ndërtimeve të reja. • Monitorimi i respektimit të standardeve të ndërtimit: Sigurimi që projektet zhvillimore respektojnë standardet për sigurinë sizmike, hidrologjike dhe gjeoteknike. • Konsultimi me ekspertë dhe institucione relevante: Bashkëpunimi me institucione shkencore dhe teknike për të vlerësuar dhe minimizuar risqet territoriale. • Propozon masa për zvogëlimin e cenueshmërisë së territorit, nëpërmjet planifikimit të hapësirave publike, gjelbërimit dhe zhvillimit urban të qëndrueshëm. • Kontribuon në zvogëlimin e riskut klimatik dhe mjedisor, përmes politikave të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve. • Bashkëpunon me strukturat përgjegjëse të Bashkisë dhe institucionet kompetente për identifikimin e faktorëve të riskut dhe përcaktimin e masave parandaluese në territorin e Bashkisë Durrës. • Hartimi dhe zbatimi i masave për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, objekteve historike dhe institucioneve kulturore nga rreziqet natyrore dhe njerëzore, duke përfshirë përmirësimin e rezistencës së tyre ndaj fatkeqësive.
Bashkia Durrës Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Trasnportit Publik.	• Hartimi dhe implementimi i projekteve dhe investimeve që synojnë përmirësimin e infrastrukturës dhe kapaciteteve të bashkisë për t'u përballur me emergjencat. • Prioritizimi i projekteve që kanë impakt të drejtpërdrejtë në uljen e dëmeve nga fatkeqësitë, si ndërtimi i infrastrukturës që mund të mbrojë zonat e pasigurta nga përmbytjet, tërmetet ose zjarret. • Sigurimi i financimeve të nevojshme për realizimin e projekteve të parandalimit të emergjencave. • Krijimi i partneriteteve dhe bashkëpunimit me institucione dhe agjenci të tjera, për të siguruar mbështetje dhe financime për projektet e parandalimit të emergjencave. • Zhvillimi dhe implementimi i sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit të performancës për projektet dhe investimet, për të siguruar që ato janë të efektshme në parandalimin e emergjencave.
Bashkia Durrës Drejtoria e Shërbimeve Sociale	• Sigurimi dhe ofrimi i informacionit mbi planin dhe masat e parandalimit dhe lehtësimit në mbrojtjen civile për strukturat që varen nga Drejtoria, me fokus në grupet më të cenueshme. • Hartimin i planeve vendore në mbështetje të personave në nevojë.

Bashkia Durrës Drejtoria e Buxhetit	• Sigurimi i burimeve financiare për menaxhimin e emergjencave civile në territorin e Bashkisë Durrës, duke identifikuar fondet e nevojshme dhe burimet e mundshme të financimit. • Planifikimi dhe buxhetimi i fondeve për masat parandaluese, gatishmërinë, përgjigjen emergjente dhe procesin e rimëkëmbjes, duke integruar nevojat financiare në buxhetin vjetor të bashkisë. • Monitorimi, menaxhimi dhe raportimi i përdorimit të fondeve në të gjitha fazat e menaxhimit të emergjencave, duke siguruar transparencë dhe efikasitet në shpërndarjen dhe përdorimin e financave publike për situatat emergjente.
Bashkia Durrës Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit i Njësisë Vendore	• **Zbatimi i dispozitave të Vendimit nr. 1162,** datë 24.12.2020, për procedurat e vërtetimit të riskut nga autoritetet përgjegjëse për subjektet që kërkojnë leje zhvillimi ose ndërtimi, në rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. • **Verifikimi i zbatimit të legjislacionit dhe standardeve** të sigurisë gjatë zhvillimit të territorit, me qëllim konstatimin e shkeljeve që mund të shtojnë rrezikun dhe cenueshmërinë ndaj fatkeqësive. • **Identifikimi, evidentimi i ndërtimeve të paligjshme në** territoret e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore, si përmbytjet, rrëshqitjet e tokës dhe tërmetet, si dhe trajtimi i tyre në përputhje me kompetencat dhe procedurat ligjore. • **Parandalimi i zhvillimit të pakontrolluar të territorit**, nëpërmjet inspektimeve periodike dhe marrjes së masave administrative ndaj ndërhyrjeve të paligjshme që cenojnë sigurinë e territorit dhe të popullatës. • **Bashkëpunimi me strukturat e mbrojtjes civile** dhe institucionet përgjegjëse për shkëmbimin e të dhënave mbi zonat me risk, si dhe për evidentimin e ndërhyrjeve që mund të shtojnë ekspozimin ndaj fatkeqësive.
Bashkia Durrës Policia bashkiake	• **Kontrolli i masave për parandalimin e risqeve:** Verifikimi periodik i zbatimit dhe funksionalitetit të masave parandaluese, duke përfshirë mirëmbajtjen e sinjalistikës rrugore dhe menaxhimin e qarkullimit në zonat me rrezik të lartë, në përputhje me rregullat dhe standardet përkatëse të sigurisë. • **Ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi i komunitetit:** Organizimi i fushatave mbi masat parandaluese të risqeve dhe mbrojtjen civile. • **Inspektimi i zonave me rrezik të lartë:** Kryerja e kontrolleve në rrugë dhe në infrastrukturën përkatëse në zonat e identifikuara si problematike, me qëllim verifikimin e pranisë dhe përshtatshmërisë së masave mbrojtëse, përfshirë sinjalistikën paralajmëruese dhe barrierat e sigurisë.
Bashkia Durrës Sektori i Shërbimit të MZSH	• Sigurimi i hapësirave të përshtatshme të kalimit për të gjitha objektet publike dhe private, në mënyrë që mjetet zjarrfikëse të mund të ndërhyjnë shpejt dhe pa pengesa në rast emergjence. • Sigurimi i ndërtesave me pajisje për shuarjen e zjarrit, siç janë aparatet me pluhur të thatë, me qëllim parandalimin e përhapjes së zjarreve dhe reduktimin e rrezikut që ato paraqesin. • Verifikimi periodik i gjendjes së kutive shpërndarëse dhe instalimeve elektrike, duke kontrolluar nëse ato janë montuar dhe mirëmbahen në përputhje me standardet dhe kërkesat e sigurisë elektrike. • Inspektimi i ndërtesave për të vlerësuar praninë dhe funksionalitetin e hidrantëve të brendshëm dhe të jashtëm, si

	dhe kontrolli i kapacitetit dhe funksionimit të burimeve të furnizimit me ujë për ndërhyrje në rast zjarri. • Vlerësimi i kushteve të evakuimit në ndërtesa përmes kontrollit të shkallëve emergjente. Në rastet kur këto mungojnë ose nuk plotësojnë kërkesat e nevojshme, duhet të ndërmerren masa për instalimin dhe përmirësimin e tyre. • Vendosja e tabelave dhe shenjave paralajmëruese në pozicione lehtësisht të dallueshme, duke përfshirë ndalimin e pirjes së duhanit dhe njoftimet për rreziqet e mundshme të zjarrit, me synim rritjen e ndërgjegjësimit dhe parandalimin e incidenteve.
Bashkia Durrës Njësitë Administrative	• Pjesëmarrje së bashku me struktura të tjera të bashkisë në procesin e identifikimit, analizës dhe vlerësimit të risqeve nga fatkeqësitë. • Kontribut në hartimin e planit vendor për emergjencat civile dhe strategjinë vendore për ZRF. • Organizimi i fushatave edukative për banorët mbi masat parandaluese dhe procedurat e reagimit në rast emergjencash. • Në bashkëpunim me strukturat e bashkisëë, asistimi dhe mbështetja në zbatimin e masave mbrojtëse, duke përfshirë ndërtimin e kanaleve kulluese, mureve mbrojtëse dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore, me qëllim zvogëlimin e ekspozimit ndaj risqeve. • Kontribut në sistemin e paralajmërimit të hershëm, duke ndihmuar në monitorimin e situatave të rrezikut, transmetimin e njoftimeve dhe aktivizimin e mekanizmave të alarmit në komunitet.
Institucione në nivel qarku	
Prefekti i Qarkut Durrës Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave	**Vlerësimi i Riskut:** • Hartimi dhe miratimi i dokumentit të vlerësimit të riskut në nivel qarku në bashkëpunim me bashkitë dhe institucionet përkatëse. • Koordinimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë në territorin e tyre, si dhe për informimin e publikut mbi risqet e identifikuara. • Hartimi dhe përditësimi i vazhdueshëm i hartave të riskut, ku evidentohen zonat e cenueshme ndaj llojeve të ndryshme të rreziqeve në territorin e qarkut. **Koordinimi i aktiviteteve për zvogëlimin e riskut:** • Koordinimi i veprimtarisë së institucioneve dhe strukturave në nivel qarku për zvogëlimin e riskut dhe mbrojtjen civile. • Mbikëqyrja e integrimit të masave për zvogëlimin e riskut në politikat dhe programet zhvillimore të bashkive. **Menaxhimi i informacionit dhe të dhënave:** • Krijimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë në nivel qarku dhe shkëmbimi i informacioneve me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. **Monitorimi dhe sistemi i paralajmërimit të hershëm:** • Sigurimi i funksionimit të sistemeve të monitorimit, paralajmërimit të hershëm dhe alarmit për rreziqet në territorin e qarkut. • Mbikëqyrja e mekanizmave të monitorimit të rreziqeve dhe informimi në kohë i bashkive dhe komuniteteve të rrezikuara. • Bashkëpunimi me operatorët telekomunikues për garantimin e shpërndarjes së shpejtë të mesazheve të emergjencës. **Parandalimi dhe lehtësimi i pasojave:**

	• Vendosja e prioriteteve për investime emergjente dhe masat për parandalimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin nga fatkeqësitë. • Bashkëpunimi me bashkitë dhe strukturat qendrore për të siguruar masa efektive në zvogëlimin e pasojave të fatkeqësive. **Promovimi i kulturës së sigurisë:** • Bashkëpunimi me AKMC dhe institucionet e tjera për ndërgjegjësimin dhe edukimin e komunitetit. • Mbështetja e bashkive në zhvillimin e programeve edukative për mbrojtjen civile dhe reagimin ndaj fatkeqësive. **Bashkëpunimi ndërinstitucional:** • Lehtësimi i shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit ndërmjet bashkive për përballimin e sfidave të përbashkëta në zvogëlimin e riskut. • Krijimi i mekanizmave të përbashkët ndërmjet nivelit vendor dhe qendror për forcimin e kapaciteteve në parandalimin e fatkeqësive. • Përgatitja e raporteve periodike për AKMC mbi statusin e masave parandaluese dhe rekomandimet për përmirësim.
Përfaqësues të FA në territorin e bashkisë.	• Siguron gatishmërinë në Forcat e Armatosura dhe koordinimin me autoritetet vendore për integrimin e kapaciteteve ushtarake në fazën e parandalimit dhe lehtësimit të emergjencave. • Mbështetja e bashkive në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve specifike të zonës. • Promovimi i kulturës së sigurisë dhe gatishmërisë ndaj emergjencave • Pjesëmarrja në aktivitete ndërgjegjësuese trajnime dhe simulime për forcimin e kapaciteteve të komunitetit ndaj rreziqeve. • Bashkëpunimi me autoritetet vendore për të informuar publikun mbi praktikat më të mira për zvogëlimin e risqeve.
Drejtoria Rajonale e OSSHE-së	**Monitorimi i rreziqeve të furnizimit me energji elektrike** • Kontrolli periodik i rrjetit të shpërndarjes për të evidentuar rreziqet që mund të çojnë në defekte të shumta. • Parandalimi i mbingarkesave në rrjet gjatë periudhave të konsumit të lartë për të shmangur prishjet dhe ndërprerjet. • Implementimi i sistemeve inteligjente të shpërndarjes për monitorimin dhe optimizimin e shpërndarjes së energjisë. **Menaxhimi i infrastrukturës kritike** • Investimi në rrjetin e shpërndarjes për ta bërë më rezistent ndaj faktorëve klimatikë dhe ngarkesave të papritura. • Forcimi i kabllove ajrore dhe nënkalimi i tyre në zonat e rrezikuara nga erozioni ose rrëshqitjet e tokës. • Mirëmbajtja periodike e linjave dhe stacioneve shpërndarëse për të zvogëluar rrezikun e defekteve. **Bashkëpunimi dhe koordinimi** • Koordinimi me bashkitë dhe njësitë administrative për mbrojtjen e infrastrukturës energjetike dhe hartimin e masave parandaluese. • Identifikimi i zonave me rrezik të lartë për të siguruar masa mbrojtëse dhe për të shmangur ndërprerjet e energjisë në sektorët kritikë. • Garantimi i furnizimit të pandërprerë për institucionet strategjike si spitalet dhe stacionet e pompimit të ujit. **Ndërgjegjësimi i publikut** • Informimi i komunitetit mbi përdorimin e sigurt të energjisë dhe parandalimin e mbingarkesave.

	• Krijimi i një mekanizmi efektiv komunikimi për njoftimet mbi mirëmbajtjen dhe ndërprerjet e planifikuara. • Sigurimi i shërbimit të mbështetjes teknike për abonentët në rast të emergjencave elektrike.
OST Durrës	**Monitorimi i rreziqeve të furnizimit me energji elektrike** • Kryerja e analizave të rreziqeve për rrjetin e transmetimit, duke përfshirë ndikimin e motit ekstrem, ngarkesat e tepërta dhe faktorët gjeologjikë. • Inspektimi i linjave të tensionit të lartë për të shmangur dëmtime nga stuhitë, zjarret ose ndërhyrjet e jashtme. • Zbatimi i teknologjive inteligjente për mbikëqyrjen e rrjetit në kohë reale dhe optimizimin e furnizimit. **Menaxhimi i infrastrukturës kritike** • Identifikimi i pikave kritike të sistemit të transmetimit në rajonin e Durrësit dhe investimi në masat mbrojtëse (përforcimi i shtyllave, instalimi i izolatorëve rezistentë ndaj kushteve atmosferike). • Mirëmbajtja dhe përmirësimi i rrjetit të transmetimit për të zvogëluar rrezikun e ndërprerjeve masive. • Sigurimi i furnizimit të vazhdueshëm për infrastrukturën kritike dhe publike (spitale, institucione shtetërore, qendra operacionale të emergjencave). **Bashkëpunimi dhe koordinimi** • Koordinimi me Prefekturën dhe bashkitë për të siguruar mbrojtjen e infrastrukturës energjetike dhe për të hartuar plane për menaxhimin e risqeve. • Identifikimi dhe menaxhimi i zonave me ndjeshmëri të lartë ku ndërprerjet e transmetimit mund të shkaktojnë pasoja të mëdha në sektorët strategjikë dhe komunitete. • Vendosja e mekanizmave të komunikimit të drejtpërdrejtë me Prefekturën, njësitë e emergjencave dhe operatorët e shpërndarjes për të siguruar koordinimin e shpejtë dhe efektiv gjatë situatave emergjente. **Ndërgjegjësimi dhe masat parandaluese** • Informimi i institucioneve dhe bizneseve mbi masat parandaluese për sigurinë e furnizimit me energji. • Organizimi i trajnimeve për institucionet lokale mbi sigurinë dhe masat e parandalimit për furnizimin me energji.
Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë	**Planifikimi dhe zbatimi i masave antisizmike:** • Hartimi dhe zbatimi i masave specifike për forcimin strukturor dhe mbrojtjen antisizmike të objekteve të trashëgimisë kulturore, në përputhje me standardet për mbrojtjen e trashëgimisë në zona të ekspozuara ndaj riskut sizmik. **Bashkëpunimi për masa preventive:** • Bashkëpunimi me institucione qendrore dhe vendore, organizata ndërkombëtare, dhe donatorë për të realizuar: – Projekte për përmirësimin e infrastrukturës së trashëgimisë kulturore. – Nisma për të integruar teknologjitë moderne në mbrojtjen e trashëgimisë (p.sh., përdorimi i sensorëve për monitorim sizmik). **Ndërgjegjësimi dhe edukimi publik:** • Organizimi i fushatave për ndërgjegjësimin e komunitetit lokal mbi rëndësinë e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe masat për parandalimin e dëmtimeve.

	• Bashkëpunimi me shkollat dhe qendrat kulturore për të edukuar brezat e rinj mbi vlerën e trashëgimisë kulturore dhe metodat për mbrojtjen e saj.
Administrata e Zonave të Mbrojtura Durrës	• **Menaxhimi i burimeve natyrore dhe biodiversitetit:** Monitoron dhe menaxhon zonat e mbrojtura për të parandaluar degradimin e habitateve dhe për të ruajtur biodiversitetin, duke minimizuar risqet mjedisore që ndikojnë në fatkeqësitë natyrore. • **Parandalimi i zjarreve dhe degradimit të pyjeve:** - Zhvillon dhe zbaton masa parandaluese për zjarret në pyje, duke përfshirë krijimin e korsive të ndalim-zjarrit dhe kontrollet periodike mbi aktivitetet me rrezik të lartë. Bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për të siguruar zbatimin e rregulloreve për mbrojtjen e pyjeve dhe parandalimin e ndotjes. • **Ndërgjegjësimi dhe edukimi për mbrojtjen e zonave të mbrojtura:** - Ofron fushata informuese dhe trajnime për publikun dhe strukturat vendore mbi rëndësinë e mbrojtjes së ekosistemeve dhe masat që duhen marrë për të parandaluar degradimin e zonave të mbrojtura. • **Monitorimi dhe raportimi mbi risqet mjedisore:** - Identifikon dhe vlerëson risqet mjedisore që mund të ndikojnë në zonat e mbrojtura, si zjarret, përmbytjet dhe erozioni, duke integruar këto analiza në planifikimin strategjik për parandalimin e emergjencave. • **Bashkëpunimi institucional për mbrojtjen e zonave të mbrojtura.** - Koordinon veprimtarinë me institucionet qendrore dhe vendore për të siguruar një menaxhim të integruar të zonave të mbrojtura, duke përfshirë monitorimin e aktiviteteve që mund të ndikojnë negativisht në ekosisteme.
Drejtoria Rajonale e AKU- Durrës	**Monitorimi dhe kontrolli i sigurisë ushqimore:** • Siguron përputhshmërinë e produkteve ushqimore, ushqimeve për kafshë dhe inputeve bujqësore me standardet higjieno-sanitare dhe fitosanitare për të parandaluar rreziqet për konsumatorët. • Kryen inspektime të rregullta për identifikimin e praktikave të pasigurta dhe vendos masa parandaluese ndaj operatorëve që nuk përmbushin kriteret ligjore. **Vlerësimi dhe parandalimi i risqeve ushqimore:** • Analizon faktorët që mund të ndikojnë në sigurinë ushqimore dhe merr masa për parandalimin e ndotjeve kimike, mikrobiologjike dhe fizike të ushqimeve. • Bashkëpunon me institucionet e shëndetit publik për monitorimin e cilësisë së furnizimeve ushqimore dhe për zbatimin e standardeve të sigurisë ushqimore. • Përmirësimi i kapaciteteve dhe ndërgjegjësimi. • Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për operatorët e biznesit ushqimor dhe publikun mbi praktikat e sigurta të përpunimit, ruajtjes dhe konsumit të ushqimit. • Mbështet trajnime për aktorët e përfshirë në zinxhirin ushqimor për të forcuar kapacitetet parandaluese ndaj risqeve ushqimore. **Planifikimi për sigurinë ushqimore në raste emergjencash:** • Harton masa parandaluese për garantimin e furnizimit me ushqime të sigurta në situata të jashtëzakonshme. • Bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për të siguruar një zinxhir furnizimi të qëndrueshëm dhe të kontrolluar në rast të krizave ushqimore.

Zyra e Administrimit të Basenit Ujor (ZABU) **Ishëm – Erzen – Mat**	**Monitorimi dhe vlerësimi i burimeve ujore:** • Mbledh dhe përditëson të dhënat mbi sasinë dhe cilësinë e burimeve ujore në basenin lumor. • Monitoron ndikimin e faktorëve natyrorë dhe njerëzorë mbi burimet ujore dhe harton raporte mbi rreziqet dhe kërcënimet e mundshme. **Menaxhimi i risqeve të lidhura me ujërat:** • Analizon dhe parashikon rreziqet e përmbytjeve dhe thatësirave, duke hartuar plane parandaluese dhe masa mbrojtëse. • Koordinon zbatimin e kushteve të lejeve dhe autorizimeve për përdorimin e ujit me qëllim parandalimin e dëmtimit të ekosistemeve ujore. **Planifikimi dhe koordinimi për zvogëlimin e riskut:** • Bashkëpunon me institucionet qendrore dhe vendore për zbatimin e strategjive për mbrojtjen dhe menaxhimin e burimeve ujore. • Harton dhe ndjek zbatimin e planeve të menaxhimit të baseneve ujore, duke përfshirë masa për zvogëlimin e ndikimeve të fatkeqësive natyrore në furnizimin me ujë. **Sistemet e paralajmërimit dhe ndërgjegjësimi publik:** • Përgatit dhe shpërndan informacion për komunitetet e rrezikuara mbi masat e mbrojtjes dhe përdorimin e qëndrueshëm të ujit. • Bashkëpunon me Këshillin e Basenit Ujor për të përcaktuar prioritetet e ndërhyrjeve dhe masave parandaluese.
Agjencia Rajonale Ekstensionit Bujqësor Tiranë/ Sektori i Ekstensionit Bujqësor (SEB) Durrës,	**Ndërgjegjësimi dhe edukimi i fermerëve:** • Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe fushatave informuese për fermerët mbi mbrojtjen dhe shpëtimin e bimëve dhe produkteve bimore nga faktorët e rrezikut. • Trajnimi i fermerëve mbi teknikat e parandalimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve për të reduktuar ndikimin e rreziqeve natyrore dhe klimaterike. **Monitorimi dhe kontrolli i shëndetit të bimëve:** • Mbikëqyrja dhe vlerësimi i gjendjes shëndetësore të bimëve dhe produkteve bimore për të identifikuar dhe parandaluar përhapjen e sëmundjeve dhe dëmtuesve. • Sigurimi i informacionit për fermerët mbi masat mbrojtëse dhe përdorimin e inputeve bujqësore në përputhje me standardet e sigurisë dhe mjedisit. **Planifikimi dhe mbështetja teknike:** • Asistimi i fermerëve në zbatimin e praktikave të qëndrueshme bujqësore për të zvogëluar ndikimin e faktorëve të jashtëm në rendimentin e prodhimit. • Ofrimi i këshillimit për përdorimin e teknologjive inovative në bujqësi për të rritur aftësinë ripërtëritëse ndaj rreziqeve natyrore. **Koordinimi dhe bashkëpunimi:** • Bashkëpunimi me institucionet përkatëse për mbledhjen e të dhënave mbi ndikimin e fenomeneve natyrore në sektorin bujqësor dhe për hartimin e strategjive parandaluese. • Sigurimi i shkëmbimit të informacionit dhe praktikave më të mira me institucionet e kërkimit shkencor dhe organizatat mbështetëse për bujqësinë.
Agjencia Rajonale e Mjedisit	**Vlerësimi i risqeve dhe planifikimi mjedisor** • Kryerja e vlerësimeve të risqeve dhe mjedisore në rajon, duke analizuar rreziqet, ekspozimin, cenueshmërinë dhe ndikimet e mundshme mbi ekosistemet dhe komunitetet

	• Zhvillimi i strategjive për mbrojtjen e ekosistemeve që zvogëlojnë ndikimet e fatkeqësive mjedisore. • Ofrimi i udhëzimeve teknike për përdorimin e tokës dhe zonimin për të minimizuar risqet mjedisore dhe ndikimet e urbanizimit në zonat e mbrojtura. **Monitorimi dhe raportimi:** • Monitorimi i cilësisë së ajrit, ujit, tokës dhe burimeve natyrore, duke identifikuar rreziqe që mund të kërcënojnë shëndetin publik. • Informimi i autoriteteve për çdo kërcënim mjedisor, si ndotje kimike apo degradim ekosistemesh. **Paralajmërimi i hershëm dhe masat parandaluese:** • Zbatimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm për fatkeqësi mjedisore si përmbytjet, rrëshqitjet e tokës apo ndotjet masive. • Hartimi dhe zbatimi i planeve për mbrojtjen dhe ruajtjen dhe restaurimin e burimeve natyrore. **Mbështetje dhe ndërgjegjësim:** • Sigurimi i të dhënave dhe politikave për zvogëlimin e risqeve mjedisore në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. • Organizimi i aktiviteteve për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi risqet mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit.
Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë	• Monitorimi dhe kontrolli i shëndetit të kafshëve dhe bimëve për të parandaluar shpërthimet e sëmundjeve infektive dhe dëmtuesve që mund të ndikojnë në shëndetin publik dhe ekonominë bujqësore. • Hartimi dhe zbatimi i masave të biosigurisë në fermat blegtorale dhe zonat bujqësore për të reduktuar përhapjen e sëmundjeve dhe ndotjen nga pesticidet ose substancat e tjera të dëmshme. • Organizimi i aktiviteteve edukative dhe fushatave ndërgjegjësuese për fermerët dhe operatorët e sektorit mbi menaxhimin e shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjen e bimëve nga faktorët e rrezikut. • Inspektimi i fermave dhe subjekteve agro-veterinare për të siguruar përputhshmërinë me standardet e sigurisë ushqimore dhe të shëndetit të kafshëve e bimëve. • Bashkëpunimi me institucionet përkatëse për menaxhimin e rreziqeve që lidhen me shëndetin e kafshëve dhe bimëve, si dhe me autoritetet përgjegjëse për emergjencat bujqësore. • Sigurimi i mbledhjes dhe analizimit të të dhënave për të vlerësuar rreziqet dhe për të marrë masa parandaluese në kohë. • Marrja e masave për kontrollin dhe menaxhimin e përdorimit të produkteve veterinare dhe fitosanitare, duke parandaluar ndikimet negative në shëndetin e kafshëve, bimëve dhe mjedisin.
Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës	**Përgatitja dhe mirëmbajtja:** • Kryerja e mirëmbajtjes dhe pastrimit të vazhdueshëm të kanaleve të ujitjes dhe kullimit për të parandaluar përmbytjet dhe degradimin e tokës.

	• Identifikimi i zonave me rrezik për grumbullimin e ujërave dhe marrja e masave parandaluese për të siguruar funksionalitetin e rrjetit të kullimit. • Zbatimi i masave strukturore dhe jostrukturore të nevojshme për rritjen e kapaciteteve. • Monitorimi i kapaciteteve hidraulike të kanaleve dhe propozimi i investimeve për përmirësimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit. **Planifikimi dhe koordinimi:** • Hartimi i planeve për menaxhimin efektiv të sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë masat për përballimin e kushteve ekstreme të motit si pasojë e ndryshimeve klimatike . • Koordinimi me autoritetet lokale për të siguruar që masat për ujitjen dhe kullimin janë në përputhje me planet për emergjencat civile dhe strategjitë e ZRF.
Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizimeve Durrës, Sh.a	**Sigurimi i cilësisë së ujit të pijshëm:** • Monitorimi dhe garantimi i kushteve higjeno-sanitare të furnizimit me ujë të pijshëm për popullatën. • Kryerja e analizave të vazhdueshme për cilësinë e ujit, duke identifikuar dhe parandaluar ndotjet që përbëjnë rrezik për shëndetin publik. Menaxhimi i përgjithshëm i monitorimit të cilësisë dhe sasisë së ujërave të ndotura industriale dhe shkarkimeve në mjedisin ujor sipërfaqësor ose nëntokësor në përputhje me legjislacionin përkatës. **Parandalimi i rreziqeve dhe menaxhimi i riskut:** • Zbatimi i masave parandaluese për të minimizuar riskun nga defektet në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve. • Hartimi i planeve të emergjencës për furnizimin me ujë të pijshëm në rastet e fatkeqësive ose avarive teknike. • Bashkëpunimi me institucionet vendore për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me ujë në kushte normale dhe emergjente.
Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës	• Informimi dhe ndërgjegjësimi i nxënësve/rinisë për risqet dhe masat parandaluese. • Edukimi për gatishmërinë ndaj fatkeqësive në kurrikulën shkollore. • Identifikimi, sëbashku me ZVAP dhe bashkitë, i aseteve infrastrukturore arsimore që mund të vihen në dispozicion Qarkut Durrës në rast fatkeqësish. • Udhëzimi dhe mbikëqyrja e hartimit të një plani paraprak evakuimi dhe përcaktimi i një vendi grumbullimi për nxënësit dhe mësuesit në rast emergjence civile. • Hartimi i një plani të detajuar veprimi nga stafi mësimor i shkollës për emergjencat natyrore, i cili duhet të publikohet në çdo korridor dhe në çdo kat të godinave. • Vendosja e tabelave në vende të dukshme: Ndalohet pirja e duhanit, Nuk lejohet zjarr. Rreziku nga zjarri etj. • Pajisja e ndërtesave me shenja evakuimi dhe drita emergjence. • Përgatitja dhe shpërndarja e broshurave, librave edukativë, dhe materiale vizuale për risqet dhe masat për parandalimin e tyre.

	• Organizimi i trajnimeve për mësuesit mbi identifikimin e rreziqeve dhe rolin e tyre në edukimin dhe ndërgjegjësimin e nxënësve. • Identifikimi bashkë me DRAP dhe bashkitë i problematikave strukturore që mund të shkaktojnë rrezik (shembje, rrëshqitje, zjarre, etj.) dhe raportimi për ndërhyrje të mëtejshme. • Angazhimi i shkollave në aktivitete komunitare për ndërgjegjësimin e familjeve dhe banorëve për masat parandaluese. • Mbështetja e aktiviteteve që inkurajojnë mbrojtjen e mjedisit dhe zvogëlimin e faktorëve që mund të rrisin risqet, si pyllëzimi dhe zvogëlimi i ndotjes.
Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Durrës	**Hartimi dhe integrimi i edukimit për fatkeqësitë në sistemin arsimor** • Mbështetja e zhvillimit të programeve të trajnimit për mësuesit mbi identifikimin e rreziqeve dhe masat parandaluese. • Miratimi dhe shpërndarja e materialeve ndërgjegjësuese për nxënësit, si broshura, libra edukativë dhe materiale vizuale mbi risqet dhe masat mbrojtëse. **Planifikimi dhe koordinimi i masave të sigurisë në shkolla** • Udhëzimi dhe mbikëqyrja e hartimit nga shkollat të planeve të evakuimit dhe përcaktimi i vendeve të grumbullimit në rast emergjence civile. • Organizimi i trajnimeve për mësuesit dhe stafin shkollor mbi menaxhimin e risqeve dhe ndërgjegjësimin e nxënësve. **Monitorimi dhe mbështetja infrastrukturore** • Monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes së infrastrukturës shkollore për rreziqe të mundshme (shembje, rrëshqitje, rrezik zjarri, etj.) dhe raportimi i problematikave tek institucionet përgjegjëse për ndërhyrje. • Identifikimi i aseteve infrastrukturore që mund të vihen në dispozicion të Bashkisë Durrës në rast fatkeqësish. • Mbikëqyrja e pajisjes së ndërtesave shkollore me shenja evakuimi dhe drita emergjence, si dhe vendosja e tabelave paralajmëruese si "Ndalohet pirja e duhanit" dhe "Rreziku nga zjarri". **Ndërgjegjësimi dhe promovimi i aktiviteteve për zvogëlimin e risqeve** • Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit në komunitet, duke përfshirë shkollat në aktivitete komunitare për rritjen e ndërgjegjësimit të familjeve dhe banorëve për masat parandaluese. • Promovimi i projekteve shkollore për qëndrueshmërinë mjedisore, si iniciativa për pyllëzimin, reduktimin e ndotjes dhe menaxhimin e mbetjeve, me qëllim zvogëlimin e faktorëve që rrisin risqet.
Drejtoria Vendore e Policisë Durrës./Komisariati i Policisë	• Hartimi dhe përditësimi i planeve të sigurisë për **parandalimin e situatave emergjente**, duke u bazuar në zonat e ndjeshme dhe risqet e identifikuara në dokumentet e vlerësimit të riskut.

	• Identifikimi dhe monitorimi i zonave të ndjeshme nga kërcënimet e mundshme për sigurinë publike. • Sensibilizimi i komunitetit për rëndësinë e sigurisë dhe masat parandaluese në rast fatkeqësish. • Bashkëpunimi me autoritetet vendore dhe institucionet përkatëse për të koordinuar masat parandaluese dhe lehtësuese në komunitet.
Përfaqësues të kompanive të telekomunikacionit (Vodafone & One)	• Mirëmbajtja dhe forcimi i rrjetit telekomunikues, për të shmangur ndërprerjet dhe për të garantuar funksionimin e vazhdueshëm të infrastrukturës. • Identifikimi dhe minimizimi i risqeve për infrastrukturën kritike, duke kryer inspektime të rregullta dhe ndërhyrje parandaluese për mbrojtjen e pikave të ndjeshme të rrjetit telekomunikues. • Koordinimi me Bashkinë dhe strukturat emergjente për të përditësuar dhe forcuar kapacitetet e rrjetit telekomunikues, duke siguruar gatishmërinë dhe funksionimin e tij në çdo situatë. • Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi përdorimin e rrjeteve të komunikimit në situata emergjente, për të parandaluar mbingarkesën e rrjetit dhe për të përmirësuar reagimin e komunitetit në raste emergjencash.
Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës.	• **Vlerësimi i riskut:** Harton dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, për institucionet shëndetësore dhe përditëson atë sipas nevojave. **Parandalimi i ndikimeve shëndetësore:** • Siguron masa parandaluese për reduktimin e rrezikut ndaj ndërprerjeve të shërbimeve mjekësore. • Vendos protokolle për identifikimin dhe trajtimin e rreziqeve që ndikojnë në shëndetin publik, si përhapja e sëmundjeve ngjitëse. • **Kualifikimi i personelit:** Organizimi i trajnimeve për personelin mjekësor për menaxhimin e situatave emergjente. • **Ndërgjegjësimi i komunitetit:** Bashkëpunon me autoritetet vendore për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi masat parandaluese për fatkeqësitë shëndetësore.
Inspektorati Shtetëror Shëndetësisë Durrës	• Kryen të gjitha inspektimet në fushën e kompetencës së ministrisë përgjegjëse në fushën e shëndetësisë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike.
Spitali Rajonal Durrës	• Trajnimi i vazhdueshëm i stafit mjekësor dhe ndihmës për menaxhimin e situatave emergjente dhe fluksit të lartë të pacientëve. • Formimi dhe përgatitja e ekipeve emergjente shëndetësore për reagim të menjëhershëm në situata emergjente. • Sigurimi dhe rishikimi i rezervave farmaceutike dhe pajisjeve shtesë për gatishmërinë ndaj situatave emergjente masive. • Mirëmbajtja dhe monitorimi i bankave të gjakut për gatishmëri në raste urgjente • Hartimi dhe përditësimi i planit të gatishmërisë spitalore, për menaxhimin e fluksit të pacientëve përtej kapaciteteve të zakonshme. • Sigurimi dhe mirëmbajtja e flotës së mjaftueshme të autoambulancave dhe mjeteve të transportit për gatishmërinë ndaj emergjencave. • Mirëmbajtja e sistemeve alternative të energjisë (gjeneratorët) dhe ujit, që spitali të punojë në mënyrë të pavarur nëse ndërpritet rrjeti publik.

	• Përdorimi strategjik i personelit dhe pajisjeve të përshtatshme në çdo njësi që ofron shërbimin e urgjencës mjekësore për të garantuar transportin e shpejtë dhe efektiv të pacientëve. • Përmirësimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të infrastrukturës për të mbështetur operacionet e emergjencës.
Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Durrës	• **Ndërgjegjësimi dhe edukimi i komunitetit** – Organizimi i fushatave të informimit mbi masat parandaluese për të zvogëluar ndikimin e fatkeqësive të shkaktuara nga rreziqet natyrore dhe në veçanti, emergjencave shëndetësore. – Promovimi i sjelljeve të sigurta dhe masave vetëmbrojtëse, duke ndihmuar komunitetet të zvogëlojnë ekspozimin ndaj rreziqeve. • **Mbështetja e strukturave vendore për zvogëlimin e riskut.** – Këshillimi i institucioneve lokale për përcaktimin e masave të duhura parandaluese, bazuar në vlerësimin e riskut. – Bashkëpunimi me komunitetet për të identifikuar faktorët e riskut dhe për të promovuar masa mbrojtëse afatgjata. • Bashkëpunimi me Institucionet Shtetërore dhe Organizatat Ndërkombëtare. – Kontribut në përcaktimin e prioriteteve për zvogëlimin e riskut në nivel vendor dhe kombëtar. – Shpërndarja e udhëzimeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, të adaptuara për realitetin lokal.

Kapitulli 7. Gatishmëria

Sipas ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" gatishmëria lidhet me njohuritë dhe kapacitetet e zhvilluara nga qeveritë, organizatat e përgjigjes dhe rimëkëmbjes, komunitetet dhe individët, për të parashikuar, për t'iu përgjigjur dhe për t'u rimëkëmbur në mënyrë efektive nga ndikimet e fatkeqësive të mundshme, të afërta apo reale.

Objektivi kryesor i fazës së gatishmërisë është të evitojë humbjet e jetës dhe të pasurive si pasojë e kërcënimeve dhe emergjencave.

Faza e Gatishmërisë, përbëhet nga shtatë komponentë kryesorë:

- Informimi dhe edukimi lidhur me risqet kryesore me të cilat përballet bashkia e Durrësit bazuar në VRFNV.
- Sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe komunikimi i emergjencave përfshijnë zhvillimin dhe funksionimin e mekanizmave për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit mbi risqet, përmirësimin e kanaleve të komunikimit ndërmjet institucioneve dhe komunitetit, si dhe sigurimin e aksesit gjithëpërfshirës në informacion për të gjitha grupet e popullsisë, veçanërisht për grupet e cenueshme.
- Ngritja e kapaciteteve të menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel vendor, trajnimi dhe stërvitjet e vazhdueshme për t'u përballur me skenarët më të mundshëm të emergjencave në nivel bashkie.
- Lokalizimi dhe përgatitja janë një tjetër komponent i fazës së gatishmërisë që lidhet me përgatitjen e kapaciteteve, testimin e gatishmërisë së tyre.
- Vlerësimi i riskut (VRFNV) i kryer paraprakisht është një prej dokumenteve bazë të identifikimit të kërcënimeve dhe të shkallës së tyre.
- Vazhdimësia e shërbimeve lidhet me nevojën që të gjitha bizneset në territorin e bashkisë dhe shërbimet e institucioneve shtetërore dhe aktorëve të tjerë jo-shtetërorë, të ruajnë vijimësinë e tyre në mënyrë sa më praktike dhe të sigurt të jetë e mundur.
- Partneritetet -fuqizimi i bashkëpunimit midis të gjithë aktorëve përgjegjës për emergjencat civile si dhe rritja e bashkëpunimit me grupet vullnetare dhe komunitetet vendore në përgjithësi.

7.1 Informimi dhe ndërgjegjësimi publik

Komunikimi dhe informimi i publikut janë pjesë thelbësore e menaxhimit të emergjencave civile, pasi mundësojnë përcjelljen e informacionit të nevojshëm për mbrojtjen e popullsisë dhe mbështesin koordinimin ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Informacioni duhet të jetë i saktë, i qartë, i verifikuar dhe në kohën e duhur, në mënyrë që qytetarët të kuptojnë rreziqet e mundshme dhe të ndërmarrin veprimet e duhura për sigurinë e tyre. Në kuadër të Planit Vendor për Emergjencat Civile të Bashkisë Durrës, vëmendje e veçantë i kushtohet organizimit të komunikimit ndërinstitucional, përcaktimit të procedurave të njoftimit dhe informimit të publikut, si dhe sigurimit të një rrjedhe të vazhdueshme informacioni përpara, gjatë dhe pas situatave emergjente.

7.1.1 Komunikimi ndërinstitucional

Gjatë emergjencës, është e rëndësishme që të gjitha institucionet e përfshira të komunikojnë në mënyrë efektive. Në bazë të VKM së nr. 923, datë 25.11.2020, pika nr. 17: "*Komunikimi me publikun në rastet e emergjencave/fatkeqësive natyrore kryhet nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen civile*".

Komunikimi ndërinstitucional siguron:

- **Unifikimin e informacionit:** Institucionet dhe strukturat e përfshira në menaxhimin e emergjencave duhet të shkëmbejnë dhe të shpërndajnë informacion të unifikuar, të saktë dhe të verifikuar, me qëllim shmangien e dezinformimit dhe të mesazheve kontradiktore.

- **Përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësive:** Çdo institucion duhet të veprojë në përputhje me përgjegjësitë e tij dhe të shmangë shpërndarjen e informacionit të pakoordinuar me institucionet e tjera. Për këtë arsye, protokollet dhe procedurat e komunikimit duhet të përcaktohen paraprakisht ndërmjet institucioneve të përfshira.

- **Koordinimin e centralizuar të informacionit:** Nëpërmjet QOECB-së, kur ajo është e aktivizuar informacioni i marrë nga institucionet dhe strukturat e tjera të përfshira në menaxhimin e emergjencave grumbullohet, verifikohet, përpunohet dhe koordinohet. Kjo ndihmon në garantimin e mesazheve të qarta, të sakta dhe të njëtrajtshme, duke shmangur keqkuptimet dhe mbivendosjen e komunikimeve.

- **Përdorimin e teknologjisë:** Platformat dixhitale dhe sistemet e brendshme të komunikimit lehtësojnë shkëmbimin në kohë reale të informacionit ndërmjet institucioneve, duke përmirësuar koordinimin, reagimin dhe marrjen e vendimeve gjatë situatave emergjente.

- **Sigurimin e pajisjeve të komunikimit me radio:** Gjatë situatave emergjente, furnizimi me energji elektrike mund të ndërpritet jo vetëm në zonën e prekur nga fatkeqësia, por edhe në zona më të gjera, duke shkaktuar ndërprerjen e funksionimit të antenave dhe të rrjeteve të operatorëve celularë. Kjo mund të vështirësojë ndjeshëm komunikimin ndërmjet strukturave të përgjigjes. Për këtë arsye, institucionet duhet të pajisen me një numër të përshtatshëm radiomarrësish dhe radiotransmetuesish që mundësojnë komunikimin e pavarur nga rrjetet celulare. Pajisjet duhet të jenë të përshtatshme për distancat e komunikimit të nevojshme dhe të testohen e mirëmbahen periodikisht, për të garantuar funksionimin e tyre në çdo situatë emergjente.

7.1.2 Fushata ndërgjegjësuese

Zhvillimi i fushatave vjetore dhe sezonale të informimit dhe ndërgjegjësimit publik, të bazuara në rreziqet dhe risqet kryesore të territorit të Bashkisë Durrës, është i rëndësishëm për forcimin e parandalimit, gatishmërisë dhe reagimit ndaj emergjencave civile.

Fushatat e ndërgjegjësimit publik janë një komponent i rëndësishëm i Planit Vendor për Emergjencat Civile dhe synojnë rritjen e njohurive, gatishmërisë dhe kapaciteteve të komunitetit për të parandaluar, përballuar dhe reaguar në mënyrë të përshtatshme ndaj emergjencave dhe fatkeqësive.

Në përputhje me risqet e identifikuara në Dokumentin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë të bashkisë Durrës, fushatat e ndërgjegjësimit do të planifikohen dhe zbatohen në mënyrë periodike, duke i dhënë prioritet risqeve me probabilitet dhe ndikim më të lartë në territorin e bashkisë.

Fushatat do të organizohen gjatë gjithë vitit dhe, sipas natyrës së riskut, do të kenë karakter vjetor, sezonal ose të posaçëm. Përmbajtja dhe mënyra e komunikimit do të përshtaten me karakteristikat e komunitetit, zonën gjeografike, grupet e synuara dhe llojin e rrezikut.

Fushatat e ndërgjegjësimit do të synojnë:

- rritjen e njohurive të qytetarëve mbi risqet kryesore që prekin territorin e bashkisë;
- informimin e komunitetit mbi masat e parandalimit dhe zvogëlimit të riskut;
- rritjen e gatishmërisë individuale, familjare dhe komunitare;
- informimin e qytetarëve mbi mënyrat e reagimit në rast emergjence;
- promovimin e përgatitjes së planeve familjare të emergjencës;
- informimin mbi sistemet e njoftimit, alarmit dhe paralajmërimit të hershëm;
- rritjen e njohurive mbi numrat dhe strukturat që duhet të kontaktohen në rast emergjence;
- përfshirjen e grupeve vulnerabël dhe marrjen në konsideratë të nevojave të tyre specifike;
- nxitjen e një kulture të qëndrueshme të parandalimit dhe gatishmërisë në komunitet.

Fushatat do të hartohen në mënyrë që të përfshijnë të gjithë komunitetin, me vëmendje të veçantë ndaj: fëmijëve dhe nxënësve; të rinjve; të moshuarve; personave me aftësi të kufizuara; familjeve dhe komuniteteve që ndodhen në zona me risk të lartë; grave; fermerëve dhe komuniteteve rurale; bizneseve dhe subjekteve private; institucioneve publike; punonjësve të bashkisë dhe strukturave të mbrojtjes civile; organizatave të shoqërisë civile dhe vullnetarëve etj.,

Për risqet që karakterizohen nga sezonaliteti, bashkia do të zhvillojë fushata të posaçme përpara dhe gjatë periudhave me risk të shtuar. Në fund të sezonit të verës në periudhën Shtator - Tetor duhet të bëhen fushata ndërgjegjësimi me komunitetin lidhur me reshjet / stuhitë / përmbytjet për periudhën vjeshtë - dimër, kurse në fund të muajit Shkurt dhe fillim në të Marsit për reshjet gjatë sezonit të pranverës. Ndërsa për zjarret që mund të ndodhin gjatë stinës së verës, fushatat e ndërgjegjësimit me komunitetin duhet të zhvillohen që gjatë muajit Maj e në vazhdim. Fushata informimi duhen ndërmarrë edhe me institucionet arsimore për të kultivuar parimin e parandalimit të kërcënimeve nga risqet e fatkeqësive.

Kurse gjatë gjithë vitit do të zhvillohen aktivitete të vazhdueshme për ndërgjegjësimin mbi risqet e fatkeqësive, gatishmërinë familjare, sistemin e alarmit dhe njoftimit, ndihmën e parë, evakuimin sjelljen e sigurt në rast emergjence, etj.

7.1.3 Komunikimi me publikun gjatë një emergjence

Komunikimi me publikun përbën një element thelbësor përpara dhe gjatë situatave emergjente. Informimi i saktë, i qartë dhe në kohën e duhur ndihmon në uljen e pasigurisë, parandalimin e përhapjes së panikut dhe orientimin e popullatës drejt veprimeve të përshtatshme për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit. Gjatë një emergjence, popullata duhet të informohet për natyrën dhe nivelin e rrezikut, masat mbrojtëse që duhet të ndërmarrë dhe procedurat e evakuimit, kur kjo është e nevojshme.

Komunikimi me publikun do të bëhet nga Zëdhënësi i shtypit i Bashkisë Durrës. Komunikimi duhet të jetë i koordinuar, i besueshëm dhe i kuptueshëm, duke shmangur alarmet e panevojshme dhe keqinterpretimin e informacionit. Për këtë qëllim, informacioni që do t'i përcillet publikut duhet të përzgjidhet dhe të verifikohet me kujdes, pa cenuar transparencën për rreziqet reale dhe masat që duhen marrë.

Për të garantuar efektivitetin e komunikimit me publikun gjatë një emergjence, duhet të zbatohen parimet e mëposhtme:

- **Burimi zyrtar i informacionit:** Informacioni duhet të përcillet nga përfaqësues ose zyrtarë të autorizuar të institucioneve publike përgjegjëse në rastin e bashkisë Durrës nga zëdhënësi i shtypit, në mënyrë që të garantohet besueshmëria dhe saktësia e njoftimeve.
- **Verifikimi dhe miratimi i informacionit:** Informacioni i përzgjedhur për transmetim duhet të verifikohet dhe të miratohet nga autoritetet kompetente në nivel vendor, qarku dhe qendror, sipas përgjegjësive dhe procedurave përkatëse, përfshirë Qendrën Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile (QKOEC) pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), sipas rastit.

Komunikimi duhet të kufizohet te informacioni i konfirmuar dhe i autorizuar, pa shtuar të dhëna të paverifikuara që mund të shkaktojnë konfuzion ose keqkuptime.

- **Qartësia e mesazheve:** Gjuha e përdorur duhet të jetë e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme për të gjithë. Mesazhet duhet të përcjellin siguri dhe përgjegjshmëri, duke informuar publikun për masat e marra nga autoritetet dhe për veprimet që duhet të ndërmarrë vetë popullata.
- **Transparenca për rreziqet reale:** Shmangia e panikut nuk duhet të cenojë transparencën lidhur me rreziqet dhe kërcënimet reale. Popullata duhet të informohet në kohën e duhur për rreziqet e identifikuara, pasojat e mundshme dhe masat mbrojtëse që duhet të zbatojë. Fshehja ose minimizimi i rreziqeve mund të dëmtojë besimin e publikut te institucionet përgjegjëse.
- **Vazhdimësia e koordinimit të komunikimit publik:** Rekomandohet që zëdhënësi i shtypit i caktuar për informimin publik të ruhet në këtë funksion gjatë gjithë situatës emergjente, për të siguruar vazhdimësinë, saktësinë dhe koherencën e komunikimit. Ndryshimet e pajustifikuara mund të krijojnë konfuzion dhe të ndikojnë negativisht në besimin e publikut.
- **Përdorimi i kanaleve të përshtatshme të komunikimit:** Pas përcaktimit dhe verifikimit të përmbajtjes së mesazhit, informacioni duhet të shpërndahet nëpërmjet kanaleve më të njohura dhe më të aksesueshme për popullatën, si televizioni, radioja, rrjetet sociale, mesazhet SMS dhe kanalet zyrtare të komunikimit të bashkisë. Kur është e nevojshme, duhet të përdoren edhe mënyra alternative njoftimi, veçanërisht në zonat ku aksesi në internet ose në rrjetet celulare është i kufizuar.

Zbatimi i këtyre parimeve synon të sigurojë një komunikim publik të koordinuar, transparent dhe të besueshëm, duke ndihmuar popullatën të kuptojë situatën, të vlerësojë rrezikun dhe të veprojë në përputhje me udhëzimet e autoriteteve gjatë një emergjence.

Komunikimi me publikun dhe fazat e emergjencës

- Përpara emergjencës *(Parandalim/Gatishmëri)*: Duhet të transmetohen mesazhe për për parandalimin, gatishmërinë dhe edukimin e popullatës për kërcënimet e mundshme, të njohura dhe të panjohura.
- Emergjenca (*Përgjigje)*: Çdo informacion duhet të jetë i qartë dhe të ofrojë një pasqyrë të gjerë të situatës, sigurisë, planit të masave dhe veprimeve konkrete që do të ndërmerren. Në rast të përshkallëzimit të emergjencës duhet të rritet frekuenca e komunikimit, duke transmetuar përditësime më të detajuara me tone të qeta.
- Pas emergjencës *(Rimëkëmbje)*: Në këtë fazë transmetohet informacioni për rehabilitimin/rimëkëmbjen, normalitetin e shërbimeve publike dhe pasojat afatgjata (nëse ka).

7.2 Monitorimi dhe paralajmërimi i hershëm

Monitorimi dhe paralajmërimi i hershëm përbëjnë elemente të rëndësishme të fazës së gatishmërisë, pasi mundësojnë identifikimin në kohë të rreziqeve të mundshme dhe krijojnë kushtet për marrjen e masave parandaluese dhe mbrojtëse. Në kuadër të Planit Vendor për Emergjencat Civile të Bashkisë Durrës, monitorimi synon mbledhjen, analizimin dhe vlerësimin e informacionit mbi rreziqet që mund të prekin territorin e bashkisë, në bashkëpunim me institucionet dhe strukturat kompetente. Paralajmërimi i hershëm synon përcjelljen në kohë të informacionit për rrezikun e mundshëm te strukturat përgjegjëse dhe popullsia e ekspozuar, në mënyrë që të mundësohet aktivizimi i procedurave të përgjigjes dhe ndërmarrja e masave të nevojshme për mbrojtjen e jetës, shëndetit, pronës dhe mjedisit.

7.2.1 Monitorimi

Monitorimi sistematik i rreziqeve në territorin e Bashkisë Durrës kërkon përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësive të strukturave përgjegjëse për monitorimin, informimin, njoftimin dhe mbrojtjen civile. Për këtë qëllim, Bashkia Durrës do të përcaktojë linjat e komunikimit, informimit dhe raportimit ndërmjet strukturave të saj, njësive administrative, institucioneve vendore dhe strukturave të mbrojtjes civile në nivel qarku dhe qendror.

Monitorimi do të realizohet në mënyrë të vazhdueshme, duke përdorur informacionin e marrë nga strukturat vendore dhe burimet zyrtare të monitorimit, si dhe do të mbështetet në kritere dhe tregues të përcaktuar për paralajmërimin e hershëm dhe rritjen e nivelit të gatishmërisë.

Strukturat përgjegjëse të Bashkisë Durrës, përfshirë MZSH-në dhe njësitë administrative, do të raportojnë periodikisht pranë Sektorit të Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile të Bashkisë Durrës. Në varësi të natyrës dhe rëndësisë së situatës, informacioni do t'i përcillet Prefekturës së Qarkut Durrës dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Në rast të evidentimit të një përkeqësimi të situatës ose të treguesve që sinjalizojnë një emergjencë të mundshme, do të kryhet menjëherë njoftimi i strukturave përgjegjëse, do të intensifikohet monitorimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe do të aktivizohen masat përkatëse të gatishmërisë dhe përgjigjes të përcaktuara në Planin Vendor për Emergjencat Civile.

Në territorin e Bashkisë Durrës, monitorimi i rreziqeve dhe i treguesve kritikë do të përqendrohet në:

- Në lidhje me monitorimin e aktivitetit sizmik, - vlerësimin e informacionit të marrë nga institucionet nga Instituti i Gjeoshkences (IGJEO), me qëllim identifikimin në kohë të ngjarjeve sizmike dhe aktivizimin e masave të nevojshme të gatishmërisë dhe reagimit.
- Në lidhje me monitorimin e kushteve meteorologjike dhe hidrologjike, -vlerësimin e informacionit të marrë nga Instituti i Gjeoshkences (IGJEO) ose Sherbimi Meterologjik Ushtarak, si dhe nga vlerësimet në terren veçanërisht të reshjeve intensive, stuhive, erërave të forta, temperaturave ekstreme dhe rrezikut nga përmbytjet.
- Monitorimin e niveleve dhe prurjeve të ujërave në zonat dhe kanalet me rrezik për përmbytje, si dhe të funksionimit të sistemeve të kullimit.
- Monitorimin e zonave të ekspozuara ndaj rrëshqitjeve dhe paqëndrueshmërisë së terrenit, veçanërisht në zonat kodrinore të bashkisë.
- Monitorimin e kushteve dhe rrezikut për përhapjen e zjarreve në pyje, kullota dhe zona të tjera me risk.
- Monitorimin e gjendjes dhe funksionimit të infrastrukturës kritike dhe publike, përfshirë rrugët, urat, sistemet e furnizimit me ujë, energji elektrike, kanalizimet dhe objektet e tjera kritike.
- Monitorimin e zonës bregdetare dhe detare, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, për rreziqe të lidhura me stuhitë, dallgëzimin, përmbytjet bregdetare dhe ndotjen detare.
- Monitorimin e ndotjes së mjedisit dhe të incidenteve me ndikim në shëndetin dhe sigurinë e komunitetit.
- Monitorimin e kushteve higjieno-sanitare dhe të situatave epidemiologjike.
- Monitorimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në bimë dhe kafshë, në bashkëpunim me strukturat veterinare dhe bujqësore.

Monitorimi në territor

Në rastin e risqeve hidro-meteorologjike, përveç indikatorëve që janë të lidhur ngushtë me parashikimin e riskut hidrometeorologjik, për të konkluduar sa më realisht mbi etapën e përgjigjes, bashkitë duhet të marrin në konsideratë edhe indikatorët që rjedhin nga:

- Informacioni nga monitorim instrumental.

- Informacioni nga prania në territor e monitoruesve.

Ky proces lidhet me vëzhgimin në kohë reale të ngjarjes dhe vlerësimin e ndikimeve të saj në territorin e prekur. Ai realizohet nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm ndërmjet ekipeve të vlerësimit dhe/ose vrojtuesve të vendosur në terren. Aktiviteti i monitorimit të prezencës territoriale meteorologjike dhe hidrogjeologjike zhvillohet në mënyrë dinamike, sipas itinerareve të paracaktuara nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Durrës, nëpërmjet personelit të caktuar dhe/ose vullnetarëve të angazhuar. Për këtë qëllim, përdoren automjete të identifikuara dhe të pajisura me sisteme komunikimi radio dhe/ose telefonike.

Gjithashtu, strukturat përgjegjëse të Bashkisë Durrës, përfshirë MZSH-në dhe njësitë administrative, kryejnë verifikime në zonat e ekspozuara ndaj rrezikut, në përputhje me itineraret dhe procedurat e përcaktuara.

Informacioni i mbledhur nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Durrës, operatorët e monitorimit territorial dhe vrojtuesit në terren i përcillet Sektorit të Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, në Drejtorinë e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile (DZHRBMC) të Bashkisë Durrës, si dhe Qendrës Operacionale të Emergjencave Civile të Bashkisë (QOECB-së), kur kjo e fundit është e aktivizuar. Për vlerësimin e situates reale, do të kombinohet informacioni nga **burimet instrumentale të monitorimit** me informacionin e marrë nga **strukturat dhe ekipet e pranishme në territor**. Në varësi të natyrës së ngjarjes, shkallës së rrezikut dhe rëndësisë së situatës, informacioni përcillet pranë Prefekturës së Qarkut Durrës dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), në përputhje me procedurat përkatëse të raportimit dhe koordinimit institucional.

Monitorimi dhe raportimi do të intensifikohen në rast të përkeqësimit të situatës ose tejkalimit të treguesve të përcaktuar për paralajmërimin e hershëm, duke shërbyer si bazë për rritjen e nivelit të gatishmërisë dhe aktivizimin e masave të përgjigjes.

7.2.2 Paralajmërimi (njoftimi) i hershëm

Paralajmërimi i hershëm, monitorimi dhe njoftimi realizohen nga institucione dhe struktura të caktuara, organizimi dhe funksionimi i të cilave rregullohet me akte të ndryshme ligjore dhe nënligjore ku përfshihet ligji nr.45/2019 dhe VKM nr. 594, datë 13.10.2021, si dhe VKM nr. 159/2021 për Sistemin Kombëtar të Monitorimit, Paralajmërimit të Hershëm dhe Alarmit, si dhe VKM nr. 159/2021 për Sistemin Kombëtar të Monitorimit, Paralajmërimit të Hershëm dhe Alarmit

Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO)

Instituti i Gjeoshkencave është institucioni qendror përgjegjës për dërgimin efektiv të informacionit në lidhje me kushtet dhe situatën hidrologjike, sizmike, meteorologjike dhe të mjedisit në AKMC, për qëllimet e paralajmërimit të hershëm. Në kuadër të parashikimit të ngjarjeve ekstreme hidrometeorologjike të pritshme, IGJEO harton buletinin e përditshëm **"Buletini i Rreziqeve Natyrore"** që lajmëron mbi rrezikun afatshkurtër të pritshëm në lidhje me fenomenet klimatike (reshjet, temperaturat, era etj.), përmbytjet dhe zjarret në pyje. Sipas standardeve evropiane, rreziku në buletin ndahet në 4 nivele (S'ka rrezik, i ulët, i moderuar, i lartë), të cilat paraqiten në katër ngjyra të ndryshme (e gjelbër, e verdhë, portokalli, e kuqe). Rreziku i pritshëm analizohet në bazë qarku dhe lajmërohet në buletin duke u paraqitur në formë tabelare dhe në hartë për çdo qark të Shqipërisë.

Parashikimi i rreziqeve hidrometeorologjike, buletini ditor i IGJEO

Niveli i Rrezikut	Reshje shiu (mm/24 orë)
S'KA RREZIK	Të dobëta (0 – 15 mm/24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike
I ULËT	Mesatare (15 – 45 mm/24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike
I MODERUAR	Intensive (45 – 90 mm/24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike
I LARTË	Shumë intensive (> 90 mm/24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike mjaft intensive

Rrezikut për zjarre në pyje përshkruan nivelet e rrezikut që kanë lidhje me zjarret në pyje brenda territorit të Shqipërisë.

S'KA RREZIK	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht
I ULËT	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara
I MODERUAR	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme
I LARTË	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve. Si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë

Në përputhje me parashikimet e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, Bashkia mbështetet në parashikimet dhe informacionin e IGJEO-së, si edhe në ato të Shërbimit Meteorologjik Ushtarak, për vlerësimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencave civile.

Në nivel vendor, roli më i rëndësishëm i bashkisë është shpërndarja e sinjalizimeve meteorologjike.

Veprimet e Bashkisë Durrës pas marrjes së një sinjalizimi meteorologjik.

- Në nivel vendor, Bashkia Durrës, pas marrjes së një sinjalizimi ose paralajmërimi meteorologjik nga strukturat kompetente, ndërmerr këto veprime:
- Komunikon informacionin dhe sinjalizimin tek strukturat operacionale, administrative dhe vullnetare.
- Informon paraprakisht popullatën për rrezikun e pritshëm, masat e vetëmbrojtjes dhe kanalet zyrtare të informacionit.
- Verifikon gatishmërinë e shërbimeve dhe strukturave teknike bashkiake.
- Verifikon disponueshmërinë e strukturave vullnetare dhe burimeve shtesë publike ose private në territor.
- Vlerëson nevojën për aktivizimin e QOECB-së.
- Identifikon strukturat kritike, aktivitetet ose zonat e cenueshme dhe merr masa parandaluese, përfshirë kufizimin ose bllokimin e zonave me risk të lartë.
- Verifikon funksionimin e sistemeve të komunikimit, mjeteve teknologjike dhe lidhjeve telefonike të QOECB-së.
- Monitoron zhvillimin e situatës dhe, sipas nevojës, aktivizon burimet dhe kapacitetet në dispozicion.
- Informon Prefektin dhe strukturat përkatëse për masat dhe veprimet e ndërmarra.

Paralajmërimet për publikun kanë qëllim informimin e tij në lidhje me riskun e fatkeqësive, për t'i dhënë atij udhëzime për masat kryesore të sigurisë që mund të marrë.

Paralajmërimet e hershme bazohen në një analizë të plotë dhe efektive të situatës dhe shpërndahen me shpejtësi tek popullata në risk. Përgjegjësia kryesore për informimin e popullsisë, në varësi të shpejtësisë dhe shkallës së emergjencës, është e Kryetarit të bashkisë dhe Prefektit, si dhe e Forcave Operacionale (FO) në terren.

Mjetet e komunikimit

Paralajmërimi i hershëm duhet t'u komunikohet të gjithë anëtarëve të publikut dhe të specifikohet në rastet kur nevojitet.

Informacioni plotësisht gjithëpërfshirës duhet të komunikohet në kohën e duhur përmes një sërë mjetesh, ku përfshihen:

• Buletinet në radio.

• Televizionet dhe mediat e shkruara.

• Njoftimet zanore nga objektet fetare (kisha, xhami, etj.).

• Media sociale.

• Mesazhet përmes telefonave celularë dhe e-mail.

• Njoftimet në komunitet.

• Njoftimet përmes automjeteve të policisë/ushtrisë/Kryqit të Kuq.

• Ekranet dhe tabelat në publik.

• Sinjale tymuese ose fluturuese.

Paralajmërimet duhet të jenë specifikë, d.m.th. ata duhet të japin informacion specifik lokal rreth kërcënimit që dëgjuesit mund ta mbajnë mend me lehtësi.

• Të jenë urgjentë (ata duhet t'i bëjnë njerëzit të lëvizin dhe të mos lënë kohë për të racionalizuar paralajmërimin).

• Të shpjegojnë pasojat e injorimit të paralajmërimit (ndoshta në detaje të qarta) në mënyrë që njerëzit të mos mund t'i shpërfillin rastësisht ato.

• Të jenë absolutisht të qartë në lidhje me probabilitetin e ndodhjes, pasi njerëzit priren t'i kushtojnë pak vëmendje diçkaje të emërtuar "një probabilitet".

Një paralajmërim zakonisht nuk mjafton; ata duhet të jenë të vazhdueshëm, sepse njerëzit duhet, ndër të tjera, të mbahen të përditësuar për atë që po ndodh dhe t›u jepen udhëzime të përshtatshme për zhvillimin e situatës. Paralajmërimi i hershëm duhet të fokusohet te një proces i plotë, në të cilin ekzistojnë sisteme përmes të cilave njerëzit mund të marrin një sinjalizim, të përgatiten/evakuohen dhe të kthehen mbrapa në mënyrë të sigurt. Publiku duhet të dijë çfarë të bëjë dhe kohën e këtyre veprimeve.

Numrat e emergjencës dhe komunikimi në situata emergjente

Në kuadër të menaxhimit të emergjencave civile, komunikimi dhe njoftimi në kohë janë elementë thelbësorë për reagimin efektiv ndaj situatave emergjente.

Numri i unifikuar i thirrjeve emergjente 112

Numri i unifikuar i thirrjeve emergjente 112 siguron komunikim, paralajmërim të hershëm, njoftim, alarm, informim, koordinim, vendimmarrje, aktivizim dhe ndërhyrje të integruar të strukturave operacionale në përballimin e aksidenteve dhe të situatave emergjente që mund të ndodhin në të gjithë vendin.

Numrat e tjerë të emergjencave që përdoren në vendin tonë janë:

• 125 - Emergjencat detare (Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare)

• 126 - Shërbimi i Policisë rrugore

• 127 - Urgjenca mjekësore

• 128 - Shërbimi zjarrfikës

• 129 - Policia e shtetit

•



7.3 Trajnimet dhe ushtrimet

Trajnimi, zhvillimi i kapaciteteve dhe ushtrimet janë elementë thelbësorë për garantimin e gatishmërisë së strukturave dhe aktorëve të përfshirë në zbatimin e Planit Vendor për Emergjencat Civile të Bashkisë Durrës. Ato synojnë që personeli përgjegjës të njohë rolet dhe përgjegjësitë e tij, të zotërojë procedurat përkatëse dhe të jetë në gjendje të veprojë në mënyrë të koordinuar përpara, gjatë dhe pas një situate emergjente.

Në zbatim të pikës "d" të nenit 30 të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", bashkitë organizojnë veprimtari trajnuese në fushën e mbrojtjes civile për punonjësit dhe banorët në territorin e tyre. Në të njëjtën kohë, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në ligji, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), nëpërmjet strukturave përkatëse të trajnimit, zhvillon trajnime për strukturat shtetërore, subjektet private dhe vullnetarët, sipas programeve dhe moduleve të miratuara.

Në këtë kuadër, Bashkia Durrës do të planifikojë dhe organizojë trajnime dhe ushtrime në nivel vendor, në koordinim me AKMC-në, Prefekturën e Qarkut Durrës dhe institucionet, strukturat dhe subjektet e tjera përgjegjëse, sipas kompetencave të tyre. Trajnimet e specializuara do të realizohen, sipas nevojës, në bashkëpunim me AKMC-në dhe institucionet përkatëse.

Programi i trajnimeve dhe ushtrimeve do të bazohet në rezultatet e Dokumentit të Vlerësimit të Riskut të Fatkeqësive, në risqet prioritare të territorit të Bashkisë Durrës, në përgjegjësitë e përcaktuara në Plan, në kapacitetet ekzistuese të strukturave përgjegjëse, në përvojën e fituar nga situatat e mëparshme emergjente dhe në gjetjet e ushtrimeve të zhvilluara.

- **Analiza e nevojave për trajnim.**

Për hartimin e planit të trajnimit duhet të kryhet periodikisht analiza e nevojave për trajnim të strukturave dhe personelit të përfshirë në përgatitjen dhe përgjigjen ndaj emergjencave civile.

Rezultatet e analizës do të përdoren për përcaktimin e prioriteteve dhe hartimin e programit vjetor të trajnimeve dhe ushtrimeve.

- **Programi vjetor i trajnimeve dhe ushtrimeve**

Bashkia Durrës, nëpërmjet Sektorit të Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile në kuadër të DZHRBMC-së, do të hartojë një program vjetor të trajnimeve dhe ushtrimeve, në përputhje me nevojat e identifikuara dhe prioritetet e Planit Vendor për Emergjencat Civile. Programi do t'i nënshtrohet shqyrtimit nga Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel bashkie dhe, pas shqyrtimit, do të finalizohet dhe miratohet nga Kryetari i Bashkisë Durrës ose nënkryetari i autorizuar për çështjet e emergjencave civile, në përputhje me kompetencat dhe procedurat në fuqi.

Programi do të përcaktojë:

- objektivat e trajnimeve dhe ushtrimeve;
- temat dhe aftësitë që synohet të zhvillohen;
- strukturat, institucionet dhe personelin pjesëmarrës;
- përgjegjësit për organizimin dhe zbatimin;
- llojin e aktivitetit;
- periudhën dhe kohëzgjatjen;
- burimet e nevojshme;
- mënyrën e vlerësimit;
- rezultatet e pritshme;
- masat që do të ndërmerren pas përfundimit të aktivitetit.

Programi do të rishikohet periodikisht në bazë të ndryshimeve të riskut, përvojës së fituar, rezultateve të ushtrimeve dhe nevojave të reja të identifikuara.

- **Trajnimet**

Trajnimet do të kombinojnë njohuritë teorike me zhvillimin e aftësive praktike dhe do të përshtaten sipas roleve dhe përgjegjësive të pjesëmarrësve.

Tematikat e trajnimeve do të përfshijnë, sipas nevojës:

- kuadrin ligjor dhe institucional të mbrojtjes civile;
- rolet dhe përgjegjësitë e strukturave të Bashkisë Durrës;
- njohjen dhe zbatimin e Planit Vendor të Emergjencave Civile;
- procedurat e njoftimit, paralajmërimit dhe aktivizimit;
- organizimin dhe koordinimin e përgjigjes;
- komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit;
- menaxhimin dhe mobilizimin e burimeve;
- vlerësimin e situatës, dëmeve dhe nevojave;
- evakuimin dhe menaxhimin e personave të prekur;
- mbrojtjen e grupeve vulnerabël;
- funksionimin e shërbimeve dhe infrastrukturave kritike;
- procedurat e rimëkëmbjes pas fatkeqësive.
- Etj.

Trajnimet do të zhvillohen në nivel individual, institucional dhe ndërinstitucional, sipas objektivave dhe nevojave të përcaktuara në programin vjetor.

- **Ushtrimet e bazuara në diskutime.**

Ushtrimet e bazuara në diskutime do të përdoren për përgatitjen dhe testimin gradual të strukturave përgjegjëse përpara zhvillimit të ushtrimeve operacionale. Ato do të fokusohen në planet, procedurat, rolet dhe përgjegjësitë, proceset e vendimmarrjes, komunikimin dhe koordinimin ndërinstitucional.

Në këtë kategori do të përfshihen:

- seminare;
- punëtori (workshop-e);
- ushtrime në tavolinë (Table Top Exercises – TTX);
- simulime dhe lojëra vendimmarrëse.

Ushtrimet në tavolinë do të zhvillohen mbi bazën e skenarëve realistë të lidhur me risqet prioritare të Bashkisë Durrës. Ato do të testojnë procedurat e njoftimit dhe aktivizimit, zinxhirin e komunikimit, procesin e vendimmarrjes, koordinimin ndërinstitucional dhe zbatimin e përgjegjësive të përcaktuara në Plan.

- **Ushtrimet operacionale dhe në terren**

Ushtrimet operacionale do të synojnë testimin praktik të kapaciteteve të strukturave dhe institucioneve përgjegjëse për përgjigjen ndaj emergjencave.

Në varësi të skenarit, ushtrimet mund të përfshijnë testimin e:

- mobilizimit dhe angazhimit të strukturave;
- komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit;
- koordinimit ndërinstitucional;
- mobilizimit dhe përdorimit të burimeve;
- evakuimit të popullsisë;
- organizimit të pikave të grumbullimit dhe strehimit;
- kërkim-shpëtimit dhe dhënies së ndihmës;
- menaxhimit të zonave të prekura;
- mbështetjes logjistike;
- funksionimit të shërbimeve dhe infrastrukturave kritike;
- zbatimit të procedurave të përcaktuara në Plan.

Ushtrimet do të zhvillohen në mënyrë progresive, duke filluar nga testimi i funksioneve të veçanta dhe duke vijuar, sipas nevojës, me skenarë kompleksë që kërkojnë aktivizimin dhe koordinimin e disa strukturave njëkohësisht.

- **Vlerësimi pas trajnimit dhe ushtrimit**

Pas çdo ushtrimi do të kryhet një vlerësim i strukturuar për të përcaktuar shkallën e përmbushjes së objektivave dhe efektivitetin e procedurave të testuara.

Për çdo ushtrim do të përgatitet një raport vlerësimi pas ushtrimit, i cili do të dokumentojë rezultatet, gjetjet dhe rekomandimet.

- **Dokumentimi dhe përditësimi**

Bashkia Durrës, nëpërmjet Sektorit të Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile të DZHRBMC-së do të mbajë evidenca të plota për trajnimet dhe ushtrimet e zhvilluara, duke përfshirë programet, listat e pjesëmarrësve, materialet e trajnimit, skenarët, rezultatet e vlerësimit, raportet pas ushtrimit dhe masat korrigjuese.

Rezultatet e trajnimeve, ushtrimeve dhe situatave reale emergjente do të përdoren për vlerësimin e vazhdueshëm të gatishmërisë së strukturave dhe për përcaktimin e nevojave të ardhshme për trajnim dhe ushtrime.

Kur nga vlerësimet ose nga përvoja e situatave reale identifikohen ndryshime të nevojshme në procedura, role, përgjegjësi ose kapacitete, këto do të reflektohen në rishikimin dhe përditësimin e Planit Vendor të Emergjencave Civile.

Ushtrimi i 13 tetorit 2026. Bashkia Durrës, AKMC, GIZ, Vodafone Foundation dhe Kryqi i Kuq Shqiptar zhvilluan një ushtrim në tavolinë të kombinuar me demonstrime në terren për një përmbytje të Erzenit në NjA Sukth, me pjesëmarrjen e 72 personave nga 12 institucione. Gjetjet kryesore që reflektohen në këtë plan janë:

- Lidhja ndërmjet terrenit dhe sallës së koordinimit u ndërpre për rreth 22 minuta; plani parashikon kanal rezervë radio dhe procedurë rikthimi brenda 5 minutash.
- Statusi i argjinaturës u raportua si i konfirmuar para verifikimit; informacioni i paverifikuar shënohet qartë si i tillë deri në konfirmim (seksioni 8.5.3).
- Shtretërit e ndihmës së parë u trajtuan si kapacitet strehimi; kapacitetet e strehimit regjistrohen veçmas në Aneksin 8.
- Të dhënat për personat me aftësi të kufizuara në Sukth nuk u përdorën për prioritetet e evakuimit; regjistri i evakuimit të asistuar lidhet drejtpërdrejt me listat e NjA-ve (seksioni 9.5).

Plani i përmirësimit i ushtrimit, me 21 masa, ndiqet nga sektori i mbrojtjes civile dhe raportohet në KMCB. Ushtrimi i radhës rekomandohet të testojë skenarin e tërmetit ose skenarin Natech të kapitullit 12.

7.4 Gatishmëria e njësive administrative dhe komuniteteve

7.4.1 Gatishmëria e njësive administrative

Gatishmëria e njësive administrative dhe komuniteteve përbën një komponent të rëndësishëm të sistemit vendor të mbrojtjes civile dhe synon rritjen e kapaciteteve për të parashikuar, përballuar dhe përgjigjur në mënyrë efektive ndaj emergjencave. Gatishmëria duhet të mbështetet në njohjen e risqeve lokale, planifikimin paraprak, përcaktimin e përgjegjësive dhe disponueshmërinë e burimeve njerëzore, materiale dhe logjistike.

Njësitë administrative të Bashkisë Durrës duhet të kenë një rol aktiv në zbatimin e masave të gatishmërisë, duke shërbyer si lidhje ndërmjet strukturave të Bashkisë dhe komuniteteve lokale. Për këtë qëllim, bazuar në vlerësimin e risqeve në nivel bashkie, në çdo njësi administrative duhet të përcaktohen zonat më të ekspozuara, objektet dhe infrastruktura kritike, grupet vulnerabël, rrugët e aksesit dhe të evakuimit, si dhe burimet njerëzore, materiale dhe logjistike të disponueshme për përballimin e emergjencave.

Gatishmëria e njësive administrative përfshinë:

- identifikimin dhe përditësimin e zonave me risk, popullsia, objektet, infrastruktura ekspozuar ndaj risqeve;
- përditësimin e listave të kontakteve të institucioneve, shërbimeve dhe aktorëve kryesorë;
- identifikimin e pikave të grumbullimit ose qendrave të pritjes, hapësirave të sigurta dhe objekteve të mundshme për strehim të përkohshëm;
- identifikimin e rrugëve alternative të aksesit dhe evakuimit;
- organizimin e fushatave ndërgjegjësuese
- evidentimin e mjeteve, pajisjeve dhe burimeve lokale që mund të përdoren gjatë emergjencave;
- organizimin e ushtrimeve dhe simulimeve periodike;
- përditësimin e listave dhe të vendndodhjes së grupeve vulnerabël.
- bashkëpunimin me strukturat e MZSH-së, shërbimet shëndetësore, policinë, operatorët e infrastrukturës kritike dhe aktorët e tjerë sipas natyrës së emergjencës.

Nga ana e Njësive Administrative një vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet **grupeve të cënueshme**, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, personat që jetojnë vetëm, fëmijët, gratë, familjet që ndodhen në zona me ekspozim të lartë. Nga ana e Njësisë Administrative për këto grupe duhet të parashikohen masa të përshtatura për njoftimin, evakuimin, strehimin dhe ofrimin e asistencës.

7.4.2 Gatishmëria e komuniteteve

Komunitetet duhet të kenë njohuritë dhe aftësitë bazë për të vepruar në mënyrë të sigurt përpara, gjatë dhe pas një emergjence. Për këtë qëllim, Sektori i Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, në DZHRBMC-së në bashkëpunim me njësitë administrative/kryetarët e lagjeve dhe të fshatrave dhe institucionet përgjegjëse sipas programeve të miratuara, duhet të zhvillojnë aktivitete informuese, trajnuese dhe praktike me komunitetin.

Gatishmëria e komuniteteve duhet të fokusohet në:

- njohjen e risqeve kryesore të zonës;
- njohjen e sinjaleve të alarmit dhe mënyrave të marrjes së njoftimeve;
- njohjen e rrugëve të evakuimit dhe pikave të grumbullimit;
- përgatitjen e planeve familjare për emergjencat;
- njohuritë bazë për ndihmën e parë dhe masat e vetëmbrojtjes;
- mbështetjen e personave që kanë nevojë për asistencë gjatë evakuimit;
- pjesëmarrjen në ushtrime dhe simulime;
- krijimin dhe trajnimin e grupeve të vullnetarëve të komunitetit.

Ushtrimet dhe simulimet periodike me komunitetin duhet të përdoren për të testuar procedurat e gatishmërisë dhe për të evidentuar problematikat që kërkojnë përmirësim. Rezultatet e këtyre aktiviteteve duhet të shërbejnë për përditësimin e planeve, procedurave dhe masave të gatishmërisë.

Në këtë mënyrë, gatishmëria e njësive administrative dhe komuniteteve kontribuon në rritjen e kapaciteteve vendore, përmirësimin e koordinimit, zvogëlimin e cenueshmërisë, përmirësimin e përgjigjes ndaj emergjencave dhe forcimin e aftësisë ripërtëritëse të komunitetit.

7.5 Strukturat dhe institucionet, rolet dhe përgjegjësitë e tyre për gatishmërinë –bashkia Durrës

Emri i institucionit, strukturës, organizatës.	**Rolet dhe përgjegjësitë kryesore në fazën e gatishmërisë**
Institucione në nivel bashkie	
Bashkia Durrës	**Nëpërmjet Sektorit të Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile**:

Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile	• Zhvillon dhe përditëson Planin Vendor të Emergjencave Civile. • Organizon dhe koordinon stërvitjet dhe simulimet e gatishmërisë ndaj fatkeqësive duke përfshirë komunitetin dhe institucionet vendore. • Mban dhe përditëson një inventar të burimeve dhe furnizimeve emergjente për përgjigjen ndaj situatave emergjente. • Vlerëson gatishmërinë e ekipeve të reagimit ndaj emergjencave dhe përgatitë ato për ndërhyrje në situata të ndryshme emergjencash civile. • Koordinon forcat mbështetëse të shpëtimit dhe të ndihmës së parë për të siguruar një reagim të shpejtë dhe efektiv gjatë emergjencave. • Siguron logjistikë për furnizimin me materiale dhe pajisje emergjente për të mbështetur ekipet e shpëtimit dhe për të përmbushur nevojat kritike gjatë emergjencave. **Nëpërmjet sektorëve të tjerë të Drejtorisë:** • Hartimi i planeve të gatishmërisë për bujqësinë, pyjet për të mbështetur komunitetin gjatë situatave emergjente. • Sigurimi i stabilitetit të infrastrukturës bujqësore (si sistemet e ujitjes dhe kanalizimeve) për të përballuar kushte ekstreme, si thatësirat dhe përmbytjet. • Përcaktimi i masave të menjëhershme për ndihmën dhe reagimin ndaj fatkeqësive që mund të prekin pyjet dhe ekosistemet natyrore (si zjarret apo shkatërrimi i habitateve natyrore). • Hartimi i planeve për mbrojtjen e kafshëve dhe sigurinë e shëndetit të tyre gjatë emergjencave. • Organizimi i trajnimeve për fermerët dhe komunitetin për të qenë të gatshëm për situata emergjencash. • Hartimi i masave për mbrojtjen e biodiversitetit dhe ekosistemit gjatë periudhave emergjencash, si përmbytjet dhe zjarret në pyje. • Krijimi dhe implementimi i sistemeve të komunikimit dhe informimit për bujqësinë, pyjet, dhe shëndetin e kafshëve gjatë situatave emergjente. • Organizimi i strukturave për strehimin dhe mbështetje për fermerët dhe komunitetin në rast të emergjencave.
Bashkia Durrës Drejtoria e Turizmit	• Koordinon me strukturat e Mbrojtjes Civile të bashkisë për masat e gatishmërisë në zonat me frekuentim të lartë turistik. • Mban dhe përditëson informacionin mbi kapacitetet turistike dhe numrin e përafërt të vizitorëve, kur ky informacion është i disponueshëm. • Informon dhe orienton operatorët turistikë, subjektet akomoduese dhe aktorët e tjerë të sektorit mbi masat e gatishmërisë dhe udhëzimet zyrtare. • Siguron gatishmërinë e kanaleve të komunikimit dhe materialeve informuese për informimin e vizitorëve në rast emergjence. • Organizon dhe zhvillon, në bashkëpunim me Sektorin e Mbrojtjes dhe të Emergjencave civile, fushata informuese dhe sensibilizuese për turistët, operatorët turistikë dhe subjektet akomoduese mbi risqet, masat e gatishmërisë dhe mënyrën e veprimit në rast emergjence. • Bashkëpunon me institucionet, bizneset dhe aktorët turistikë për zbatimin e masave të gatishmërisë dhe informimin e vizitorëve. • Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe turistike për të promovuar gatishmërinë e komunitetit për emergjencat.

	• Lehtëson koordinimin me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen civile. • Merr pjesë në trajnime dhe ushtrime në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe Mbrojtjes Civile.
Bashkia Durrës Drejtoria e Burimeve Njerëzore	• Përgatitja dhe përditësimi i listave të punonjësve që angazhohen në rast emergjencash civile. • Organizimi i personelit, turneve të shërbimit dhe zëvendësimeve, sipas planit të gatishmërisë. • Garantimi i vazhdimësisë së funksionimit të administratës dhe shërbimeve thelbësore të Bashkisë. • Informimi i punonjësve për detyrat, masat e sigurisë dhe procedurat që duhet të zbatohen gjatë emergjencave. • Bashkëpunimi me strukturën përgjegjëse për mbrojtjen civile për trajnimin dhe ndërgjegjësimin e personelit. • Sigurimi i gatishmërisë së shërbimeve mbështetëse, përfshirë rojet, shoferët dhe punonjësit e mirëmbajtjes. • Administrimi dhe ruajtja e dokumentacionit të nevojshëm për organizimin e personelit gjatë emergjencave. • Bashkërendimi me drejtoritë dhe sektorët e Bashkisë për zbatimin e masave të gatishmërisë. .
Bashkia Durrës Drejtoria e Informatikës dhe Dixhitalizimit	• Kontrollon gatishmërinë dhe funksionimin e sistemeve informatike, serverëve, rrjeteve dhe pajisjeve elektronike të Bashkisë. • Siguron ruajtjen e të dhënave dhe kryerjen e kopjeve rezervë për rikuperimin e informacionit në rast dëmtimi ose ndërprerjeje. • Garanton funksionimin e sistemeve të komunikimit elektronik, postës elektronike dhe rrjetit të institucionit. • Monitoron sigurinë kibernetike dhe merr masa për mbrojtjen e sistemeve dhe të dhënave nga aksesi i paautorizuar. • Kontrollon funksionimin e sistemeve të kamerave të sigurisë dhe të kontrollit të hyrje-daljeve. • Siguron mbështetje teknike për strukturat e Bashkisë të angazhuara në menaxhimin e emergjencave civile. • Përgatit procedurat për rikthimin në funksion të sistemeve informatike dhe shërbimeve digjitale në rast avarie ose ndërprerjeje. • Bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për mbrojtjen civile dhe drejtoritë e tjera për shkëmbimin e informacionit dhe garantimin e vazhdimësisë së komunikimit.
Bashkia Durrës Drejtoria Ligjore	• Siguron asistencë ligjore për strukturat e Bashkisë Durrës lidhur me zbatimin e legjislacionit në fuqi për emergjencat civile. • Shqyrton dhe përgatit akte administrative, urdhra, vendime dhe projektakte që lidhen me masat e gatishmërisë ndaj emergjencave civile. • Harton dhe shqyrton kontrata dhe marrëveshje me institucionet publike dhe subjektet private, kur lidhen me masat e gatishmërisë ndaj emergjencave civile. • Ofron asistencë ligjore për administrimin dhe vënien në dispozicion të pronave publike për nevoja të emergjencave civile, në përputhje me kompetencat ligjore. • Bashkëpunon me strukturat përgjegjëse të bashkisë për zgjidhjen e problematikave ligjore që lidhen me gatishmërinë ndaj emergjencave civile. • Ndjek çështjet dhe mosmarrëveshjet ligjore që lidhen me zbatimin e masave të gatishmërisë, brenda kompetencave të drejtorisë.
Bashkia Durrës	• **Identifikimi i institucioneve arsimore dhe kulturore** në administrim ose varësi të Bashkisë Durrës, që mund të

Drejtoria e Arsim Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare	përdoren për strehimin e përkohshëm të personave të prekur nga emergjencat civile. • **Bashkëpunimi me institucionet arsimore dhe strukturat përgjegjëse** për informimin dhe ndërgjegjësimin e nxënësve, fëmijëve, personelit arsimor dhe komunitetit mbi masat e gatishmërisë dhe sjelljen gjatë emergjencave civile. • **Informimi dhe ndërgjegjësimi i të rinjve dhe komunitetit** përmes aktiviteteve edukative, kulturore dhe sportive mbi parandalimin e rreziqeve dhe reagimin e duhur në situata emergjente. • **Koordinimi me institucionet kulturore dhe sportive në varësi të Bashkisë** për evidentimin e ambienteve, kapaciteteve dhe burimeve që mund të vihen në dispozicion në rast emergjence, sipas nevojave dhe udhëzimeve të strukturave përgjegjëse. • **Bashkëpunimi me komunitetet fetare dhe organizatat e komunitetit** për informimin, ndërgjegjësimin dhe mbështetjen e aktiviteteve sensibilizuese për gatishmërinë ndaj emergjencave civile.
Bashkia Durrës Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit.	• Identifikimi dhe evidentimi i zonave me rrezikshmëri në territorin e Bashkisë Durrës, nëpërmjet të dhënave urbanistike dhe hartografike. • Përgatitja dhe përditësimi i hartave tematike dhe të dhënave gjeohapësinore për zonat e rrezikuara, ndërtesat, rrugët dhe hapësirat publike, në mbështetje të planifikimit të masave të gatishmërisë. • Evidentimi i objekteve dhe ndërtesave që paraqesin problematika të mundshme strukturore, duke përcjellë informacionin te strukturat kompetente për vlerësim teknik. • Identifikimi i hapësirave publike që mund të përdoren si pika grumbullimi ose zona të përkohshme për sistemimin e personave të prekur nga emergjencat civile, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse. • Evidentimi i rrugëve dhe korridoreve të mundshme të evakuimit, në bashkëpunim me strukturat e mbrojtjes civile dhe institucionet përgjegjëse për infrastrukturën. • Sigurimi i informacionit teknik dhe hartografik për hartimin dhe përditësimin e Planit Vendor për Emergjencat Civile. • Identifikimi i problematikave territoriale dhe mjedisore që mund të rrisin rrezikun nga përmbytjet, erozioni bregdetar dhe fenomene të tjera natyrore. • Bashkëpunimi me strukturat përgjegjëse për kontrollin e territorit për evidentimin e problematikave që mund të cenojnë sigurinë publike.
Bashkia Durrës Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Trasnportit Publik.	• **Verifikimi i gatishmërisë së infrastrukturës publike**, duke evidentuar gjendjen e rrugëve, urave, objekteve publike, ndriçimit dhe rrjeteve inxhinierike që janë në administrim ose monitorim të Bashkisë. • **Identifikimi i akseve rrugore dhe rrugëve alternative të aksesit**, për të lehtësuar lëvizjen e mjeteve të emergjencës, ambulancave, zjarrfikësve dhe forcave të tjera të ndërhyrjes. • **Koordinimi me ndërmarrjet e shërbimeve publike**, për verifikimin e gatishmërisë së rrjeteve të ujësjellësit, kanalizimeve, ndriçimit publik dhe shërbimeve të tjera infrastrukturore. • **Përgatitja e të dhënave teknike dhe dokumentacionit përkatës**, për infrastrukturën publike, objektet bashkiake dhe investimet, me qëllim mbështetjen e vendimmarrjes dhe ndërhyrjeve gjatë emergjencave.

	• **Verifikimi i gatishmërisë së objekteve publike në administrim të Bashkisë**, si shkollat, kopshtet, çerdhet dhe qendrat sociale, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse përkatëse. • **Koordinimi për gatishmërinë e transportit publik**, duke shqyrtuar mundësitë e përshtatjes së itinerareve, organizimit të lëvizjes dhe mbështetjes së transportit sipas nevojave që mund të krijohen gjatë një emergjence. • **Sigurimi i gatishmërisë së sinjalistikës dhe masave të qarkullimit rrugor**, në bashkëpunim me ndërmarrjet përkatëse dhe strukturat e Policisë Bashkiake, për të mundësuar orientimin dhe menaxhimin e trafikut gjatë situatave emergjente. • **Përditësimi i informacionit mbi investimet dhe punimet në proces**, për të evidentuar kantieret, ndërhyrjet dhe kufizimet që mund të ndikojnë në aksesueshmërinë e rrugëve dhe funksionimin e infrastrukturës gjatë një emergjence. • **Përgatitja për ndërhyrje teknike emergjente**, nëpërmjet identifikimit të kapaciteteve të disponueshme dhe koordinimit të strukturave përkatëse për riparimin e defekteve infrastrukturore që mund të pengojnë reagimin ndaj emergjencave.
Bashkia Durrës Drejtoria e Shërbimeve Sociale	• Identifikon gupet e cenueshme dhe nevojat e tyre specifike gjatë emergjencave • Kryen trajnime të vazhdueshme të stafit. • Zhvillon një bazë të dhënash të burimeve të shërbimeve sociale për reagimin ndaj emergjencave • Harton dhe vendos paraprakisht një sistem mbrojtjeje, trajtimi, asistence sociale për grupet e cenueshme për shkak të emergjencës civile. • Zhvillon dhe zbaton mjetet, protokollet dhe udhëzimet e nevojshme që rregullojnë përgjegjësinë për mbrojtjen sociale. • Vlerësimi i nevojave sociale të popullsisë në zonat me rrezik të lartë, për të identifikuar individët dhe grupet që mund të kenë nevoja të veçanta gjatë një emergjence.
Bashkia Durrës Drejtoria e Buxhetit	• Ndan buxhetet për aktivitetet e gatishmërisë ndaj fatkeqësive dhe përmirësimet e infrastrukturës. • Krijon paraprakisht një sistem mbrojtjeje, trajtimi financiar, punësimi, mbështetjeje dhe përkujdesjeje sociale për grupet e cenueshme dhe për personat që për shkak të një emergjence civile humbasin masivisht strehimin dhe punën. • Siguron fonde nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare për iniciativa gatishmërie. • Krijon mekanizma financiarë për shpërndarje të shpejtë gjatë emergjencave. Monitoron dhe auditon fondet e alokuara për projektet e gatishmërisë.
Bashkia Durrës Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit i Njësisë Vendore	• Identifikon dhe monitoron ndërtimet në zonat me risk të lartë për të siguruar zbatimin e masave të sigurisë dhe minimizimin e risqeve gjatë emergjencave civile. • Monitoron dhe inspekton përdorimin e tokës për të siguruar që aktivitetet e zhvillimit dhe të ndërtimit të jenë në përputhje me standardet e gatishmërisë për emergjencat civile. • Pajisja e objekteve me shenja evakuimi dhe llamba emergjence.
Policia bashkiake	• Siguron mirëmbajtjen e rrugëve të hapura të transportit dhe garanton aksesin e rrugëve përmes shërbimeve të trafikut rrugor. • Fushata sensibilizuese dhe garantimi i sigurisë rrugore dhe transportit në bashkëpunim me Policinë e Shtetit. • Asistencë në vendosjen e komunikimit nëpërmjet radiove.

	• Siguron koordinimin me Policinë e Shtetit për të garantuar lëvizjen e sigurt të mjeteve dhe stafit emergjent gjatë situatave të gatishmërisë dhe përgatitjes për emergjenca civile. • Ngritja e strukturave të përkohshme për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit që lidhet me emergjencat civile. • Siguron aktivizimin e masës së gatishmërisë përgjatë rrugëve dhe infrastrukturës ku është lëshuar një alarm.
Bashkia Durrës Sektori i Shërbimit të MZSH	• Sigurimi që zjarrfikësit dhe personeli i shpëtimit të marrin trajnime të rregullta mbi teknikat, pajisjet dhe protokollet më të fundit. • Kryerja e stërvitjeve të rregullta të zjarrit dhe shpëtimit për të testuar gatishmërinë dhe për të përmirësuar procedurat. • Inspektimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të zjarrfikësve, automjeteve dhe pajisjeve mbrojtëse për t'u siguruar që ato janë funksionale gjatë gjithë kohës. • Mbajtja e një ekipi plotësisht operacional të pajisur dhe në gatishmëri për të ndërhyrë shpejt në rast të emergjencave të parashikuara.
Bashkia Durrës Njësitë Administrative	• Siguron trajnimin e stafit dhe të vullnetarëve të Njësisë Administrave për emergjencat. • Informon qytetarët për risqet e ndryshme dhe për mënyrat e veprimit në situata të emergjencës. • Siguron burimet e nevojshme për reagim, si pajisje, shërbime dhe vendstrehime. • Teston në mënyrë periodike sistemet e komunikimit brenda Njësisë për emergjencat. • Identifikon personat me aftësi të kufizuar, banesat me risk të lart dhe të izoluara dhe identifikon të gjitha akseset në raste emergjencash.
Institucione dhe struktura në nivel qarku	
Prefekti i Qarkut Durrës Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave	Planifikimi dhe Bashkërendimi: • Përgatitja dhe rishikimi periodik i Planit të Emergjencave Civile në nivel qarku, duke garantuar përputhjen dhe bashkërendimin e tij me planet përkatëse të bashkive. • Ofrimi i mbështetjes për bashkitë në hartimin, rishikimin dhe përditësimin e planeve të emergjencave civile, si dhe në vlerësimin e risqeve përkatëse në territoret që ato administrojnë. • Bashkëpunimi me institucionet publike dhe organizatat joqeveritare për forcimin e koordinimit dhe ruajtjen e gatishmërisë operacionale për përballimin e emergjencave. • Krijimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe formalizimi i tyre përmes nënshkrimit, me qëllim lehtësimin e shkëmbimit të burimeve, ekspertizës dhe kapaciteteve operacionale në funksion të gatishmërisë ndaj emergjencave. **Monitorimi dhe Administrimi i Burimeve** • Evidentimi dhe përditësimi i informacionit mbi burimet në dispozicion për përballimin e emergjencave, duke përfshirë mjediset e strehimit, pajisjet dhe personelin e trajnuar. • Ndjekja e funksionimit të mekanizmave të monitorimit dhe të sistemeve të paralajmërimit të hershëm për identifikimin në kohë të rreziqeve në territorin e qarkut. **Ndërgjegjësimi i Publikut dhe Përgatitja Operacionale**

	• Organizimi i veprimtarive informuese për komunitetin lidhur me rreziqet kryesore, procedurat e evakuimit dhe vendet e sigurta të strehimit. • Garantimi i informimit të vazhdueshëm të popullatës përmes komunikimit të të dhënave të sakta dhe të përditësuara mbi masat e gatishmërisë dhe mënyrat e veprimit në rast fatkeqësish.
Përfaqësues të FA në territorin e bashkisë	**Gatishmëria dhe Mbështetja Operacionale** • Organizimi i ushtrimeve për dislokimin e shpejtë të kapaciteteve në situata emergjente. • Hartimi i planeve logjistike për mbështetjen e operacioneve emergjente, përfshirë transportin dhe shpërndarjen e furnizimeve. • Përgatitja e mjeteve, pajisjeve ushtarake, kapaciteteve të transportit dhe spitaleve fushore për ofrimin e mbështetjes gjatë emergjencave. • Bashkëpunimi me autoritetet vendore dhe strukturat e mbrojtjes civile për planifikimin dhe koordinimin e masave të gatishmërisë. • Organizimi i trajnimeve për personelin, ekipet e ndërhyrjes së parë dhe komunitetin, me qëllim rritjen e kapaciteteve për përballimin e emergjencave.
Drejtoria Rajonale e OSSHE-së Durrës	**Monitorimi dhe Menaxhimi i Riskut** • Zbatimi i sistemeve të monitorimit për ndjekjen e funksionimit të rrjeteve të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe evidentimin në kohë të ndërprerjeve të mundshme. • Kryerja e inspektimeve dhe mirëmbajtja e nënstacioneve, transformatorëve dhe linjave të shpërndarjes, me qëllim uljen e rrezikut të defekteve. • Vlerësimi i ngarkesës së rrjetit për identifikimin e mbingarkesave dhe shmangien e ndërprerjeve të furnizimit. **Planifikimi dhe Garantimi i Furnizimit me Energji** • Planifikimi dhe testimi i skenarëve për vijimësinë e furnizimit me energji elektrike të objekteve dhe infrastrukturave kritike, si spitalet dhe impiantet e ujësjellësit. • Identifikimi i burimeve alternative të energjisë, përfshirë gjeneratorët rezervë, për objektet me rëndësi kritike në situata emergjente. • Hartimi dhe përditësimi i planeve të gatishmërisë për përballimin e ndërprerjeve të energjisë elektrike, duke përfshirë procedurat për riparimin dhe rikthimin sa më të shpejtë të furnizimit. **Koordinimi dhe Komunikimi** • Bashkëpunimi me bashkitë dhe institucionet përgjegjëse për koordinimin e masave të gatishmërisë ndaj emergjencave në sektorin energjetik. • Përcaktimi i procedurave të komunikimit për njoftimin në kohë të autoriteteve dhe konsumatorëve për ndërprerjet e planifikuara dhe situatat emergjente.
Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)	**Monitorimi dhe Mbrojtja e Infrastrukturës Kritike**

	• Monitorimi i vazhdueshëm i funksionimit të rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike për identifikimin në kohë të problematikave të mundshme. • Identifikimi dhe zbatimi i masave për mbrojtjen e nënstacioneve, transformatorëve dhe linjave të transmetimit me rëndësi kritike. **Planifikimi dhe Testimi i Gatishmërisë** • Hartimi dhe testimi i skenarëve për garantimin e vazhdimësisë së furnizimit me energji elektrike për shërbimet kritike gjatë situatave emergjente. • Përcaktimi i masave për kufizimin e ndërprerjeve të furnizimit me energji elektrike dhe rritjen e gatishmërisë për përballimin e situatave të jashtëzakonshme.
Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë	**Planifikimi dhe Monitorimi** • Hartimi dhe rishikimi periodik i planeve të gatishmërisë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në rast fatkeqësish. • Vlerësimi i gjendjes së aseteve kulturore dhe evidentimi i rreziqeve që mund të kërkojnë ndërhyrje për mbrojtjen e tyre. **Forcimi i Kapaciteteve** • Rritja e kapaciteteve profesionale dhe sigurimi i mjeteve të nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. • Organizimi i trajnimeve për personelin dhe vullnetarët lidhur me procedurat e mbrojtjes së aseteve kulturore gjatë situatave emergjente. **Ndërgjegjësimi dhe Bashkëpunimi** • Organizimi i veprimtarive informuese për komunitetin, pronarët dhe administratorët e aseteve kulturore mbi masat e gatishmërisë dhe mbrojtjes nga rreziqet. • Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore gjatë emergjencave
Administrata e Zonave të Mbrojtura Durrës.	**Monitorimi dhe raportimi i gjendjes së ekosistemeve pyjore dhe Zonave të Mbrojtura** • Kryerja e monitorimeve për evidentimin e rreziqeve të mundshme, si zjarret pyjore, përmbytjet dhe ndotjet mjedisore që mund të prekin zonat e mbrojtura. • Raportimi pranë strukturave përgjegjëse i problematikave dhe kërcënimeve që cenojnë biodiversitetin dhe habitatet natyrore. Mbledhja dhe analizimi i të dhënave mbi ndikimet natyrore dhe njerëzore në ekosisteme, në funksion të përmirësimit të gatishmërisë.

	Planifikimi dhe Përgatitja për Emergjencat Mjedisore • Përditësimi i procedurave të gatishmërisë për përballimin e zjarreve pyjore, përmbytjeve dhe ndotjeve mjedisore në zonat e mbrojtura. • Evidentimi i nevojave për personel, pajisje, mjete komunikimi dhe kapacitete të tjera të nevojshme për situata emergjente. • Përcaktimi i procedurave për njoftimin dhe shkëmbimin e informacionit me strukturat përgjegjëse në rast evidentimi të rreziqeve. **Monitorimi dhe Paralajmërimi i Hershëm** • Ndjekja dhe raportimi i treguesve të ndotjes së ajrit dhe ujërave, si dhe i ndryshimeve që mund të ndikojnë në ekosistemet e zonave të mbrojtura. • Bashkëpunimi me institucionet shkencore dhe strukturat e monitorimit për evidentimin dhe sinjalizimin në kohë të rreziqeve, si zjarret pyjore dhe përmbytjet. **Ndërgjegjësimi dhe Trajnimi i Komunitetit** • Informimi dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve lokale mbi risqet që mund të prekin zonat e mbrojtura dhe masat për mbrojtjen e tyre. • Organizimi i trajnimeve për personelin dhe vullnetarët mbi gatishmërinë ndaj emergjencave mjedisore dhe ruajtjen e burimeve natyrore.
Drejtoria Rajonale e AKU- Durrës	**Monitorimi i rreziqeve për sigurinë ushqimore:** • Mbledh dhe analizon të dhëna mbi fatkeqësitë natyrore, aksidentet industriale dhe shpërthimet e sëmundjeve që mund të ndikojnë në sigurinë ushqimore. • Siguron informacion mbi situatën e furnizimit me produkte ushqimore në treg. **Mbikëqyrja e operatorëve ushqimorë për përgatitjen ndaj emergjencave:** • Siguron që operatorët e biznesit ushqimor zbatojnë masa parandaluese për ruajtjen e standardeve të sigurisë në rast emergjencash. • Jep udhëzime teknike për ruajtjen e ushqimeve dhe zvogëlimin e humbjeve në situata emergjente. **Koordinimi përgatitor për emergjencat ushqimore:** • Merr pjesë në hartimin e planeve të gatishmërisë me institucionet përgjegjëse për menaxhimin e emergjencave. **Inspektimi i pikave të kontrollit kufitar:** • Zbaton protokolle të rrepta kontrolli për të parandaluar hyrjen e ushqimeve të pasigurta në situata emergjente. **Mbështetja e mekanizmave të paralajmërimit të hershëm:** • Monitoron dhe raporton për ndotjet ushqimore dhe faktorët që mund të sinjalizojnë rreziqe. **Sigurimi i zinxhirit të furnizimit:**

	• Raporton për gjendjen e furnizimit me ushqime, duke garantuar që produktet bazë mbeten të disponueshme në treg edhe gjatë emergjencave.
Zyra e Administrimit të Basenit Ujor (ZABU) **Ishëm – Erzen – Mat**	• **Monitorimi i vazhdueshëm i burimeve ujore:** Mbledh dhe analizon të dhëna mbi sasinë dhe cilësinë e ujërave për të identifikuar sinjalet e hershme të emegjencave ujore (p.sh., ndotje, thatësira ose përmbytje të mundshme). • **Identifikimi dhe raportimi i kërcënimeve ndaj burimeve ujore**: Vlerëson dhe dokumenton rreziqet që lidhen me ndotjen, abuzimin ose keqmenaxhimin e burimeve ujore dhe njofton autoritetet për marrjen e masave të nevojshme. • **Monitorimi i përputhshmërisë me kushtet e lejeve dhe autorizimeve:** Inspekton në terren përdorimin e burimeve ujore për të siguruar që operatorët e ujit të zbatojnë kërkesat ligjore dhe të mos cënojnë sigurinë e furnizimit. • **Koordinimi për gatishmërinë ndaj emergjencave ujore:** Bashkëpunon me institucionet përkatëse (autoritetet lokale, Këshillin e Basenit Lumor, prefekturat) për të harmonizuar masat parandaluese dhe për të përmirësuar mekanizmat e reagimit ndaj emergjencave ujore. • **Sigurimi i informacionit për publikun mbi masat mbrojtëse të ujit:** Përhap informacion mbi përdorimin e qëndrueshëm të ujërave dhe masat mbrojtëse në rast të përkeqësimit të cilësisë ose sasisë së ujit.
Agjencia Rajonale Ekstensionit Bujqësor Tiranë/ Sektori i Ekstensionit Bujqësor (SEB) Durrës,	**Monitorimi dhe vlerësimi i ndikimit të situatave emergjente në bujqësi:** • Kryen monitorim dhe mbledh të dhëna mbi ndikimin e fatkeqësive natyrore si përmbytjet, thatësirat, breshëri dhe sëmundjet e bimëve në sektorin bujqësor. • Përpilon raporte të rregullta mbi ekspozimin e sektorit bujqësor ndaj risqeve dhe propozon masa për të përmirësuar gatishmërinë dhe mbrojtjen e fermerëve. • Ofron rekomandime për përdorimin e metodave të qëndrueshme bujqësore që zvogëlojnë ndjeshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive. **Ndërgjegjësimi dhe këshillimi i fermerëve mbi risqet bujqësore dhe gatishmërinë:** • Informon dhe këshillon fermerët për rreziqet natyrore dhe ndikimin e tyre në prodhimin bujqësor. • Udhëzon fermerët mbi praktikat e sigurta të ruajtjes së prodhimeve dhe masat parandaluese për të minimizuar dëmet nga faktorët e jashtëm të rrezikut. • Siguron informacion për zbatimin e strategjive për gatishmërinë, duke ndihmuar fermerët të kenë rezerva ujore, mbrojtje ndaj dëmtuesve dhe sigurime bujqësore. **Koordinimi për rritjen e gatishmërisë në sektorin bujqësor:** • Bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, strukturat e emergjencave civile dhe njësitë vendore për menaxhimin e fatkeqësive që prekin sektorin bujqësor. • Jep mbështetje teknike për identifikimin dhe zbatimin e masave të gatishmërisë që ndihmojnë në mbrojtjen e prodhimit bujqësor dhe të gjësë së gjallë. • Siguron pjesëmarrjen e fermerëve në programet e gatishmërisë dhe i lidh ata me mekanizmat ekzistues të menaxhimit të risqeve në sektorin bujqësor.

	Ofrimi i trajnimeve mbi gatishmërinë dhe menaxhimin e risqeve në bujqësi: • Organizon trajnime për fermerët dhe specialistët bujqësorë mbi menaxhimin e thatësirave, përmbytjeve dhe sëmundjeve bujqësore. • Zhvillon udhëzime teknike mbi mbrojtjen e kulturave bujqësore dhe përdorimin e metodave rezistente ndaj ndryshimeve klimatike. • Siguron trajnime mbi sistemet e hershme të paralajmërimit dhe masat e gatishmërisë që fermerët mund të ndërmarrin për të reduktuar dëmet.
Agjencia Rajonale e Mjedisit	**Monitorimi dhe Raportimi:** • Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve mjedisorë për të identifikuar sinjalet e hershme të ndotjes ose ndikimeve të tjera mjedisore që mund të çojnë në fatkeqësi. • Raportimi periodik dhe informimi i autoriteteve përgjegjëse mbi ndryshimet mjedisore dhe rreziqet potenciale. **Forcimi i Kapaciteteve:** • Organizimi i trajnimeve për reaguesit dhe autoritetet vendore mbi menaxhimin e rreziqeve mjedisore gjatë fatkeqësive. • Sigurimi i protokolleve të qarta për menaxhimin e ndotjeve të mundshme dhe rreziqeve të tjera që mund të ndikojnë në mjedis dhe shëndetin publik.
Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë	**Monitorimi dhe vlerësimi i risqeve për shëndetin e kafshëve dhe bimëve:** • Kryen monitorim të vazhdueshëm mbi shëndetin e kafshëve dhe bimëve, duke vlerësuar rreziqet për shpërthimin e sëmundjeve. • Mbledh të dhëna mbi shpërthimet e mundshme të sëmundjeve infektive dhe ndikimet e tyre në shëndetin publik dhe sektorin bujqësor. • Përgatit raporte periodike mbi situatat e rrezikut, të cilat dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme për koordinim të mëtejshëm. **Planifikimi i masave parandaluese për sëmundjet e kafshëve dhe bimëve:** • Zhvillon dhe përditëson plane për parandalimin dhe menaxhimin e shpërthimeve epidemike, duke përfshirë protokollet për veprim në situata emergjente. • Siguron që të gjitha strukturat veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve janë të përgatitura për ndërhyrje, në përputhje me rregullat dhe standardet ligjore. • Koordinon me Drejtorinë e Përgjithshme për planifikimin e nevojave për shërbimin veterinar dhe mbrojtjen e bimëve në territorin e mbuluar. **Ndërgjegjësimi dhe trajnimi për parandalimin e sëmundjeve:** • Ofron udhëzime teknike për fermerët dhe operatorët bujqësorë mbi masat e gatishmërisë për sëmundjet e kafshëve dhe bimëve. • Siguron trajnime për fermerët mbi praktikat e sigurta në menaxhimin e shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjen e bimëve nga infeksionet. • Promovon masa për sigurinë veterinare dhe fitosanitare, duke ofruar informacion mbi monitorimin e sëmundjeve dhe përdorimin e mjeteve parandaluese. **Koordinimi dhe mbështetja institucionale për gatishmërinë** • Bashkëpunon me institucionet vendore dhe qendrore për të siguruar një planifikim të unifikuar për menaxhimin e emergjencave që prekin shëndetin e kafshëve dhe bimëve.

	• Koordinon me institucionet ndërkombëtare dhe partnerët e fushës për të përdorur praktikat më të mira në parandalimin e shpërthimeve epidemike. • Siguron përputhshmërinë e ofrimit të shërbimeve veterinare dhe fitosanitare me standardet ligjore dhe rregulloret në fuqi.
Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës	**Sigurimi i Funksionalitetit të Infrastrukturës:** • Monitorimi i vazhdueshëm dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujitjes dhe kullimit për të garantuar gatishmërinë teknike. • Identifikimi i pikave kritike të rrjetit dhe përgatitja e masave për ndërhyrje të shpejta. **Përgatitja e Burimeve Njerëzore dhe Teknike:** • Sigurimi i gatishmërisë së menaxherëve dhe specialistëve të jenë në gatishmëri dhe të përgatitur për të vepruar shpejt gjatë situatave emergjente. • Organizimi i trajnimeve për stafin mbi procedurat teknike dhe riparimet emergjente për të garantuar gatishmërinë teknike të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit. **Planifikimi dhe Koordinimi:** • Hartimi dhe përditësimi i planeve të gatishmërisë për menaxhimin e ujit duke u fokusuar në masat ndërhyrjet e menjëhershme dhe sigurinë e infrastrukturës. • Bashkëpunimi me bashkitë dhe institucionet përgjegjëse për koordinimin e masave parandaluese dhe emergjente.
Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizimeve Durrës, Sh.a	**Sigurimi i Furnizimit të Qëndrueshëm me Ujë:** • Planifikimi dhe garantimi i burimeve alternative për furnizimin me ujë në raste emergjencash për institucionet kritike, si spitalet, shkollat dhe zonat urbane. • Identifikimi dhe përgatitja e skenarëve të ndërprerjeve të furnizimit me ujë, duke siguruar masa alternative për vazhdimësinë e shërbimeve. **Funksionaliteti i Infrastrukturës:** • Inspektimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rezervë të trajtimit të ujit për t'u siguruar që ato janë funksionale gjatë emergjencave. • Kryerja e kontrolleve dhe ndërhyrjeve të rregullta dhe mirëmbajtja e rrjetit ekzistues të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për të siguruar funksionimin gjatë emergjencave. **Përgatitja Operacionale:** • Rishikimi i kapaciteteve teknike dhe burimeve për t'u siguruar që ekipi dhe infrastruktura janë në gatishmëri për ndërhyrje të menjëhershme. • Koordinimi me njësitë e emergjencave dhe institucionet përgjegjëse për të garantuar një reagim të shpejtë dhe efikas.
Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës	• **Mbështetja e institucioneve arsimore** në hartimin dhe përditësimin e **planeve të gatishmërisë** dhe protokolleve të evakuimit, duke siguruar që ato të jenë në përputhje me planin vendor të emergjencave civile. • **Koordinimi me institucionet përgjegjëse** për zbatimin e masave të sigurisë dhe gatishmërisë në institucionet arsimore. • **Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe stafit arsimor** për masat parandaluese dhe sjelljen e duhur gjatë situatave emergjente, në përputhje me udhëzimet e institucioneve përgjegjëse. • **Monitorimi i kapaciteteve të institucioneve arsimore** për përballimin e situatave emergjente dhe raportimi i problematikave tek autoritetet përkatëse.

	• **Mbështetja për organizimin e simulimeve dhe ushtrimeve praktike**, duke siguruar që shkollat të bashkëpunojnë me autoritetet lokale për zbatimin e protokolleve të sigurisë. • **Sigurimi i funksionimit të shërbimeve psikosociale** për të ofruar mbështetje emocionale për nxënësit dhe personelin në rast të situatave të jashtëzakonshme. • **Koordinimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore** për sigurimin e infrastrukturës së përshtatshme dhe mirëmbajtjen e objekteve arsimore për të garantuar sigurinë e tyre.
Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Durrës	**Hartimi dhe Përditësimi i Planeve të Gatishmërisë:** • Hartimi dhe përditësimi i planeve të emergjencave për institucionet arsimore, duke përfshirë protokollet e evakuimit dhe masat për sigurinë e nxënësve dhe stafit. • Udhëzimi dhe mbështetja e shkollave publike dhe private për harmonizimin e planeve të tyre emergjente me Planin Vendor për Emergjencat Civile dhe vlerësimin e riskut në nivel vendor. **Trajnimi dhe Përgatitja e Stafit:** • Organizimi i trajnimeve për mësuesit dhe personelin arsimor mbi masat e gatishmërisë, ndihmën e parë dhe menaxhimin e situatave emergjente. • Rritja e kapaciteteve të stafit për të vepruar si pika kyçe koordinimi gjatë emergjencave. **Ndërgjegjësimi dhe Përgatitja e Nxënësve:** • Zhvillimi i programeve edukative dhe fushatave ndërgjegjësuese për të rinjët mbi rreziqet, sigurinë dhe përgjigjen ndaj emergjencave. • Organizimi i ushtrimeve praktike dhe simulimeve emergjente për të testuar gatishmërinë e shkollave dhe stafit për t'iu përgjigjur situatave emergjente.
Drejtoria Vendore e Policisë Durrës./Komisariati i Policisë Durrës	**Planifikimi dhe Trajnimi për Situata Emergjente:** • Zhvillimi dhe përditësimi i planeve të sigurisë për mbrojtjen e popullsisë dhe infrastrukturës gjatë emergjencave. • Trajnimi i oficerëve për evakuim, menaxhimin e turmave dhe reagim ndaj fatkeqësive • Organizimi i ushtrimeve dhe simulimeve në bashkëpunim me shërbimet e emergjencës. **Masat për Sigurinë dhe Rendin Publik:** • Planifikimi dhe zbatimi i masave paraprake për garantimin e rendit dhe sigurisë publike para ndodhjes së emergjencave. • Identifikimi dhe hartimi i skenarëve për menaxhimin e trafikut dhe lëvizjen e qytetarëve në rast evakuimi. **Koordinimi dhe Mbështetja Operacionale në Fazën e Gatishmërisë:** • Planifikimi i mbështetjes logjistike për operacionet e evakuimit, përfshirë identifikimin e rrugëve të sigurta, zonave të grumbullimit dhe mjeteve të transportit emergjent. • Koordinimi me institucionet dhe strukturat e emergjencave për hartimin e strategjive të evakuimit dhe mbrojtjes së grupeve vulnerabël. • Përcaktimi i protokolleve për asistencën ndaj popullsisë në rrezik, duke siguruar që mekanizmat e ndihmës të jenë të qarta dhe të gatshme për zbatim.
Përfaqësues të kompanive të telekomunikacionit (Vodafone & One)	**Planifikimi dhe Përditësimi i Sistemeve të Komunikimit:** • Zhvillimi, testimi dhe përditësimi i planeve të gatishmërisë për komunikimet për rastet e emergjencave. • Vendosja e linjave prioritare të komunikimit për autoritetet dhe shërbimet e emergjencës. **Sigurimi i Mbështetjes Teknike dhe Operacionale:**

	• Ofrimi i mbështetjes teknike për institucionet vendore dhe shërbimet e emergjencës për të garantuar funksionimin e rrjetit gjatë emergjencave. • Trajnimi i stafit mbi protokollet emergjente për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit në emergjenca. **Komunikimi dhe Informimi i Përdoruesve:** • Sigurimi i udhëzimeve dhe informacioneve të menjëhershme për përdoruesit mbi përdorimin e shërbimeve të komunikimit emergjent.
Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës.	• **Vlerësimi i riskut:** Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve shëndetësore për institucionet shëndetësore dhe përditësimi periodik i dokumentacionit përkatës. • **Masat parandaluese:** Planifikimi i masave për reduktimin e ndikimeve të fatkeqësive dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve shëndetësore. • **Përgatitja e personelit:** Organizimi i trajnimeve dhe ushtrimeve simuluese për rritjen e gatishmërisë së personelit shëndetësor. **Koordinimi ndërinstitucional:** Bashkëpunimi me strukturat vendore dhe institucionet shëndetësore për përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive në emergjenca. • **Ndërgjegjësimi i komunitetit:** Në bashkëpunim me strukturat vendore informimi i popullatës për risqet shëndetësore dhe masat mbrojtëse në rast fatkeqësish. • **Monitorimi i gatishmërisë:** Evidentimi i nevojave dhe mangësive dhe propozimi i masave për përmirësimin e kapaciteteve për përballimin e emergjencave.
Inspektorati Shtetëror Shëndetësisë Durrës	• Përgatitja për ushtrimin e funksioneve të inspektimit në fushën e shëndetit publik gjatë situatave emergjente. • Evidentimi dhe raportimi i problematikave që mund të cenojnë shëndetin publik, në kuadër të kompetencave ligjore. • Bashkëpunimi me strukturat përgjegjëse për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e veprimeve në situata emergjente. • Sigurimi i gatishmërisë së strukturës për përmbushjen e detyrave institucionale gjatë emergjencave.
Spitali Rajonal Durrës	• Trajnimi i vazhdueshëm i stafit mjekësor dhe ndihmës për menaxhimin e situatave emergjente dhe fluksit të lartë të pacientëve. • Formimi dhe përgatitja e ekipeve emergjente shëndetësore për reagim të menjëhershëm në situata emergjente. • Sigurimi dhe rishikimi i rezervave farmaceutike dhe pajisjeve shtesë për gatishmërinë ndaj situatave emergjente masive. • Mirëmbajtja dhe monitorimi i bankave të gjakut për gatishmëri në raste urgjente • Hartimi dhe përditësimi i planit të gatishmërisë spitalore, për menaxhimin e fluksit të pacientëve përtej kapaciteteve të zakonshme. • Sigurimi dhe mirëmbajtja e flotës së mjaftueshme të autoambulancave dhe mjeteve të transportit për gatishmërinë ndaj emergjencave. • Përdorimi strategjik i personelit dhe pajisjeve të përshtatshme në çdo njësi që ofron shërbimin e urgjencës mjekësore për të garantuar transportin e shpejtë dhe efektiv të pacientëve.
Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Durrës	**Menaxhimi i Burimeve dhe Përgatitja për Emergjencat**

	• Sigurimi, ruajtja dhe mirëmbajtja e rezervave të furnizimeve emergjente, përfshirë ushqimet, ujin dhe materialet e ndihmës së parë. • Hartimi dhe zbatimi i programeve komunitare për gatishmërinë ndaj fatkeqësive, me synim rritjen e kapaciteteve lokale për përballimin e tyre. • Trajnimi i vullnetarëve për ndërhyrjen në situata emergjente dhe ofrimin e ndihmës së parë. • Organizimi i ushtrimeve praktike dhe simulimeve për vlerësimin dhe përmirësimin e aftësive të reagimit të vullnetarëve dhe komunitetit. • Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese për informimin e publikut mbi gatishmërinë dhe masat për mbrojtjen nga fatkeqësitë. • Organizimi dhe mobilizimi i strukturave vullnetare të trajnuara për mbështetjen e veprimeve në situata emergjente. •

Kapitulli 8. Përgjigjja dhe funksionet operacionale

Sipas përkufizimit të ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen Civile" **"Përgjigje"** është ofrimi i shërbimeve emergjente dhe të asistencës para dhe gjatë një fatkeqësie ose menjëherë pas saj, për mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, për të garantuar sigurinë publike dhe për të përmbushur nevojat themelore për mbijetesë të njerëzve të prekur.

8.1 Qëllimet kryesore të përgjigjes

Shpëtimi i jetëve. Përparësi absolute i jepet mbrojtjes së jetës njerëzore dhe ndërhyrjes në ndihmë të personave që ndodhen në rrezik. Kjo kërkon mobilizimin në kohë të strukturave të përgjigjes, organizimin e kërkim-shpëtimit dhe evakuimit, si dhe krijimin e kushteve të sigurta për personat e prekur dhe për personelin që kryen operacionet. Siguria dhe mirëqenia e strukturave të përgjigjes duhet të garantohet gjatë gjithë kohës, në mënyrë që ato të mund të vazhdojnë përmbushjen e detyrave të tyre.

Zbutja e vuajtjeve. Emergjencat mund të sjellin pasoja fizike, psikologjike dhe sociale që prekin individët, familjet dhe komunitetin edhe përtej periudhës së menjëhershme të ngjarjes. Përgjigjja duhet të synojë lehtësimin e këtyre pasojave nëpërmjet ndihmës së përshtatshme, mbështetjes së personave të prekur dhe adresimit të nevojave të tyre prioritare.

Kufizimi i emergjencës. Veprimet e përgjigjes duhet të synojnë ndalimin ose kufizimin e përhapjes dhe përshkallëzimit të emergjencës. Kjo përfshin identifikimin e rreziqeve, ndërhyrjen ndaj burimit të rrezikut kur është e mundur, mbrojtjen e zonave të ekspozuara dhe marrjen e masave për të parandaluar dëme të mëtejshme.

Mbrojtja e shëndetit publik. Përgjigjja duhet të sigurojë trajtimin e nevojave shëndetësore të personave të prekur dhe aksesin në shërbimet e kujdesit shëndetësor. Një vëmendje e veçantë i kushtohet parandalimit të rreziqeve shëndetësore që mund të shfaqen si pasojë e emergjencës, përfshirë sëmundjet, mungesën e ujit të sigurt dhe kushtet e papërshtatshme higjieno-sanitare.

Sigurimi i nevojave thelbësore. Personave të prekur ose të zhvendosur nga emergjenca duhet t'u sigurohen kushtet minimale të nevojshme për jetesë dhe mbrojtje. Në varësi të situatës, kjo përfshin ujë të pijshëm, ushqim, strehim, higjienë, veshmbathje dhe mbështetje të tjera bazë, duke marrë parasysh në mënyrë të veçantë nevojat e grupeve të cenueshme.

Mbrojtja e pronës. Përgjigjja duhet të synojë kufizimin e dëmeve ndaj pronës publike dhe private dhe mbrojtjen e objekteve dhe infrastrukturës me rëndësi për komunitetin. Vëmendje e veçantë i kushtohet ruajtjes së funksionalitetit të shërbimeve dhe infrastrukturës kritike, përfshirë furnizimin me ujë dhe energji, transportin, komunikimet dhe objektet publike.

Mbrojtja e mjedisit. Masat e përgjigjes duhet të synojnë kufizimin e dëmeve ndaj mjedisit dhe parandalimin e krijimit ose përhapjes së rreziqeve mjedisore si pasojë e emergjencës. Ndërhyrjet duhet të planifikohen dhe zbatohen duke marrë në konsideratë edhe sigurinë e personelit të angazhuar në operacionet e përgjigjes.

Rivendosja e funksionimit të komunitetit. Pas stabilizimit të situatës, përgjigjja duhet të krijojë kushtet për rikthimin gradual të jetës normale të komunitetit. Kjo përfshin rikthimin e shërbimeve thelbësore, transportit dhe komunikimeve, mbështetjen e individëve dhe familjeve të prekura, si dhe rivendosjen e funksioneve sociale dhe ekonomike. Çdo mbështetje financiare ose materiale ofrohet në përputhje me legjislacionin dhe procedurat në fuqi, me synim lehtësimin e procesit të rimëkëmbjes dhe forcimin e qëndrueshmërisë së komunitetit.

Në çdo situatë emergjente, vendimmarrja dhe përdorimi i burimeve duhet të orientohen fillimisht nga **mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerëzve**, vijuar nga kufizimi i pasojave të emergjencës, mbrojtja e funksioneve kritike dhe rikthimi i shpejtë e i sigurt i komunitetit në funksionim normal. Në PVEC të Bashkisë Durrës faza e *Përgjigjes* kalon nëpër katër etapa aktivizimi.

Tabela: Etapat e përgjigjes:

Alarmi për rritjen e gatishmërisë	**Etapa I**	Të gjitha masat për njoftimin e parë Mbledhja e informacionit Sinjalizimi për të rritur gatishmërinë
Vendosja e gjendjes së gatishmërisë	**Etapa II**	Gatishmëri e plotë Njoftimi i situatës së pashmangshme
Aktivizimi	**Etapa III**	Dislokimi i plotë dhe mobilizimi
Dalja nga situata	**Etapa IV**	Rikthimi i burimeve në veprimtaritë e zakonshme

Burimi Plani Kombëtar për Emergjencat Civile

Skema e menaxhimit të fatkeqësive në tre nivelet.



8.2 Marrja dhe verifikimi i informacionit

Është detyra e çdo strukture shtetërore, joshtetërore dhe qytetari në Shqipëri që, në mënyrë të menjëhershme, të informojë tek njësitë vendore: bashki, qark, në administratën e prefektit dhe institucionet e strukturat qendrore të çdo niveli në lidhje me situata reale apo të mundshme për emergjenca civile.

Informacioni për ngjarje reale apo të mundshme emergjente zakonisht vjen nga vrojtuesi i parë drejtpërdrejt në vendngjarje, strukturat policore, forcat e armatosura, zjarrfikës, punonjës të strukturave të ndryshme shtetërore, institucione monitoruese apo qytetar dhe, nëpërmjet tyre, tek autoritetet e qeverisjes vendore, qarkut dhe ato qendrore dhe detajet rreth situatës duhet të shpërndahen për të gjitha autoritetet përkatëse dhe të bëhen të disponueshme për të gjitha institucionet, strukturat dhe publikun e gjerë në të gjithë territorin e prekur. Për këtë qëllim shfrytëzohen të gjitha mundësitë e komunikimit dhe kapacitetet që ekzistojnë në strukturat shtetërore dhe joshtetërore.

Pas marrjes së njoftimit, autoritetet zyrtare duhet të kenë si përparësi përcjelljen e informacionit në Qendrën Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile (QKOEC). Në rastin kur informacioni merret drejtpërdrejt

nga QKOEC-ja, informohen autoritetet përkatëse në bashki, dhe qark dhe kërkohet prej tyre verifikimi i informacionit. QKOEC-ja informon drejtorin e AKMC-së, i cili, sipas rastit, informon Ministrin e Mbrojtjes për çdo emergjencë ose mundësi të ndodhjes së saj.

Në rastin e marrjes së informacionit nga bashkia rreth ndonjë situate emergjente ose ngjarjeje të mundshme të cilat mund të shkaktojnë një emergjencë në nivel bashkie strukturat e mbrojtjes civile në nivel bashkie, sektori përkatës, KMCB dhe autoritetet e zgjedhura në nivel vendor do të ndërmarrin veprime si më poshtë vijon:

8.3 Aktivitetet e bashkisë në fazën e përgjigjes

8.3.1 Etapa I. Alarmi për rritjen e gatishmërisë

Etapa I: Alarmi për rritjen e gatishmërisë vendoset në çastin e marrjes së njoftimit paraprak ose të informacionit për mundësinë e ndodhjes së një ngjarjeje e cila mund të shoqërohet me dëmtime në njerëz dhe dëme materiale.

Drejtori/Përgjegjësi i sektorit për emergjencat në Bashki/KMCB.	**Koha e reagimit**
Informon Kryetarin e Bashkisë dhe Prefektin për situatën dhe nevojën e aktivizimit të Etapës I: "Alarm për rritjen e gatishmërisë". Kryetari i bashkisë pas vlerësimit të situatës dhe konsultimeve vendos për fillimin e kësaj faze.	Urgjente
Komunikon me drejtuesit e Njësive Administrative të bashkisë për situatën.	E menjëhershme
Verifikon nëse QOECB ka staf dhe pajisje të mjaftueshme për të punuar 24 orë gjatë etapës "Sinjalizim për rritjen e gatishmërisë".	E menjëhershme
Verifikon dhe jep informacion prefektit, QOECQ ose QKOEC për ngjarje të mundshme rreziku.	Brenda 1 ore
Informon institucionet dhe strukturat përkatëse monitoruese dhe informuese/njoftuese në juridiksionin e bashkisë dhe kërkon prej tyre monitorimin e vazhdueshëm të rrezikut, dhënien e informacionit dhe parashikimin e zhvillimit të situatës.	Brenda 1 ore
Në koordinim me prefekturën, informon strukturat operacionale si MM, FA dhe PSH dhe kërkon prej tyre të vënë në gatishmëri strukturat e tyre dhe të japin informacion të vazhdueshëm për situatën.	Brenda 1 ore
Verifikon nëse mjetet e transportit ose më saktë kapacitetet e deklaruara në PVEC të bashkisë Durrës janë në gatishmëri, të pajisura me mjetet e nevojshme dhe nëse kanë rezerva karburanti.	Brenda 1 ore
Kërkon informacion për rezervat monetare të gatshme, të mbajtura nga bashkia dhe njësitë administrative për situata emergjente.	Brenda 1 ore
Kontrollon mjetet e komunikimit, përditësimin e listave të kontaktit të planit të emergjencave civile dhe aktivizon sistemin e paralajmërimit.	Brenda 1 ore
Siguron informacion të saktë për të bërë paralajmërimet dhe këshillimet e duhura për publikun me anë të mjeteve të informimit.	Brenda 1ore.
Përgatit informacion të përmbledhur për Institucionin e Prefektit sikurse dhe AKMC-në dhe nëse është e nevojshme.	Çdo 2 orë

8.3.2 Etapa II Vendosja e gjendjes së gatishmërisë

Vlerësohet nevoja për fillimin e fazës së dytë "*Vendosja e gjendjes së gatishmërisë*". Kjo bëhet kur një rrezik i afërt konsiderohet i pashmangshëm dhe mund të shoqërohet me dëme në njerëz.

Tabela: Etapa II: Vendosja e gjendjes së gatishmërisë

Drejtori/përgjegjësi i sektorit për EC në Bashki/KMCB.	**Koha e reagimit**
Informon kryetarin e bashkisë për situatën dhe nevojën e fillimit të Etapës 2 "*Vendosja e gjendjes së gatishmërisë*". Kreu i bashkisë pas konsultimeve dhe vlerësimeve vendos nisjen e kësaj faze.	Urgjente
Pas miratimit të kryetarit të bashkisë mblidhet KMCB dhe kërkohet përgatitje për vendimmarrje, takime informuese për median dhe popullatën.	Brenda 2 orësh
Komunikon me drejtuesit e njësive administrative dhe i informon për fillimin e Etapës 2 "*Vendosja e gjendjes së gatishmërisë*" dhe u kërkon të ndjekin situatën..	Menjëherë
Në koordinim me prefekturën informon strukturat e MM, FA dhe PSH dhe u kërkon atyre të ndjekin situatën sipas PVEC dhe të japin informacion të vazhdueshëm për situatën.	Brenda 1 ore
Në koordinim me prefekturën komunikon me strukturat e tjera monitoruese dhe informuese/njoftuese, operacionale aktive, operacionale mbështetëse dhe me strukturat të decentralizuara që operojnë në territorin e bashkisë dhe kërkon prej tyre të ndjekin situatën sipas PVEC dhe të japin informacion të vazhdueshëm për zhvillimin e situatës.	Brenda 1 ore
Harton raportin e parë mbi situatën dhe informacionin periodik që i dërgohet prefektit dhe AKMC-së sipas rastit.	Brenda 2 orësh
Kontrollon dhe konfirmon që të gjitha masat e mëparshme janë përmbushur.	Brenda 1 ore
Pas konsultimit me Prefektin dhe AKMC-në sipas rastit aktivizon QOECB që punon me staf të plotë, të pajisur për të punuar në etapën e "*Vendosjes të gjendjes së gatishmërisë*" për 24 orë. Në rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore QOECB aktivizohet menjeherë.	Menjëherë
Përgatit informacion për Institucionin e Prefektit, AKMC, publikun, median, donatorët dhe OJF-të e interesuara.	Brenda 2 orësh
Në bashkëpunim me prefekturën krijon dhe merr pjesë në grupe të përbashkëta vlerësimi dhe verifikimi të të dhënave për situatën në zonat në rrezik fatkeqësie.	Brenda 4 orësh
Informon popullatën për situatën e pritshme dhe i komunikon nevojën e zbatimit të masave vetëmbrojtëse. Prioritet i jepet banorëve të zonave në rrezik dhe në veçanti grupeve të cenueshme, si personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, personat që jetojnë vetëm, duke siguruar që informacioni të arrijë te të gjithë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.	Brenda 2 orësh
Verifikon disponueshmërinë/funksionalitetin e zonave të emergjencës, objekteve për pritjen e popullsisë dhe rrugëve të evakuimit	Brenda 2 orësh

8.3.3 Etapa III Aktivizimi

Aktivizimi fillon kur një ngjarje e papritur shkakton dëme në njerëz, pasuri ose mjedis, ose kur një ngjarje me zhvillim të ngadaltë paraqet rrezik të lartë për pasoja të njëjta, duke tejkaluar kapacitetet e strukturave të mbrojtjes civile në nivel vendor.

Ministri përgjegjës për Mbrojtjen Civile është autoriteti që shpall nisjen e Etapës së tretë, "A*ktivizimi*", duke angazhuar në mision vetëm strukturat e përhershme që kanë detyra të mbrojtjes civile.

Në rastet e emergjencave civile kombëtare, kur shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore, Komiteti Nderministror i Emergjencave Civile (KNEC) krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Në mbledhjen e tij të parë, KNEC emëron DQO, i cili merr drejtimin e përgjithshëm të përgjigjes në nivel qendror dhe koordinon ndihmën ndërkombëtare, sipas nevojës.

Tabela: Etapa III: Aktivizimi

Për emergjencat e shkallës së ulët, kryetari i bashkisë/KMCB	**Koha e reagimit**
Siguron aktivizimin e të gjitha strukturave dhe kapaciteteve të reagimit operacional dhe mbështetës në nivel bashkie, funksionimin e panderprerë të KMCB dhe aktivizimin e QOECB.	Brenda 1 ore
Kërkon informacion nga drejtori/përgjegjësi i strukturës së emergjencave civile në bashki për gjendjen emergjente.	Brenda 1 ore
Mbledh KMCB ose thërret urgjentisht atë pjesë të nevojshme të saj për konsultime sipas llojit të emergjencës për procesin e vendimmarrjes.	Brenda 2-4 orësh

Së bashku me prefektin dhe AKMC siguron që gjitha strukturat e nevojshme monitoruese dhe informuese/njoftuese si edhe strukturat operacionale aktive dhe operacionale mbështetëse të jenë funksionale 24/7 dhe në veprim për situatën..	Vazhdimisht
Nëse është e nevojshme, i propozon prefektit shpalljen e "Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore" për zonën e prekur.	Sipas situatës
Drejtori/Përgjegjësi i sektorit për EC në bashki/KMCB.	
Kërkon informacion periodik për situatën në terren nga grupet e përbashkëta të vlerësimit të situatës.	Çdo 2 orë
Nëse është e nevojshme, i propozon kryetarit të bashkisë shpalljen e "Gjendjes së Fatkeqësisë Natyrore" për zonën e prekur.	Sipas situatës
Harton raportin e parë për situatën dhe informacionin periodik, të cilat i dërgohen prefektit dhe AKMC-së sipas rastit..	Çdo 2 orë
Për fatkeqësitë e shkallës së lartë, pas emërimit, DOB do të sigurojë këto aktivitete.	
Siguron aktivizimin e të gjitha strukturave dhe kapaciteteve të reagimit operacional dhe mbështetës në nivel bashkie.	Menjëherë
Harton raporte me shkrim të situatës për Kryetarin e bashkisë, KMCB, prefektin, QOECQ ose drejtpërdrejt për QKOEC	Çdo 2 orë
Koordinon strukturat vendore , si dhe strukturat e tjera qendrore apo ndërkombëtare që vijnë në ndihmë	Vazhdimisht
Mban lidhje të rregullta dhe kontakte të vazhdueshme me drejtues të tjerë të forcave operacionale në nivel qarku dhe bashkitë fqinje, informon dhe kërkon ndihmë nga DOQ.	Vazhdimisht
Zbaton detyrat dhe urdhrat e marra nga KMC në bashki dhe Drejtuesi i Operacionit në qark (DOQ), si edhe nga DQO.	Vazhdimisht.

8.3.4 Etapa IV. Dalja nga situata

Tabela: Etapa IV. Dalja nga situata.

Në etapën IV, "Dalja nga situata", mund të kalohet:

Drejt nga etapa I ose etapa II, pa kaluar në situatën e fatkeqësisë.

Nga etapa III, kur një fatkeqësi ka ndodhur realisht dhe situata është stabilizuar.

Etapa IV përfaqëson rikthimin në situatë normale, ku nuk ka më një kërcënim të drejtpërdrejtë.

Dalja nga situata bëhet kur:

- Është kryer një vlerësim i plotë i situatës.
- Kërcënimi i fatkeqësisë është zvogëluar në mënyrë të qëndrueshme.
- Operacionet e ndihmës kanë dhënë rezultatet e pritshme.
- Nevojat më urgjente janë adresuar.

Drejtori/përgjegjësi i sektorit të Emergjencave në bashki/ KMCB.	**Koha e reagimit**
Raporton tek kryetari i bashkisë dhe komunikon me të gjithë kryetarët e Njësive Administrative për shpalljen e Etapës "*Dalja nga situata*".	Menjëherë
Informon të gjitha strukturat në varësi, institucionet dhe strukturat e tjera që veprojnë në territorin e bashkisë për etapën "*Dalja nga situata*".	Menjëherë
Verifikon nëse informacioni dhe këshillat e nevojshme i janë transmetuar popullatës nëpërmjet mjeteve të informimit publik.	Brenda 2 orësh
Harton raportin përfundimtar të situatës dhe ia dërgon prefekturës dhe AKMC.	Brenda 2-4 orësh
Përgatit informacion përmbledhës, për shpalljen e Etapës "*Dalja nga situata*", për mediat, donatorët dhe përfaqësuesit e OJQ-ve.	Në vazhdim

Grumbullon të gjitha të dhënat, raportet, hartat dhe korrespondencën duke i vendosur në dosjet përkatëse nën datën/numrin dhe titullin përkatës.	Brenda 2-4 orësh
Kthen çdo pajisje të marrë hua nga institucione dhe struktura të tjera.	Brenda ditës
Siguron rikthimin e QOECB në gjendjen e mëparshme dhe administratës së bashkisë në gjendjen normale të funksionimit.	Brenda ditës
Kontrollon që mjetet e transportit dhe asetet e tjera të marra nga institucionet dhe kompanitë private gjatë situatës, të kthehen në pronësi dhe gjendje normale pranë tyre.	Brenda ditës
Kërkon inventarizimin e gjendjes financiare dhe mbledhjen e faturave përkatëse	Çdo ditë
Kontrollon funksionimin e mjeteve të komunikimit, përditësimin e listës së kontakteve dhe rishikimin e numrave të celularëve të personelit kyç.	Në vazhdim

Diagrami më poshtë ilustron katër raste se si mund të arrihet Etapa IV.



8.4 Strukturat dhe institucionet, përgjegjësitë e tyre për përgjigjen - bashkia Durrës

Emri i institucionit, strukturës, organizatës.	**Rolet dhe përgjegjësitë kryesore në fazën e përgjigjes**
Institucione në nivel bashkie	
Bashkia Durrës Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile Komisioni i Mbrojtjes Civile i Bashkisë (KMCB)	**Roli kryesor:** Organizimi, koordinimi dhe bashkëpunimi me strukturat e administratës së Bashkisë Durrës, institucionet dhe strukturat e tjera që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në nivel vendor, Institucionin e Prefektit të Qarkut, bashkitë fqinje, subjektet private, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetin, për përballimin e emergjencës ose fatkeqësisë. **Përgjegjësi të detajuara:**

	• Mobilizimi, aktivizimi dhe koordinimi i burimeve njerëzore, materiale, teknike dhe financiare në nivel bashkie, për të siguruar përballimin sa më efektiv të emergjencës apo fatkeqësisë. • Bashkërendimi i punës së strukturës së MZSH-së me strukturat e tjera përkatëse për realizimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit. • Organizimi i evakuimit në kohë të popullsisë civile nga zonat e rrezikuara ose të prekura nga emergjenca. • Sigurimi i strehimit /akomodimit e përkohshëm të banorëve gjatë emergjencës, si dhe plotësimi i kushteve të nevojshme dhe i kërkesave të tyre bazë. • Adresimi i nevojave të popullsisë së prekur nga fatkeqësia për sigurimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe mbështetjes për shëndetin mendor. • Organizimi dhe koordinimi i ofrimit të ndihmave ushqimore dhe asistencës së nevojshme për banorët e prekur nga fatkeqësia gjatë situatës emergjente. • Bashkëpunimi me strukturat e Policisë së Shtetit (PSH) për ruajtjen e rendit dhe garantimin e sigurisë publike në zonat e prekura nga fatkeqësia. • Bashkërendimi i veprimeve me strukturat e bashkisë dhe institucionet e tjera në nivel vendor për marrjen e masave për mbrojtjen e gjësë së gjallë. • Dhënia në kohë e paralajmërimeve të hershme dhe informimi i publikut lidhur me situatat emergjente dhe masat që duhen marrë për përballimin e tyre. • Vlerësimi i gjendjes në terren për përcaktimin e natyrës dhe përmasave të emergjencës, si dhe identifikimi i masave të nevojshme për menaxhimin e situatës. • Kryerja e vlerësimit paraprak dhe të specializuar të dëmeve të shkaktuara dhe nevojave të evidentuara në zonat e prekura nga fatkeqësia. • Përgatitja e të dhënave dhe raporteve periodike mbi situatën e krijuar dhe përcjellja e tyre te Kryetari i Bashkisë, KMCB-ja dhe, sipas nevojës, te Prefektura dhe AKMC-ja. • Ofrimi i mbështetjes për QOECB-në dhe DOB-në në përmbushjen e detyrave përkatëse, në rastet kur këto struktura janë ngritur dhe janë funksionale. • Komunikimi i vazhdueshëm me Sektorin e Planifikimit, Përballimit të Emergjencave dhe Krizave në prefekturë dhe sipas nevojës me AKMC-në për situatën, si dhe nevojat për përballimin e saj. • Komunikimi i vazhdueshëm me njësitë administrative për situatën, si dhe me strukturat që janë të angazhuara për përballimin e emergjencës apo fatkeqësisë. • Komunikimi dhe bashkëpunimi me bashkitë fqinje për kryerjen e përgjigjes emergjente. • Aktivizimi i QOECB, bazuar në kriteret e përcaktuara në PKEC dhe PVEC. • Caktimi i DOB-së sipas rastit, për të drejtuar operacionin për menaxhimin e situatës së shkaktuar nga emergjenca ose fatkeqësia. në territorin e saj. • Nxjerrja e urdhrave dhe udhëzimeve për menaxhimin e situatës së shkaktuar nga emergjenca ose fatkeqësia nëse është e nevojshme. • Informimi i publikut dhe i medias për situatën.

	• Menaxhimi i asistencës ndërkombëtare duke kryer procedurat e Mbështetjes së Vendit Pritës (MVP). • Koordinimi dhe bashkëpunimi me strukturat përkatëse për sigurimin dhe restaurimin e infrastrukturës publike dhe kritike (ujë, rrugë, energji elektrike, kanalizime, qendra publike, shkolla etj.). • Sigurimi i përputhshmërisë së veprimeve të ndërmarra gjatë fazës së përgjigjes me legjislacionin në fuqi dhe procedurat përkatëse për menaxhimin e emergjencave civile. • Regjistrimi dhe dokumentimi i veprimeve të kryera gjatë procesit të Menaxhimit të Emergjencës Civile (MEC) ose përballimit të fatkeqësisë, me qëllim analizimin e përvojës së fituar, garantimin e llogaridhënies dhe raportimin pranë autoriteteve përkatëse.
Bashkia Durrës Sektori i Marrëdhënieve me Publikun	• Administron, regjistron dhe protokollon kërkesat, ankesat dhe njoftimet e qytetarëve të lidhura me situatën emergjente. • Përcjell pa vonesë pranë strukturave kompetente kërkesat dhe problematikat e qytetarëve që lidhen me pasojat e emergjencës civile. • Bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për mbrojtjen civile dhe njësitë administrative për evidentimin dhe përcjelljen e nevojave të qytetarëve të prekur. • Orienton qytetarët drejt strukturave përgjegjëse për marrjen e shërbimeve dhe ndihmës së nevojshme, sipas informacionit të konfirmuar nga autoritetet kompetente. • Kujdeset për përcjelljen me përparësi të kërkesave të personave në nevojë dhe të grupeve në kushte cenueshmërie. • Mban evidenca për kërkesat e administruara dhe problematikat e përcjella, duke informuar strukturat drejtuese për nevojat e evidentuara. • Bashkëpunon me strukturat kompetente për ndjekjen e kërkesave dhe adresimin e problematikave të qytetarëve gjatë situatës emergjente.
Bashkia Durrës Drejtoria e Turizmit	• Aktivizon personelin dhe burimet për të përballuar situatat emergjente që lidhen me territorin. • Bashkëpunon me strukturat bashkiake dhe aktorët e turizmit për koordinimin e veprimeve gjatë emergjencës. • Siguron informimin e turistëve dhe vizitorëve për situatën emergjente, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse. • Siguron mbledhjen dhe raportimin e informacionit mbi problematikat dhe pasojat e emergjencës në sektorin e turizmit. • Përcjell pranë strukturave kompetente nevojat e evidentuara në zonat turistike. • Bashkëpunon në vlerësimin e dëmeve dhe nevojave të lidhura me strukturat dhe zonat e prekura. **Nëpërmjet Sektorit të Integrimit Evropian dhe Ndihmës së Huaj.** **Monitorimi i zbatimit të procedurave të Mbështetjes së Vendit Pritës (MVP**): • Siguron që procedurat për pranimin dhe koordinimin e ndihmës ndërkombëtare të zbatohen në përputhje me rregullat dhe standardet ndërkombëtare. **Koordinimi i ndihmës ndërkombëtare:** • Ndërmjetëson ndërmjet autoriteteve vendore dhe partnerëve ndërkombëtarë për shpërndarjen e ndihmave humanitare dhe burimeve në zonat e prekura. **Mbështetja logjistike për ekipet ndërkombëtare:** • Siguron mbështetje logjistike dhe informacione për ekipet ndërkombëtare që veprojnë në terren gjatë emergjencave. **Raportimi mbi ndihmën ndërkombëtare:**

	• Përgatit raporte për institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare mbi ndihmën e marrë dhe shpërndarjen e saj.
Bashkia Durrës Drejtoria e Burimeve Njerëzore	• Koordinon me strukturat përgjegjëse për organizimin dhe angazhimin e personelit të bashkisë, sipas nevojave të krijuara nga situata emergjente. • Administron dhe përcjell dokumentacionin dhe korrespondencën zyrtare që lidhet me menaxhimin e emergjencës, duke garantuar ruajtjen dhe sigurinë e tyre. • Siguron funksionimin e shërbimeve mbështetëse të institucionit, përfshirë ruajtjen e objektit, mirëmbajtjen e ambienteve dhe pajisjeve, si dhe gatishmërinë e furnizimit me energji elektrike (gjeneratorin). • Bashkëpunon për organizimin e transportit dhe mbështetjen logjistike të nevojshme për kryerjen e detyrave institucionale gjatë emergjencës. • Kujdeset për ruajtjen e dokumentacionit dhe administrimin e të dhënave të nevojshme për vijimësinë e veprimtarisë administrative gjatë situatës emergjente. • Mbështet vijimësinë e funksioneve administrative të Bashkisë gjatë emergjencës, nëpërmjet administrimit të personelit, dokumentacionit dhe shërbimeve mbështetëse.
Bashkia Durrës Drejtoria e Informatikës dhe Dixhitalizimit	• Siguron funksionimin e sistemeve informatike, rrjeteve dhe pajisjeve elektronike të bashkisë. • Mbështet shkëmbimin elektronik të informacionit ndërmjet strukturave të angazhuara në përballimin e emergjencës. • Ofron asistencë teknike për zgjidhjen e problemeve që pengojnë funksionimin e sistemeve informatike. • Garanton sigurinë, ruajtjen dhe rikthimin e të dhënave elektronike kur nevojitet. • Mbështet publikimin dhe përditësimin e informacionit në kanalet elektronike të bashkisë, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse. • Evidenton dhe raporton problematikat teknike që ndikojnë në vijimësinë e shërbimeve informatike gjatë emergjencës.
Bashkia Durrës Drejtoria Ligjore	• Ofron mbështetje dhe këshillim ligjor për strukturat e bashkisë lidhur me masat dhe veprimet që ndërmerren gjatë emergjencës. • Shqyrton dhe përgatit aktet administrative, urdhrat, vendimet dhe dokumentacionin ligjor të nevojshëm për menaxhimin e situatës emergjente. • Bashkëpunon me drejtoritë dhe strukturat përkatëse për hartimin e marrëveshjeve dhe kontratave të nevojshme për sigurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve gjatë emergjencës, në përputhje me legjislacionin në fuqi. • Asiston në trajtimin ligjor të çështjeve që lidhen me përdorimin e pronave publike gjatë emergjencës. • Trajton kërkesat dhe ankesat e qytetarëve që lidhen me çështje juridike të lindura gjatë situatës emergjente, brenda kompetencave të drejtorisë. • Kujdeset që veprimet administrative të ndërmarra gjatë përgjigjes ndaj emergjencës të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të dokumentohen sipas procedurave përkatëse.

Bashkia Durrës Drejtoria e Arsim Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare	• Bashkërendon me institucionet arsimore dhe strukturat përkatëse për evidentimin e problematikave dhe nevojave të krijuara nga emergjenca. • Bashkëpunon për marrjen e masave për sigurinë e fëmijëve, nxënësve dhe personelit në institucionet arsimore, në koordinim me strukturat përgjegjëse. • Evidenton dhe raporton dëmet dhe problematikat e konstatuara në institucionet arsimore, kulturore dhe sportive, në bashkëpunim me strukturat teknike përgjegjëse. • Bashkëpunon me institucionet kulturore, sportive, rinore dhe komunitetet fetare për të mbështetur veprimet e nevojshme në ndihmë të komunitetit të prekur. • Mbështet koordinimin për vënien në dispozicion të ambienteve të institucioneve në varësi, kur kjo kërkohet dhe miratohet nga autoritetet përgjegjëse. • Informon drejtuesit e bashkisë për situatën, problematikat dhe nevojat e evidentuara në fushat e përgjegjësisë së drejtorisë.
Bashkia Durrës Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit.	• **Organizon personelin për të kryer vlerësime fillestare dhe të specializuara të dëmeve dhe nevojave** në zonat e prekura nga fatkeqësia, duke përfshirë ndikimet në pronat publike dhe private. • **Ofron informacion hartografik dhe gjeohapësinor** për identifikimin e zonave të prekura dhe mbështetjen e vendimmarrjes gjatë emergjencës. • Bashkëpunon me drejtoritë dhe institucionet përgjegjëse për përcaktimin e nevojave për ndërhyrje në territorin e prekur nga emergjenca. • Mbështet identifikimin e hapësirave publike të përshtatshme për organizimin e shërbimeve dhe masave të përkohshme gjatë emergjencës, në koordinim me strukturat përgjegjëse. • Bashkëpunon me institucionet përkatëse për shkëmbimin e informacionit teknik, hartografik dhe mjedisor lidhur me situatën e krijuar.
Bashkia Durrës Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Trasnportit Publik.	• Organizon personelin për të kryer vlerësime fillestare dhe të specializuara të dëmeve dhe nevojave në zonat e prekura nga fatkeqësia. • Evidenton dhe vlerëson dëmet në infrastrukturën në administrim të Bashkisë Durrës. • Identifikon problematikat infrastrukturore që paraqesin rrezik për qytetarët dhe propozon masat teknike për eliminimin e tyre. • Koordinon ndërhyrjet emergjente për riparimin e dëmtimeve, largimin e pengesave, mbetjeve dhe rikthimin e funksionalitetit të infrastrukturës publike. • Bashkëpunon me strukturat e mbrojtjes civile, Policinë Bashkiake, ndërmarrjet në varësi dhe institucionet përgjegjëse për sigurimin e aksesit të mjeteve të emergjencës dhe kalueshmërinë e rrugëve. • Monitoron gjendjen e infrastrukturës dhe të objekteve publike të dëmtuara, duke kërkuar sipas rastit vlerësime teknike nga struktura kompetente dhe duke propozuar masa për garantimin e sigurisë. • Vlerëson nevojat për mjete, material dhe burime financiare për ndërhyrjet emergjente dhe përgatit dokumentacionin teknik përkatës. • Vlerëson ndikimin e emergjencës në transportin publik dhe qarkullimin rrugor, duke propozuar masa të përkohshme në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse.

	• Ndjek dhe monitoron punimet emergjente. • Bashkëpunon me institucionet dhe operatorët përgjegjës për rikthimin e shërbimeve të transportit, ndriçimit dhe infrastrukturës publike të prekur nga emergjenca.
Bashkia Durrës Drejtoria e Shërbimeve Sociale	• **Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave sociale:** Identifikon dhe vlerëson nevojat për individët dhe familjet e prekura nga emergjencat civile, duke u dhënë përparësi fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve dhe familjeve në situatë vulnerabël. • **Koordinimi i ndihmës sociale:** Bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për organizimin e ndihmës për familjet e prekura. • **Mbrojtja e grupeve vulnerabël:** Identifikon personat që kanë nevojë për mbrojtje të menjëhershme dhe koordinon referimin e rasteve pranë institucioneve kompetente, veçanërisht për fëmijët në rrezik, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit pa mbështetje familjare. • **Ofrimi i mbështetjes psikosociale:** Nëpërmjet punonjësve socialë dhe psikologëve, ofron këshillim dhe mbështetje emocionale për individët dhe familjet e prekura. • **Mbështetja për strehimin e përkohshëm:** Vlerëson nevojat sociale të familjeve të evakuuara ose të mbetura pa strehim dhe bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për sistemimin e tyre. • **Koordinimi ndërinstitucional:** Bashkëpunon me strukturat e mbrojtjes civile të Bashkisë Durrës, institucionet shëndetësore, Policinë e Shtetit, organizatat humanitare dhe ofruesit e shërbimeve sociale për adresimin e nevojave të popullatës së prekur. • **Garantimi i vazhdimësisë së shërbimeve sociale:** Kujdeset, brenda kompetencave dhe kapaciteteve të institucionit, për vazhdimësinë e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, familjet në nevojë dhe personat që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm. • **Informimi dhe orientimi i qytetarëve:** Informon familjet e prekura për shërbimet sociale të disponueshme, procedurat e përfitimit të ndihmës dhe institucionet ku mund të drejtohen për mbështetje. • **Dokumentimi dhe raportimi i situatës sociale:** Regjistron dhe administron informacionin mbi personat e prekur, nevojat e identifikuara dhe ndihmën e ofruar, si dhe raporton te drejtuesit përkatës për problematikat që kërkojnë ndërhyrje.
Bashkia Durrës Drejtoria e Buxhetit	• Siguron dhe shpërndan fondet emergjente, duke garantuar akses të menjëhershëm për të gjitha strukturat operacionale të bashkisë. • Bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe donatorët ndërkombëtarë për të siguruar financime shtesë për përballimin e situatave emergjente dhe për të ndihmuar në rikuperimin e zonave të prekura. • Monitoron disbursimin dhe përdorimin e fondeve të përgjigjes për të siguruar transparencë dhe për të parandaluar keqpërdorimet. • Merr pjesë në vlerësimin e dëmeve dhe identifikimin e nevojave në zonat e prekura, për të mbështetur procesin e rivendosjes së shërbimeve kryesore. • Bashkëpunon me Drejtorinë e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Trasnportit Publik, si dhe me Drejtorinë e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit.për të përcaktuar prioritetet financiare për rehabilitimin e infrastrukturës së dëmtuar.

	• Përcakton nevojat për fonde shtesë dhe mobilizon mekanizmat e financimit, duke kërkuar mbështetje nga fondet qendrore të qeverisë dhe partnerët ndërkombëtarë. • Koordinon procesin e pagesave për ndihmën emergjente dhe kompensimet financiare për të prekurit, sipas vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe strukturave qendrore.
Bashkia Durrës Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit i Njësisë Vendore	• **Mobilizimi i burimeve:** Aktivizon personelin dhe burimet për të përballuar situatat emergjente që lidhen me territorin. • **Vlerësimi i dëmeve:** Bashkëpunon në vlerësimin e dëmeve dhe nevojave të lidhura me strukturat dhe zonat e prekura. • **Kontrolli i territorit dhe i hapësirave publike** për evidentimin e zënieve të paligjshme, pengesave dhe ndërhyrjeve që mund të vështirësojnë veprimtarinë e strukturave të emergjencave civile. • **Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe qendrore** për shkëmbimin e informacionit dhe trajtimin e problematikave që lidhen me territorin dhe sigurinë e objekteve në zonat e prekura.
Bashkia Durrës Policia bashkiake	• **Mobilizimi dhe koordinimi:** Aktivizimi i burimeve për përballimin e emergjencave dhe fatkeqësive dhe koordinimi me strukturat vendore të policisë dhe strukturat e tjera: • **Evakuimi i popullatës:** Zbatimi i procesit të evakuimit të popullatës civile në zonat e prekura nga fatkeqësia duke siguruar një lëvizje të sigurt dhe të rregullt. • **Siguria dhe rendi:** Siguron masat e nevojshme për ruajtjen e rendit publik, kontrollin e trafikut dhe garantimin e sigurisë në zonat e prekura nga fatkeqësia; Monitorimi i zonave me rrezik për të parandaluar veprimet e paautorizuara apo të rrezikshme. • **Mbështetje për strehimin dhe akomodimin:** Asistenca në ruajtjen e rendit dhe sigurisë në vendet e strehimit të përkohshëm, duke ndihmuar në lëvizjen dhe organizimin e popullsisë së evakuuar dhe duke mbështetur strukturat përgjegjëse për menaxhimin e kushteve në këto vende. • **Mbështetje logjistike:** Pjesëmarrje në ofrimin e ndihmës ushqimore dhe ndihmës të tjera emergjente për popullsinë e prekur, duke siguruar shpërndarjen në mënyrë të organizuar dhe të sigurt.
Bashkia Durrës Sektori i Shërbimit të MZSH	**Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve.** • Aktivizimi i burimeve njerëzore, materiale dhe teknike për t'u përgjigjur emergjencave dhe fatkeqësive në mënyrë efektive. • Sigurimi që pajisjet dhe personeli të jenë në gatishmëri të plotë për operacione emergjente. **Bashkëpunimi dhe koordinimi:** • Bashkëpunim i ngushtë me strukturat vendore, si policia, strukturat e mbrojtjes civile dhe organizatat ndërkombëtare të kërkim-shpëtimit. • Pjesëmarrje në operacione të integruara për menaxhimin e emergjencave dhe fatkeqësive. **Kryerja e operacioneve të kërkim-shpëtimit:** • Zhvillimi i operacioneve për kërkimin dhe shpëtimin e personave të bllokuar ose të humbur në zonat e prekura. • Ndërhyrje për të shpëtuar jetën dhe për të minimizuar dëmet në pronë dhe mjedis. • Shmangia e rreziqeve dytësore gjatë operacioneve emergjente. **Menaxhimi i zjarreve dhe mbrojtja e mjedisit:** • Ndërhyrje në shuarjen e zjarreve në zonat urbane, rurale dhe pyjore. • Parandalimi i përhapjes së zjarreve dhe minimizimi i dëmeve në mjedis.

Bashkia Durrës Njësitë Administrative	• **Evidentimi dhe raportimi i situatës:** Konstaton dëmet dhe rreziqet në territor, identifikon zonat e prekura dhe informon menjëherë strukturat e emergjencave civile të bashkisë. • **Njoftimi i popullsisë:** Informon banorët për rrezikun, masat e sigurisë, udhëzimet e autoriteteve dhe nevojën për evakuim, sipas udhëzimeve të strukturave kompetente. • **Mbështetja e evakuimit:** Në koordinim me strukturat përgjegjëse ndihmon në identifikimin e personave që kanë nevojë për evakuim, veçanërisht të moshuarit, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe personat e tjerë në nevojë, si dhe për evakuimin e tyre. • **Koordinimi me strukturat vendore:** Mbështet bashkinë, strukturat e mbrojtjes civile, shërbimet e emergjencës, Policinë e Shtetit, shërbimin zjarrfikës dhe institucionet e tjera të përfshira në përballimin e emergjencës. • **Mbështetja e kryetarëve të fshatrave:** Koordinon komunikimin me kryetarët e fshatrave për marrjen e informacionit nga terreni, identifikimin e nevojave të banorëve dhe përcjelljen e udhëzimeve zyrtare. • **Identifikimi i nevojave të popullsisë:** Mbledh dhe përcjell informacion për familjet e prekura, personat e evakuuar dhe nevojat për ushqime, ujë të pijshëm, veshmbathje, medikamente dhe strehim të përkohshëm. • **Mbështetja logjistike:** Ndihmon në organizimin e transportit, shpërndarjen e ndihmave dhe sigurimin e ambienteve të përshtatshme për strehimin e përkohshëm të banorëve. • **Mbështetja e funksionimit të shërbimeve publike:** Raporton ndërprerjet ose dëmtimet që prekin shërbimet publike dhe ndihmon në koordinimin e ndërhyrjeve për rikthimin e tyre, sipas përgjegjësive përkatëse. • **Dokumentimi i situatës:** Mban evidenca dhe përgatit raporte për situatën emergjente, dëmet e konstatuara, masat e ndërmarra dhe nevojat e komunitetit. • **Parandalimi i rreziqeve të mëtejshme:** Njofton strukturat kompetente për situatat që mund të përkeqësojnë emergjencën, si rrëshqitjet e tokës, përmbytjet, dëmtimet e ndërtesave dhe bllokimi i rrugëve. • I**dentifikimi i dëmeve në territor:** Pas përfundimit të emergjencës, kontrbuon në kryerjen e një vlerësimi të dëmeve dhe nevojave për rindërtim dhe mbështetje.
Bashkia Durrës Ndërmarrja "Rruga"	• Aktivizon personelin, mjetet dhe makineritë në dispozicion për ndërhyrje të menjëhershme në zonat e prekura nga fatkeqësia. • Ndërhyn për pastrimin dhe hapjen e akseve rrugore të bllokuara, duke garantuar kalueshmërinë për mjetet e emergjencës dhe të shpëtimit. • Kryen ndërhyrje emergjente për pastrimin dhe zhbllokimin e kanaleve kulluese dytësore dhe tretësore, me qëllim lehtësimin e largimit të ujërave. • Vë në dispozicion mjetet e rënda për largimin e dherave, inerteve, pemëve të rrëzuara dhe pengesave të tjera në zonat e prekura.

	• Mbështet operacionet për kufizimin e përhapjes së përmbytjeve, nëpërmjet ndërhyrjeve në infrastrukturën kulluese që është në përgjegjësi të saj. • Sinjalizon dhe raporton menjëherë dëmtimet në rrugë, kanale dhe struktura të tjera infrastrukturore, duke njoftuar strukturat përgjegjëse. • Merr masa për kufizimin e qarkullimit në segmentet rrugore të rrezikshme, në koordinim me Policinë Bashkiake dhe strukturat kompetente. • Mbështet evakuimin e popullsisë dhe ndërhyrjet e strukturave të emergjencës, duke siguruar aksesin në zonat e prekura. • Bashkëpunon me strukturat e Mbrojtjes Civile dhe institucionet përgjegjëse për organizimin dhe koordinimin e ndërhyrjeve në terren.
Bashkia Durrës Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale	• Aktivizon personelin dhe mjetet në dispozicion për ndërhyrje të menjëhershme në zonat e prekura nga fatkeqësia. • Kryen pastrimin emergjent të rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike nga balta, mbetjet, inertet dhe materialet e tjera të krijuara nga fatkeqësia. • Organizon grumbullimin dhe largimin e mbetjeve që pengojnë qarkullimin ose paraqesin rrezik për shëndetin e popullatës. • Mbështet ruajtjen e higjienës në zonat e prekura dhe në ambientet e përdorura për evakuimin dhe strehimin e përkohshëm të qytetarëve. • Evidenton dhe raporton problematikat higjieno-sanitare që mund të krijojnë rreziqe për shëndetin publik. • Kryen, në koordinim me strukturat kompetente të shëndetit publik dhe sektorin veterinar, masat sanitare të nevojshme për parandalimin e rreziqeve biologjike. • Bashkëpunon me Ndërmarrjen Rruga për pastrimin e akseve rrugore dhe largimin e materialeve të depozituara gjatë fatkeqësisë. • Mbështet operacionet emergjente me personel, mjete dhe shërbime komunale, sipas kërkesave të strukturave përgjegjëse. • Raporton pranë strukturave të Mbrojtjes Civile për ndërhyrjet e kryera, problematikat e evidentuara dhe nevojat për mjete e burime shtesë.
Institucione dhe struktura në nivel qarku	
Prefekti i Qarkut Durrës Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave	• Koordinon forcat operacionale që veprojnë në nivel qarku për përballimin e emergjencës ose fatkeqësisë. • Koordinon dhe bashkërendon kapacitetet dhe burimet e disponueshme në nivel qarku për përballimin e situatës së krijuar nga emergjenca civile ose fatkeqësia. • Koordinon veprimtarinë e institucioneve, strukturave dhe administratave që veprojnë në nivel qarku për realizimin e ndërhyrjeve të nevojshme. • Siguron shkëmbimin e informacionit me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe prefektët e qarqeve të tjera të prekura ose të rrezikuara. • Koordinon marrjen e masave për përballimin e situatës emergjente, monitorimin e saj dhe zbatimin e shërbimeve urgjente, si dhe aktivizimin e institucioneve përgjegjëse për ndërhyrje specifike. • Kërkon ndihmë për ndërhyrje nga AKMC-ja, pasi të jenë ezauruar kapacitetet brenda qarkut për përballimin e emergjencës civile ose fatkeqësisë.

	• Grumbullon dhe përpunon informacionin e nevojshëm të përcjellë nga bashkitë dhe strukturat e tjera në nivel qarku dhe informon në mënyrë të vazhdueshme AKMC-në për situatën dhe nevojat e evidentuara. • Bashkëpunon me bashkitë e qarkut dhe prefektët e qarqeve fqinje për bashkërendimin dhe përdorimin e kapaciteteve të nevojshme për përballimin e situatave emergjente. • Koordinon shpërndarjen e asistencës ndërkombëtare në nivel qarku, në rastet kur ofrohet një asistencë e tillë për përballimin e fatkeqësisë.
Përfaqësues të FA në territorin e bashkisë	• Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve për evakuimin e popullatës civile. • Asistencë për procesin e strehimit (të përkohshëm)/akomodimin e popullsisë së evakuuar gjatë emergjencës. • Asistencë gjatë procesit të shpërndarjes të ndihmës ushqimore dhe ndihmës tjetër gjatë emergjencës. • Bashkëpunim dhe koordinim me strukturat e tjera operacionale që veprojnë në territor. • Në rastin e vërshimeve të lumenjve, asistencë për vendosjen e barrierave mbrojtëse dhe për punimet mbrojtëse në argjinatura. • Asistencë për operacionet e mbrojtjes nga zjarret. • Kontribuon për mbrojtjen infrastrukturës kritike dhe ndihmon në riparimet dhe pastrimin e mbeturinave gjatë emergjencave. • Kontribuon në sigurimin e rendit publik, menaxhimin e turmave dhe ruajtenn e aseteve strategjike gjatë emergjencave.
Drejtoria Rajonale e OSHEE-së Durrës	**Menaxhimi i ndërprerjeve dhe riparimi i rrjetit** • Menaxhimi i situatave të shkaktuara nga dëmtimet ose aksidentet në rrjetin e shpërndarjes së energjisë energjetike. • Organizimi i ekipeve të emergjencës për riparimin e defekteve dhe rikthimin e furnizimit me energji në zonat e prekura. **Koordinimi dhe reagimi.** • Organizimi i sistemit të njoftimit dhe ndërhyrjes emergjente në bashkëpunim me autoritetet përkatëse dhe strukturat e emergjencave civile. • Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike për infrastrukturën kritike dhe publike si spitalet, institucionet publike dhe qendrat e emergjencës. **Informimi dhe komunikimi me publikun** • Njoftimi i publikut mbi ndërprerjet e energjisë dhe afatet e rikuperimit. • Bashkëpunimi me institucionet vendore për të siguruar transparencë dhe koordinim efektiv gjatë emergjencave. **Ruajtja e funksionimit të infrastrukturës kritike** • Monitorimi i vazhdueshëm i rrjetit të shpërndarjes dhe parandalimi i mbingarkesave që mund të çojnë në dështime sistemike. • Aktivizimi i mekanizmave alternativë për furnizim të energjisë në rast të ndërprerjeve të gjata.
Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)	**Menaxhimi i situatës dhe rikthimi i furnizimit me energji elektrike** • Menaxhimi i situatave emergjente të shkaktuara nga dëmtimet në rrjetin elektrik dhe vlerësimi i ndikimit të tyre në furnizimin me energji. • Aktivizimi dhe koordinimi i ekipeve teknike për riparimin e linjave dhe pajisjeve të dëmtuara, me qëllim rikthimin sa më të shpejtë dhe të sigurt të furnizimit me energji elektrike. **Koordinimi dhe reagimi operacional**

	• Koordinimi me autoritetet vendore dhe institucionet qendrore për ndërhyrjet në infrastrukturën e transmetimit. • Sigurimi i furnizimit të vazhdueshëm me energji për objektet strategjike dhe kritike, si spitalet dhe qendrat e emergjencës. **Monitorimi dhe stabilizimi i rrjetit** • Monitorimi i gjendjes së rrjetit të transmetimit për të shmangur kolapsin. • Zbatimi i masave emergjente për të balancuar ngarkesën në sistemin e transmetimit dhe shmangur ndërprerjet masive. **Komunikimi dhe informimi** • Informimi i autoriteteve dhe institucioneve për situatën dhe masat e marra për stabilizimin e furnizimit me energji. • Bashkëpunimi me OSHEE për koordinimin e veprimeve të përbashkëta për rimëkëmbjen e rrjetit.
Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë	**Aktivizimi dhe koordinimi i strukturave:** • Angazhimi i strukturave dhe specialistëve përgjegjës për zbatimin e masave emergjente për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në zonat e prekura nga fatkeqësia. • Bashkëpunimi me Bashkinë Durrës, strukturat e mbrojtjes civile dhe shërbimet e emergjencës për sigurimin e zonave ku ndodhen pasuri kulturore të dëmtuara ose të rrezikuara dhe për garantimin e sigurisë gjatë ndërhyrjeve. **Mbrojtja e vlerave të trashëgimisët kulturore:** Identifikimi i monumenteve dhe pasurive kulturore që paraqesin rrezik të menjëhershëm dëmtimi ose shembjeje dhe njoftimi i strukturave përgjegjëse për marrjen e masave mbrojtëse. • Organizimi i evakuimit, sistemimit dhe ruajtjes së materialeve të rëndësishme nga institucionet e trashëgimisë kulturore, muzeumet dhe objektet monumentale. • Organizimi dhe realizimi i ndërhyrjeve urgjente për kufizimin e dëmtimeve të mëtejshme dhe mbrojtjen e pasurive kulturore të prekura, nëpërmjet specialistëve dhe strukturave të specializuara. **Vlerësimi i dëmeve:** • Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në objektet e trashëgimisë kulturore dhe institucionet muzeale. • Hartimi i raporteve teknike mbi dëmet e konstatuara dhe nevojat për ndërhyrje emergjente, konservim dhe restaurim.
Administrata e Zonave të Mbrojtura Durrës.	**Monitorimi dhe vlerësimi i situatës mjedisore** • Monitorimi dhe vlerësimi i pasojave të emergjencës në zonat e mbrojtura, duke përfshirë dëmtimet në biodiversitet, florë, faunë, ekosisteme dhe habitate natyrore. • Evidentimi dhe raportimi pranë institucioneve përgjegjëse i dëmeve të shkaktuara në zonat e mbrojtura dhe i ndikimeve të tyre në mjedis. **Masat e menaxhimit të emergjencës** • Koordinimi me autoritetet lokale, bashkitë, prefekturat dhe strukturat e mbrojtjes civile për përballimin e emergjencës ose fatkeqësisë. • Sigurimi i mbrojtjes së biodiversitetit dhe ekosistemeve duke ndërmarrë masa të menjëhershme për të kufizuar dëmet dhe për të parandaluar degradimin e mëtejshëm të mjedisit. • Angazhimi i stafit dhe burimeve për përgjigjen ndaj emergjencës, përfshirë mbikëqyrjen e ndërhyrjeve të paligjshme në zonat e mbrojtura. • Zbatimi i masave për të kufizuar ndikimet e emergjencës në florën dhe faunën, përfshirë evakuimin ose mbrojtjen e specieve të rrezikuara nëse është e nevojshme. **Komunikimi dhe ndërgjegjësimi**

	• Dhënia e udhëzimeve dhe paralajmërimeve për publikun dhe vizitorët për të shmangur rreziqet dhe për të siguruar respektimin e rregullave gjatë emergjencës. • Njoftimi i organeve kompetente për shkeljet ligjore të konstatuara në zonat e mbrojtura gjatë emergjencës dhe mbështetja për zbatimin e masave të menjëhershme ligjore.
Drejtoria Rajonale e AKU- Durrës	• Kryerja e kontrolleve për vlerësimin e sigurisë së produkteve ushqimore, në përputhje me riskun e paraqitur nga situata emergjente. • Reagimi ndaj njoftimeve të alarmit dhe marrja e masave urgjente për identifikimin, parandalimin dhe kufizimin e rreziqeve që cenojnë sigurinë ushqimore. • Kontrolli i produkteve ushqimore të ekspozuara ndaj ndotjes ose dëmtimit si pasojë e emergjencës, si dhe marrja e masave për produktet që rezultojnë të pasigurta. • Gjurmimi i produkteve ushqimore që paraqesin rrezik dhe bashkëpunimi për bllokimin ose tërheqjen e tyre nga qarkullimi, sipas kompetencave ligjore. • Informimi i konsumatorëve për rreziqet ushqimore: Informimi i publikut, nëpërmjet njoftimeve zyrtare, për produktet ushqimore të pasigurta të hedhura në treg, si dhe dhënia e udhëzimeve përkatëse për mbrojtjen e shëndetit dhe menaxhimin e situatës së emergjencës. • Bashkëpunimi me Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB) dhe institucionet e tjera përkatëse për shkëmbimin e informacionit dhe kufizimin e rreziqeve në zinxhirin ushqimor. • Bashkërendimi me Bashkinë Durrës dhe strukturat kompetente për trajtimin dhe asgjësimin e produkteve ushqimore, ushqimit për kafshë dhe inputeve bujqësore të papërshtatshme për përdorim, në përputhje me legjislacionin në fuqi. • Informimi dhe raportimi te strukturat përgjegjëse për problematikat e konstatuara, rreziqet e evidentuara dhe masat e ndërmarra gjatë emergjencës. • Zbatimi i masave për menaxhimin e situatave të krizës në fushën e sigurisë ushqimore, në përputhje me kompetencat institucionale dhe procedurat përkatëse.
Zyra e Administrimit të Basenit Ujor (ZABU) **Ishëm – Erzen – Mat**	**Monitorimi dhe raportimi i situatës:** • Monitorimi në mënyrë të vazhdueshme i nivelit të ujit, rrjedhjes së lumenjve, rezervuarëve dhe ujërave nëntokësore dhe kushteve të motit për të identifikuar përkeqësime kritike që mund të shkaktojnë përmbytje ose thatësira. • Kryen inspektime të menjëhershme për të vlerësuar ndikimin e emergjencës mbi burimet ujore dhe harton raporte për autoritetet përgjegjëse. • Informon Këshillin e Basenit Lumor dhe Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMB) mbi problematikat emergjente dhe kërkesën për masa urgjente. **Koordinimi i përgjigjes emergjente:** • Koordinimi me autoritetet lokale, bashkitë, prefekturën, degët e tjera territoriale dhe ato në nivel qendror për menaxhimin e situatës së emergjencës.

	• Sigurimi i të dhënave dhe analizave në kohë reale për të mbështetur vendimmarrjen për rastet emergjente. • Identifikon përdoruesit kryesorë të burimeve ujore që preken nga situata emergjente dhe koordinon me ta për menaxhimin e konsumit të ujit. **Sigurimi i cilësisë dhe sasisë së ujit** • Vlerësimi i cilësisë dhe sasisë së burimeve ujore në rajon, duke përfshirë lumenjtë, liqenet dhe rezervuarët. • Kryrja e monitorimeve të menjëhershme për cilësinë dhe ndotjen e ujit në zonat e prekura, duke raportuar për situatat me rrezik për shëndetin publik. • Identifikimi i dëmtimeve në infrastrukturën e burimeve ujore (p.sh., kanale ujitëse, diga, rezervuarë) dhe sinjalizimi i autoriteteve për masat e riparimit emergjent. **Komunikimi dhe ndërgjegjësimi publik:** • Lëshon njoftime emergjente për përdorimin dhe kursimin e ujit përmes kanaleve të informimit publik. • Siguron informacion dhe udhëzime për qytetarët dhe bizneset për reduktimin e rreziqeve që lidhen me krizën e ujit. • Koordinon me institucionet përgjegjëse për informimin e komuniteteve të prekura mbi situatën dhe masat mbrojtëse.
Agjencia Rajonale Ekstensionit Bujqësor Tiranë/ Sektori i Ekstensionit Bujqësor (SEB) Durrës,	**Vlerësimi i situatës dhe ndikimit në bujqësi** • Mbledhja dhe raportimi i të dhënave për dëmet në sektorin bujqësor, përfshirë dëmet në kultura bujqësore, blegtori dhe infrastrukturën bujqësore. • Koordinimi me institucionet qendrore dhe vendore për vlerësimin e ndikimit të emergjencës dhe përcaktimin e nevojave për ndërhyrje emergjente. **Mbështetja për fermerët në zonat e prekura** • Dhënia e informacionit dhe udhëzimeve urgjente për fermerët mbi masat e menjëhershme për mbrojtjen e prodhimit bujqësor dhe blegtorisë. • Sigurimi i mbështetjes logjistike për furnizimin e ushqimit të blegtorisë dhe farave emergjente, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse. **Koordinimi dhe mbështetja institucionale** • Bashkëpunimi me bashkitë, prefekturën dhe Ministrinë e Bujqësisë për të siguruar një përgjigje të koordinuar ndaj emergjencës. • Pjesëmarrja në vlerësimin e nevojave për ndihmë emergjente për fermerët dhe sigurimi i inputeve bujqësore thelbësore (farëra, ushqim për bagëtinë, plehra emergjente) për fermerët e prekur. **Informimi dhe ndërgjegjësimi publik** • Informimi i fermerëve mbi masat emergjente dhe ndihmën e disponueshme nga qeveria dhe organizatat ndërkombëtare për sektorin bujqësor. • Komunikimi i vazhdueshëm me institucionet përgjegjëse për përditësimin e të dhënave mbi nevojat emergjente dhe monitorimin e situatës.
Agjencia Rajonale e Mjedisit	**Mobilizimi dhe aktivizimi** • Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve për adresimin e emergjencave që ndikojnë në mjedis. • Monitorimi dhe menaxhimi i ndotjeve të shkaktuara nga fatkeqësitë, duke identifikuar zonat me risk të lartë. **Vlerësimi i dëmeve dhe ndikimit mjedisor** • Pjesëmarrja në bashkëpunim me strukturat e tjera për vlerësimin e dëmeve në mjedis. • Identifikimi i rreziqeve mjedisore shtesë të shkaktuara nga emergjenca dhe propozimi i masave mbrojtëse.

	Komunikimi dhe Koordinimi • Shkëmbimi i informacionit me institucionet përgjegjëse për menaxhimin e emergjencës dhe autoritetet vendore. • Ofrimi i udhëzimeve teknike për minimizimin e pasojave mjedisore dhe zbutjen e ndotjes në zonat e prekura.
Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë	**Kontrolli dhe menaxhimi i sëmundjeve infektive në kafshë.** • Zbatimi i masave të kontrollit për sëmundjet infektive në kafshë dhe ndalimi i lëvizjes së kafshëve të infektuara për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve zoonotike dhe epizootike. • Evidentimi dhe raportimi i gjendjes epizootike në zonat e prekura nga fatkeqësia dhe komunikimi me institucionet përkatëse. • Kryerja e veprimeve të menjëhershme sanitare dhe epidemiologjike, duke përfshirë izolimin e kafshëve të infektuara dhe zbatimin e masave të dezinfektimit. **Menaxhimi i situatës emergjente në blegtori.** • Koordinimi me autoritetet vendore dhe qendrore për menaxhimin e emergjencave në sektorin blegtoral, përfshirë Ministrinë e Bujqësisë, bashkitë dhe prefekturat. • Vlerësimi i dëmeve në blegtori, duke përcaktuar shkallën e humbjeve dhe nevojat për mbështetje emergjente për fermerët e prekur. • Zbatimi i masave të sigurisë ushqimore për produktet me origjinë shtazore, duke garantuar cilësinë e konsumit në kushtet e emergjencës. **Eliminimi dhe dëmshpërblimi për kafshët e ngordhura.** • Zbatimi i procedurave për eliminimin e kafshëve të ngordhura nga sëmundjet infektive ose nga ndikimi i fatkeqësive natyrore. • Bashkëpunimi me institucionet për sigurimin e kompensimeve për fermerët, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. **Mbrojtja e bimëve dhe vlerësimi i dëmeve në sektorin bujqësor.** • Identifikimi dhe raportimi i dëmeve në kulturat bujqësore dhe produktet bimore në zonat e prekura nga fatkeqësia. • Koordinimi me njësitë vendore dhe institucionet për mbështetje emergjente për fermerët, përfshirë masat për mbrojtjen e bimëve dhe përdorimin e pesticideve emergjente në rast të përhapjes së sëmundjeve bimore. **Koordinimi dhe mbështetja institucionale** • Bashkëpunimi me bashkitë, prefekturën dhe Ministrinë e Bujqësisë për të siguruar një përgjigje të koordinuar ndaj emergjencës. • Përcjellja e informacionit mbi gjendjen epizootike dhe fitosanitare tek institucionet përgjegjëse, për të mundësuar një reagim më të shpejtë dhe efikas.
Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës	**Menaxhimi i emergjencës dhe mobilizimi i burimeve** • Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve për menaxhimin e situatave emergjente, në veçanti për ujitjen dhe kullimin. • Zbatimi i masave emergjente të menaxhimit të ujit gjatë fatkeqësive (p.sh. çlirimet e kontrolluara të ujit për të shmangur përmbytjet dhe dëmtimet e infrastrukturës). **Monitorimi dhe vlerësimi i dëmeve** • Vlerësimi i dëmeve dhe nevojave në bujqësi, në infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit në zonat e prekura nga fatkeqësia dhe identifikimi i ndërhyrjeve të menjëhershme për stabilizimin e rrjetit. • Raportimi i dëmeve në sektorin e bujqësisë dhe ndikimit në prodhimin bujqësor në zonat e prekura. **Ndihma dhe mbështetja emergjente**

	• Sigurimi i funksionalitetit të rrjetit të kullimit për të shmangur përkeqësimin e situatës në zonat bujqësore. • Koordinimi me autoritetet vendore dhe fermerët për menaxhimin e emergjencës në furnizimin me ujë.
Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizimeve Durrës, Sh.a	• Mobilizimi dhe aktivizimi i burimeve për furnizimin e vazhdueshëm me ujë në zonat e prekura. • Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm për popullatën dhe objektet kritike në zonat e prekura nga emergjenca. • Ndërhyrja dhe riparimi i avarive në rrjetin e ujësjellësit për të rikthyer funksionalitetin sa më shpejt të jetë e mundur. • Informimi i publikut për ndërprerjet, masat e ndërmarra, dhe këshilla për ruajtjen e higjienës në kushte emergjence. • Koordinimi me strukturat e emergjencës për shpërndarjen alternative të ujit dhe asistencën në transportin e ujit në zonat e prekura.
Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës	**Koordinimi dhe komunikimi në Emergjenca:** • Bashkëpunimi me bashkitë, Prefektin e qarkut, Ministrinë e Arsimit, strukturat e planifikimit dhe të mbrojtjes civile për të siguruar një përgjigje të koordinuar ndaj emergjencave dhe fatkeqësive. • Shkëmbimi i informacionit rreth situatës dhe nevojave të shkollave të prekura, duke përfshirë transportin dhe shërbimet e emergjencës • Krijimi i linjave të qarta të komunikimit ndërmjet shkollave, mësuesve, prindërve për të ofruar përditësime dhe udhëzime për situatën. **Vlerësimi dëmeve dhe nevojave:** • Vlerësimi i ndikimit të emergjencës në shkolla, duke përfshirë dëmet në infrastrukturë dhe ndërprerjet e mësimit. • Identifikimi i nevojave emergjente të nxënësve dhe stafit (ushqim, ujë, mbështetje psikologjike). • Sigurimi i mbështetjes mjekësore dhe këshillimit psikologjik për nxënësit dhe stafin e prekur. **Garantimi i sigurisë së nxënësve dhe personelit dhe evakuuimi:** • Zbatimi i protokolleve të sigurisë për nxënësit, stafin dhe ndërtesat e shkollave, duke u siguruar që ato të jenë të sigurta nga dëmtimet e mëtejshme. • Mbështetja e evakuimit të shkollave të rrezikuara dhe sigurimi i transportit emergjent për nxënësit në zona të sigurta. • Ofrimi i mbështetjes mjekësore, ndihmës së parë dhe këshillimit psikologjik për nxënësit dhe stafin e prekur. • Mbështetje për popullatat e cenueshme (p.sh., fëmijët me aftësi të kufizuara ose ata në rrethana të veçanta). **Sigurimi i vazhdimësisë së edukimit:** • Vlerësimi i shkollave që mund të rifillojnë funksionimin dhe përcaktimi i afateve për rikthimin në mësim. • Përdorimi i metodave alternative të ofrimit të arsimit, si mësimi nëpërmjet programeve në internet, objektet e përkohshme shkollore ose metoda të tjera të mësimit në distancë, në rast të mbylljes së shkollave ose dëmtimit të infrastrukturës fizike. • Koordinimi me personelin arsimor për të siguruar që mësimdhënia dhe të nxënit mund të vazhdojnë edhe në mjedise të përkohshme ose të ndërprera.

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Durrës	• Krijimi i linjave të qarta të komunikimit ndërmjet shkollave, mësuesve, prindërve për të ofruar përditësime dhe udhëzime për situatën.
	• Identifikimi i nevojave emergjente të nxënësve dhe stafit (ushqim, ujë, mbështetje psikologjike).
	  ○ **Garantimi i sigurisë së nxënësve dhe personelit dhe evakuuimi:**
	• Zbatimi i protokolleve të sigurisë për nxënësit, stafin dhe ndërtesat e shkollave, duke u siguruar që ato të jenë të sigurta nga dëmtimet e mëtejshme.
	• Mbështetja e evakuimit të shkollave të rrezikuara dhe sigurimi i transportit emergjent për nxënësit në zona të sigurta.
	• Ofrimi i mbështetjes mjekësore, ndihmës së parë dhe këshillimit psikologjik për nxënësit dhe stafin e prekur.
	• Mbështetje për popullatat e cenueshme (p.sh., fëmijët me aftësi të kufizuara ose ata në rrethana të veçanta).
	  ○ **Sigurimi i vazhdimësisë së edukimit:**
	• Vlerësimi i shkollave që mund të rifillojnë funksionimin dhe përcaktimi i afateve për rikthimin në mësim.
	• Përdorimi i metodave alternative të ofrimit të arsimit, si mësimi nëpërmjet programeve në internet, objektet e përkohshme shkollore ose metoda të tjera të mësimit në distancë, në rast të mbylljes së shkollave ose dëmtimit të infrastrukturës fizike.
	• Koordinimi me personelin arsimor për të siguruar që mësimdhënia mund të vazhdojë edhe në mjedise të përkohshme ose të ndërprera.

Drejtoria Vendore e Policisë Durrës./Komisariati i Policisë Durrës	• Mbështetjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit. • Lehtësimin e dhënies së ndihmës së parë, duke siguruar aksesin e ekipeve mjekësore. • Mbështetjen e evakuimit të popullsisë dhe sigurimin e zonave të prekura. • Mbështetjen për sistemimin e përkohshëm të popullsisë së evakuuar. • Evidentimin dhe dokumentimin e personave të zhvendosur, viktimave dhe personave të humbur ose të zhdukur, në bashkëpunim me institucionet kompetente dhe në përputhje me procedurat ligjore. • Kontrollin dhe izolimin e zonave të prekura nga fatkeqësia, duke kufizuar hyrjen e personave të paautorizuar dhe duke parandaluar veprimet që mund të rrezikojnë sigurinë ose të pengojnë ndërhyrjen. • Ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, përmes marrjes së masave parandaluese dhe ndërhyrjes në rastet kur cenohen siguria e qytetarëve dhe mbarëvajtja e operacioneve. • Menaxhimin e qarkullimit rrugor në zonat e prekura, duke organizuar devijimet dhe kufizimet e nevojshme për të garantuar kalueshmërinë e akseve rrugore dhe lëvizjen e mjeteve të emergjencës. • Mbështetjen e masave për kontrollin dhe sigurinë kufitare, në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse dhe në përputhje me kompetencat ligjore. • Lehtësimin e procedurave kufitare për asistencën ndërkombëtare në bashkpunim me institucionet përgjegjëse. • Mbështetjen e proceseve të ribashkimit familjar, nëpërmjet evidentimit të personave të ndarë nga familjarët dhe shkëmbimit të informacionit me strukturat përgjegjëse.

	• Bashkëpunimin me organet kompetente për hetimin e ngjarjeve, dokumentimin e rrethanave të fatkeqësisë dhe kryerjen e veprimeve procedurale në përputhje me legjislacionin në fuqi. • Shoqërimin dhe lehtësimin e lëvizjes së mjeteve të evakuimit dhe të emergjencës. • Garantimin e komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit operacional, nëpërmjet sistemeve radiofonike dhe kanaleve të tjera të komunikimit. • Përforcimin e masave të sigurisë në objektet me rëndësi të veçantë, përfshirë institucionet e rëndëishme, portin dhe pikat e kalimit kufitar, në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse. • Garantimin e kushteve të përshtatshme të sigurisë për ekipet ndërkombëtare të ndihmës dhe përfaqësuesit e medias. • Mbështetjen e transportit dhe shpërndarjes së ndihmave humanitare. • Mbështetjen e përmbushjes së nevojave bazë të popullsisë së dëmtuar
Përfaqësues të kompanive të telekomunikacionit (Vodafone & One)	• Garantimi i vazhdimësisë së shërbimeve të telefonisë dhe internetit gjatë emergjencës. • Sigurimi i aksesit në numrat e emergjencës dhe mbështetja e transmetimit të njoftimeve publike. • Angazhimi i ekipeve teknike për riparimin e dëmtimeve të rrjeteve të komunikimit. • Informimi mbi ndërprerjet dhe kufizimet e shërbimeve të komunikimit, sipas detyrimeve ligjore. • Bashkëpunimi me Bashkinë Durrës dhe strukturat e emergjencave civile për koordinimin e komunikimit gjatë operacioneve të përgjigjes.
Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës.	• **Mobilizimi i burimeve shëndetësore:** Mbajtja në gatishmëri e dhomave të urgjencës, laboratorëve dhe mjekëve dhe infermierëve specialistë për t'u përgjigjur emergjencave • **Ndihma e parë dhe kujdesi emergjent:** Ofrimi i ndihmës së parë dhe kujdesit mjekësor emergjent për të lënduarit në zonat e prekura. • **Aktivizimi i ekipeve shëndetësore të urgjencës:** Aktivizimi i ekipeve shëndetësore të urgjencës për t'iu përgjigjur situatave kritike. • **Vlerësimi i situatës shëndetësore:** Evidentimi i problematikave dhe rreziqeve që mund të cenojnë shëndetin e popullsisë në zonat e prekura nga emergjenca. • **Survejanca epidemiologjike:** Monitorimi dhe raportimi i rasteve të dyshuara për sëmundje infektive dhe i situatave që mund të paraqesin rrezik epidemik. • **Parandalimi i sëmundjeve infektive:** Mbështetja e zbatimit të masave parandaluese dhe bashkëpunimi me strukturat shëndetësore për kufizimin e përhapjes së sëmundjeve. • **Mbikëqyrja higjieno-sanitare:** Vlerësimi i kushteve higjieno-sanitare në zonat e prekura dhe në mjediset e strehimit të përkohshëm, sipas kompetencave të institucionit. • **Vlerësimi i rreziqeve mjedisore për shëndetin:** Bashkëpunimi me institucionet kompetente për evidentimin e rreziqeve që lidhen me ujin e pijshëm, higjienën dhe faktorët e tjerë mjedisorë. • **Informimi i popullsisë:** Dhënia e informacionit dhe udhëzimeve për masat e higjienës, parandalimin e

	sëmundjeve infektive dhe mbrojtjen e shëndetit gjatë emergjencës. • **Koordinimi ndërinstitucional:** Bashkëpunimi me Bashkinë Durrës, strukturat e kujdesit shëndetësor dhe institucionet e tjera përgjegjëse për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e masave të shëndetit publik. • **Raportimi i situatës shëndetësore:** Përcjellja e të dhënave mbi problematikat dhe rreziqet e evidentuara te strukturat përkatëse, me qëllim mbështetjen e vendimmarrjes dhe ndërhyrjeve të nevojshme. • **Vlerësimi i nevojave të grupeve të cenueshme:** Identifikimi i problematikave të shëndetit publik që prekin personat e evakuuar dhe grupet në nevojë, në bashkëpunim me shërbimet përkatëse.
Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Durrës	• Verifikimi i kushteve higjieno-sanitare në qendrat e evakuimit dhe të strehimit të përkohshëm, si dhe në objektet e prekura nga emergjenca, brenda fushës së përgjegjësisë. • Identifikimi dhe raportimi i rreziqeve shëndetësore që mund të cenojnë shëndetin e popullatës gjatë situatës së emergjencës. • Kontrolli i respektimit të kërkesave sanitare dhe i masave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit publik. • Njoftimi i strukturave përgjegjëse për problematikat e konstatuara që paraqesin rrezik për shëndetin e popullatës dhe rekomandimi i masave korrigjuese. • Bashkëpunimi me strukturat e mbrojtjes civile, institucionet shëndetësore dhe autoritetet vendore për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e masave brenda kompetencave institucionale. • Dokumentimi i gjetjeve nga inspektimet dhe hartimi i raporteve përkatëse, me evidentimin e problematikave dhe rekomandimet për ndërhyrje. • Ndjekja e zbatimit të masave korrigjuese që lidhen me kompetencat e institucionit dhe raportimi i rezultateve pranë strukturave përgjegjëse.
Spitali Rajonal Durrës	• Përgatitja dhe aktivizimi i strukturave të emergjencës në spital për të përballuar fluksin e pacientëve gjatë fatkeqësive. • **Vlerësimi dhe trajtimi i të lënduarve:** Vlerësimi dhe trajtimi i pacientëve të lënduar ose të sëmurë si pasojë e fatkeqësisë. • **Përzgjedhja e pacientëve për trajtim sipas urgjencës:** Triazhimi i pacientëve, ku ata të klasifikohen sipas nevojave të emergjencës. • **Koordinimi me shërbimet e urgjencës dhe autoritetet lokale:** Bashkëpunimi dhe koordinimi me shërbimet e urgjencës, autoritetet lokale dhe ekipet e shpëtimit për të siguruar një reagim të organizuar dhe të shpejtë. • **Menaxhimi i burimeve dhe pajisjeve mjekësore:** Menaxhimi i burimeve mjekësore, përfshirë ilaçet, pajisjet mjekësore dhe materialet e tjera të nevojshme. • **Ofrimi i kujdesit pas trajtimit akut:** Ofrimi i shërbimeve të kujdesit të mëtejshëm për ata që kanë nevojë për trajtim të vazhdueshëm ose mbikëqyrje të specializuar. • **Menaxhimi i të dhënave dhe raportimi:** Mbajtja e regjistrimeve të sakta të të lënduarve dhe të dërgimi i raporteve të rregullta te autoritetet për të ndihmuar në vlerësimin e situatës dhe planifikimin
Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Durrës	• Merr pjesë në strukturat e ngritura nga qeveria për menaxhimin e emergjencave.

	• Reagon menjëherë me shpërndarjen e ndihmave materiale nga gjendja e mallrave stok për të ndihmuar familjet më të prekura në nevojë. • Koordinon marrjen dhe shpërndarjen e produkteve ushqimore, joushqimore dhe medikamenteve që i janë dhënë Kryqit të Kuq. • Mbështet operacionet e kërkim shpëtimit dhe të evakuimit. • Ofron promovimin për shëndetin, higjienën, dhe dhurimin vullnetar të gjakut. • Ofron mbështetje për strehimet e përkohshme ose afatgjata, duke përfshirë dhënien e ndihmës së parë dhe të avancuar dhe suportin psikosocial. • Mbështet në gjurmimin e personave të humbur dhe rivendosjen e lidhjeve familjare. • Mbështet në njoftimin e qytetarëve për rrezikun e pritshëm me fokus të veçantë në grupet më të cenueshme. • Mbështet autoritetet vendore në vlerësimin e nevojave dhe të dëmeve nga fatkeqësitë. • Mbështet autoritetet vendore në dhënien e ndihmës sociale dhe mbështetjen psikosociale/zvogëlimin e panikut. • Mbështet shërbimin shëndetësor parësor sidomos në emergjencat e shkallës së lartë dhe atyre ku nevojitet menaxhimi i të dëmtuarve/viktimave në masë.

8.5 Funksionet operacionale

8.5.1 Drejtimi dhe koordinimi

- *Në nivel bashkie*: KMCB kryesohet nga kryetari i bashkisë. Ajo është struktura kryesore përgjegjëse për marrjen e masave për menaxhimin gjithëpërfshirës dhe drejtimin e procesit të menaxhimit të emergjencave civile në territorin e bashkisë.
- *Në nivel qarku*: KMCQ kryesohet nga prefekti. Ajo është struktura kryesore përgjegjëse për marrjen e masave për menaxhimin gjithëpërfshirës dhe drejtimin e procesit të menaxhimit të emergjencave civile në territorin e qarkut.
- Për emergjencat kombëtare kur nuk është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, AKMC/MM dhe Komiteti për Mbrojtjen Civile KMC janë përgjegjëse për organizimin, drejtimin dhe koordinimin.
- Për emergjencat kombëtare kur është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, KNEC është përgjegjëse për organizimin, drejtimin dhe koordinimin.
- Në rast të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, për të drejtuar strukturat e emergjencës civile caktohen drejtuesit e mëposhtëm të operacioneve:
- DQO në nivel qendror, i cili emërohet nga KNEC;
- DOQ, i cili emërohet nga prefekti;
- DOB, i cili emërohet nga kryetari i bashkisë.

8.5.2 Aktivizimi dhe koordinimi i strukturave operacionale të nivelit vendor.

Aktivizimi i forcave operacionale në nivel bashkie, bëhet nga kryetari i bashkisë, ndërsa bashkërendimi i strukturave të Policisë së Shtetit (PSH), Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH), Forcave të Armatosura (FA) dhe Shërbimit të Urgjencës Mjekësore (SHUM) në nivel qarku dhe i strukturave që vijnë në ndihmë, janë përgjegjësi e Prefektit, i cili këshillohet nga KMCQ.

8.5.3 Vlerësimi i shpejtë dhe tabloja e situatës

Vlerësimi i shpejtë i situatës është një proces i organizuar për mbledhjen, verifikimin, analizimin dhe paraqitjen e informacionit mbi pasojat e një emergjence ose fatkeqësie dhe nevojat emergjente të popullsisë, infrastrukturës dhe shërbimeve në territorin e Bashkisë Durrës.

Koordinimi për vlerësimin e situatës, nevojave, dëmeve në aspektin e dëmtimeve të infrastrukturës dhe objekteve të ndërtimit, është nën përgjegjësinë e bashkisë së prekur, e mbështetur nga Prefekti i Qarkut që koordinon degët territoriale dhe kapacitete të tjera në qark, sipas nevojës. Në përputhje me rrethanat, AKMC mbështet koordinimin dhe sigurimin e angazhimit të ministrive të linjës, për infrastrukturat dhe asetet që janë prekur. Në procesin e vlerësimit të nevojave mund të përfshihen Kryqi i Kuq Shqiptar (KKSH), subjektet private të prekura, OJF të specializuara dhe kapacitete të tjera joqeveritare dhe private.

Për infrastrukturën dhe asetet në administrim të ministrive, institucioneve të tjera qendrore dhe subjekteve private, ato janë vetë përgjegjëse kryesore për vlerësimin e dëmeve. Për vlerësimin e nevojave dhe të dëmeve në asetet e subjekteve private me qëllim mundësimin e vazhdimësisë së veprimtarisë së tyre, këto të fundit të bashkëpunojnë me bashkitë, Prefektin e qarkut ku ushtrojnë veprimtarinë dhe AKMC, për lejimin e hyrjes së grupeve përkatëse të punës si edhe për të vendosur në dispozicion të vlerësimit të nevojave, të kapaciteteve që disponojnë.

Qëllimi i vlerësimit të shpejtë është krijimi i një pasqyre sa më të saktë dhe të përditësuar të situatës në territorin e Bashkisë Durrës, menjëherë pas ndodhjes së një emergjence ose fatkeqësie.Vlerësimi i shpejtë nuk zëvendëson vlerësimin e detajuar të dëmeve dhe humbjeve, por shërben si bazë për reagimin fillestar dhe për orientimin e fazave të mëtejshme të vlerësimit.

Ekipet e vlerësimit

Në rastet e emergjencave civile vendore në territorin e Bashkisë Durrës, ekipet e vlerësimit përbëhen nga personeli i strukturave të bashkisë dhe, sipas nevojës dhe natyrës së ngjarjes, me mbështetjen e Prefektit të Qarkut Durrës, mund të përfshijnë edhe përfaqësues teknikë të degëve territoriale që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e bashkisë.

Përbërja e ekipeve përcaktohet në varësi të llojit dhe përmasave të emergjencës, si dhe të ekspertizës së nevojshme për vlerësimin e pasojave dhe dëmeve. Çdo ekip ka një përgjegjës të përcaktuar, i cili koordinon punën në terren, siguron plotësimin e formularëve dhe raporton informacionin e mbledhur te QOECB-së kur ajo është aktivizuar ose te Sektori i Mbrojtjes dhe Emergjencave civile të bashkisë për konsolidimin e të dhënave. Ekipet nuk ndërhyjnë në operacionet e shpëtimit dhe të ndërhyrjes kur kjo mund të cenojë sigurinë e tyre. Vlerësimi kryhet vetëm kur kushtet e sigurisë lejojnë hyrjen dhe punën në zonën e prekur.

Vlerësimi në terren

Vlerësimi në terren kryhet në mënyrë të organizuar dhe sipas një procedure të njëjtë për të gjitha ekipet. Gjatë vlerësimit mblidhet informacion mbi situatën, dëmet, personat e prekur, infrastrukturën, shërbimet jetike dhe nevojat prioritare. Informacioni i marrë nga burime të tjera evidentohet si i tillë dhe, kur është e mundur, verifikohet përpara se të përfshihet në tablonë zyrtare të situatës. Në rastet kur nuk është e mundur kryerja e menjëhershme e vlerësimit në terren, përdoren burime alternative informacioni dhe vlerësimi në terren kryhet sapo kushtet ta lejojnë.

Formularët dhe raportimi

Për të siguruar mbledhjen e njëtrajtshme të informacionit, Bashkia Durrës përdor formularë standardë për vlerësimin e shpejtë.

Formularët përmbajnë, sipas nevojës:

- datën dhe orën e vlerësimit;
- vendndodhjen dhe zonën e vlerësuar;
- llojin e ngjarjes;

- përshkrimin e situatës;
- numrin e viktimave dhe personave të dëmtuar, kur ky informacion është i konfirmuar;
- numrin e personave të evakuuar ose të zhvendosur;
- dëmet në banesa;
- dëmet në ndërtesa publike;
- dëmet në infrastrukturën kritike;
- dëmet në rrugë, ura dhe objekte të tjera infrastrukturore;
- ndërprerjet e energjisë, ujit, komunikimit dhe shërbimeve të tjera;
- nevojat urgjente;
- kapacitetet dhe burimet e disponueshme;
- nevojat për kapacitete shtesë;
- fotografi ose dokumentim tjetër mbështetës;

Formularët mund të përdoren në format fizik ose elektronik. Të dhënat elektronike ruhen në mënyrë të organizuar dhe duhet të mundësojnë identifikimin e burimit, datës dhe orës së informacionit. Për të shmangur raportimet kontradiktore, informacioni i pakonfirmuar identifikohet qartë deri në momentin e verifikimit.

Hartëzimi dhe përdorimi i GIS.

Hartëzimi është pjesë integrale e procesit të vlerësimit. Në funksion të menaxhimit të emergjencës, Bashkia Durrës përdor, sipas mundësive teknike, sistemet GIS për evidentimin dhe paraqitjen e të dhënave të mbledhura gjatë vlerësimit. Të dhënat hartografike përditësohen në bazë të informacionit të marrë nga ekipet e terrenit. Hartat e situatës përdoren nga strukturat drejtuese dhe operacionale për orientimin e ndërhyrjeve, përcaktimin e prioriteteve dhe shpërndarjen e burimeve.

Mbledhja dhe konsolidimi i të dhënave

Të gjitha të dhënat e mbledhura nga ekipet e vlerësimit dhe burimet e tjera përcillen pranë QOECB-së kur ajo është e aktivizuar e cila është struktura përgjegjëse për mbledhjen, verifikimin, konsolidimin e informacionit dhe përgatitjen e përmbledhjes së situatës, kurse në rastet e tjera pranë Sektorit të Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile në bashki. Konsolidimi i të dhënave kryhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës së reagimit, duke reflektuar ndryshimet dhe informacionin e ri të verifikuar.

8.5.4 Kërkim shpëtimi

Qëllimi i kërkim-shpëtimit është gjetja e vendndodhjes së të lënduarve dhe shpëtimi i atyre që janë ende në rrezik. Ekipet Kombëtare të Kërkimit dhe Shpëtimit (EKKSH) sigurohen nga Forcat e Armatosura (FA) e Ministrisë së Mbrojtjes (MM), Ministria e Brendshme (MB), strukturat e shërbimit zjarrfikës, grupet vullnetare etj. Në rastet e emergjencave civile kombëtare, Operacionet e Kërkimit dhe Shpëtimit (OKSH) mbështeten nga EKKSH dhe strukturat e shërbimit zjarrfikës, Policia e Shtetit (PSH), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe grupet ndërkombëtare të kërkim-shpëtimit kur thirren për të ndihmuar.

Në bashkinë Durrës forcat që angazhohen në operacionet e kërkim shpëtimit janë forcat e MZSH-së bashkisë Durrës (56 punonjës, nga të cilët 44 efektivë operacionalë, 5 mjete zjarrfikëse, 2 mjete shpëtimi, 2 autobote uji, 1 autoambulance, 2 varka skafe dhe 3 pompa thithëse uji), Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, Komisariati i Policisë së Durrës dhe nëse është e nevojshme Komisariatet e Policisë Shijak, Kavajë, Krujë, të mbështetura nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës (NJVKSh) strukturat e MZSH-së të bashkive të tjera të qarkut, si të Shijakut, Krujës, të cilat mbështeten nga Policia bashkiake e cila ka një personel prej 80 vetash, Dega KKSH Durrës, si dhe struktura të tjera të kërkim shpëtimit që mund të vijnë nga institucionet qendrore, si dhe ekipe ndërkombëtare në raste kur ato janë thirrur për ndihmë

8.5.5 Rendi dhe siguria publike

Policia e Shtetit organizohet dhe kryen detyrat e saj në operacionet e shpëtimit dhe të lehtësimit, sipas planeve të hartuara më parë, si dhe planeve të përbashkëta me institucionet e tjera për çështje të mbrojtjes civile. Detyrat e saj përfshijnë: Mbrojtjen e zonës së emergjencës civile; ruajtjen e rendit publik, procesin

e identifikimit dhe të informimit rreth të dëmtuarve dhe viktimave; largimin e tyre nga zona e emergjencës, kontrollin e qarkullimit, si dhe detyra të tjera që dalin në zbatim të legjislacionit në fuqi për Policinë e Shtetit. Kur policia merr pjesë në operacionet e shpëtimit dhe në raste të tjera të fatkeqësive, forcat e saj komandohen nga eprorët e tyre.

Në të gjitha rastet e emergjencave, në nivel bashkie, rolin kryesor në zbatimin e ligjit dhe masat e ruajtjes së rendit do ta ketë Komisariati i Policisë/Drejtoria Vendore e Policisë Durrës të mbështetura nga Policia Bashkiake. Në raste të veçanta do të mbështeten edhe nga FA. E rëndësishme në rastet e evakuimeve është si mbrojtja e vendbanimeve të braktisura për shkak të emergjencës ndaj autorëve, ashtu edhe mbrojtja e qendrave të pritjes dhe strehimit.

8.5.6 Shëndetësia publike dhe ndihma mjekësore

Shërbimi Shëndetësor parësor: Përgjegjëse për Shërbimin Shëndetësor parësor në bashkinë Durrës është Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH). Ajo është përgjegjëse për sigurimin e shërbimit të urgjencës dhe shërbimit shëndetësor parësor nëpërmjet qendrave/klinikave shëndetësore. Secila prej qendrave/klinikave shëndetësore ka në varësi rrjetin përkatës të ambulancave duke mbuluar në këtë mënyrë me shërbim shëndetësor dhe ambulator gjithë territorin e bashkisë Durrës. NJVKSH dhe Inspektorati Shtetëror Shëndetësor kanë përgjegjësinë për monitorimin e cilësisë të ujit të pijshëm dhe higjienës si dhe për zbatimin e programit të zgjeruar për vaksinimin e popullatës.

Shërbimi Shëndetësor dytësor (spitalor) në bashkinë Durrës konsiston në Spitalin Rajonal të Durrësit. Spitali në Durrës është në gjendje të kryejë triazhimin/klasifikimin e personave të dëmtuar nga fatkeqësia që mund të jenë si popullata e prekur prej fatkeqësisë ashtu edhe forcat operacionale (FO) apo edhe strukturat e tjera të angazhuara në parandalimin apo përballimin e saj. Spitali do të mbështetet nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës si dhe nga struktura të tjera shtetërore që veprojnë në qark.

Monitorimi i shëndetit publik dhe i kushteve higjieno-sanitare.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) ushtron funksionet e inspektimit dhe kontrollit për respektimin e kërkesave higjieno-sanitare nga subjektet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) Durrës, nëpërmjet strukturave përkatëse të shëndetit publik, kontribuon në monitorimin dhe vlerësimin e rreziqeve për shëndetin e popullsisë, përfshirë ato që lidhen me cilësinë e ujit të pijshëm dhe kushtet higjieno-sanitare dhe zbaton programet e vaksinimit.

Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) ofron ekspertizë teknike dhe laboratorike dhe mbështet strukturat përgjegjëse në vlerësimin e rreziqeve për shëndetin publik. Gjatë situatave emergjente, këto institucione bashkëpunojnë, sipas kompetencave përkatëse, për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve shëndetësore, përcaktimin e nevojave për ndërhyrje dhe rekomandimin e masave për mbrojtjen e shëndetit të popullsisë.

8.5.7 Menaxhimi i trafikut dhe aksesit

Menaxhimi i trafikut dhe aksesit gjatë emergjencave synon garantimin e lëvizjes së sigurt të popullsisë, mjeteve të emergjencës dhe strukturave të ndërhyrjes, si dhe sigurimin e aksesit në zonat e prekura. Në varësi të situatës, përcaktohen kufizimet e qarkullimit, mbylljet e përkohshme, devijimet e trafikut, akset prioritare dhe korridoret e dedikuara për mjetet e emergjencës.

Vlerësimi i situatës dhe përcaktimi i masave: Pas evidentimit të situatës, përcaktohen rrugët e prekura, pengesat për qarkullimin dhe akset që kërkojnë kufizim ose mbyllje. Masat përcaktohen në bazë të:

- shkallës së dëmtimit të rrugëve;
- rrezikut për jetën dhe sigurinë e personave;
- nevojës për ndërhyrje të mjeteve të emergjencës;
- nevojës për evakuim;
- aksesit në spitale, qendra shëndetësore dhe objekte të tjera kritike;

- gjendjes së rrjetit rrugor alternativ.

Mbylljet dhe kufizimet e qarkullimit: Në zonat ku ekziston rrezik për jetën, dëmtime të infrastrukturës ose pengesa serioze për qarkullimin, vendosen mbyllje ose kufizime të përkohshme të trafikut. Mbylljet shoqërohen me sinjalistikë të përshtatshme dhe, kur është e nevojshme, me personel për kontrollin e qarkullimit. Rihapja e akseve bëhet pasi të jetë vlerësuar se kushtet e sigurisë e lejojnë qarkullimin.

Devijimi i trafikut: Kur një aks rrugor mbyllet ose kufizohet, përcaktohen rrugë alternative për devijimin e trafikut. Devijimet duhet të jenë të përshtatshme për kushtet e emergjencës dhe të shmangin, sa të jetë e mundur, zonat e prekura dhe akset që përdoren për ndërhyrje. Informacioni mbi devijimet përcillet te strukturat përgjegjëse dhe, kur është e nevojshme, bëhet publik për përdoruesit e rrugës.

Akset prioritare: Në kuadër të menaxhimit të emergjencës përcaktohen akset prioritare që duhet të mbahen të aksesueshme për:

- ambulancat dhe shërbimet shëndetësore;
- zjarrfikësit;
- policinë;
- mjetet e kërkim-shpëtimit;
- mjetet e furnizimit me ndihma;
- mjetet e tjera të autorizuara për reagimin ndaj emergjencës.

Për këto akse sigurohet, sa të jetë e mundur, kalimi i lirë dhe ndërhyrja e shpejtë në rast të pengesave.

Koordinimi dhe kontrolli i trafikut: Menaxhimi i trafikut kryhet në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Durrës, Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës të cilat mbështeten nga Policia Bashkiake, strukturat e emergjencave të Bashkisë Durrës. Në raste të veçanta do të mbështeten edhe nga Forcat e Armatosura (FA). Informacioni mbi mbylljet, devijimet, akset prioritare dhe korridoret e emergjencës përditësohet në bazë të ndryshimit të situatës.

Hartëzimi dhe informacioni: Akset e mbyllura, rrugët alternative, akset prioritare dhe korridoret e emergjencës paraqiten në hartat e situatës dhe përditësohen gjatë gjithë periudhës së reagimit. Informacioni përdoret nga strukturat drejtuese dhe operacionale për planifikimin e lëvizjes së mjeteve dhe organizimin e ndërhyrjeve.

Përfundimi i masave: Masat për kufizimin dhe menaxhimin e trafikut hiqen gradualisht pas vlerësimit të situatës dhe rikthimit të kushteve të sigurta të qarkullimit. Hapja e akseve bëhet në mënyrë të kontrolluar dhe, kur është e nevojshme, me kufizime të përkohshme deri në rikthimin e plotë të sigurisë dhe funksionalitetit të rrjetit rrugor.

8.5.8 Mbrojtja e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore

Bashkia Durrës, në bashkëpunim me Agjencinë Rajonale të Mjedisit dhe institucionet e tjera përgjegjëse, angazhohet për mbrojtjen e mjedisit dhe kufizimin e pasojave mjedisore gjatë emergjencave civile. Në rast përmbytjesh, zjarresh, incidentesh teknologjike ose ndotjeje, evidentohen zonat mjedisore të prekura dhe vlerësohen dëmet e shkaktuara, me qëllim marrjen e masave për kufizimin e përhapjes së ndotjes dhe mbrojtjen e popullsisë dhe të ekosistemeve natyrore. Në rast ndotjeje të tokës, ujërave identifikohen burimi, lloji dhe shtrirja e ndotjes. Sipas situatës, përcaktohen masat për izolimin e zonës së prekur, kufizimin e përhapjes së ndotësve dhe rehabilitimin mjedisor pas përfundimit të emergjencës

Incidentet detare dhe bregdetare: Në rast incidentesh detare ose ndotjeje të zonës bregdetare, Bashkia Durrës bashkëpunon sipas rastit me Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), ministrinë përgjegjëse për energjinë dhe infrastrukturën për vlerësimin e situatës, kufizimin e pasojave, mbrojtjen e popullsisë dhe mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve të krijuara.

Menaxhimi i mbetjeve të emergjencës: Mbetjet e krijuara nga emergjenca, përfshirë inertet, materialet e dëmtuara dhe mbetjet potencialisht të rrezikshme, grumbullohen, transportohen dhe menaxhohen në mënyrë të kontrolluar. Gjatë pastrimit të zonave të prekura merren masa për të shmangur ndotjen e tokës,

ujërave dhe zonave bregdetare, si dhe dëmtimin e zonave natyrore dhe arkeologjike. Ndërmarrja Rruga e bashkisë luan një rol të rëndësishësh për heqjen e mbetjeve të materialeve të dëmtuar nga emergjenca.

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore

Në bazë të Vlerësimit të Riskut në nivel bashkie, vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet objekteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore, përfshirë Amfiteatrin Romak, Murin Bizantin, Muzeun Arkeologjik, zonat arkeologjike, gjurmët e Via Egnatia-s dhe objektet e tjera të mbrojtura, të cilat mund të pësojnë dëmtime nga tërmetet, përmbytjet, zjarret dhe ngjarje të tjera emergjente. Bashkia Durrës në kuadër të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore.

Pas një tërmeti, përmbytjeje, zjarri ose ngjarjeje tjetër të rrezikshme, kryhet vlerësimi fillestar i gjendjes së objekteve të trashëgimisë kulturore të prekura. Kur ekziston rrezik për dëmtime të mëtejshme, kufizohet aksesi në zonat e rrezikuara dhe merren masa për sigurimin e tyre. Gjatë operacioneve të emergjencës shmangen, sa të jetë e mundur, ndërhyrjet dhe përdorimi i mjeteve që mund të shkaktojnë dëmtime shtesë në monumente, struktura arkeologjike dhe objekte historike.

Mbrojtja e muzeve dhe pasurive kulturore: Në rast rreziku për muzeumet dhe koleksionet kulturore, merren masa për mbrojtjen e tyre nga dëmtimet e shkaktuara nga shembjet, zjarri, uji dhe lagështia. Sipas kushteve të sigurisë, mund të parashikohet sigurimi ose zhvendosja e kontrolluar e objekteve me vlerë të veçantë, në bashkëpunim me strukturat dhe specialistët kompetentë.

Vlerësimi, dokumentimi dhe raportimi: Dëmtimet mjedisore dhe dëmtimet e trashëgimisë kulturore dokumentohen gjatë vlerësimit të situatës përmes formularëve, fotografive dhe të dhënave të tjera mbështetëse. Informacioni i mbledhur përfshihet në raportin përmbledhës për situatën e krijuar nga emergjenca ose fatkeqësia dhe përcillet te strukturat dhe institucionet kompetente për vlerësim të mëtejshëm dhe përcaktimin e masave të nevojshme.

8.5.9 Menaxhimi i viktimave në masë dhe personave të humbur

Në kuptimin e këtij plani, menaxhimi i viktimave në masë, konsiderohet një numër më i madh të viktimash se sa mundësitë përballuese të sistemit shëndetësor në kohë normale. Emergjenca të tilla mund të jenë të papritura dhe me zhvillim të menjëhershëm ose nga sëmundje infective.

Emergjenca të tilla shoqërohen normalisht me shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore prandaj edhe menaxhimi i tyre kryhet nga Komiteti Nderministror i Emergjencave Civile (KNEC). Menaxhimi i viktimave në masë në momentet e para drejtohet nga strukturat e para reaguese (MZSH, SHU, FA, PSH), të cilat janë zakonisht forcat operacionale më të afërta në vendin e ngjarjes. Në varësi të vendit, triazhi (ndihma e shpejtë) dhe ndihma e parë kryhet nga struktura të shërbimit Shëndetësor Parësor të NJVKSH, të mbështetura nga MM, PSH, MZSH, KKSH, dhe vullnetarë nga sektori privat.

Për identifikimin dhe menaxhimin e viktimave në masë, në nivelin e bashkisë do të jenë përgjegjëse strukturat e Bashkisë si Policia Bashkiake, PSH dhe NJ.V.K.SH.

Për personat e humbur, **Policia e Shtetit, nëpërmjet strukturave të saj vendore në Durrës, është struktura kryesore përgjegjëse për administrimin e rasteve, kërkimin dhe identifikimin e personave të humbur**. Në varësi të natyrës dhe përmasave të ngjarjes, Policia bashkëpunon me Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit të bashkisë, struktura të tjera të bashkisë Durrës, Forcat e Armatosura, strukturat shëndetësore dhe institucione të tjera kompetente.

Bashkia Durrës mbështet procesin përmes mbledhjes dhe përcjelljes së informacionit nga njësitë administrative dhe strukturat vendore, si dhe përmes koordinimit me strukturat përgjegjëse. Informacioni për personat e humbur regjistrohet, verifikohet dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme deri në gjetjen ose identifikimin e tyre

Kapitulli 9. Evakuimi, pikat e grumbullimit (qendrat e pritjes) dhe strehimi

Evakuimi është zhvendosja e përkohshme e njerëzve dhe e pasurive në vende më të sigurta para, gjatë ose pas ndodhjes së një ngjarjeje të rrezikshme, me qëllim mbrojtjen e tyre.

Në raste emergjente duhet të merret vendim i shpejtë por i mirëmenduar nëse është e nevojshme të organizohet evakuimi i një zone. Evakuimi është zakonisht një mundësi e fundit, ku ekziston një rrezik i dukshëm i menjëhershëm ose afatgjatë për njerëzit dhe ku ndërtesat nuk do të siguronin mbrojtjen e duhur. Arsyet më të shpeshta të evakuimeve janë zjarri, stuhitë, përmbytja, ndotja dhe rreziqet eksplozive. Bazuar në dokumentin e vlerësimit të riskut të fatkeqësive, por edhe në historikun e fatkeqësive të ndodhura, bashkia duhet të evidentojë të gjitha zonat urbane dhe rurale në të cilat pritet të ndodhë evakuimi i njerëzve.

9.1 9.1 Vendimmarrja për evakuim, organizimi, koordinimi dhe procedurat e zbatimit

Në nivel qarku, përgjegjësia për evakuimin është e Prefektit ndërsa në nivel vendor e kryetarit të bashkisë. Kryetari i Bashkisë Durrës urdhëron për evakuimin e pjesshëm ose të plotë të popullsisë, në bazë të vlerësimit të situatës, informacionit të raportuar nga strukturat përgjegjëse në terren dhe rekomandimeve të Komisionit të Mbrojtjes Civile të Bashkisë (KMCB), në përputhje me kompetencat dhe legjislacionin në fuqi. Gjatë situatave të emergjencës, forcat operacionale në terren si FA, PSH, MZSH etj., mund të vendosin evakuimin e menjëhershëm për territore të kufizuara.

Strukturat përgjegjëse të Bashkisë Durrës për evakuimin dhe strehimin.

Përgjegjësia për planifikimin dhe koordinimin e evakuimit i takon Bashkisë. Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile, nëpërmjet Sektorit të Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile koordinon procesin e evakuimit, ndërsa Njësitë Administrative, strukturat e MZSH-së, Policia Bashkiake, drejtoritë e tjera të bashkisë angazhohen, sipas kompetencave, për shpëtimin, transportin, asistencën, sigurinë dhe sistemimin e personave në pikat e grumbullimit ose qendrat e strehimit.

Në rastet kur caktohet Drejtuesi i Operacionit në nivel bashkie, ai bashkërendon veprimtarinë e strukturave të angazhuara për realizimin e procesit të evakuimit, në përputhje me përgjegjësitë dhe kompetencat përkatëse. Në rast aktivizimi të QOECB-së, informacioni mbi situatën, ecurinë e operacionit, personat e evakuuar dhe nevojat emergjente mblidhet dhe përpunohet në këtë qendër, duke shërbyer si bazë për koordinimin e mëtejshëm dhe informimin e strukturave përgjegjëse.

Policia Bashkiake: Mbështet procesin e evakuimit të qytetarëve në raste emergjencash, duke vënë në dispozicion automjetet dhe kapacitetet e saj njerëzore, teknike dhe logjistike për transportin drejt ambienteve të akomodimit. Në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe strukturat përgjegjëse, kontribuon në ruajtjen e rendit dhe sigurisë, mbrojtjen e pronës dhe asistimin gjatë evakuimit të qytetarëve dhe të gjësë së gjallë, sipas nevojave të situatës dhe kompetencave ligjore.

MZSH (Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi): Ofron asistencë për nxjerrjen dhe shpëtimin e personave të bllokuar, kryen ndërhyrje për shpëtimin e jetës në situata emergjente, siguron mbështetje logjistike dhe merr masa për identifikimin, vlerësimin dhe minimizimin e rreziqeve gjatë operacioneve të ndërhyrjes.

Njësitë Administrative: Njoftojnë banorët, identifikojnë familjet në nevojë, organizojnë pikat lokale të grumbullimit dhe mbajnë listat e personave të evakuuar.

Ndërmarrja "Rruga": Garanton aksesin rrugor përmes hapjes, pastrimit dhe sinjalizimit të rrugëve, si dhe vë në dispozicion mjetet për ndërhyrje në infrastrukturë.

Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale: Siguron mbështetje për higjienën, pastrimin dhe dezinfektimin e pikave të grumbullimit dhe strehimit të përkohshëm.

Strukturat e tjera që angazhohen në procesin e evakuimit

Në varësi të llojit dhe shkallës së emergjencës, në procesin e evakuimit të popullsisë në territorin e Bashkisë Durrës angazhohen edhe strukturat shtetërore dhe institucionet përgjegjëse, të cilat bashkëpunojnë me strukturat e bashkisë për realizimin e evakuuimit, shpëtimin e jetës, garantimin e sigurisë dhe përmbushjen e nevojave emergjente.

- **Policia e Shtetit:** Siguron rendin dhe sigurinë publike, menaxhon qarkullimin rrugor, kontrollon perimetrin e zonave të rrezikuara dhe mbështet evakuimin e popullsisë.
- **Strukturat e Forcave të Armatosura:** Angazhohen, sipas nevojës dhe procedurave ligjore, për transport, shpëtim, mbështetje logjistike dhe vënie në dispozicion të kapaciteteve të specializuara.
- **Shërbimi i urgjencës mjekësore:** Siguron ndihmën e parë, triazhimin dhe transportin e personave të dëmtuar drejt institucioneve shëndetësore.
- **Strukturat e shëndetit publik:** Vlerësojnë dhe trajtojnë problematikat shëndetësore që mund të lindin gjatë evakuimit dhe qëndrimit në qendrat e strehimit.
- **Prefekti i Qarkut Durrës:** Mbështetë koordinimin institucional dhe bashkërendimin e burimeve, sipas kompetencave ligjore.
- **Institucionet dhe operatorët e shërbimeve publike:** Ndihmojnë në garantimin e furnizimit me energji elektrike, ujë të pijshëm, komunikime dhe shërbime të tjera thelbësore, sipas nevojave të situatës.
- **Kryqi i Kuq Shqiptar:** Mbështet procesin e evakuimit duke ofruar ndihmë të parë, asistencë humanitare, mbështetje psikosociale dhe ndihmë për personat e evakuuar, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të emergjencave civile. Gjithashtu, mund të kontribuojë në shpërndarjen e ushqimeve, ujit dhe materialeve bazë për personat e strehuar përkohësisht, sipas kapaciteteve dhe nevojave të identifikuara.
- **Subjektet private:** Mbështesin procesin e evakuimit, sipas kapaciteteve dhe mundësive të tyre, duke vënë në dispozicion mjete transporti, pajisje, ambiente për strehim të përkohshëm dhe burime të tjera logjistike, në koordinim me Bashkinë Durrës dhe strukturat përgjegjëse për emergjencat civile.

Aktivizimi dhe angazhimi i këtyre strukturave përcaktohen në varësi të natyrës së emergjencës, nevojave në terren dhe kompetencave ligjore të secilit institucion.
Njoftimi i popullsisë dhe kategoritë prioritare për evakuim.

Në fazën e evakuimit, rëndësi të veçantë merr:

- Informimi i popullsisë për rrezikun, masat që duhet të ndërmerren dhe rrugët drejt zonave të sigurta.
- Identifikimi dhe evakuimi me përparësi i personave dhe grupeve më të cenueshme.

Njoftimi i popullsisë kryhet në mënyrë të kombinuar, në varësi të situatës, nëpërmjet:

- Njoftimit në terren nga Njësitë Administrative dhe Policia Bashkiake.
- Medias lokale dhe rrjeteve sociale zyrtare të Bashkisë Durrës.
- Përdorimit të mjeteve të tjera të njoftimit, si altoparlantët dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me banorët, sipas nevojës.

Përparësi në procesin e evakuimit u jepet fëmijëve, të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara, grave shtatzëna, personave me sëmundje kronike dhe personave të tjerë që kanë nevojë për asistencë të veçantë. Vëmendje e posaçme u kushtohet institucioneve ku përqendrohet një numër i madh personash, si shkollat, kopshtet, konviktet dhe qendrat sociale.

Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Bashkisë Durrës, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, mban lista orientuese të personave në nevojë për asistencë të veçantë dhe përcakton personat e kontaktit për organizimin e ndihmës gjatë emergjencave civile.

Hapat dhe procedurat për evakuimin e popullsisë:

- **Vlerësimi i situatës:** Mbledhja e informacionit nga terreni dhe strukturat e mbrojtjes civile për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut.
- **Vendimmarrja për evakuimin:** Marrja e vendimit dhe nxjerrja e urdhrit për evakuim nga autoriteti kompetent, sipas situatës dhe shkallës së rrezikut.
- **Njoftimi dhe mobilizimi**: Njoftimi i popullsisë dhe aktivizimi i strukturave përgjegjëse për zbatimin e procesit të evakuimit.
- **Transporti i asistuar:** Organizimi i transportit për personat që kanë nevojë për asistencë të veçantë, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse.

- **Regjistrimi dhe strehimi:** Regjistrimi i personave të evakuuar, evidentimi i nevojave të tyre dhe organizimi i strehimit të përkohshëm.
- **Sigurimi i zonës së evakuar:** Kontrolli i perimetrit dhe kufizimi i hyrjes në zonat e rrezikuara, në bashkëpunim me strukturat kompetente.
- **Raportimi dhe dokumentimi:** Raportimi periodik pranë Qendrës Operacionale të Emergjencave Civile të Bashkisë dhe strukturave përgjegjëse mbi ecurinë e operacionit, numrin e personave të evakuuar dhe nevojat e evidentuara.
- **Kthimi i kontrolluar:** Rikthimi i popullsisë në banesa vetëm pasi strukturat kompetente të kenë verifikuar sigurinë e zonës dhe të jetë dhënë autorizimi përkatës.

Të gjitha strukturat e përfshira në procesin e evakuimit raportojnë sipas linjës së komandimit te Drejtuesi i Operacionit në nivel bashkie dhe tek Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile.

Në rast aktivizimi të Qendrës Operacionale të Emergjencave Civile të Bashkisë Durrës (QOECB-së), informacioni raportohet, mblidhet dhe përpunohet në këtë qendër, për të mbështetur koordinimin e veprimeve, ndjekjen e situatës dhe informimin e strukturave përgjegjëse.

Raportimi përfshin zonën e prekur nga fatkeqësia, numrin e personave të evakuuar, problematikat e evidentuara, nevojat urgjente, mjetet e angazhuara dhe rekomandimet për ndërhyrje të mëtejshme.

9.2 Rrugët dhe transporti

Për evakuimin e personave nga zonat e rrezikuara, Bashkia Durrës përcakton dhe përdor rrugët kryesore dhe alternative të evakuimit, në varësi të natyrës, shtrirjes dhe drejtimit të emergjencës.

Rrugët e evakuimit duhet të sigurojnë lidhjen e zonave të prekura me pikat e grumbullimit të popullsisë së evakuar, strehimit të përkohshëm dhe strukturat shëndetësore, sipas nevojës.
Në rast bllokimi ose dëmtimi të akseve kryesore, përdoren rrugët alternative të përcaktuara në planifikimin vendor. Gjendja e rrugëve vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë emergjencës dhe rrugët e evakuimit përditësohen sipas situatës në terren.

Transporti i personave që evakuohen organizohet sipas nevojave dhe kapaciteteve të disponueshme. Për këtë qëllim përdoren mjetet e Bashkisë dhe, sipas nevojës, mjetet e strukturave publike, operatorëve të transportit dhe subjekteve të tjera që mund të mobilizohen për përballimin e emergjencës.

Pikat e grumbullimit të personave të evakuuar përcaktohen në zona të sigurta dhe të aksesueshme dhe lidhen me rrugët e përcaktuara të evakuimit. Përparësi i jepet transportit të personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve, fëmijëve, personave të sëmurë dhe personave të tjerë që kanë nevojë për asistencë të veçantë.

Menaxhimi i trafikut gjatë evakuimit kryhet në bashkëpunim ndërmjet Policisë bashkiake të Bashkisë Durrës dhe Policisë së Shtetit. Sipas nevojës, vendosen kufizime ose ndalime të përkohshme të qarkullimit, devijime të trafikut dhe masa për garantimin e kalimit të mjeteve të emergjencës.

Në akset e evakuimit sigurohet përparësi për mjetet e emergjencës, ambulancat, mjetet e kërkim-shpëtimit dhe mjetet që transportojnë personat e evakuuar. Rrugët prioritare dhe korridoret për mjetet e emergjencës mbahen të lira dhe monitorohen gjatë gjithë periudhës së evakuimit.

Bashkia Durrës siguron informimin e popullsisë mbi rrugët e evakuimit, pikat e grumbullimit dhe mënyrën e transportit, duke përdorur kanalet e përcaktuara të komunikimit dhe informimit si: Njoftimit në terren nga Njësitë Administrative dhe Policia Bashkiake; nëpërmjet medias lokale dhe rrjeteve sociale zyrtare të Bashkisë Durrës etj..

Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile, në bashkëpunim me Njësitë Administrative, strukturat e MZSH-së, Drejtorine e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtorinë e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Transportit Publik, Policinë e Shtetit dhee struktura të tjera sipas nevojës përcakton për cdo Njësi Administrative rrugët kryesore dhe alternative të evakuimit, në varësi të natyrës, shtrirjes dhe drejtimit të emergjencës. Ndërmarrja "Rruga" e bashkisë Durrës siguron

kalueshmërinë e rrugëve përmes pastrimit të baltës dhe mbetjeve, hapjes së kanaleve dhe vendosjes së sinjalistikës së përkohshme.

Rrjeti rrugor dhe hekurudhor sipas NjA (km)

NjA	Rrugë mbi 18 m	Rrugë deri 18 m	Rrugë lokale	Hekurudhë	Rrugë në zonën e planifikimit të Erzenit
Durrës	8.2	20.3	30.4	11.5	0.0
Rrashbull	4.7	15.7	36.3	5.7	0.0
Sukth	2.2	18.8	27.2	2.2	4.5
Katund i Ri	0.0	11.2	26.1	0.0	4.3
Manëz	0.0	0.7	32.9	0.0	0.0
Ishëm	0.0	0.0	77.4	0.0	0.0
Bashkia	**15.1**	**66.7**	**230.3**	**19.4**	**8.8**

Burimi: Baza GIS e paketës DRR (Qarku Durrës), ndërtesat DR, Census 2011 dhe 2023 (INSTAT); përpunim GIS, nëntor 2026.

Akset kryesore të evakuimit për ultësirën e Erzenit janë rruga Sukth-Durrës dhe lidhjet me autostradën Durrës-Tiranë, të cilat duhet të mbahen të lira nga mjetet e parkuara gjatë paralajmërimit. Për qytetin, rruga bregdetare dhe akset drejt Rrashbullit dhe Shkozetit shërbejnë si korridore evakuimi nga zona bregdetare. Rrugët që kalojnë mbi urat e Erzenit verifikohen para përdorimit pas një tërmeti ose përmbytjeje.

9.3 Pikat e grumbullimit (qendrat e pritjes)

Pikat e grumbullimit janë zonat ku në momentet menjëherë pas fatkeqësisë, do të grumbullohen njerëzit të cilët janë larguar nga banesat e tyre pas ngjarjes ose pas dhënies së urdhrit për tu evakuuar nga zona kur ka ndodhur fatkeqësia në të cilat garantohet ndihma e parë për popullatën, në pritje të përgatitjes së vendeve të strehimit ose kthimit në kushte normale të jetesës. Këto zona duhen të jenë të sigurta. Zonat e pritjes do të përdoren për një periudhë kohore nga disa orë në disa ditë.
Pikat e grumbullimit përcaktohen në zona të aksesueshme dhe të sigurta, duke marrë në konsideratë ekspozimin ndaj rreziqeve, aksesin rrugor, mundësinë e hyrjes së mjeteve të emergjencës, kapacitetin e hapësirës dhe afërsinë me zonat që mund të evakuohen.

Për çdo pikë grumbullimi përcaktohen paraprakisht:

- vendndodhja dhe koordinatat;
- kapaciteti i përafërt i personave që mund të grumbullohen;
- zonat dhe popullsia që mbulon;
- rrugët kryesore dhe alternative të aksesit;
- rreziqet që mund të ndikojnë në sigurinë e pikës;
- përgjegjësia për aktivizimin dhe funksionimin e saj;
- mënyra e informimit dhe orientimit të personave të evakuuar;
- nevojat për transport dhe lidhja me vendet e sistemimit ose strehimit.

Pikat e grumbullimit duhet të kenë, sipas mundësive dhe natyrës së emergjencës, infrastrukturën minimale të nevojshme për qëndrimin e përkohshëm të personave, duke përfshirë aksesin në ujë të pijshëm, ndriçim, ambiente sanitare, komunikim dhe ndihmë të parë. Në varësi të kohëzgjatjes së qëndrimit, sigurohen edhe masa për ushqimin, higjienën, mbrojtjen nga kushtet atmosferike dhe menaxhimin e mbetjeve.

Në përzgjedhjen dhe organizimin e pikave të grumbullimit i kushtohet vëmendje e veçantë personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve, fëmijëve, grave shtatzëna, personave të sëmurë dhe personave të tjerë që kanë nevojë për asistencë të veçantë.

Në pikat e grumbullimit Policia e Shtetit mbështet menaxhimin e sigurisë dhe qarkullimit, ndërsa Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit dhe strukturat shëndetësore angazhohen sipas nevojës dhe natyrës së

emergjencës. **Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale e bashkisë** siguron mbështetje për higjienën, pastrimin dhe dezinfektimin e pikave të grumbullimit dhe të strehimit të përkohshëm.

Pikat e grumbullimit dhe të dhënat përkatëse pasqyrohen në anekset e Planit Vendor të Emergjencave Civile dhe përditësohen periodikisht, si dhe pas çdo ndryshimi të rëndësishëm në infrastrukturë, përdorimin e territorit ose profilin e rrezikut.

Gjatë një emergjence, pika e grumbullimit aktivizohet vetëm pasi të jetë vlerësuar siguria e saj dhe të jetë konfirmuar se nuk ndodhet brenda zonës së rrezikuar ose në rrugën e përhapjes së pasojave të ngjarjes.

Harta 9.1 tregon hapësirat kandidate për pika grumbullimi në territor, ndërsa Harta 9.2 paraqet pamjet e zmadhuara për qytetin e Durrësit me Rrashbullin dhe për Sukthin me Katundin e Ri. Hapësirat PG-08 dhe PG-16 ndodhen brenda PG-02 dhe kapaciteti i tyre nuk mblidhet veçmas. Lista e plotë jepet në Aneksin 8.



Harta 9.1: Hapësirat kandidate për pika grumbullimi në Bashkinë Durrës



Harta 9.2: Hapësirat kandidate në qytetin e Durrësit dhe Rrashbull (A) dhe në Sukth e Katund i Ri (B), me kodet e Aneksit 8

9.4 Qendrat e strehimit

Vlerësimi i nevojave për strehim dhe identifikimi paraprak i objekteve dhe zonave për sigurimin e vendstrehimeve të përkohshme të sigurta është përgjegjësi e bashkisë e mbështetur nga Prefekti i qarkut. Menaxhimi i strehimit të të evakuuarve gjatë emergjencës është përgjegjësi e bashkisë e mbështetur nga Prefekti i qarkut, të mbështetur nga AKMC/ DQO në nivel qendror. Ndihmë në strehimin e popullatës së evakuuar jepet nga ministritë dhe strukturat që kanë kapacitete në ndërtesa apo terrene/ambiente për strehime emergjente të përkohshme, ku përfshihen: Ministria e Arsimit (MA), Minsistria e Turizmit Kulturës dhe Sportit (MTKS), Ministria e Mbrojtjes (MM), Ministria e Infrasrtukturës dhe Energjisë (MIE), Ministria e Brendshme (MB) dhe Ministria e Drejtësisë (MD) (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve DPB) (për evakuimin dhe strehimin e personave të paraburgosur dhe të burgosur) por edhe nga PSH, KKSH, OJF, subjekte private dhe organizata vullnetare. Duhet të sigurohet që grupet më të cenueshme të mos diskriminohen në planifikimin, hartimin ose caktimin e strehimit të përkohshëm pas fatkeqësisë, i cili duhet të jetë i arritshëm dhe funksional në përputhje me nevojat e tyre. Ata nuk duhet të diskriminohen as në caktimin e strehimeve të përkohshme dhe as në banesat e përhershme.

Qendrat e strehimit janë ambiente të përcaktuara për akomodimin e përkohshëm të personave të evakuuar, të cilët nuk mund të rikthehen në banesat e tyre ose në zonat e prekura nga emergjenca.

Bashkia Durrës me mbështetje të Prefektit të qarkut përcakton paraprakisht qendrat e mundshme të strehimit, duke marrë në konsideratë sigurinë e objektit, kapacitetin, aksesueshmërinë, vendndodhjen dhe mundësinë për sigurimin e shërbimeve bazë. Qendrat aktivizohen vetëm pasi të jetë vlerësuar siguria e tyre dhe të jetë konfirmuar përshtatshmëria për akomodimin e personave të evakuuar.

Për çdo qendër strehimi përcaktohen:

- vendndodhja dhe kapaciteti maksimal;
- gjendja dhe siguria strukturore e objektit;
- zonat që mund të mbulojë dhe numri i personave që mund të akomodohen;
- furnizimi me ujë të pijshëm dhe shërbimet sanitare;

- furnizimi me energji elektrike dhe ndriçimi;
- mundësia për sigurimin dhe shpërndarjen e ushqimit;
- aksesibiliteti për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me nevoja të veçanta;
- mundësia për ofrimin e ndihmës së parë dhe shërbimeve shëndetësore;
- masat për sigurinë dhe mbrojtjen e personave të strehuar;
- mënyra e regjistrimit dhe administrimit të personave të akomoduar;
- menaxhimi i higjienës, mbetjeve dhe furnizimeve.

Qendrat e strehimit duhet të sigurojnë, sipas kohëzgjatjes së qëndrimit, kushtet minimale për ujë, kanalizime dhe higjienë, energji, ushqim, kujdes shëndetësor, siguri dhe mbrojtje.

Strukturat shëndetësore mbështesin ofrimin e shërbimeve shëndetësore, Policia e Shtetit mbështet garantimin e sigurisë, ndërsa strukturat e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit vlerësojnë dhe mbështesin masat e sigurisë nga zjarri dhe emergjencat e tjera.

Regjistrimi i personave të akomoduar bëhet në mënyrë të organizuar, duke evidentuar numrin e personave, familjet, personat me nevoja të veçanta dhe nevojat për shërbime apo mbështetje shtesë. Të dhënat përditësohen gjatë gjithë periudhës së funksionimit të qendrës.

Qendrat e strehimit dhe kapacitetet e tyre pasqyrohen në anekset përkatëse të Planit Vendor të Emergjencave Civile dhe verifikohen periodikisht për gatishmërinë dhe funksionalitetin e tyre.

Commented [D1]: Per plotesim nga bashkia

Harta 9.3 tregon 65 shkollat e propozuara si strehime të përkohshme. Dy prej tyre (ST-42 dhe ST-65) ndodhen në zonën e planifikimit të Erzenit dhe nuk përdoren gjatë përmbytjeve. Çdo strehim përdoret pas tërmetit vetëm pas kontrollit strukturor.



Burimi: AKPT, e-Planifikimi (PPV Durrës, përdorimi i tokës); baza GIS e paketës DRR të Qarkut Durrës (ndërtesat, ujërat, rrugët, zonat e rrezikut); VRF Bashkia Durrës (2026). Përpunim: Co-PLAN / MetroPOLIS, nëntor 2026.

Harta 9.3: Strehimet e mundshme në shkolla, me kodet ST të Aneksit 8

9.5 Evakuimi i asistuar

Evakuimi i asistuar synon të garantojë largimin e sigurt, në kohë dhe në mënyrë të koordinuar të personave që, për shkak të moshës, aftësisë së kufizuar, gjendjes shëndetësore, moshës së mitur ose mungesës së transportit, nuk janë në gjendje të evakuohen në mënyrë të pavarur.

Përgjegjësia për planifikimin dhe koordinimin e evakuimit të asistuar i takon Bashkisë, Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile koordinon procesin, ndërsa Njësitë Administrative dhe Drejtoria e Shërbimeve Sociale kontribuojnë në identifikimin dhe vlerësimin e personave që kërkojnë asistencë. Strukturat e MZSH-së, Policia Bashkiake, drejtoritë e tjera të bashkisë dhe institucionet bashkëpunuese angazhohen, sipas kompetencave, për shpëtimin, transportin, asistencën, sigurinë dhe sistemimin e personave në pikat e grumbullimit ose qendrat e strehimit.

Grupet që kërkojnë evakuim të asistuar

- Personat me aftësi të kufizuara (PAK), përfshirë personat me vështirësi në lëvizje, dëgjim, shikim ose komunikim.
- Personat e moshuar, veçanërisht ata që jetojnë vetëm ose kanë kufizime në lëvizje.
- Fëmijët, veçanërisht ata që ndodhen pa prindër ose kujdestarë gjatë situatës emergjente.
- Personat me sëmundje kronike ose nevoja të veçanta shëndetësore.
- Personat që përdorin pajisje ndihmëse ose pajisje mjekësore.
- Familjet dhe individët që nuk kanë mjete transporti.
- Persona të tjerë që, sipas vlerësimit të situatës, kanë nevojë për ndihmë të veçantë gjatë evakuimit.

Identifikimi dhe regjistrimi
Bashkia, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Sociale dhe Njësive Administrative përgatitë dhe përditëson periodikisht një regjistër të personave dhe familjeve që mund të kërkojnë evakuim të asistuar. Regjistri përfshin të dhënat e nevojshme për planifikimin e asistencës, si vendndodhjen, nevojat specifike, mënyrën e transportit dhe kontaktet e personit ose kujdestarit, duke respektuar kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale. Në rast emergjence, regjistri përdoret për prioritizimin dhe organizimin e evakuimit të asistuar.

Personat në nevojë kategorizohen sipas nivelit të asistencës që kërkojnë:

- Persona që mund të evakuohen me udhëzim dhe shoqërim.
- Persona që kërkojnë ndihmë fizike ose pajisje ndihmëse.
- Persona që kërkojnë transport të përshtatur.
- Persona me nevoja të veçanta shëndetësore, të cilët kërkojnë koordinim me shërbimet shëndetësore.

Prioriteti i evakuimit përcaktohet në bazë të rrezikut të menjëhershëm, vulnerabilitetit të personit dhe nevojës për asistencë, duke shmangur vonesat e panevojshme.

Asistenca gjatë evakuimit
Personat e identifikuar për evakuim të asistuar shoqërohen nga personat përgjegjës deri në pikën e grumbullimit, gjatë transportit dhe, kur është e nevojshme, deri në destinacionin e strehimit.

Komunikimi dhe njoftimi.
Njësitë administrative luajnë një rol të rëndësishëm në organizimin dhe njoftimin e evakuimit të asistuar. Personat e regjistruar për evakuim të asistuar njoftohen për: kohën dhe mënyrën e evakuimit; pikën e grumbullimit; mjetin e transportit; destinacionin; udhëzimet kryesore të sigurisë.

Organizimi i transportit.
Transporti i personave që evakuohen organizohet sipas nevojave dhe kapaciteteve të disponueshme. Për këtë qëllim përdoren mjetet e Bashkisë dhe, sipas nevojës, mjetet e strukturave publike, operatorëve të transportit dhe subjekteve të tjera që mund të mobilizohen për përballimin e emergjencës.

9.6 Regjistrimi dhe bashkimi familjar

Në rastet e emergjencave civile që shoqërohen me numër të madh viktimash ose personash të lënduar, persona të humbur ose të paidentifikuar, dëmtime të infrastrukturës së komunikimit dhe evakuime masive, niveli vendor mund të përballet me një numër të madh kërkesash nga familjarët për informacion mbi vendndodhjen dhe gjendjen e të afërmve të tyre.

Në këto raste, strukturat e Policisë së Shtetit (PSH), të mbështetura nga Bashkia Durrës, Prefekti i Qarkut Durrës dhe Kryqi i Kuq Shqiptar (KKSH), luajnë rolin kryesor në këtë funksion mbështetës të emergjencës. Një rol të rëndësishëm në procesin e ribashkimit familjar luajnë gjithashtu strukturat rajonale dhe vendore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), vullnetarët, organizatat jofitimprurëse dhe media, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre.

Veprimet kryesore

1. **Regjistrimi i kërkesave:** Mblidhen dhe regjistrohen kërkesat e familjarëve për personat me të cilët kanë humbur kontaktin, duke evidentuar të dhënat e nevojshme identifikuese, kontaktet dhe vendndodhjen e fundit të njohur.

2. **Regjistrimi i personave të prekur:** Mblidhet informacioni për personat e evakuar, të lënduar, të humbur ose të paidentifikuar, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, strukturat shëndetësore dhe strukturat përgjegjëse për administrimin e qendrave të strehimit të përkohshëm.

3. **Verifikimi dhe gjurmimi:** Informacioni verifikohet dhe krahasohet nga institucionet kompetente për të përcaktuar identitetin dhe vendndodhjen e personave, duke shmangur shpërndarjen e informacionit të paverifikuar.
4. **Koordinimi ndërinstitucional:** Bashkia Durrës bashkërendon veprimet në nivel vendor, ndërsa Prefekti i Qarkut Durrës siguron bashkërendimin ndërinstitucional në nivel qarku dhe lehtëson bashkëpunimin ndërmjet Bashkisë Durrës, Policisë së Shtetit, Kryqit të Kuq Shqiptar (KKSH) dhe strukturave përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre ligjore.

5. **Informimi i familjarëve:** Mundësohet komunikimi me familjarët dhe përcillet informacioni i verifikuar nëpërmjet kanaleve të përshtatshme dhe të sigurta, duke respektuar konfidencialitetin dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

6. **Realizimi i ribashkimit familjar:** Pas verifikimeve të nevojshme nga institucionet kompetente, organizohet ribashkimi familjar në kushte të sigurta. Për fëmijët dhe personat në situatë vulnerabël, kryhen verifikimet dhe vlerësimet e nevojshme për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së tyre.

7. **Mbështetja sociale dhe psikosociale:** Strukturat e shërbimeve sociale, institucionet shëndetësore, Kryqi i Kuq Shqiptar dhe organizatat partnere, sipas rolit dhe kapaciteteve të tyre, ofrojnë orientim, mbështetje dhe referim për personat dhe familjet që kanë nevojë për asistencë të specializuar.

8. **Dokumentimi dhe ndjekja e rasteve:** Evidentohen kërkesat e trajtuara, rezultatet e verifikimeve dhe rastet e zgjidhura ose të referuara për ndjekje të mëtejshme. Të dhënat përditësohen dhe ruhen në mënyrë të sigurt, me akses të kufizuar për personat e autorizuar.

Strukturat e përfshira dhe përgjegjësitë

- **Policia e Shtetit (PSH):** Bashkëpunon për trajtimin e rasteve të personave të raportuar të humbur, verifikimin e informacionit, identifikimin dhe lokalizimin e personave, në përputhje me kompetencat ligjore, si dhe për lehtësimin e ribashkimit familjar.
- **Prefekti i Qarkut Durrës:** Mbështet koordinimin ndërinstitucional në nivel qarku dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve përgjegjëse për trajtimin e rasteve të ribashkimit familjar, në përputhje me kompetencat ligjore.
- **Bashkia Durrës:** Kryen koordinimin e veprimeve në nivel vendor, lehtëson komunikimin ndërmjet strukturave të përfshira dhe bashkëpunon për organizimin e veprimeve për trajtimin e rasteve të ribashkimit familjar.
- **Kryqi i Kuq Shqiptar (KKSH):** Mbështet procesin e ribashkimit familjar nëpërmjet veprimtarive humanitare, informimit dhe orientimit të personave të prekur dhe, sipas mandatit dhe kapaciteteve të tij, lehtësimit të rivendosjes së kontakteve familjare, në koordinim me autoritetet përgjegjëse
- **Strukturat e shëndetësisë dhe MSHMS-së:** Bashkëpunojnë për identifikimin e personave të trajtuar në institucionet shëndetësore dhe lehtësimin e komunikimit me familjarët, në përputhje me kompetencat e tyre dhe legjislacionin në fuqi.
- **Vullnetarët dhe organizatat jofitimprurëse:** Mbështesin informimin, orientimin dhe asistencën për personat e prekur, nën koordinimin e autoriteteve përgjegjëse dhe duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave personale.
- **Media:** Mbështet shpërndarjen e njoftimeve zyrtare dhe informacionit të verifikuar, në koordinim me autoritetet përgjegjëse dhe duke respektuar privatësinë dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

9.7 Zonat prioritare për evakuim, pikat e grumbullimit dhe strehimet e propozuara

Për përmbytjet e Erzenit, zona prioritare për paralajmërim dhe evakuim parandalues përfshin 1,734 ndërtesa dhe rreth 5,340 banorë. Fshatrat dhe lagjet me numrin më të madh të ndërtesave në këtë zonë janë paraqitur më poshtë dhe përbëjnë rendin e njoftimit derë më derë nga NjA-të dhe Policia Bashkiake.

Vendbanimet me ndërtesa në zonën e planifikimit të Erzenit

Vendbanimi	NjA	Ndërtesa në zonë
Sukth i Ri	Sukth	998
Erzen	Katund i Ri	394
Sukth	Katund i Ri	162
Katund i Ri	Katund i Ri	120
Vadardhë	Sukth	48
Gjuricaj	Ishëm	45
Mallkuç	Ishëm	21

Burimi: Baza GIS e paketës DRR (Qarku Durrës), ndërtesat DR, Census 2011 dhe 2023 (INSTAT); përpunim GIS, nëntor 2026.

Pikat e grumbullimit dhe objektet e strehimit u përzgjodhën me kriteret e mëposhtme, të njëjta për të tri bashkitë e qarkut:

- Pikat e grumbullimit janë hapësira publike rekreative, sociale ose arsimore sipas planit të përdorimit të tokës (kategoritë AR dhe AS), me sipërfaqe 0.15 deri 20 ha.
- Përjashtohen hapësirat brenda zonës së planifikimit të përmbytjes, zonat RRP-N2, zonat gjeologjike me rrezikshmëri të lartë dhe brezi 50 m nga rrëshqitjet dhe erozioni.
- Kapaciteti afatshkurtër llogaritet me 2 m² për person mbi 60% të sipërfaqes; kapaciteti për kamp të përkohshëm me 45 m² për person (standardi Sphere).
- Strehimet e mundshme janë shkolla 9-vjeçare dhe të mesme jashtë zonës së përmbytjes. Kapaciteti orientues llogaritet me 3.5 m² hapësirë të mbuluar për person mbi 50% të gjurmës së godinës, vetëm për katin përdhe.
- Pas një tërmeti, çdo strehim përdoret vetëm pasi godina të jetë kontrolluar nga inxhinierë strukturistë dhe të jetë shpallur e sigurt.

Përmbledhja e pikave të grumbullimit dhe e strehimeve të propozuara sipas NjA

NjA	Pika grumbullimi	Kapaciteti afatshkurtër (persona)	Shkolla për strehim	Kapaciteti orientues i strehimit (persona)
Durrës	14	177,550	28	2,680
Rrashbull	6	9,550	7	450
Sukth	6	16,750	9	420
Katund i Ri	6	23,550	5	260
Manëz	4	7,050	6	340
Ishëm	3	3,200	8	300
Bashkia	**39**	**237,650**	**63**	**4,450**

Burimi: Baza GIS e paketës DRR (Qarku Durrës), ndërtesat DR, Census 2011 dhe 2023 (INSTAT); përpunim GIS, nëntor 2026.

Bashkia aktualisht disponon dy strehime emergjente me rreth 200 vende, që mbulojnë më pak se 2% të nevojës për një skenar si tërmeti i vitit 2019. Kapaciteti orientues i shkollave është tregues planifikimi dhe duhet konfirmuar me verifikim në terren për çdo objekt (siguria strukturore, uji, energjia, sanitaret dhe aksesi për personat me aftësi të kufizuara). Lista e plotë me kodet PG dhe ST, vendndodhjen dhe kufizimet jepet në Aneksin 8, ndërsa hartat në Aneksin 9.

Kapitulli 10. Menaxhimi i burimeve dhe logjistika

Menaxhimi i burimeve dhe logjistika kanë për qëllim sigurimin, organizimin, përdorimin dhe shpërndarjen në kohë të burimeve të nevojshme për përballimin e emergjencave dhe garantimin e vazhdimësisë së operacioneve.

Burimet përfshijnë personelin, mjetet dhe pajisjet, transportin, karburantin, materialet, furnizimet, pajisjet e komunikimit, artikujt e ndihmës dhe çdo kapacitet tjetër të nevojshëm për reagimin ndaj emergjencave.

10.1 Inventari i kapaciteteve

Inventari i kapaciteteve për përballimin e emergjencave civile është lista e strukturuar e burimeve njerëzore, mjeteve, pajisjeve, infrastrukturës dhe materialeve që mund të angazhohen për përballimin e situatave emergjente në territorin e Bashkisë Durrës.

Inventari përbën një element të rëndësishëm të Planit Vendor për Emergjencat Civile, pasi mundëson identifikimin e burimeve të disponueshme, vendndodhjen e tyre, strukturat përgjegjëse për administrimin e tyre dhe kohën e nevojshme për vënien e tyre në dispozicion.

Planifikimi i masave për përballimin e emergjencave civile mbështetet në vlerësimin e kapaciteteve ekzistuese dhe në përcaktimin e mënyrës së angazhimit dhe bashkërendimit të tyre gjatë situatave emergjente.

Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile përgatit, administron dhe përditëson inventarin e kapaciteteve të Bashkisë dhe të burimeve të tjera të identifikuara për mbështetje. Për çdo kapacitet të evidentuar në inventar përcaktohen, sipas rastit, autoriteti përgjegjës, personi i kontaktit, mënyra e aktivizimit, koha e pritshme e mobilizimit, pika e grumbullimit ose e dislokimit, operatori, vendndodhja dhe gjendja teknike.

Kapacitetet kryesore të njohura dhe boshllëqet

Struktura / burimi	Kapacitetet e njohura	Boshllëqet kryesore
Sektori i mbrojtjes civile	1 përgjegjës dhe 7 inspektorë; regjistër i ngjarjeve dhe i dëmeve në Excel	QOECB jo e konsoliduar; GIS i përdorur pak; pa staf të dedikuar për 24/7
MZSH Durrës	44 efektivë operacionalë (56 punonjës gjithsej); 5 mjete zjarrfikëse, 2 mjete shpëtimi, 2 autobote uji, 1 autoambulancë, 2 varka, 3 pompa thithëse	Pajisje të kufizuara për kërkim-shpëtim nën rrënoja; nevojë për mbështetje të menjëhershme nga niveli qendror në tërmet
Policia Bashkiake	80 efektivë	Pa radio të dedikuara për komunikim me QOECB
Ndërmarrja "Rruga" dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale	Makineri për hapjen e rrugëve, pastrimin e baltës dhe mbetjeve, dezinfektim	Mobilizim ndërsektorial pa listë të paracaktuar mjetesh dhe operatorësh
Strehimi emergjent	2 strehime me rreth 200 vende	Kapacitet shumë i ulët krahasuar me skenarët e tërmetit dhe të përmbytjes së madhe
Energjia rezervë	Gjeneratorë të disa institucioneve	Pa gjeneratorë të dedikuar; energji rezervë e pamjaftueshme në hidrovorë
Vullnetarët	Kryqi i Kuq Shqiptar, dega Durrës	Lista e vullnetarëve nuk është funksionale; pa vullnetarë të trajnuar në Ishëm dhe Manëz
Financimi	Fondi i mbrojtjes civile; kompensime 121.4 milionë lekë për ngjarjet e 2025	Fondi shkon kryesisht për kompensime; deri në shkurt 2026 ishin likuiduar 12.3 milionë lekë

Burimi: PVEC (8.5.4); pyetësori institucional (shkurt 2026); VRF Bashkia Durrës (2026).

Inventari i plotë i kapaciteteve plotësohet në tabelat e Aneksit 7 dhe përditësohet çdo vit, si dhe pas çdo ngjarjeje të madhe ose ushtrimi.

10.2 Mobilizimi dhe dislokimi

Mobilizimi dhe dislokimi i burimeve njerëzore, mjeteve, pajisjeve dhe kapaciteteve të tjera bëhet në përputhje me natyrën dhe përmasat e emergjencës, si dhe nevojat e përcaktuara gjatë vlerësimit të situatës.

Në nivel vendor, Kryetari i Bashkisë është autoriteti përgjegjës për aktivizimin dhe mobilizimin e kapaciteteve të Bashkisë dhe të subjekteve publike e private brenda territorit të saj. Në nivel qarku, Prefekti i Qarkut koordinon forcat operacionale, angazhon kapacitetet në nivel qarku dhe bashkërendon mbështetjen ndërmjet bashkive, si dhe kërkon mbështetje nga strukturat kombëtare, sipas nevojës.

Kërkesa për mobilizimin e kapaciteteve përcaktohet në bazë të nevojave operacionale dhe vlerësimit të situatës.

Mobilizimi mund të jetë:

Mobilizim i pjesshëm, kur nevojiten vetëm kapacitete të kufizuara për përballimin e një situate të lokalizuar;

Mobilizim i zgjeruar, kur situata kërkon angazhimin e disa strukturave, njësive administrative ose burimeve shtesë të Bashkisë;

Mobilizim i plotë, kur përmasat ose kohëzgjatja e emergjencës kërkojnë angazhimin e një pjese të konsiderueshme të kapaciteteve vendore dhe, sipas nevojës, kërkesë për mbështetje nga strukturat e tjera të sistemit të mbrojtjes civile.

Niveli i mobilizimit përcaktohet në përputhje me shkallën e situatës, rrezikun për jetën dhe pronën, zonën e prekur dhe kapacitetet e disponueshme.

Dislokimi i kapaciteteve

Pas konfirmimit të mobilizimit, personeli, mjetet dhe pajisjet dislokohen në zonën e përcaktuar sipas prioriteteve operacionale. Para nisjes verifikohet gatishmëria e personelit, gjendja teknike e mjeteve dhe pajisjeve, karburanti, pajisjet mbrojtëse dhe dokumentacioni i nevojshëm.

Për çdo dislokim përcaktohen: vendi i nisjes; zona e pritjes ose grumbullimit; destinacioni; rruga e aksesit; personi përgjegjës; operatori ose drejtuesi i mjetit; koha e nisjes dhe mbërritjes; detyra që do të kryhet dhe kohëzgjatja e pritshme e angazhimit.

Kur kushtet e terrenit ose situata e sigurisë nuk lejojnë përdorimin e rrugës së planifikuar, përcaktohet një rrugë alternative në koordinim me strukturat përgjegjëse.

Prioritetet e dislokimit

Në kushtet e burimeve të kufizuara, dislokimi bëhet sipas prioriteteve të mëposhtme:

- shpëtimi dhe mbrojtja e jetës;
- mbështetja e personave që kërkojnë evakuim të asistuar;
- sigurimi i zonave dhe aksesit për ekipet e ndërhyrjes;
- mbrojtja e objekteve dhe shërbimeve kritike;
- sigurimi i furnizimeve dhe mbështetjes logjistike;
- mbështetja e operacioneve të tjera sipas zhvillimit të situatës.
- Prioritetet mund të ndryshojnë sipas natyrës së emergjencës dhe vlerësimit operacional.

Koordinimi dhe ndjekja e kapaciteteve

Gjatë dislokimit, Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile ose QOECB-së kur është aktivizuar mban informacion të përditësuar mbi statusin dhe vendndodhjen e kapaciteteve të angazhuara. Drejtoritë, strukturat dhe subjektet që kanë vënë në dispozicion burime raportojnë për nisjen, mbërritjen, përdorimin dhe çdo ndryshim të gjendjes së tyre.

Për operacionet që zgjasin në kohë, planifikohet rrotacioni dhe zëvendësimi i personelit dhe kur është e mundur dhe e mjeteve, me qëllim ruajtjen e kapacitetit të përgjigjes dhe shmangien e mbingarkesës së personelit.

Mobilizimi i kapaciteteve të jashtme.

Kur kapacitetet e Bashkisë nuk janë të mjaftueshme, kërkohet mbështetje nga Prefekti i qarkut, bashkitë fqinje, subjektet private, organizatat dhe burime të tjera.

Kërkesat për mbështetje koordinohen në përputhje me nivelin e situatës dhe, kur është e nevojshme, nëpërmjet Prefektit të Qarkut dhe AKMC-së

Regjistrimi i mobilizimit dhe dislokimit

Çdo mobilizim dhe dislokim dokumentohet në regjistrin operacional.

Ky informacion përdoret për ndjekjen e operacionit, raportimin, vlerësimin e përdorimit të burimeve dhe dokumentimin e kostove.

Të dhënat mbi kapacitetet e bashkisë pasqyrohen në **Aneksin 4 – Inventari i Kapaciteteve** të cilat përditësohen periodikisht nga Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile, në bashkëpunim

me strukturat dhe institucionet që disponojnë ose administrojnë kapacitetet e evidentuara. Përditësimi shoqërohet me verifikimin e disponueshmërisë, gatishmërisë dhe funksionalitetit të tyre.

10.3 Furnizimi dhe mbështetja

- **Karburanti**

Bashkia identifikon paraprakisht burimet e furnizimit me karburant për mjetet dhe pajisjet e angazhuara në operacion.

Duhet të përcaktohen:

- pikat e furnizimit;
- mënyra e autorizimit;
- prioritetet e furnizimit;
- dokumentimi i konsumit;
- mënyra e sigurimit të karburantit gjatë operacioneve të zgjatura.

- **Ushqimi dhe uji**

- Përcaktohen burimet dhe procedurat për sigurimin e:
- ujit të pijshëm;
- ushqimit;
- pakove ushqimore;
- furnizimit të ekipeve në terren.
- Prioritet duhet t'u jepet ekipeve që kryejnë operacione të zgjatura

- **Pajisjet personale mbrojtëse**

Bashkia dhe strukturat operacionale duhet të evidentojnë pajisjet që kërkohen sipas skenarëve:

- përmbytje;
- zjarr;
- mot ekstrem;
- incidente me materiale të rrezikshme;
- epidemi;
- shembje/dëmtime infrastrukturore.
- Pajisjet duhet të kontrollohen periodikisht dhe të jenë të disponueshme për ekipet që mund të mobilizohen.

- **Mirëmbajtja**

Bashkia përcakton mënyrën e mirëmbajtjes dhe riparimit të:

- automjeteve;
- makinerive;
- gjeneratorëve;
- pompave;
- pajisjeve të komunikimit;
- pajisjeve të tjera kritike.

- **Transporti**

Duhet të përcaktohen paraprakisht:

- mjetet në dispozicion;
- drejtuesit/operatorët;
- kapacitetet e transportit;
- rrugët alternative;
- mënyra e mobilizimit;
- prioritetet e transportit.

– Akomodimi i ekipeve

Për operacione që zgjasin më shumë se një turn pune duhet të identifikohen paraprakisht ambiente për:

- fjetje;
- ushqim;
- higjienë;
- pushim;
- ndërrim turnesh.

10.4 Burimet private vullnetarët dhe marrëveshjet

Bashkia duhet të krijojë një **regjistër të kapaciteteve private dhe vullnetare** që mund të mobilizohen në emergjencë.

Për kapacitetet kritike rekomandohet që të ketë **marrëveshje paraprake** ku të përcaktohen:

- lloji i burimit;
- kapaciteti;
- kushtet e mobilizimit;
- kohëzgjatja e përdorimit;
- përgjegjësitë e palëve;
- kostot dhe mënyra e kompensimit, kur aplikohet;
- transporti dhe mirëmbajtja;
- mënyra e dokumentimit.

10.5 Kërkesa për mbështetje

Kërkesa për mbështetje drejtuar bashkive fqinje, Prefektit dhe strukturave të nivelit qendror bëhet sipas formularit të standardizuar të përcaktuar në Anekset e këtij Plani. Kërkesa duhet të përmbajë, në mënyrë të qartë dhe të plotë, boshllëkun/nevojën, sasinë, specifikimet e mbështetjes së kërkuar dhe afatin kohor për sigurimin e saj.

Kapitulli 11. Rimëkëmbja dhe rindërtimi më i sigurt

Faza e rimëkëmbjes pason fazën e përgjigjes emergjente dhe synon rikthimin gradual të funksioneve të komunitetit, përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë së prekur dhe rehabilitimin e sistemeve, infrastrukturës dhe shërbimeve të dëmtuara. Kjo fazë nuk kufizohet vetëm në riparimin e dëmeve të shkaktuara, por përfshin edhe zbatimin e masave për zvogëlimin e cenueshmërisë dhe rritjen e aftësisë ripërtëritëse të territorit dhe të komunitetit ndaj fatkeqësive të ardhshme.

Në territorin e Bashkisë Durrës, procesi i rimëkëmbjes do të planifikohet dhe zbatohet në varësi të natyrës së fatkeqësisë, shkallës së dëmeve, numrit të personave të prekur dhe nevojave të identifikuara. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet rehabilitimit të infrastrukturës dhe rikthimit të shërbimeve thelbësore, mbështetjes së familjeve të prekura, rimëkëmbjes së veprimtarisë ekonomike, si dhe mbrojtjes dhe rehabilitimit të aseteve mjedisore e kulturore.

Rimëkëmbja do të trajtohet si pjesë përbërëse e ciklit të vazhdueshëm të menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë, duke siguruar lidhjen e saj me fazat e parandalimit, gatishmërisë dhe përgjigjes emergjente. Gjatë këtij procesi do të evidentohen problematikat dhe mangësitë e konstatuara, me qëllim përmirësimin e masave parandaluese, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e gatishmërisë së komunitetit për përballimin e fatkeqësive të ardhshme.

Nëpërmjet kësaj qasjeje, Bashkia Durrës do të synojë jo vetëm rikthimin e funksioneve dhe kushteve të jetesës përpara fatkeqësisë, por edhe përmirësimin e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së popullsisë,

infrastrukturës dhe veprimtarisë ekonomike, në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe konceptin "rindërto më mirë".

11.1 Parimet udhëzuese të rimëkëmbjes

Procesi i rimëkëmbjes në Bashkinë Durrës do të mbështetet në tetë parimet udhëzuese të përcaktuara në Planin Kombëtar për Emergjencat Civile 2023: fuqizimi i individëve dhe familjeve; lidershipi dhe udhëheqja vendore; planifikimi i rimëkëmbjes përpara fatkeqësive; partneritetet e angazhuara dhe përfshirja; bashkimi i përpjekjeve; afati kohor dhe fleksibiliteti; aftësia ripërtëritëse dhe qëndrueshmëria; si dhe rimëkëmbja psikologjike dhe emocionale.

Këto parime do të shërbejnë si bazë për përcaktimin e prioriteteve, organizimin e ndërhyrjeve, koordinimin e institucioneve dhe përdorimin e burimeve gjatë rimëkëmbjes. Zbatimi i tyre do të përshtatet me karakteristikat dhe nevojat e territorit të Bashkisë Durrës, duke synuar një proces gjithëpërfshirës, të koordinuar dhe të qëndrueshëm.

11.2 Masat e rimëkëmbjes sipas periudhave kohore

Masat e rimëkëmbjes në territorin e Bashkisë Durrës do të organizohen në tri periudha kohore: afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Kohëzgjatja dhe renditja e tyre do të përcaktohen në varësi të llojit të fatkeqësisë, shkallës së dëmeve, nevojave të popullsisë së prekur dhe kapaciteteve në dispozicion.

Masat afatshkurtra synojnë plotësimin e nevojave emergjente të popullsisë dhe rikthimin fillestar të kushteve të sigurisë dhe të shërbimeve thelbësore. Masat afatmesme përqendrohen në stabilizimin e situatës, rehabilitimin e shërbimeve dhe rikthimin gradual të jetës sociale dhe ekonomike. Masat afatgjata synojnë rindërtimin e qëndrueshëm, rivendosjen e plotë të funksioneve të komunitetit dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë e ardhshme.

11.2.1 Masat afatshkurtra (ditët e para pas fatkeqësisë)

Në këtë periudhë, përparësi do t'u jepet mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të popullsisë, sigurimit të kushteve minimale të jetesës dhe identifikimit të dëmeve dhe nevojave prioritare.

- **Ofrimin e përkujdesjes masive dhe shërbimeve të emergjencës:** Për personat dhe familjet e evakuuara të cilat ndodhen në qendrat e strehimit vazhdimi i sigurimit të strehimit të përkohshëm, ushqimit, ujit të pijshëm, artikujve të higjienës dhe shërbimeve bazë.
- **Pastrimi nga mbetjet, hapja e akseve prioritare të rrugëve kryesore:** Pastrimi i rrugëve kryesore të transportit dhe i akseve të nevojshme për aksesin e ekipeve të emergjencës, ambulancave, zjarrfikësve dhe mjeteve të furnizimit. Identifikimi i infrastrukturës së dëmtuar dhe kufizimi i aksesit në zonat e pasigurta.
- **Krijimi i infrastrukturës së përkohshme për të mbështetur rihapjen e biznesit:** Identifikimi i nevojave për rikthimin e veprimtarisë ekonomike, përfshirë nevojën për ambiente ose zgjidhje të përkohshme, kur është e mundur.
- **Identifikimi i personave që kanë nevojë për mbështetje psiko-sociale**. Me vëmendje të veçantë ndaj fëmijëve, të moshuarve dhe personave që kanë përjetuar humbje ose trauma të rënda dhe fillimi i trajtimit.
- **Sigurimin e kujdesit shëndetësor:** Bashkëpunimi me strukturat shëndetësore për sigurimin e kujdesit mjekësor urgjent, identifikimin e rreziqeve për shëndetin publik dhe organizimin e mbikëqyrjes së nevojshme epidemiologjike e sanitare.
- **Vlerësimi i riskut dhe masat zbutëse:** Vlerësimi paraprak i rreziqeve dhe i cenueshmërisë pas fatkeqësisë, identifikimi i rreziqeve dytësore dhe përcaktimi i masave urgjente për parandalimin e dëmeve të mëtejshme.

11.2.2 Masat afatmesme (javët dhe muajt pas fatkeqësisë)

Në këtë periudhë, ndërhyrjet do të synojnë stabilizimin e kushteve të jetesës, rehabilitimin e infrastrukturës dhe shërbimeve të dëmtuara, si dhe rikthimin gradual të veprimtarisë ekonomike dhe sociale.

- **Zgjidhje të përshtatshme për familjet e zhvendosura (strehimi):** Identifikimi dhe zbatimi i zgjidhjeve të përshtatshme të strehimit për familjet që nuk mund të rikthehen në banesat e tyre, duke garantuar sigurinë, aksesueshmërinë dhe përshtatshmërinë e tyre.
- **Largimi i mbetjeve dhe rehabilitimi i menjehershëm i infrastrukturës së dëmtuar.** Organizimi i largimit dhe administrimit të mbetjeve të krijuara nga fatkeqësia, si dhe riparimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës së dëmtuar, sipas vlerësimeve teknike dhe kompetencave të institucioneve përgjegjëse.
- **Mbështetja e rifillimit të aktivitetit të biznesit:** Mbështetja e rikthimit të bizneseve të dëmtuara përmes identifikimit të nevojave, orientimit drejt skemave të mundshme të financimit dhe lehtësimit të koordinimit me institucionet përgjegjëse.
- **Mbështetja psikologjike dhe sociale:** Vazhdimi i shërbimeve psiko-sociale dhe angazhimi i rrjeteve të mbështetjes komunitare për personat që kanë nevojë për ndihmë të vazhdueshme.
- **Shëndeti publik dhe kujdesi shëndetësor:** Mbështetja e vazhdimësisë së shërbimeve shëndetësore dhe, kur është e nevojshme, organizimi i zgjidhjeve të përkohshme për ofrimin e kujdesit në zonat ku objektet shëndetësore janë dëmtuar.
- **Aktivitetet zbutëse dhe informimi:** Informimi i komunitetit mbi mundësitë e rehabilitimit dhe rindërtimit më të sigurt, si dhe përfshirja e masave për zvogëlimin e riskut në ndërhyrjet e planifikuara.

11.2.3 Masat afatgjata (muajt dhe vitet pas fatkeqësisë)

Masat afatgjata synojnë rindërtimin dhe rehabilitimin e zonave të prekura, përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve të jetesës së komunitetit, si dhe integrimin e masave për zvogëlimit të e riskut nga fatkeqësitë në proceset e zhvillimit dhe planifikimit të territorit të Bashkisë Durrës.

- **Strehimi:** Mbështetja e zgjidhjeve të qëndrueshme dhe të përhershme të strehimit për familjet e prekura, në përputhje me vlerësimet teknike, legjislacionin në fuqi dhe programet përkatëse të mbështetjes.
- **Infrastruktura:** Rindërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së dëmtuar, duke marrë në konsideratë nevojat e ardhshme të komunitetit, standardet e sigurisë dhe masat për zvogëlimin e riskut.
- **Mbështetja e rifillimit të aktivitetit të biznesit. aktiviteteve tregtare atje ku është e mundur:** Mbështetja e rimëkëmbjes ekonomike të zonave të prekura, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, sektorin privat dhe aktorët e tjerë ekonomikë.
- **Mbështetja psikologjike dhe sociale:** Vijimi i shërbimeve të këshillimit dhe mbështetjes psiko-sociale për individët dhe familjet që vazhdojnë të përballen me pasojat e fatkeqësisë.
- **Shëndeti publik dhe kujdesi shëndetësor:** Rehabilitimi ose rindërtimi i objekteve shëndetësore të dëmtuara, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, si dhe përmirësimi i kushteve për vazhdimësinë e shërbimeve.
- **Zvogëlimi i riskut dhe qëndrueshmëria:** Zbatimi i masave strukturore dhe jostrukturore për zvogëlimin e riskut, përmirësimi i planifikimit vendor, forcimi i kapaciteteve institucionale dhe rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit për fatkeqësitë e ardhshme.

Zbatimi i masave në të tria periudhat do të monitorohet nga strukturat përgjegjëse, sipas kompetencave të tyre. Në rastet kur natyra dhe shkalla e fatkeqësisë e kërkojnë, masat mund të mbivendosen ose të rishikohen, duke ruajtur përparësinë e mbrojtjes së jetës, sigurisë së popullsisë dhe rikthimit të shërbimeve thelbësore.

11.2.4 Tabelë përmbledhëse e masave afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjata

Fusha	Afatshkurtër (ditë)	Afatmesëm (javë/muaj)	Afatgjatë (muaj/vite)
Strehimi	Ofrimin e përkujdesjes masive dhe shërbimeve të emergjencës.	Zgjidhje të përshtatshme për familjet e zhvendosura	Strehim i qëndrueshëm dhe i përhershëm

Mbetjet dhe infrastruktura	Pastrimi nga mbetjet, hapja e akseve prioritare të rrugëve kryesore.	Largimi i mbetjeve dhe rehabilitimi i menjehershëm i infrastrukturës së dëmtuar.	Rindërtim dhe përmirësim i infrastrukturës për të përmbushur nevojat e ardhshme të komunitetit.
Biznesi	Krijimi i infrastrukturës së përkohshme për të mbështetur rihapjen e biznesit.	Mbështetja e rifillimit të aktivitetit.	Bazuar strategjive rigjallërimi ekonomik i zonave të prekura
Mbështetja psiko-sociale	Identifikimin e të rriturve dhe fëmijëve që kanë nevojë për mbështetje për shëndetin psikosocial dhe fillimi i trajtimit të tyre.	Vazhdimi i shërbimeve dhe rrjeteve mbështetëse	Mbështetje afatgjatë sipas nevojave
Shëndeti publik	Kujdes urgjent dhe masa sanitare dhe krijimi i protokolleve të përshtatshme mbikëqyrjeje.	Sigurimi i vazhdimësia e shërbimeve shëndetësore Sigurimi i vazhdimësisë së kujdesit përmes objekteve të përkohshme (nëse është e nevojshme).	Rehabilitimi ose rindërtimi i objekteve
Zvogëlimi i riskut	Vlerësimi i rreziqeve dytësore dhe i cënueshmërisë	Integrimi i masave parandaluese në rehabilitim	Zbatim i masave për rritjen e aftësisë ripërtëritëese dhe "rindërto më mirë"

11.3 Zbatimi i masave të rimëkëmbjes

11.3.1 Masat afatshkurtra (ditët e para pas fatkeqësisë)

1. Ofrimin e përkujdesjes masive dhe shërbimeve të emergjencës.

Në vijim të masave të evakuimit dhe strehimit emergjent të realizuara gjatë fazës së përgjigjes, Bashkia Durrës, nëpërmjet strukturave përgjegjëse dhe në bashkëpunim me institucionet e angazhuara (shif kapitullin 9 të Planit), në fazën e rimëkëmbjes vlerëson nevojat e personave dhe familjeve të prekura që vijojnë të jenë të pastreha ose që nuk mund të rikthehen menjëherë në banesat e tyre. Në kuadër të aktiviteteve afatshkurtra, për personat dhe familjet që nuk mund të rikthehen menjëher në banesat e tyre Bashkia koordinon masat për vazhdimësinë e strehimit të përkohshëm të tyre, sigurimin e ushqimit, ujit të pijshëm, artikujve të higjienës dhe shërbimeve të tjera bazë.

2. Pastrimi nga mbetjet, hapja e akseve prioritare të rrugëve kryesore.

Bashkia Durrës nëpërmjet Ndërmarrjes "Rruga", **Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale dhe** strukturat operacionale që veprojnë në terren organizojnë ndërhyrjet për pastrimin e rrugëve dhe hapësirave publike nga mbetjet, rrënojat, balta dhe materialet e tjera të krijuara nga fatkeqësia, me qëllim garantimin e aksesit për ekipet e emergjencës, mjetet e transportit dhe furnizimet. Përparësi u jepet akseve rrugore që lidhin zonat e prekura me spitalet, qendrat shëndetësore, ambientet e strehimit dhe objektet e tjera kritike.

3. Krijimi i infrastrukturës së përkohshme për të mbështetur rihapjen e biznesit.

Bashkia Durrës, në bashkëpunim me bizneset e prekura, strukturat përfaqësuese të sektorit privat dhe institucionet përgjegjëse, evidenton nevojat për rifillimin e veprimtarisë ekonomike pas fatkeqësisë. Në varësi të dëmeve të konstatuara dhe burimeve të disponueshme, identifikohen mundësitë për sigurimin e ambienteve ose zgjidhjeve të përkohshme për vazhdimin e aktivitetit.

4.Identifikimin e të rriturve dhe fëmijëve që kanë nevojë për mbështetje për shëndetin psikosocial dhe fillimi i trajtimit të tyre.

Bashkia Durrës, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, identifikon personat dhe familjet e prekura që kanë nevojë për mbështetje psikosociale, evidenton nevojat e tyre dhe koordinon referimin pranë shërbimeve shëndetësore dhe specialistëve përkatës për këshillim, vlerësim dhe trajtim. Gjithashtu, Bashkia bashkëpunon me institucionet përgjegjëse dhe organizatat që ofrojnë shërbime mbështetëse, duke ndjekur rastet në nevojë, me prioritet fëmijët, të moshuarit dhe personat në situatë vulnerabël.

5. Sigurimin e kujdesit shëndetësor.

Në vijim të masave të ndërmarra gjatë fazës së përgjigjes emergjente, Bashkia Durrës, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të shëndetësisë, mbështet vazhdimësinë e kujdesit shëndetësor për popullsinë e prekur dhe identifikimin e rreziqeve për shëndetin publik, përfshirë rreziqet higjieno-sanitare dhe epidemiologjike. Monitorimi i situatës dhe trajtimi i problematikave të evidentuara realizohen nga strukturat kompetente, sipas përgjegjësive të tyre.

11.3.2 Masat afatmesme (javët dhe muajt pas fatkeqësisë)

1. Strehimi dhe mbështetja e popullsisë: Zgjidhje të përshtatshme për familjet e zhvendosura

Gjatë periudhës afatmesme, Bashkia Durrës, organizon vlerësimin e gjendjes së banesave të dëmtuara nga fatkeqësia, me qëllim përcaktimin e kushteve për rikthimin e sigurt të familjeve të evakuuara në banesat e tyre.

Për familjet, banesat e të cilave rezultojnë të pabanueshme ose paraqesin rrezik për sigurinë e banorëve, identifikohen dhe shqyrtohen zgjidhje alternative strehimi, në përputhje me nevojat e evidentuara, kohëzgjatjen e zhvendosjes dhe burimet e disponueshme. Këto zgjidhje mund të përfshijnë ambiente të përshtatshme akomodimi të përkohshëm, struktura akomoduese ose forma të tjera mbështetjeje, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Bashkia, sipas kompetencave dhe mundësive të saj, bashkëpunon me institucionet shtetërore, Prefektin e Qarkut, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) dhe aktorë të tjerë për identifikimin e mundësive të mbështetjes dhe sigurimin e zgjidhjeve të përshtatshme për familjet e prekura, deri në krijimin e kushteve për kthimin e sigurt në banesat e tyre ose sigurimin e një zgjidhjeje të qëndrueshme strehimi.

2. Rehabilitimi i infrastrukturës dhe shërbimeve

Bashkia Durrës, bashkëpunon me institucionet dhe operatorët përgjegjës për identifikimin e dëmeve në infrastrukturën publike dhe përcaktimin e ndërhyrjeve të nevojshme për rehabilitimin e saj.

Ndërhyrjet synojnë rikthimin gradual të funksionimit të rrugëve, sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, shërbimeve publike dhe infrastrukturës tjetër të dëmtuar. Kur kapacitetet vendore janë të pamjaftueshme, kërkohet mbështetja e institucioneve qendrore dhe e mekanizmave të tjerë të ligjshëm të financimit.

Punimet planifikohen duke marrë në konsideratë jo vetëm rikthimin e funksioneve të mëparshme, por edhe masat e nevojshme për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë e ardhshme.

3. Kujdesi shëndetësor dhe mbështetja psiko-sociale

Në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të shëndetësisë dhe shërbimeve sociale, mbështetet vazhdimësia e kujdesit shëndetësor për popullsinë e prekur, përfshirë trajtimet që nuk kanë karakter urgjent dhe ndjekjen e personave me sëmundje kronike. Vijon gjithashtu mbështetja psiko-sociale për personat dhe familjet që përballen me pasojat e fatkeqësisë.

Vëmendje e veçantë u kushtohet personave që kanë humbur familjarë, banesën ose mjetet e jetesës, si dhe individëve që kanë nevojë për mbështetje të vazhdueshme.

4. Rikthimi i veprimtarisë ekonomike

Në bashkëpunim me institucionet dhe aktorët ekonomikë, evidentohen dëmet e shkaktuara në bizneset dhe aktivitetet prodhuese të zonave të prekura.

Mbështeten, sipas kompetencave dhe programeve të disponueshme, pastrimi i ambienteve, vlerësimi i dëmeve dhe krijimi i kushteve për rifillimin gradual të veprimtarisë ekonomike. Përparësi u jepet aktiviteteve që sigurojnë punësim, furnizime dhe shërbime thelbësore për komunitetin.

5. Informimi dhe zvogëlimi i riskut

Komuniteti dhe subjektet e prekura informohen mbi masat e rehabilitimit dhe mundësitë e mbështetjes, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse. Në planifikimin e ndërhyrjeve të rimëkëmbjes përfshihen, sipas vlerësimeve teknike, masa për zvogëlimin e riskut dhe parandalimin e dëmeve të ngjashme në të ardhmen.

11.3.3 Masat afatgjata (muajt dhe vitet pas fatkeqësisë)

1. Zgjidhjet e qëndrueshme të strehimit

Për familjet që nuk mund të rikthehen në banesat e tyre, identifikohen dhe zbatohen zgjidhje të qëndrueshme strehimi, në përputhje me legjislacionin dhe programet përkatëse.

Këto zgjidhje mund të përfshijnë rindërtimin ose riparimin e banesave, përfitimin nga programet e strehimit social, mbështetjen për qiranë ose forma të tjera të asistencës, sipas kritereve të zbatueshme.

2. Rindërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës

Planifikohen dhe realizohen ndërhyrjet për rindërtimin e infrastrukturës së dëmtuar dhe përmirësimin e shërbimeve publike, në përputhje me vlerësimet teknike, legjislacionin në fuqi dhe burimet financiare të disponueshme.

Projektet përfshijnë, sipas rastit, masa për zvogëlimin e riskut, përmirësimin e standardeve të sigurisë dhe rritjen e qëndrueshmërisë së infrastrukturës, në përputhje me parimin "rindërto më mirë".

3. Vazhdimësia e kujdesit shëndetësor dhe psiko-social

Vijon ofrimi i kujdesit shëndetësor dhe i mbështetjes psiko-sociale për personat që vazhdojnë të përballen me pasojat e fatkeqësisë. Në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, synohet rehabilitimi ose rindërtimi i objekteve shëndetësore të dëmtuara dhe përmirësimi i kapaciteteve për përballimin e emergjencave të ardhshme.

4. Rimëkëmbja ekonomike dhe sociale

Mbështetet rikthimi i qëndrueshëm i veprimtarisë ekonomike, rehabilitimi i aseteve të dëmtuara dhe përmirësimi i kushteve sociale të komunitetit, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe aktorët ekonomikë.

Përvojat e fituara gjatë emergjencës përdoren për përmirësimin e planifikimit vendor, të masave parandaluese dhe të gatishmërisë për fatkeqësitë e ardhshme.

5. Zvogëlimi i riskut dhe rritja e aftësisë ripërtëritëse

Zbatohen masa strukturore dhe jostrukturore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, përmirësohet planifikimi vendor dhe forcohen kapacitetet institucionale dhe ndërgjegjësimi i komunitetit. Gjatë

rindërtimit merren në konsideratë rreziqet e identifikuara dhe mundësitë për të shmangur krijimin e cenueshmërive të reja.

11.4 Monitorimi dhe koordinimi i masave të rimëkëmbjes

Zbatimi i masave të rimëkëmbjes ndiqet nga strukturat përgjegjëse, sipas kompetencave të tyre dhe në bashkëpunim me institucionet e angazhuara.

Në varësi të natyrës dhe shkallës së fatkeqësisë, masat përshtaten dhe rishikohen sipas nevojave të evidentuara, duke i dhënë përparësi mbrojtjes së jetës, sigurisë së popullsisë dhe rikthimit të shërbimeve thelbësore.

Problematikat e konstatuara dhe përvoja e fituar gjatë këtij procesi merren në konsideratë në përditësimin e planifikimit vendor dhe në përmirësimin e masave për menaxhimin e fatkeqësive të ardhshme.

Tabela: Strukturat dhe institucionet, përgjegjësitë e tyre për rimëkëmbjen - bashkia Durrës

Emri i institucionit, strukturës, organizatës.	Rolet dhe përgjegjësitë kryesore në fazën e rimëkëmbjes
	Institucione në nivel bashkie
Bashkia Durrës Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile	**Nëpërmjet Sektorit të Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile:** • Bashkërendimi dhe monitorimi i zbatimit të masave të rimëkëmbjes nga strukturat e Bashkisë Durrës. • Koordinimi i veprimeve dhe përcaktimi i prioriteteve për rimëkëmbjen e territorit dhe komunitetit të prekur. • Koordinimi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për vlerësimin e dëmeve në banesa, infrastrukturë, objekte publike dhe veprimtari ekonomike, në bashkëpunim me komisionet dhe strukturat kompetente. • Identifikimi dhe prioritizimi i nevojave për rimëkëmbjen afatshkurtër dhe afatgjatë. • Bashkëpunimi me drejtoritë e bashkisë për planifikimin e masave të rehabilitimit dhe rindërtimit të objekteve dhe infrastrukturës së dëmtuar. • Koordinimi me njësitë administrative për identifikimin e nevojave të popullsisë së prekur dhe përcjelljen e tyre pranë strukturave përgjegjëse. • Bashkëpunimi me institucionet përkatëse për sistemimin e përkohshëm të familjeve të zhvendosura dhe rikthimin e kushteve normale të jetesës. • Përgatitja dhe paraqitja e raporteve mbi dëmet, nevojat dhe ecurinë e rimëkëmbjes pranë drejtuesve të bashkisë. • Bashkëpunimi me strukturat financiare për dokumentimin e nevojave buxhetore dhe përgatitjen e dokumentacionit për financimin e masave të rimëkëmbjes. • Informimi i komunitetit për planet e rimëkëmbjes, afatet kohore dhe përparimin përmes përditësimeve të rregullta. • Dokumentimi i problematikave dhe i mësimeve të nxjerra nga emergjenca dhe paraqitja e propozimeve për përmirësimin e Planit Vendor për Emergjencat Civile (PVEC). • Propozimi i masave për zvogëlimin e riskut dhe forcimin e kapaciteteve vendore për përballimin e fatkeqësive të ardhshme.

	• **Sektori i Politikave Bujqësore, Granteve, Ujitjes, Kullimit dhe Këshillimit Bujqësor** • Evidenton dëmet në tokat bujqësore, kulturat bujqësore dhe blegtori, në bashkëpunim me strukturat përkatëse. • Vlerëson dëmet në sistemet e ujitjes dhe kullimit dhe propozon ndërhyrjet e nevojshme. • Informon dhe këshillon fermerët për rikuperimin e prodhimit dhe mundësitë e mbështetjes financiare. • Monitoron zbatimin e projekteve të rimëkëmbjes bujqësore. • **Sektori i Zhvillimit Rural, Fondit Pyjor, Kullosor dhe Burimeve Natyrore** • Evidenton dhe vlerëson dëmet në pyje, kullota dhe burime natyrore. • Propozon dhe ndjek masat për rehabilitimin e zonave të dëmtuara nga zjarret, përmbytjet, erozioni dhe rrëshqitjet e dherave. • Monitoron zbatimin e ndërhyrjeve për mbrojtjen dhe rikuperimin e mjedisit. • **Sektori i Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Konsumatorit** • Evidenton humbjet dhe dëmet në blegtori dhe raporton problematikat veterinare. • Organizon, në bashkëpunim me institucionet kompetente, trajtimin dhe asgjësimin e sigurt të kafshëve të ngordhura. • Monitoron shëndetin e kafshëve dhe rreziqet për sigurinë ushqimore pas fatkeqësive. • Bashkëpunon me autoritetet veterinare dhe ushqimore për parandalimin e rreziqeve shëndetësore
Bashkia Durrës Sektori i Marrëdhënieve me Publikun	• Informon dhe orienton qytetarët e prekur nga emergjencat civile për shërbimet publike, procedurat administrative dhe dokumentacionin e nevojshëm gjatë fazës së rimëkëmbjes. • Administron, regjistron dhe protokollon kërkesat, ankesat dhe aplikimet e qytetarëve të prekur nga emergjencat civile. • Përcjell kërkesat dhe problematikat e qytetarëve pranë strukturave kompetente dhe ndjek ecurinë e trajtimit të tyre. • Bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për mbrojtjen civile dhe strukturat e tjera të bashkisë për evidentimin dhe përcjelljen e nevojave të qytetarëve gjatë procesit të rimëkëmbjes. • Mban evidenca dhe përgatit përmbledhje mbi kërkesat e administruara dhe problematikat e evidentuara, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike për qytetarët e prekur.
Bashkia Durrës Drejtoria e Turizmit	• Mbledhja dhe përpunimi i informacionit mbi ndikimin e fatkeqësisë në sektorin e turizmit, përfshirë atraksionet turistike, strukturat akomoduese dhe bizneset e lidhura me turizmin. • Bashkëpunimi me drejtoritë dhe strukturat përgjegjëse të Bashkisë për identifikimin e nevojave dhe përcaktimin e prioriteteve për rimëkëmbjen e aktivitetit turistik.

	• Koordinimi me bizneset turistike dhe aktorët e sektorit për evidentimin e problematikave dhe mbështetjen e rikthimit të aktivitetit ekonomik. • Bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse për rikthimin në funksion të atraksioneve dhe shërbimeve turistike, sipas kompetencave përkatëse. • Përditësimi dhe shpërndarja e informacionit mbi gjendjen e destinacionit turistik dhe shërbimet e disponueshme për vizitorët. • Mbështetja e rikthimit të imazhit të destinacionit Durrës dhe promovimi i ofertës turistike, në përputhje me kushtet e sigurisë dhe funksionalitetit. • Monitorimi i ecurisë së rimëkëmbjes së sektorit të turizmit dhe raportimi i problematikave e nevojave për ndërhyrje të mëtejshme. **Nëpërmjet Sektorit të Integrimit Evropian dhe Ndihmës së Huaj në fazën e rimëkëmbjes** • Koordinimi me të gjitha drejtoritë dhe strukturat e Bashkisë për identifikimin e nevojave dhe projekteve prioritare të rimëkëmbjes pas fatkeqësive. • Identifikimi i programeve të financimit dhe asistencës teknike nga Bashkimi Evropian, donatorët kombëtarë e ndërkombëtarë dhe partnerët e zhvillimit. • Mbështetja e përgatitjes dhe aplikimit të projekteve për rimëkëmbjen e infrastrukturës, shërbimeve publike dhe funksioneve të tjera të Bashkisë. • Koordinimi me donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë për prezantimin e nevojave të Bashkisë dhe mobilizimin e asistencës financiare e teknike. • Krijimi dhe përditësimi i një baze të dhënash mbi projektet e propozuara, financimet e mundshme dhe projektet e mbështetura për rimëkëmbje. • Bashkërendimi me strukturat përgjegjëse për të shmangur mbivendosjen e projekteve dhe për të siguruar përputhjen e financimeve me prioritetet e Bashkisë. • Monitorimi dhe raportimi, në bashkëpunim me drejtoritë zbatuese, mbi ecurinë e projekteve të financuara për rimëkëmbje.
Bashkia Durrës Drejtoria e Informatikës dhe Dixhitalizimit	• Rikthimi në funksion i sistemeve informatike dhe infrastrukturës së IT-së të Bashkisë, përfshirë serverat, rrjetet, pajisjet elektronike dhe sistemet e komunikimit. • Rikuperimi dhe garantimi i sigurisë së të dhënave elektronike, nëpërmjet zbatimit të procedurave të kopjeve rezervë (backup) dhe rikthimit të të dhënave (restore). • Sigurimi i mbështetjes teknike për drejtoritë dhe sektorët e Bashkisë, për zgjidhjen e problemeve teknike dhe rikthimin e funksionimit të pajisjeve dhe sistemeve informatike. • Rikthimi i funksionimit të aplikacioneve dhe shërbimeve dixhitale, si dhe garantimi i shkëmbimit elektronik të të dhënave ndërmjet strukturave të Bashkisë.

	• Marrja e masave për mbrojtjen e sistemeve informatike dhe konfidencialitetin e informacionit, duke garantuar sigurinë dhe integritetin e të dhënave. • Identifikimi i nevojave për riparimin, zëvendësimin dhe përmirësimin e pajisjeve e sistemeve informatike të dëmtuara nga fatkeqësia. • Koordinimi me institucionet përgjegjëse dhe ofruesit e shërbimeve të teknologjisë së informacionit për rikthimin dhe funksionimin normal të sistemeve elektronike të Bashkisë. • Dokumentimi dhe raportimi i problematikave teknike dhe masave të ndërmarra për rikthimin e sistemeve informatike dhe shërbimeve dixhitale.
Bashkia Durrës Drejtoria Ligjore	• Sigurimi i mbështetjes ligjore për proceset e rimëkëmbjes, rehabilitimit dhe rindërtimit pas fatkeqësive. • Ndjekja e procedurave të shpronësimit për realizimin e investimeve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi. • Hartimi dhe shqyrtimi i akteve administrative, kontratave dhe marrëveshjeve që lidhen me procesin e rindërtimit. • Mbështetja ligjore e procedurave të prokurimit publik për rehabilitimin e infrastrukturës dhe objekteve të dëmtuara. • Mbrojtja e interesave të Bashkisë në çështjet gjyqësore dhe administrative që lindin gjatë rimëkëmbjes. • Trajtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve të prekur nga fatkeqësitë, brenda kompetencave ligjore të Bashkisë. • Mbështetja ligjore për rehabilitimin dhe administrimin e ndërtesave në bashkëpronësi të dëmtuara. • Bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse për zgjidhjen e problematikave ligjore dhe administrative që pengojnë rimëkëmbjen. • Garantimi i ligjshmërisë, transparencës dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve gjatë zbatimit të masave të rimëkëmbjes.
Bashkia Durrës Drejtoria e Arsim Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare	• Evidentimi i dëmeve në institucionet arsimore dhe ambientet kulturore e sportive. • Bashkëpunimi për rehabilitimin e objekteve arsimore dhe rikthimin e shërbimeve në kushte të sigurta. • Organizimi i rifillimit të aktiviteteve arsimore, kulturore, rinore dhe sportive. • Identifikimi i nevojave për mbështetjen e fëmijëve, të rinjve dhe komuniteteve të prekura. • Bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse, organizatat dhe donatorët për mbështetjen e procesit të rimëkëmbjes. • Kontributi në evidentimin e dëmeve dhe rehabilitimin e aseteve të trashëgimisë kulturore. • Raportimi periodik mbi dëmet, nevojat dhe masat e ndërmarra për rikthimin e shërbimeve.
Bashkia Durrës Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit.	• **Vlerësimi i dëmeve në territor dhe ndërtesa**, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, duke evidentuar objektet e dëmtuara dhe zonat që kërkojnë ndërhyrje. • **Vlerësimi teknik dhe urbanistik i objekteve të dëmtuara**, për të identifikuar nevojën për riparim, rikonstruksion, përforcim strukturor ose prishje, sipas vlerësimeve dhe vendimeve të autoriteteve kompetente. • **Planifikimi i ndërhyrjeve për rehabilitimin e territorit**, duke përcaktuar zonat prioritare dhe masat për rikthimin e funksionalitetit të hapësirave publike. • **Hartimi dhe përshtatja e planeve urbanistike**, duke marrë parasysh rreziqet e evidentuara dhe nevojën për zhvillim të sigurt e të qëndrueshëm të territorit.

	• **Koordinimi i projekteve të rindërtimit dhe rikonstruksionit** me drejtoritë e tjera të Bashkisë, institucionet përgjegjëse dhe subjektet zbatuese. • **Përditësimi i të dhënave hartografike dhe gjeohapësinore**, për evidentimin e dëmeve, përcaktimin e zonave të prekura dhe mbështetjen e vendimmarrjes për ndërhyrjet. • **Mbështetja e rikthimit të infrastrukturës dhe hapësirave publike**, nëpërmjet planifikimit të ndërhyrjeve urbanistike dhe koordinimit me strukturat përgjegjëse. • **Kontrolli i përputhshmërisë së projekteve të rindërtimit** me planet urbanistike, lejet përkatëse dhe standardet e sigurisë në fuqi. • **Identifikimi i zonave me rrezik të lartë**, ku rindërtimi duhet të kufizohet ose të shoqërohet me masa të posaçme sigurie, bazuar në vlerësimet e institucioneve kompetente. • **Raportimi i dëmeve, nevojave dhe progresit të ndërhyrjeve** te drejtuesit e Bashkisë dhe strukturat përgjegjëse për menaxhimin e emergjencave civile.
Bashkia Durrës Drejtoria e Projekteve, Infrastrukturës Publike dhe Trasnportit Publik.	• **Koordinon vlerësimin e dëmeve** në infrastrukturën publike, rrugë, ndërtesa publike, rrjetet e shërbimeve dhe sistemin e transportit publik, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse. • **Planifikon dhe propozon ndërhyrjet prioritare** për rehabilitimin, riparimin dhe rindërtimin e objekteve dhe infrastrukturës së dëmtuar, duke përcaktuar nevojat teknike dhe financiare. • **Organizon hartimin e projekteve teknike dhe preventivave** për investimet e rimëkëmbjes, nëpërmjet Sektorit të Projekteve Publike, duke synuar rikthimin e funksionalitetit dhe rritjen e qëndrueshmërisë së infrastrukturës. • **Ndjek dhe monitoron zbatimin e investimeve publike**, nëpërmjet Sektorit të Ndjekjes së Investimeve Publike dhe Kontratave Publike, duke kontrolluar respektimin e projekteve të miratuara, cilësinë e punimeve, afatet dhe detyrimet kontraktuale. • **Koordinon rikthimin e shërbimeve publike**, në bashkëpunim me Sektorin e Monitorimit të Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrjeve të Varësisë, për riparimin e rrugëve, ndriçimit publik dhe problematikave të infrastrukturës së ujësjellësit e shërbimeve të tjera, sipas kompetencave. • **Organizon masat për rikthimin e transportit publik**, nëpërmjet Sektorit të Planifikimit të Transportit Publik dhe të Licencave, duke identifikuar rrugët e bllokuara, propozuar itinerare alternative dhe koordinuar masat për sigurinë rrugore dhe vijimësinë e shërbimit. • **Bashkëpunon me institucionet dhe ndërmarrjet përgjegjëse** për pastrimin, riparimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës së dëmtuar, si dhe për zgjidhjen e problematikave që pengojnë rikthimin në normalitet. • **Ndjek procedurat e kolaudimit dhe dorëzimit të objekteve të rehabilituara**, si dhe monitoron zbatimin e detyrimeve të kontraktorëve gjatë periudhës së garancisë. • **Përgatit raporte periodike teknike dhe administrative** për dëmet, ndërhyrjet e kryera, investimet në proces dhe nevojat e mbetura për financim, duke ia paraqitur titullarit të bashkisë. • **Siguron respektimin e legjislacionit dhe procedurave përkatëse**, në bashkëpunim me juristin e drejtorisë, gjatë

	hartimit të dokumentacionit teknik, administrativ dhe kontraktual për projektet e rimëkëmbjes. • **Monitoron rezultatet e ndërhyrjeve** dhe propozon masa për përmirësimin e infrastrukturës, parandalimin e dëmeve të përsëritura dhe rritjen e rezistencës ndaj fatkeqësive të ardhshme.
Bashkia Durrës Drejtoria e Shërbimeve Sociale	• Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirëse për të identifikuar ndikimet sociale, ekonomike dhe psikologjike tek individët dhe familjet. • I jep përparësi asistencës për grupet e cenueshme, duke përfshirë fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe familjet me të ardhura të ulëta. • Koordinon shpërndarjen e ushqimit, veshjeve dhe strehimit për personat e zhvendosur ose të prekur nga fatkeqësia. • Siguron akses në shërbimet e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë mbështetjen e shëndetit mendor, për të trajtuar traumat dhe kushtet e lidhura me stresin. • Ofron këshillim dhe mbështetje për të ndihmuar individët të përballojnë humbjen dhe të lehtësojnë kthimin e tyre në normalitet. • Partneritet me organizatat joqeveritare, grupet e komunitetit dhe aktorë të tjerë për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve. • Përdor kanale të shumta komunikimi për të arritur popullata të ndryshme. • Merr pjesë në zhvillimin e planeve afatgjata të rimëkëmbjes që përfshijnë përcaktuesit socialë të shëndetit dhe mirëqenies. • Mbledhja e të dhënave për të informuar strategjitë e ardhshme të gatishmërisë dhe reagimit ndaj fatkeqësive. • Trajnimi i personelit të shërbimit social në reagimin ndaj fatkeqësive dhe praktikat më të mira të rimëkëmbjes për të rritur gatishmërinë për ngjarjet e ardhshme.
Bashkia Durrës Drejtoria e Buxhetit	• Vlerësimi i nevojave buxhetore për masat e rimëkëmbjes, në bashkëpunim me drejtoritë dhe strukturat përgjegjëse të Bashkisë Durrës. • Përfshirja në projektbuxhet e fondeve të nevojshme për riparimin, rehabilitimin dhe rindërtimin, sipas prioriteteve dhe procedurave ligjore. • Përgatitja dhe propozimi i ndryshimeve buxhetore për përballimin e nevojave të krijuara nga emergjenca. • Bashkërendimi me drejtoritë e bashkisë për shqyrtimin e kërkesave për fonde dhe përcaktimin e prioriteteve buxhetore të rimëkëmbjes. • Monitorimi i realizimit të buxhetit dhe i përdorimit të fondeve të miratuara për masat e rimëkëmbjes, në bashkëpunim me strukturat financiare përgjegjëse. • Përgatitja e raporteve mbi realizimin e fondeve buxhetore të planifikuara për rimëkëmbjen. • Bashkëpunimi me Sektorin e Mbrojtjes Civile dhe strukturat përkatëse për përfshirjen e nevojave financiare të emergjencave në planet dhe programet buxhetore.

	• Evidentimi i nevojave për përmirësimin e planifikimit buxhetor për emergjencat e ardhshme, bazuar në përvojën e fituar gjatë rimëkëmbjes.
Bashkia Durrës Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit i Njësisë Vendore	• Kontrolli i zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e territorit dhe respektimin e lejeve të ndërtimit gjatë proceseve të riparimit dhe rindërtimit. • Identifikimi dhe trajtimi, sipas kompetencave ligjore, i ndërtimeve dhe punimeve të kundërligjshme në zonat e prekura nga emergjencat. • Inspektimi i punimeve të rindërtimit për verifikimin e përputhshmërisë me lejet dhe kërkesat ligjore në fushën e ndërtimit. • Kontrolli dhe marrja e masave ligjore ndaj hedhjes së paligjshme të mbetjeve inerte dhe materialeve të ndërtimit, brenda kompetencave të institucionit. • Bashkëpunimi me strukturat përgjegjëse për parandalimin e ndërhyrjeve të kundërligjshme në territor dhe në zonat e mbrojtura. • Informimi i qytetarëve për kërkesat ligjore që lidhen me punimet e ndërtimit dhe rindërtimit. • Raportimi i shkeljeve të konstatuara dhe bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse për garantimin e zhvillimit të ligjshëm të territorit gjatë rimëkëmbje
Bashkia Durrës Policia bashkiake	• Patrullimi dhe mbikëqyrja e zonave të prekura për parandalimin e shkeljeve dhe veprimtarive të paautorizuara, brenda kompetencave ligjore. • Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit për kufizimin e qarkullimit dhe bllokimin e përkohshëm të rrugëve ose hapësirave publike, kur është e nevojshme. • Bashkëpunimi në organizimin dhe shpërndarjen e ndihmave për popullatën e prekur. • Identifikimi i personave dhe familjeve në nevojë dhe referimi i tyre pranë shërbimeve sociale përkatëse. • Bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e personave të cenueshëm dhe parandalimin e abuzimit në zonat e prekura. • Informimi i qytetarëve për masat e sigurisë, kufizimet e qarkullimit dhe udhëzimet e autoriteteve vendore. • Trajtimi i ankesave që lidhen me kompetencat e Policisë Bashkiake dhe referimi i rasteve të tjera pranë institucioneve përgjegjëse. • Raportimi i incidenteve, shkeljeve dhe rreziqeve të konstatuara gjatë procesit të rimëkëmbjes. • Bashkëpunimi me strukturat e mbrojtjes civile, shërbimet e emergjencës dhe drejtoritë përkatëse të Bashkisë Durrës për garantimin e sigurisë dhe normalizimin e jetës së komunitetit.
Bashkia Durrës	• Garantimi i vazhdimësisë së shërbimeve të shuarjes së zjarrit dhe shpëtimit gjatë fazës së rimëkëmbjes.

• Sektori i Shërbimit të MZSH	• Identifikimi dhe raportimi i rreziqeve nga zjarri në ndërtesat e dëmtuara, infrastrukturën kritike dhe zonat e prekura. • Evidentimi i rreziqeve dytësore, si rrjedhjet e gazit, defektet elektrike dhe prania e materialeve të ndezshme, në kuadër të ndërhyrjeve për sigurinë nga zjarri. • Marrja e masave për parandalimin e zjarreve dhe incidenteve të tjera gjatë procesit të rimëkëmbjes. • Ofrimi i asistencës për operacionet e shpëtimit dhe ndërhyrjet me rrezik të lartë, sipas kompetencave dhe kapaciteteve të shërbimit. • Informimi i publikut për masat e sigurisë nga zjarri, parandalimin e incidenteve dhe procedurat e evakuimit. • Vlerësimi dhe raportimi i dëmeve në stacionet zjarrfikëse, automjetet, pajisjet dhe sistemet e komunikimit. • Rikthimi i kapaciteteve operacionale të dëmtuara dhe rivlerësimi i gatishmërisë së personelit, mjeteve dhe pajisjeve. • Bashkëpunimi me institucionet kompetente për evidentimin e shkaqeve dhe rrethanave të zjarreve. • Bashkëpunimi me strukturat përgjegjëse për identifikimin dhe trajtimin e rreziqeve mjedisore që lidhen me zjarret. • Rishikimi i masave të reagimit dhe alarmimit, si dhe evidentimi i mësimeve të nxjerra nga emergjenca. • Propozimi i masave për përmirësimin e kapaciteteve dhe forcimin e gatishmërisë ndaj emergjencave të ardhshme.
Bashkia Durrës Njësitë Administrative	• Dhënia e informacionit dhe asistencës në terren për strukturat e bashkisë gjatë vlerësimit të dëmeve dhe identifikimit të nevojave për riparim e rindërtim. • Mbështetja e procesit të planifikimit të masave për rehabilitimin e infrastrukturës, objekteve dhe shërbimeve komunitare, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse. • Identifikimi i familjeve dhe individëve të prekur që kanë nevojë për ndihmë dhe përcjellja e informacionit pranë strukturave kompetente. • Orientimi i personave të prekur drejt shërbimeve të ndihmës sociale dhe mbështetjes psikologjike. • Koordinimi me strukturat përgjegjëse për rikthimin e shërbimeve bazë, si arsimi, shëndetësia dhe transporti. • Informimi i qytetarëve për masat e rimëkëmbjes dhe mundësitë e përfitimit nga programet e ndihmës. • Përcjellja e problematikave të evidentuara në territor dhe e mësimeve të nxjerra nga emergjenca pranë Bashkisë Durrës dhe strukturave të mbrojtjes civile.
Bashkia Durrës Ndërmarrja "Rruga"	• Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në rrugët, kanalet kulluese, strukturat hidroteknike dhe infrastrukturën tjetër që është në administrim ose përgjegjësi të saj. • Organizimi i ndërhyrjeve për pastrimin e rrugëve nga inertet, dherat, mbetjet dhe materialet e tjera të depozituara si pasojë e fatkeqësisë. • Kryerja e punimeve për riparimin dhe rehabilitimin e segmenteve rrugore të dëmtuara, me qëllim rikthimin e qarkullimit dhe garantimin e aksesit në zonat e banuara. • Pastrimi, zhbllokimi dhe rehabilitimi i kanaleve kulluese dytësore dhe tretësore, si dhe të strukturave të tjera kulluese që janë në përgjegjësi të ndërmarrjes. • Evidentimi i dëmeve në sistemet e kullimit, hidrovorët, argjinaturat dhe strukturat hidroteknike, si dhe koordinimi me

	institucionet përgjegjëse për realizimin e ndërhyrjeve të nevojshme. • Vënia në dispozicion e mjeteve teknike, makinerive dhe personelit për largimin e materialeve të grumbulluara, pastrimin e zonave të prekura dhe mbështetjen e punimeve të rehabilitimit. • Bashkëpunimi me strukturat e Mbrojtjes Civile, si dhe operatorët përgjegjës për infrastrukturën, për përcaktimin e prioriteteve dhe realizimin e ndërhyrjeve.
Bashkia Durrës Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale	• Organizimi i operacioneve për pastrimin e rrugëve, shesheve, trotuareve dhe hapësirave publike nga mbetjet, inertet, balta dhe materialet e tjera të shkaktuara nga fatkeqësia. • Grumbullimi, transportimi dhe depozitimi i mbetjeve të krijuara gjatë operacioneve të pastrimit dhe rehabilitimit, në bashkëpunim me strukturat dhe operatorët përgjegjës. • Pastrimi dhe rehabilitimi i hapësirave publike, parqeve, lulishteve dhe mjediseve të tjera në administrim të saj, të dëmtuara nga përmbytjet, stuhitë, zjarret apo fatkeqësi të tjera. • Marrja e masave për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare në zonat e prekura, me qëllim parandalimin e ndotjes së mjedisit dhe të rreziqeve për shëndetin publik. • Kryerja e shërbimeve të dezinfektimit, dezinsektimit dhe, kur është e nevojshme, të deratizimit, në bashkëpunim me strukturat e shëndetit publik dhe sektorin veterinar, sipas vlerësimit të riskut dhe protokolleve përkatëse. • Mbështetja e procesit të pastrimit dhe rehabilitimit të institucioneve publike, shkollave, kopshteve, çerdheve, qendrave sociale dhe mjediseve të tjera publike të prekura, sipas prioriteteve të përcaktuara nga Bashkia. • Bashkëpunimi me Ndërmarrjen Rruga, strukturat e Mbrojtjes Civile dhe institucionet e tjera për largimin e mbetjeve dhe materialeve të rrezikshme, duke respektuar procedurat e sigurisë dhe kompetencat përkatëse.
Institucione dhe struktura në nivel qarku	
Prefekti i Qarkut Durrës Sektori i Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave	• Vepron si autoriteti qendror në nivel qarku për koordinimin e përpjekjeve të rimëkëmbjes midis shumë institucioneve, strukturave brenda qarkut. • Krijon një strukturë të unifikuar komanduese për të përmirësuar komunikimin dhe vendimmarrjen ndërmjet aktorëve institucionalë. • Zhvillon një plan rimëkëmbjeje që prioritizon nevojat kritike si strehimi, shërbimet komunale dhe transporti. • Identifikon dhe shpërndan burime, përfshirë personelin dhe pajisjet, për të mbështetur përpjekjet vendore të rimëkëmbjes. • Bashkëpunon me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare për sigurimin e mbështetjes teknike dhe fondeve. • Siguron koordinimin e veprimtarive të rimëkëmbjes për infrastrukturën kritike si rrugët, urat, shërbimet komunale dhe ndërtesat publike. • Raporton rregullisht mbi progresin dhe sfidat e rimëkëmbjes pranë AKMC, MM, MB.
Përfaqësues të FA në territorin e bashkisë	• Mbështesin rehabilitimin e infrastrukturës kritike, si rrugët dhe urat, kur autoritetet civile nuk disponojnë kapacitete të mjaftueshme.

	• Sigurojnë pajisje të rënda dhe personel për heqjen e mbeturinave, pastrimin e rrugëve dhe ndërtimin e strehimoreve emergjente. • Mbështesin logjistikën dhe ruajtjen e integritetit të pikave të shpërndarjes së ndihmës. • Vazhdon të mbështesë misionet e kërkimit dhe shpëtimit siç kërkohet gjatë fazës së rimëkëmbjes, veçanërisht në zonat e vështira për t'u arritur ose të rrezikshme. • Siguron pajisje dhe personel të trajnuar për të ndihmuar në operacionet e rimëkëmbjes. • Ofron ekspertizë inxhinierike për vlerësimin e dëmeve dhe mbështet hartimin dhe zbatimin e projekteve të rimëkëmbjes, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet civile dhe sipas kërkesës së tyre.
Drejtoria Rajonale e OSHEE-së Durrës	• **Vlerësimi i dëmeve** – Kryerja e një vlerësimi të hollësishëm të dëmeve në rrjetin e shpërndarjes, kabinat elektrike dhe transformatorët për të përcaktuar nevojat për riparim dhe restaurim. • **Restaurimi i furnizimit me energji** – Rikthimi gradual i energjisë për konsumatorët, duke i dhënë përparësi objekteve kritike si spitalet, qendrat e emergjencës dhe infrastrukturës publike. • **Zbatimi i zgjidhjeve të përkohshme –** Vendosja e zgjidhjeve të përkohshme si gjeneratorët për zonat ku rikuperimi i plotë kërkon më shumë kohë. • **Siguria e rrjetit –** Monitorimi i rrjetit të shpërndarjes për të parandaluar mbingarkesat dhe rreziqet elektrike gjatë fazës së rimëkëmbjes. • **Informimi i komunitetit** – Komunikimi i qartë me qytetarët për ndërprerjet e planifikuara, përdorimin e sigurt të energjisë dhe kufizimet e furnizimit. • **Riparimi dhe modernizimi** – Restaurimi dhe përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes duke integruar masa për rritjen e qëndrueshmërisë ndaj fatkeqësive në të ardhmen. • **Koordinimi me institucionet** – Bashkëpunimi me autoritetet vendore dhe qendrore për të siguruar burimet dhe mbështetjen e nevojshme për rimëkëmbjen e rrjetit të shpërndarjes.
Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)	• **Vlerësimi i infrastrukturës:** Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës të infrastrukturës energjetike, duke përfshirë nënstacionet dhe linjat e transmetimit, në bashkëpunim me autoritetet vendore dhe qendrore. • **Prioritet për objektet kritike**: – Identifikimi dhe restaurimi i menjëhershëm i energjisë në objektet kritike si spitalet, qendrat e emergjencës dhe furnizimet me ujë. • **Rikthimi gradual i energjisë:** – Koordinimi për të siguruar furnizimin e qëndrueshëm me energji elektrike, duke përdorur zgjidhje të përkohshme si gjeneratorët në zonat ku riparimet kërkojnë kohë. • **Siguria e komunitetit:** – Informimi i popullsisë për përdorimin e sigurt të energjisë dhe kufizimet e mundshme gjatë fazës së rimëkëmbjes. • **Modernizimi i rrjetit:** – Integrimi i masave për rritjen e aftësisë ripërtëritëse ndaj fatkeqësive, përfshirë përdorimin e teknologjive të avancuara si kabllot nëntokësore. • **Monitorimi dhe masa parandaluese:** –Vëzhgimi i vazhdueshëm i rrjetit për të parandaluar ndërprerjet dytësore dhe rreziqet si zjarret apo mbingarkesat elektrike.

	• **Mbështetja për investime afatgjata:** – Promovimi i investimeve në sistemet e ruajtjes së energjisë dhe burimet alternative për të forcuar qëndrueshmërinë e rrjetit pas fatkeqësive.
Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë	• **Vlerësimi i dëmeve** – Kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës të dëmeve të vendeve të trashëgimisë kulturore, muzeve, bibliotekave, arkivave dhe pasurive të tjera kulturore. • **Dokumentimi dhe planifikimi** – Identifikimi dhe dokumentimi i dëmeve dhe humbjeve ndaj objekteve kulturore dhe trashëgimisë jo-materiale, të tilla si traditat ose praktikat e prekura nga fatkeqësia, duke siguruar një bazë për prioritetet e rimëkëmbjes. • **Stabilizimi dhe mbrojtja** – Zbatimi i masave për stabilizimin dhe mbrojtjen e vendeve dhe objekteve kulturore të dëmtuara nga përkeqësimi ose humbja e mëtejshme. • **Restaurimi dhe ruajtja** –Bashkëpunimi me ekspertë të restaurimit për mbrojtjen dhe rikthimin e objekteve kulturore sipas standardeve ndërkombëtare. • **Mbështetja institucionale dhe financiare** – Koordinimi me njësitë vendore, organizatat ndërkombëtare (p.sh. UNESCO) dhe institucionet kulturore, për të siguruar mbështetje teknike dhe financiare për restaurimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore. • **Ndërgjegjësimi dhe edukimi** – Promovimi i fushatave për sensibilizimin e komunitetit mbi rëndësinë e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. • Përfshirja e komunitetit – Angazhimi i komunitetit në përpjekjet për ruajtjen dhe restaurimin e trashëgimisë kulturore.
Administrata e Zonave të Mbrojtura Durrës.	• Vlerësimi i dëmeve mjedisore në zonat e mbrojtura dhe evidentimi i ndikimeve në habitatet natyrore. • Monitorimi i florës dhe faunës pas zjarreve, përmbytjeve dhe emergjencave të tjera. • Rehabilitimi i habitateve të dëmtuara dhe mbështetja e rikuperimit të biodiversitetit. • Parandalimi dhe bashkëpunimi për shuarjen e zjarreve në zonat e mbrojtura. • Raportimi i ndotjeve dhe dëmtimeve pranë institucioneve kompetente. • Bashkëpunimi me bashkitë dhe strukturat e mbrojtjes civile për koordinimin e masave të rimëkëmbjes.
Drejtoria Rajonale e AKU- Durrës	• Kontrolli i sigurisë dhe i cilësisë së produkteve ushqimore pas emergjencave. • Inspektimi i operatorëve ushqimorë dhe verifikimi i kushteve higjieno-sanitare. • Identifikimi dhe bllokimi i produkteve ushqimore të pasigurta, sipas kompetencave ligjore. • Mbledhja dhe raportimi i të dhënave për rreziqet që lidhen me sigurinë ushqimore. • Vlerësimi i riskut ushqimor dhe marrja e masave për parandalimin e rreziqeve për shëndetin publik. • Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe strukturat e emergjencave civile për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e masave.

Zyra e Administrimit të Basenit Ujor (ZABU) **Ishëm – Erzen – Mat**	• Vlerësimi dhe monitorimi i gjendjes së burimeve ujore pas përmbytjeve dhe emergjencave të tjera. • Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave mbi prurjet, cilësinë e ujit dhe dëmet në mjedisin ujor. • Identifikimi i problematikave që lidhen me ndotjen e ujërave dhe rreziqet për burimet ujore. • Përgatitja e raporteve dhe dhënia e rekomandimeve për menaxhimin dhe mbrojtjen e burimeve ujore. • Bashkëpunimi me bashkitë, prefekturat dhe institucionet e mbrojtjes civile për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e masave. • Mbështetja e zbatimit të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe masave për parandalimin e dëmeve të ardhshme.
Agjencia Rajonale Ekstensionit Bujqësor Tiranë/ Sektori i Ekstensionit Bujqësor (SEB) Durrës,	• Vlerësimi dhe evidentimi i dëmeve në sektorin bujqësor dhe blegtoral. • Mbledhja dhe raportimi i të dhënave për dëmet e shkaktuara nga emergjencat natyrore. • Këshillimi teknik i fermerëve për rikthimin e aktivitetit prodhues. • Informimi dhe asistenca për përfitimin nga skemat mbështetëse dhe programet e zhvillimit rural. • Mbështetja për hartimin e planeve të investimit dhe rimëkëmbjen ekonomike të fermave. • Trajnimi i fermerëve për praktika bujqësore të qëndrueshme. • Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe strukturat e mbrojtjes civile për shkëmbimin e informacionit dhe mbështetjen e rimëkëmbjes.
Agjencia Rajonale e Mjedisit	**Vlerësimi dhe Monitorimi i Dëmeve Mjedisore** • Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirës të ndikimeve mjedisore të shkaktuara nga fatkeqësia, duke përfshirë ndikimet në tokë, ujë, cilësinë e ajrit dhe biodiversitetin, në bashkëpunim me institucione përkatëse dhe ekspertë të fushës. • Identifikimi dhe prioritizimi i zonave që kërkojnë rehabilitim të menjëhershëm mjedisor, duke i adresuar ato në koordinim me autoritetet lokale dhe qendrore. • Monitorimi i rreziqeve dytësore mjedisore, si rrëshqitjet e dheut, përmbytjet ose ndotja nga materialet e rrezikshme, dhe zbatimi i masave parandaluese për të shmangur dëme të mëtejshme. **Rehabilitimi i Mjedisit dhe Ekosistemeve** • Zbatimi i programeve për restaurimin e ekosistemeve të dëmtuara, të tilla si ripyllëzimi, restaurimi i ligatinave dhe restaurimi i habitateve të specieve të egra, në përputhje me standardet e ruajtjes së mjedisit. • Trajtimi i efekteve të fatkeqësisë mbi mjedisin, si erozioni i tokës, ndotja e ujit dhe ajrit, për të rivendosur ekuilibrin ekologjik. • Bashkëpunimi me agjenci të tjera për të siguruar asgjësim të sigurt të mbetjeve dhe materialeve të rrezikshme nga fatkeqësia në përputhje me rregulloret mjedisore. • Promovon përfshirjen e masave të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në përpjekjet për rimëkëmbje, të tilla si ndërtimi i barrierave natyrore ose rehabilitimi i ekosistemeve që ndihmojnë në zbutjen e ndikimeve të ardhshme mjedisore. **Ndërgjegjësimi dhe Angazhimi i Komunitetit**

	• Kryerja e fushatave ndërgjegjësuese për të informuar komunitetet për rreziqet mjedisore dhe rëndësinë e praktikave të qëndrueshme të rimëkëmbjes. • Inkurajimi i pjesëmarrjes së komunitetit në projektet e rehabilitimit mjedisor, të tilla si mbjellja e pemëve ose pastrimi i zonave, për të forcuar angazhimin dhe ndërgjegjësimin publik. • Mbështetja e politikave që promovojnë standarde të qëndrueshmërisë në përpjekjet për rimëkëmbje dhe zhvillim afatgjatë. **Sigurimi i burimeve për rimëkëmbjen.** • Mbështetja e projekteve që forcojnë aftësinë ripërtëritëse ekologjike dhe përmirësojnë infrastrukturën natyrore për të përballuar fatkeqësitë e ardhshme. • Siguron fonde nga qeveria, organizatat ndërkombëtare dhe donatorët për iniciativat për rimëkëmbjen e mjedisit.
Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë	• Vlerësimi dhe raportimi i problematikave në shëndetin e kafshëve dhe të bimëve pas emergjencave. • Monitorimi dhe kontrolli i sëmundjeve infektive të kafshëve dhe i dëmtuesve të bimëve. • Marrja e masave veterinare dhe fitosanitare për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve. • Kontrolli i biosigurisë dhe zbatimi i masave për dezinfektimin dhe trajtimin e materialeve të infektuara, sipas kompetencave ligjore. • Koordinimi i shërbimeve veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve në territorin që mbulon drejtoria. • Raportimi i situatës dhe propozimi i masave për zgjidhjen e problematikave pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB)-së.
Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës	**Vlerësimi dhe Prioritizimi i Ndërhyrjeve** • Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirëse të dëmeve në kanale, rezervuarë, stacione të pompimit dhe rrjetet e kullimit për të përcaktuar masat e nevojshme të rikuperimit. • Identifikimi i zonave ku dëmtimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit ka ndikuar në bujqësi, furnizim me ujë ose sigurinë publike. • Prioritizimi i riparimeve dhe rehabilitimit të infrastrukturës së ujitjes për të mundësuar rifillimin e aktiviteteve bujqësore dhe përdorimeve të tjera jetike. **Rikuperimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit** • Rivendosja e funksionalitetit të rezervuarëve, digave dhe kanaleve të ujit për të siguruar shpërndarjen e ujit në mënyrë të qëndrueshme për bujqësi dhe përdorime të tjera komunitare. • Zbatimi i zgjidhjeve të tjera të përkohshme, si sistemet portative të pompimit për të siguruar funksionalitetin deri në zgjidhjen përfundimtare.

	• Pastrimi i kanaleve të kullimit nga bllokimet për të shmangur përmbytjet dhe për të zvogëluar riskun e përmbytjeve në zonat e prekura. • Riparimi dhe përforcimi i sistemeve të kullimit për të garantuar rrjedhje efikase të ujit dhe për të mbrojtur infrastrukturën dhe komunitetet përreth. **Monitorimi dhe zbatimi i masave për parandalimin e rreziqeve.** • Monitorimi i sistemeve të kullimit për të parandaluar rreziqet dytësore, të tilla si rrëshqitjet e dheut ose përmbytjet e mëtejshme. • Zbatimi i masave të kontrollit të erozionit përgjatë rrjedhave ujore dhe në zonat me risk të lartë, për të zvogëluar ndikimin në tokat bujqësore dhe mjedis. • Promovimi i metodave të qëndrueshme të përdorimit të ujit dhe teknikave efikase të ujitjes për të optimizuar përdorimin e burimeve gjatë fazës së rimëkëmbjes. • Monitorimi i sistemeve të restauruara të ujitjes dhe kullimit për të garantuar që ato funksionojnë me efikasitet dhe qëndrueshmëri afatgjatë. **Mësime të nxjerra dhe planifikimi për të ardhmen.** • Vlerësimi i ndikimit të përpjekjeve për rimëkëmbje dhe dokumentimi i mësimeve të nxjerra për të përmirësuar gatishmërinë ndaj fatkeqësive në të ardhmen. • Mbështetja e projekteve të qëndrueshmërisë mjedisore, që ndihmojnë në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe rrisin aftësinë e qarkut për të menaxhuar burimet ujore në mënyrë efektive.
Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizimeve Durrës, Sh.a	**Vlerësimi dhe prioritizimi i ndërhyrjeve** • Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirëse të dëmeve të rrjeteve të furnizimit me ujë, impianteve të trajtimit, stacioneve të pompimit dhe sistemeve kanalizimeve. • Identifikimi i zonave më kritike për ndërhyrje dhe vendosja e prioriteteve për rikuperimin e shpejtë të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të kanalizimeve. • Zbatimi i zgjidhjeve të përkohshme, të tilla si rezervuarët e ujit ose njësitë e lëvizshme të trajtimit, për t'u shërbyer komuniteteve të prekura. **Rikuperimi i infrastrukturës së ujit dhe kanalizimeve** • Riparimi i rrjedhjeve dhe plasaritjeve në tubacione për të minimizuar humbjet e ujit dhe për të parandaluar rreziqet e ndotjes. • Pastrimi dhe rehabilitimi i sistemeve të kanalizimeve dhe ujërave të zeza për të parandaluar ndotjen dhe rreziqet shëndetësore. • Monitorimi dhe garantimi i funksionimit të impianteve të trajtimit të ujit dhe kanalizimeve për të shmangur ndotjen mjedisore. • Zbatimi i masave për reduktimin e ndikimit të fatkeqësive të ardhshme, si përforcimi i tubacioneve dhe rritja e rezistencës së impianteve të trajtimit të ujit ndaj përmbytjeve. **Sigurimi i higjienës dhe informimi i publikut** • Kryerja e testimeve të rregullta të cilësisë së ujit për të siguruar që furnizimet e restauruara të ujit janë të sigurta për konsum.

	• Ofrimi i përditësimeve të vazhdueshme për publikun, mbi ecurinë e rimëkëmbjes dhe afatet kohore për restaurimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. • Edukimi i komuniteteve të prekura për rëndësinë e ruajtjes së ujit dhe praktikave të sigurta të higjienës gjatë rimëkëmbjes.
Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës	**Vlerësimi i dëmeve në infrastrukturën arsimore.** • Kryen vlerësime të dëmeve në shkolla dhe objekte arsimore. **Sigurimi i vazhdimësisë së procesit arsimor.** • Organizimi i mësimit alternativ, përfshirë përdorimin e objekteve të përkohshme ose mësimit online në rastet kur shkollat janë të papërdorshme. • Sigurimi i teksteve dhe materialeve mësimore për nxënësit e prekur nga fatkeqësia. **Mbështetje psiko-sociale për nxënësit dhe mësuesit.** • Ofron mbështetje psiko-sociale për nxënësit dhe mësuesit për të lehtësuar rikthimin në shkollë. • Ofrimi i ndihmës psikologjike dhe mbështetjes sociale për nxënësit dhe mësuesit e prekur • Bashkëpunimi me strukturat psikosociale për të adresuar nevojat e grupeve të ndjeshme. **Koordinimi për rimëkëmbjen e sektorit arsimor.** • Bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe strukturat qeveritare për zbatimin e masave të rimëkëmbjes. • Përgatitja e raporteve mbi situatën arsimore pas fatkeqësisë dhe rekomandime për përmirësim.
Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Durrës	**Vlerësimi dhe rindërtimi i infrastrukturës arsimore.** • Kryerja e vlerësimeve gjithëpërfshirëse të dëmeve të ndërtesave, objekteve dhe burimeve shkollore, duke identifikuar zonat që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme. • Dhënia përparësi riparimit dhe rindërtimit të ndërtesave dhe objekteve shkollore të dëmtuara për të siguruar rifillimin sa më të shpejtë të procesit mësimor. • Zëvendësimi ose riparimi i materialeve arsimore të humbura ose të dëmtuara, si tekstet shkollore, mobiljet dhe pajisjet teknologjike, për të mbështetur mësimdhënien. **Sigurimi i vazhdimësisë së arsimit.** • Hartimi dhe zbatimi i një plani të përkohshëm për rifillimin e procesit mësimor, duke i dhënë përparësi shkollave dhe komuniteteve më të prekura. • Rregullimi i kalendarit akademik, për të kompensuar kohën e humbur të mësimit dhe për të garantuar përmbushjen e objektivave arsimore. • Krijimi i hapësirave të përkohshme për zhvillimin e mësimit në rast se infrastruktura shkollore nuk është funksionale. **Mbështetja psikosociale dhe bashkëpunimi.** • Ofrimi i këshillimit dhe mbështetjes për shëndetin mendor për nxënësit, mësuesit dhe stafin e prekur nga fatkeqësia , përmes këshillimit dhe aktiviteteve psikosociale. • Bashkëpunimi me prindërit, autoritetet lokale dhe komunitetin për të lehtësuar rikthimin në shkollë dhe për të siguruar një mjedis të sigurt dhe mbështetës.

	• Koordinimi me OJQ dhe donatorë për të siguruar fonde, furnizime dhe mbështetje teknike për rindërtimin dhe restaurimin e infrastrukturës arsimore. **Monitorimi dhe përmirësimi i gatishmërisë për të ardhmen.** • Monitorimi i procesit të rimëkëmbjes për të siguruar që ndërtesat dhe objektet arsimore janë funksionale, të sigurta dhe të përshtatshme për nxënësit dhe mësuesit. • Dokumentimi i mësimeve të nxjerra nga përpjekjet për rimëkëmbje dhe përdorimi i tyre për të përmirësuar gatishmërinë dhe planifikimin për emergjencat e ardhshme.
Drejtoria Vendore e Policisë Durrës./Komisariati i Policisë Durrës	• Siguria publike dhe ruajtja e rendit. • Sigurimi i rendit në zonat e prekura dhe parandalimi i krimeve si vjedhja, vandalizmi dhe aktivitete të tjera kriminale. • Monitorimi dhe mbrojtja e ndërtesave dhe objekteve publike të dëmtuara për të parandaluar aksesin e paautorizuar dhe dëmtimet e mëtejshme. • Parandalimi i tensioneve sociale dhe konflikteve të lidhura me ndarjen e burimeve apo pronësinë. • Hetimi dhe parandalimi i incidenteve e mashtrimve ose korrupsionit që lidhen me rimëkëmbjen, duke siguruar llogaridhënie, drejtësi dhe transparencë. • Menaxhimi i lëvizjes dhe mbështetja logjistike. • Rregullimi i trafikut për të lehtësuar lëvizjen e automjeteve, pajisjeve dhe personelit duke prioritizuar automjetet dhe pajisjet që marrin pjesë në përpjekjet për rimëkëmbje. • Ofrimi i sigurisë dhe mbështetjes logjistike për qendrat e shpërndarjes së ndihmës dhe strehimoret e komunitetit. • Mbështetja e ekipeve të emergjencës dhe koordinimi me autoritetet lokale për të optimizuar operacionet e rimëkëmbjes. • Mbrojtja e grupeve të cenueshme. • Ofrimi i sigurisë për grupet e cenueshme, përfshirë fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. • Monitorimi dhe ndërhyrja për të parandaluar incidentet e shfrytëzimit, trafikimit të qenieve njerëzore ose abuzimeve të tjera në zonat e prekura nga fatkeqësitë. • Komunikimi dhe ndërgjegjësimi publik • Shpërndarja e informacionit për publikun në lidhje me masat e sigurisë, afatet kohore të rikuperimit dhe burimet e disponueshme për komunitetin. • Inkurajimi i qytetarëve të raportojnë aktivitete të dyshimta duke përfshirë shqetësime sigurie ose aktivitetet kriminale në zonat e prekura. • Mbështetja për personelin e policisë • Ofrimi i mbështetjes operacionale dhe emocionale për oficerët e policisë dhe stafin e prekur nga fatkeqësia. • Koordinimi me profesionistët e shëndetit mendor për të ofruar këshillim për stafin e prekur ndaj stresit dhe traumës pas fatkeqësisë.
Përfaqësues të kompanive të telekomunikacionit (Vodafone & One)	**Vlerësimi dhe rivendosja e infrastrukturës.** • Kryerja e një vlerësimi të dëmtimeve në infrastrukturën e telekomunikacionit, duke përfshirë kullat celulare, linjat e transmetimit dhe pajisjet e rrjetit. • Prioritizimi dhe zbatimi i riparimeve për të rivendosur kanalet kritike të komunikimit në përputhje me kërkesat e autoriteteve civile dhe planifikimin e përgjithshëm të rimëkëmbjes.

	• Vendosja e njësive të përkohshme të komunikimit celular për të siguruar lidhje të menjëhershme në zonat e prekura. **Mbështetja e komunikimit për publikun dhe institucionet** • Ofrimi i informacionit të rregullt për publikun mbi statusin e ndërprerjet e shërbimit dhe përparimin e restaurimit. • Sigurimi i linjave të dedikuara të komunikimit për qendrat e operacioneve emergjente dhe ekipet në terren, për të mbështetur përpjekjet e koordinuara të përgjigjes dhe rimëkëmbjes. • Ofrimi i shërbimeve të veçanta për klientët, si ofrimi i telefonatave falas ose internet të limituar pa pagesë, për të ndihmuar popullatën e prekur të komunikojë gjatë periudhës së rimëkëmbjes. • Vendosja e stacioneve të karikimit dhe pikave të Ëi-Fi në qendrat e strehimit dhe ato komunitare për të mbështetur individët e zhvendosur dhe komunitetet e prekura. **Rritja e aftësisë ripërtëritëse të rrjetit.** • Investimi në teknologji dhe sisteme që përmirësojnë aftësinë ripërtëritëse të rrjetit për të përballuar risqet e fatkeqësive të ardhshme. • Monitorimi i performancës së rrjetit gjatë dhe pas rimëkëmbjes për të identifikuar cenueshmëritë dhe për të përmirësuar aftësinë ripërtëritëse ndaj ndërprerjeve të ardhshme.
Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Durrës.	• Monitorimi i gjendjes shëndetësore të popullatës së prekur dhe mbikëqyrja epidemiologjike për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive. • Identifikimi dhe raportimi i rreziqeve mjedisore që mund të ndikojnë në shëndetin publik. • Informimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit për higjienën dhe parandalimin e sëmundjeve. • Mbledhja dhe raportimi i të dhënave për problematikat dhe nevojat shëndetësore pas emergjencës. • Evidentimi dhe raportimi i dëmeve në godinat dhe pajisjet shëndetësore, sipas kompetencave. • Identifikimi dhe raportimi i nevojave për rikonstruksion, rehabilitim ose rindërtim të objekteve shëndetësore të dëmtuara. • Bashkëpunimi me Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe institucionet përgjegjëse për rikthimin e shërbimeve shëndetësore.
Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Durrës	• Vlerësimi dhe monitorimi i kushteve shëndetësore • Monitorimi dhe inspektimi i institucioneve shëndetësore për të garantuar rifillimin e shërbimeve bazë pas fatkeqësisë. • Vlerësimi i ndikimit të emergjencës në shëndetin publik, përfshirë monitorimin e sëmundjeve të lidhura me fatkeqësinë. • Inspektimi i kushteve higjieno-sanitare në objektet e riparimit dhe vendstrehimit të përkohshëm për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve. • Mbështetja për rivendosjen e sigurisë shëndetësore

	• Kontrolli i cilësisë së ujit dhe ushqimit në zonat e prekura nga fatkeqësia për të shmangur ndotjet dhe infeksionet. • Monitorimi i shëndetit të popullsisë dhe ambientit për të identifikuar faktorët e rrezikut të shëndetit pas fatkeqësisë. • Koordinimi me institucionet e tjera shëndetësore për zbatimin e masave parandaluese kundër epidemive dhe për të siguruar trajtim mjekësor për grupet e cenueshme. • Koordinimi dhe mbështetja institucionale • Bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe organizatat ndërkombëtare për të siguruar ndihmë teknike dhe burime për rimëkëmbjen e sistemit shëndetësor. • Dhënia e udhëzimeve për masat e rimëkëmbjes sanitare për institucionet publike dhe private. • Përcaktimi i prioriteteve për inspektime urgjente dhe rishikimi i planeve të emergjencave shëndetësore në përputhje me përvojën e fituar nga fatkeqësia.
Spitali Rajonal Durrës	• Rikthimi dhe garantimi i vazhdimësisë së shërbimeve spitalore, përfshirë urgjencën dhe shërbimet e specializuara. • Trajtimi dhe rehabilitimi i personave të dëmtuar nga emergjencat dhe fatkeqësitë. • Vlerësimi dhe raportimi i dëmeve në godinën spitalore, pajisjet mjekësore dhe infrastrukturën mbështetëse. • Identifikimi i nevojave për rikonstruksion, rehabilitim ose rindërtim të ambienteve të dëmtuara. • Sigurimi i gatishmërisë së personelit, autoambulancave, barnave dhe materialeve mjekësore për përballimin e pasojave të emergjencave. • Parandalimi dhe kontrolli i infeksioneve spitalore dhe zbatimi i masave të higjienës e dezinfektimit. • Bashkëpunimi me institucionet shëndetësore dhe strukturat e mbrojtjes civile për koordinimin e ndihmës mjekësore dhe rimëkëmbjen e shërbimeve.
Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Durrës	• Sigurimi i nevojave themelore për popullsinë e prekur • Ofrimi i artikujve thelbësorë, si ushqimi, ujë i pastër, veshjet dhe kompletet e higjienës, për komunitetet e prekur. • Mbështetja e përpjekjeve për strehim të përkohshëm për individët dhe familjet e zhvendosura nga fatkeqësitë. • Lehtësimi i aksesit në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe barnat për komunitetet e prekura në bashkëpunim me autoritetet shëndetësore vendore. • Mbështetja psikosociale dhe shëndeti mendor • Ofrimi i ndihmës së parë psikologjike dhe mbështetjes afatgjatë të shëndetit mendor për individët e prekur nga fatkeqësia, si dhe për forcat operacionale dhe stafin e përfshirë në rimëkëmbje. • Organizimi i seancave të këshillimit dhe programeve mbështetëse emocionale për individët që përballen me trauma pas fatkeqësisë. • Promovimi i higjienës dhe parandalimi i sëmundjeve përmes fushatave ndërgjegjësuese dhe shpërndarjes së materialeve sanitare. • Rimëkëmbja e komunitetit dhe zhvillimi i aftësive

	• Ofrimi i mbështetje për familjet më të prekura për një periudhë deri në një vit, duke përfshirë ndihmën materiale, asistencën psikosociale dhe promovimin e shëndetit dhe higjienës. • Angazhimi dhe trajnimi i vullnetarëve për të ndihmuar në aktivitetet e rimëkëmbjes, si shpërndarja e ndihmave dhe mbështetja e komunitetit. • Trajnimi i komuniteteve për aftësi të veçanta rimëkëmbjeje, si ndihma e parë dhe mbështetja psikosociale. • Menaxhimi i burimeve dhe monitorimi i rimëkëmbjes • Mobilizimi i fondeve dhe burimeve nga donatorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të mbështetur përpjekjet e rimëkëmbjes. • Monitorimi i ndikimit të aktiviteteve të rimëkëmbjes për t'u siguruar që ato plotësojnë nevojat e komuniteteve të prekura. • Sigurimi i aksesit të barabartë në burimet dhe shërbimet e rimëkëmbjes për të gjitha grupet e prekura.

11.5 Financimi i sistemit të mbrojtjes civile në nivel bashkie

Financimi i masave për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile në nivel bashkie është sanksionuar në kuadrin ligjor në fuqi ku përcaktohet se: Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", mbështeten në parashikimin minimal prej 4 % të totalit të buxhetit vjetor të tyre, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare, si: nga të ardhurat e veta vendore; nga fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare; huamarrja vendore; donacionet; si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

VKM nr. 414, datë 8.7.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", parashikon prioritizmet e perdorimit të këtij fondi nga bashkitë. Qëllimi i vendimit është të sigurojë përdorimin e fondeve të mbrojtjes civile kryesisht për përballimin e emergjencave, mbrojtjen e jetës dhe pronës, rehabilitimin e infrastrukturës dhe rikthimin e normalitetit në komunitet, për trajnime, pajisje, bashkëpunim ndërbashkiak dhe veprimtari të tjera, duke respektuar kufijtë e përcaktuar dhe procedurat e miratimit e të raportimit.

Kapitulli 12. Skenarët operacionalë

Ky kapitull paraqet skenarët operacionalë për rreziqet me nivelin më të lartë në VRF: përmbytjen e Erzenit (PM-1 dhe PM-2), tërmetin (SZ-2) dhe aksidentin teknologjik në Porto Romano (TK-1). Çdo skenar përmban kontekstin, ndikimet e pritshme, nevojat, kronologjinë e veprimeve dhe strukturat përgjegjëse. Skenarët përdoren për ushtrimet dhe për përditësimin vjetor të planit.

12.1 Skenari A: Përmbytja e lumit Erzen në Sukth dhe Katund i Ri

12.1.1 Analiza e kontekstit dhe e skenarit të riskut

Vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë në nivel vendor përbën një element të rëndësishëm për planifikimin dhe menaxhimin e emergjencave civile, si dhe për kufizimin e pasojave të mundshme mbi popullsinë, infrastrukturën, ekonominë dhe mjedisin.

Bashkia Durrës është e ekspozuar ndaj përmbytjeve për shkak të pozicionit gjeografik, pranisë së zonave të ulëta, karakteristikave të pellgjeve ujëmbledhëse të lumenjve Erzen dhe Ishëm, urbanizimit dhe kufizimeve të sistemeve të kullimit dhe drenazhimit.

Një nga skenarët kryesorë të riskut për territorin e Bashkisë Durrës është përmbytja nga lumi Erzen, e cila mund të prekë veçanërisht zonat përgjatë lumit, përfshirë Sukthin dhe Katundin e Ri. Rreziku mund të përkeqësohet nga reshjet e dendura e të vazhdueshme, rritja e prurjeve lumore, dalja e ujit nga shtrati dhe dëmtimi ose tejkalimi i kapacitetit të argjinaturave.

Skenari i paraqitur në këtë kapitull shërben për të vlerësuar pasojat e mundshme të një përmbytjeje të konsiderueshme nga lumi Erzen dhe për të përcaktuar masat që duhet të ndërmerren nga strukturat përgjegjëse për paralajmërimin, gatishmërinë, reagimin dhe rimëkëmbjen.

12.1.2 Ndikimet e një përmbytjeje në territorin e Bashkisë Durrës

Skenari parashikon një periudhë me reshje të dendura që përfshijnë pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen dhe shkaktojnë rritje të prurjeve dhe të nivelit të ujit. Nëse prurjet tejkalojnë kapacitetin e përcjelljes së lumit dhe të veprave mbrojtëse, mund të ndodhin përmbytje në zonat e ulëta dhe të banuara përgjatë tij.

Si pasojë, mund të preken banesa, biznese, toka bujqësore, rrugë dhe infrastruktura të tjera. Përmbytja mund të kufizojë lëvizjen e automjeteve dhe aksesin e shërbimeve të emergjencës, si dhe të shkaktojë ndërprerje të përkohshme të energjisë elektrike, furnizimit me ujë dhe komunikimeve.

Për qëllime të planifikimit, skenari mbështetet në parametrat e mëposhtëm:

- Sipërfaqja e mundshme e përmbytur: rreth 2,370 ha (1,061 ha në Sukth dhe 1,309 ha në Katund i Ri), sipas gjurmës së përmbytjes së janarit 2026 të përdorur në ushtrimin e 13 tetorit 2026.
- Numri i ndërtesave të prekura: 788 (275 në Sukth dhe 513 në Katund i Ri), kryesisht banesa; në zonën më të gjerë të paralajmërimit (brezi 500 m) ndodhen 1,722 ndërtesa.
- Numri i bizneseve të prekura: nuk disponohet regjistër sipas vendndodhjes; vlerësohet nga NjA-të gjatë vlerësimit të shpejtë dhe shtohet në regjistrin e dëmeve.
- Popullsia e ekspozuar ndaj përmbytjes: rreth 2,300 persona në gjurmën e përmbytjes dhe rreth 5,320 persona në zonën e paralajmërimit.
- Popullsia që mund të ketë nevojë për evakuim: 550 deri 850 persona (në janar 2026 Bashkia raportoi rreth 543 të evakuuar, ndërsa raportimet arritën deri në 848); nevoja për strehim publik planifikohet për deri në 260 persona.
- Gjatësia e segmenteve rrugore të prekura: rreth 22 km (14 km në Sukth dhe 8 km në Katund i Ri).
- Koha e parashikuar e mbërritjes së ujit: 8-10 orë nga fillimi i reshjeve intensive në pellgun e Erzenit; paralajmërimi meteorologjik i IGJEO-s jepet zakonisht 24-48 orë përpara.
- Dëmet e mundshme: si referencë, për ngjarjet e fillimit të vitit 2025 u kompensuan 431 banesa me një fond prej 121.4 milionë lekësh; dëmtohen gjithashtu rrugë rurale, kanale kulluese, toka bujqësore dhe rrjeti elektrik.

Vlerat mbështeten në gjurmën e ngjarjes së janarit 2026, në VRF dhe në bazën GIS të planit. Ato rishikohen kur të jenë në dispozicion hartat zyrtare të përmbytjes T=10, 50 dhe 100 vjet.

12.1.3 Nevojat humanitare të popullsisë së prekur

Përmbytja e mundshme e zonave të banuara përgjatë lumit Erzen mund të krijojë nevojë për evakuimin dhe akomodimin e përkohshëm të familjeve të prekura. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara, fëmijëve, personave me probleme shëndetësore dhe individëve që nuk kanë mundësi të sigurojnë vetë transportin.

Nevojat kryesore humanitare mund të përfshijnë:

- Evakuimin dhe transportin e sigurt të popullsisë.
- Sigurimin e ambienteve të përkohshme të pritjes dhe strehimit.
- Furnizimin me ujë të pijshëm, ushqime, veshmbathje dhe artikuj higjienikë.
- Ofrimin e ndihmës së parë dhe shërbimeve shëndetësore.
- Mbështetjen sociale dhe psikologjike për personat e prekur.

- Sigurimin e informacionit të saktë dhe në kohë për popullsinë.

Numri i personave që mund të kenë nevojë për evakuim dhe kapacitetet e nevojshme të strehimit do të përcaktohen në bazë të popullsisë së ekspozuar, shtrirjes së përmbytjes dhe kapaciteteve të konfirmuara të strukturave pritëse.

12.1.4 Funksionet operacionale për menaxhimin e emergjencës

Menaxhimi i një përmbytjeje nga lumi Erzen fillon me monitorimin e kushteve meteorologjike dhe hidrologjike dhe me marrjen e paralajmërimeve nga institucionet përgjegjëse.

Në fazën e parë, strukturat e Bashkisë Durrës dhe njësitë administrative të prekura monitorojnë situatën, verifikojnë informacionin në terren dhe vlerësojnë zonat me rrezik të shtuar. Në varësi të paralajmërimeve dhe gjendjes së lumit, aktivizohen procedurat e gatishmërisë dhe njoftohen strukturat përgjegjëse.

Nëse niveli i ujit vazhdon të rritet dhe rrezikohen banesa ose infrastruktura, Bashkia organizon vlerësimin e situatës, koordinon burimet vendore dhe merr masat e nevojshme për paralajmërimin dhe mbrojtjen e popullsisë. Kur plotësohen kushtet për evakuim, përcaktohen zonat që duhet të evakuohen, rrugët e sigurta, mjetet e transportit dhe vendet e pritjes.

Në rast të daljes së lumit nga shtrati ose dëmtimit të argjinaturave, strukturat e emergjencës ndërhyjnë sipas kompetencave dhe kapaciteteve të tyre, duke i dhënë përparësi shpëtimit të jetës, sigurisë së personelit dhe ruajtjes së aksesit për shërbimet e emergjencës.

Nëse burimet vendore nuk janë të mjaftueshme për përballimin e situatës, Bashkia dokumenton nevojat dhe kërkon mbështetjen e institucioneve përkatëse, nëpërmjet mekanizmave të përcaktuar në legjislacion dhe planet e emergjencave civile.

Pas tërheqjes së ujit, kryhen vlerësimi i dëmeve, pastrimi i zonave të prekura, kontrolli i sigurisë së infrastrukturës dhe verifikimi i cilësisë së ujit të pijshëm. Më pas përcaktohen prioritetet për rikthimin e shërbimeve dhe rehabilitimin e zonave të dëmtuara.

12.1.5 Institucionet, strukturat dhe organizatat e përfshira në përgjigje

Në nivel bashkie:

- **Kryetari i Bashkisë Durrës dhe strukturat vendimmarrëse:** drejtojnë vendimmarrjen dhe aktivizimin e masave sipas kompetencave ligjore.
- **Struktura e Mbrojtjes Civile dhe Qendra Operacionale e Emergjencave Civile, sipas organizimit dhe procedurave në fuqi:** koordinojnë informacionin, monitorimin e situatës, raportimin dhe angazhimin e burimeve vendore.
- **Njësitë administrative Sukth dhe Katund i Ri:** mbledhin dhe përcjellin informacionin nga terreni, identifikojnë familjet e rrezikuara dhe mbështesin paralajmërimin e popullsisë.
- **Shërbimi zjarrfikës dhe shpëtimi:** ndërhyn për shpëtimin e personave, evakuimin dhe operacionet e tjera brenda kapaciteteve dhe kompetencave të veta.
- **Shërbimet sociale:** identifikojnë personat në nevojë dhe organizojnë mbështetjen sociale dhe akomodimin e përkohshëm.
- **Shërbimet shëndetësore:** ofrojnë ndihmën e parë dhe trajtimin e rasteve urgjente.
- **Strukturat e shërbimeve publike dhe infrastrukturore:** mbështesin vlerësimin dhe rikthimin e funksionimit të rrugëve, kullimit, energjisë dhe furnizimit me ujë, sipas përgjegjësive përkatëse.
- **Policia dhe strukturat e tjera të rendit:** mbështesin kontrollin e trafikut, sigurinë e zonave të rrezikuara dhe evakuimin sipas kompetencave.

Në nivel qarku dhe kombëtar:

- **Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës:** koordinon funksionet që i ngarkon kuadri ligjor dhe përcjell nevojat e bashkisë sipas procedurave përkatëse.
- **Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC):** mbështet koordinimin dhe përballimin e situatave që kërkojnë kapacitete përtej nivelit vendor, sipas kompetencave ligjore.
- **Institucionet përgjegjëse për monitorimin meteorologjik dhe hidrologjik:** sigurojnë paralajmërime dhe informacion teknik për reshjet, prurjet dhe rrezikun e përmbytjes.
- **Institucionet dhe operatorët përgjegjës për infrastrukturën:** mbështesin vlerësimin e dëmeve dhe ndërhyrjet në sistemet e energjisë, ujësjellës-kanalizimeve, kullimit dhe infrastrukturës rrugore.
- **Forcat e Armatosura dhe strukturat e tjera mbështetëse:** angazhohen kur kërkohet dhe autorizohet mbështetja, në përputhje me procedurat ligjore.

12.1.6 Kronologjia e veprimeve

Kronologjia e veprimeve për skenarin e përmbytjes së Erzenit

Pragu / koha	Veprimet kryesore	Përgjegjës
Paralajmërim portokalli ose i kuq i IGJEO-s (T-48 deri T-24 orë)	Etapa I; verifikim i kanaleve dhe hidrovorëve; njoftim i NjA Sukth dhe Katund i Ri; kontroll i gatishmërisë së varkave, pompave dhe gjeneratorëve	Sektori i MC, NjA, MZSH
Rritje e nivelit të Erzenit (T-12 orë)	Etapa II; mbledhje e KMCB; aktivizim i QOECB; vrojtues në argjinaturë; informim i publikut me zonën, veprimin dhe orën e përditësimit	Kryetari, KMCB, QOECB
Rrezik i afërt për banesat (T-6 orë)	Evakuim parandalues i personave që kërkojnë asistencë sipas regjistrit; hapje e strehimeve jashtë zonës; mbyllje e rrugëve në zonat e ulëta	NjA, Shërbimet Sociale, Policia Bashkiake, Policia e Shtetit
Dalje e lumit nga shtrati (T0)	Etapa III; evakuim i zonave të prekura; kërkim-shpëtim me varka; kontroll i trafikut; raport i parë te Prefekti brenda 1 ore	DOB, MZSH, Policia e Shtetit, QOECB
T+6 deri T+24 orë	Regjistrim në strehime; ujë, ushqim dhe ndihmë mjekësore; vlerësim i shpejtë i dëmeve; kërkesë për mbështetje kur kapacitetet nuk mjaftojnë	QOECB, Shërbimet Sociale, NjVKSH, KKSH
T+24 deri T+72 orë	Pompim dhe pastrim; kontroll i ujit të pijshëm; dezinfektim; kthim i kontrolluar i banorëve; kalim në Etapën IV dhe rimëkëmbje	Ndërmarrja "Rruga", NSHK, Ujësjellësi, NjVKSH

Burimi: PVEC, kapitulli 8; mësimet e ushtrimit të 13 tetorit 2026.

12.2 Skenari B: Tërmet i fortë në qytetin e Durrësit

Skenari përfaqëson një tërmet të krahasueshëm me atë të 26 nëntorit 2019 (Mw 6.4), me epiqendër pranë bregut dhe në orët e natës (skenari SZ-2 i VRF-së). Gjasat janë të ulëta, por pasojat janë katastrofike për shkak të dendësisë së ndërtimit, depozitimeve të buta bregdetare, potencialit për lëngëzim dhe cenueshmërisë së fondit të vjetër dhe informal. Në sezonin turistik pasojat do të ishin më të mëdha.

Parametrat dhe ndikimet e pritshme të skenarit të tërmetit

Elementi	Vlera për planifikim
Ngjarja referuese	Tërmeti i 26 nëntorit 2019: 25 viktima në Durrës, mijëra të pastrehë, shembje e disa pallateve dhe hoteleve bregdetare
Zonat më të prekura	NjA Durrës (IR sizmik 6.6) dhe Sukth (6.1); zona bregdetare jugore me lëngëzim; fondi informal në periferi
Popullsia rezidente e ekspozuar	153,614 banorë (Census 2023), nga të cilët rreth dy të tretat në qytet; plus vizitorët në sezon
Ndërtesa	41,479 ndërtesa në bazën GIS; 23,036 në NjA Durrës
Nevoja për strehim	Disa mijëra persona për javë të tëra; kapaciteti aktual është rreth 200 vende në 2 strehime
Infrastruktura kritike	Spitali Rajonal, porti dhe depozitat e Porto Romanos, urat dhe mbikalimet, hidrovorët, rrjeti i ujit dhe i energjisë
Efektet zinxhir	Zjarre, rrjedhje në depozita, ndërprerje energjie dhe uji; mundësi cunami për tërmet në det

Burimi: VRF Bashkia Durrës (2026); PDNA (2020); baza GIS e planit.

Kronologjia e veprimeve për skenarin e tërmetit

Koha	Veprimet kryesore	Përgjegjës
0-1 orë	Vetëmbrojtje dhe largim në pikat e grumbullimit (Aneksi 8); aktivizim automatik i KMCB dhe QOECB (në vendndodhjen alternative nëse godina është e dëmtuar); raport i parë te Prefekti dhe QKOEC	Kryetari, QOECB, NjA

Koha	Veprimet kryesore	Përgjegjës
1-6 orë	Kërkim-shpëtim në ndërtesat e shembura; kërkesë e menjëhershme për ekipe USAR nga niveli qendror; triazh dhe transport i të plagosurve; mbyllje e zonave të rrezikshme; kontroll i depozitave të Porto Romanos	MZSH, Policia, SHUM, Spitali Rajonal, operatorët
6-24 orë	Hapje e pikave të grumbullimit dhe e strehimeve pas kontrollit të shpejtë strukturor; ujë, ushqim dhe batanije; informim i rregullt i publikut; regjistrim i të zhvendosurve	QOECB, Shërbimet Sociale, KKSH, inxhinierët
24-72 orë	Vlerësim i shpejtë i ndërtesave (jeshile, e verdhë, e kuqe); kampe të përkohshme në pikat e grumbullimit me kapacitet më të madh; rikthim i ujit dhe energjisë	Komisionet e vlerësimit, AKMC, operatorët
Mbi 72 orë	Strehim afatmesëm; vlerësim i dëmeve dhe nevojave; mbështetje psikosociale; kalim në rimëkëmbje	Bashkia, Prefekti, AKMC

Burimi: PVEC, kapitujt 8-11.

Kapaciteti aktual i strehimit nuk mjafton për këtë skenar. Bashkia duhet të paraqesë kërkesë për tenda, krevate dhe artikuj të ndihmës te Prefekti dhe AKMC menjëherë pas vlerësimit fillestar, ndërsa hapësirat më të mëdha të grumbullimit (p.sh. PG-01 deri PG-05) planifikohen si vende për kampe të përkohshme. Hapësirat pranë bregut (PG-01, PG-04, PG-06, PG-13) nuk përdoren nëse ka paralajmërim për cunami.

12.3 Skenari C: Aksident teknologjik në Porto Romano

Skenari përfaqëson një zjarr, shpërthim ose rrjedhje në depozitat e hidrokarbureve dhe të LPG-së në Porto Romano (TK-1), i shkaktuar nga dështim teknik, aksident gjatë transferimit ose nga një tërmet. Në zonë ndodhen 53 depozita me kapacitet magazinimi mbi 399 mijë m³; brenda 500 m ndodhen 4,871 ndërtesa, ndërsa brenda 1 km 37 shkolla dhe 8 objekte shëndetësore.

Veprimet kryesore për skenarin Natech në Porto Romano

Faza	Veprimet kryesore	Përgjegjës
Njoftimi	Operatori njofton menjëherë 112/128, Bashkinë dhe Prefektin; QOECB merr informacion për substancën, sasinë dhe drejtimin e erës	Operatori, MZSH, QOECB
Mbrojtja e popullsisë	Zonë sigurie 500 m me evakuim të menjëhershëm; deri në 1 km strehim në vend (dyer e dritare të mbyllura) ose evakuim sipas vlerësimit të MZSH-së; njoftim i shkollave dhe objekteve shëndetësore	MZSH, Policia e Shtetit, NjA, Zëdhënësi
Kontrolli i zonës	Mbyllje e aksit port-Porto Romano; devijim i trafikut të rëndë; kordon sigurie	Policia e Shtetit, Policia Bashkiake
Mjedisi dhe shëndeti	Monitorim i ajrit dhe i ujit; kufizim i ndotjes në det dhe në kanale; trajtim i të intoksikuarve	ARM, AKM, NjVKSH, Autoriteti Portual
Përshkallëzimi	Kërkesë për mbështetje të specializuar (materiale të rrezikshme) nga AKMC-ja; koordinim me QNOD për ndotjen detare	DOB, Prefekti, AKMC

Burimi: VRF Bashkia Durrës (2026); PKEC.

Për këtë skenar Bashkia duhet të hartojë, bashkë me operatorët, një protokoll të përbashkët njoftimi dhe një plan të jashtëm emergjence për Porto Romanon, si dhe të zhvillojë një ushtrim në tavolinë brenda vitit 2027.

Kapitulli 13. Referencat dhe anekset

Referencat ligjore dhe dokumentare.

Referencat ligjore.

1. Ligji nr. 45/2019, datë 18.07.2019, "Për mbrojtjen civile".
2. Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
3. VKM nr. 88, datë 22.02.2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030".
4. VKM nr. 94, datë 22.02.2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023–2030 dhe Planit të Veprimit".
5. VKM nr. 168, datë 24.03.2023, "Për miratimin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror".

Implemented by giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MJEDISIT
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MBROJTJES

6. VKM nr. 807, datë 28.12.2023, "Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile".
7. Aktet e tjera nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile".
8. Ligji nr. 97/2019, "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, 'Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore'".
9. Ligji nr. 75/2016, "Për miratimin e Marrëveshjes së Parisit".
10. Ligji nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike".

2. Dokumentet strategjike dhe teknike në nivel vendor

1. Bashkia Durrës, *Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Vendor*, draft, 2026.
2. Bashkia Durrës, *Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë*, draft, 2026.
3. Bashkia Shijak, *Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Vendor*, draft, 2026.
4. Bashkia Shijak, *Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë*, draft, 2026.
5. Bashkia Krujë, *Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Vendor*, draft, 2026.
6. Bashkia Krujë, *Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë*, draft, 2026.

3. Referencat dokumentare.

1. Kombet e Bashkuara, *Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015–2030* (Sendai Framework for Disaster Risk Reduction 2015–2030).
2. Kombet e Bashkuara, *Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm*, miratuar në Samitin e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork, më 25–27 shtator 2015.
3. *Qeveria e Shqipërisë, me mbështetjen e BE-së, Kombeve të Bashkuara dhe Bankës Botërore, Albania Post-Disaster Needs Assessment, Volume A: Report, Tiranë, shkurt 2020.*
4. *Comprehensive Preparedness Guide (CPG) 101: Developing and Maintaining Emergency Operations Plans*, Version 3.0, shtator 2021.

Anekset operative

Aneks 1: Zonë e mbuluar për strehimin e popullsisë

ZONË E MBULUAR PËR STREHIMIN E POPULLSISË			
Emri i Zonës:			
Koordinatat			
Rrugët e Aksesit			
Nënkalime		**Prania e kufizimeve në masë dhe/ose hapësirë për automjetet e rënda**	
Karakteristikat e Përgjithshme të Zonës			
Energjia Elektrike		**Rrjeti Internet / WiFi**	
Gaz		**Linja Telefonike Fikse**	
Uji i Pijshëm		**Sinjal Celular**	
Kanalizime			
Tiparet e Ndërtimit			
Pronësia e Zonës			
Përdorimi i Synuar			
Sipërfaqja			

Aneks 2: Zonë e hapur për strehimin e popullsisë

ZONË E HAPUR PËR STREHIMIN E POPULLSISË			
Emri i Zonës:			
Koordinatat			
Rrugët e Aksesit			
Nënkalime		**Prania e kufizimeve në masë dhe/ose hapësirë për automjetet e rënda**	
Karakteristikat e Përgjithshme të Zonës			
Energjia Elektrike		**Rrjeti Internet / WiFi**	
Gaz		**Linja Telefonike Fikse**	
Uji i Pijshëm		**Sinjal Celular**	
Kanalizime			
Tiparet e Ndërtimit			
Pronësia e Zonës			
Përdorimi i Synuar			
Sipërfaqja			

Aneks 3: Raportimi fillestar i emergjencës

Bashkia:

Data: ___ / ___ / _____ **Ora:** __ : ___ **Raporti Nr/datë:** _____

Shkaku i Emergjencës:

□ Përmbytje	□ Zjarre në pyje	□ Ndotje
□ Tërmet	□ Zjarre Urbane/Industriale	□ Diga
□ Rreshkitje toke	□ Incident	□ Të tjera _____
□ Stuhi	□ Aksident Industrial	

Vendi i origjinës së emergjencës (adresa, vendndodhja, detaje kontakti):

_____
_____
_____

Përshkrim i shkurtër i zonës në fjalë:

_____
_____
_____

Përshkrim i shkurtër i situatës:

_____
_____
_____
_____

Popullsia

Përfshirë	Mungojnë	Vdekur	Dëmtuar	Zhvendosur	Të tjera (përshkruaj)
n.	n.	n.	n.	n.	

Dëmtim rruge

Tipi i rrugës	Emri	Vendi	Vendndodhja e izoluar	Shënim
□ Kryesore □ Sekondare				
□ Kryesore □ Sekondare				
□ Kryesore □ Sekondare				

Implemented by giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MJEDISIT
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MBROJTJES

□ Kryesore □ Sekondare				

Kushtet atmosferike

Dukshmëria	**Erërat**	**Retë**
□ Qartë - □ 500 m - □ 100 m	□ Mungojnë □ E lehtë □ E fortë	□ Mungon □ Pranishme □ Shi

Strukturat e përfshira:

□ Shtëpi	□ Fermë	□ Shkollë	□ Stacion Policie
□ Hotel/Fshat	□ Fabrikë	□ Spital	□ Stacion Zjarrfikëse

Burimet:

Aktivizuar	**Kërkuar**

Emri _____ **Numër telefoni** _____

Veprimet kryesore të ndërmarra:

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

Harta:



Aneks 4: Formulari standard i kërkesës për mbështetje

I. TË DHËNAT E KËRKESËS

Nr. i kërkesës: _____ **Data:** ____ / ____ / _____ **Ora:** _____ **Niveli/faza e situatës:** _____ **Ngjarja/rreziku:** _____

II. INSTITUCIONI KËRKUES

Institucioni: Bashkia_____ **Struktura/Sektori i Mbrojtjes Civile/ Qendra Operacionale e Emdrgjencave Civile:** _____ **Personi përgjegjës:** _____ **Funksioni:** _____ **Telefon:** _____ **E-mail:** _____

III. DREJTUAR

☐ Bashkisë së _____ ☐ Prefektit të Qarkut Durrës ☐ Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) ☐ Institucionit qendror kompetent: _____ ☐ Institucionit/strukturës tjetër: _____

Personi i kontaktit, nëse është i njohur: _____

IV. PËRSHKRIMI I SITUATËS

Përshkrim i shkurtër i ngjarjes dhe situatës aktuale:

_____
_____
_____

Zona/territori i prekur:

_____

Data dhe ora e konstatimit: _____

Burimi i informacionit: ☐ Vlerësim në terren ☐ Monitorim instrumental ☐ Paralajmërim zyrtar ☐ Raportim nga strukturat operative ☐ Raportim nga qytetarët/vullnetarët ☐ Tjetër: _____

V. VLERËSIMI I PASOJAVE DHE I NEVOJËS

Pasojat e evidentuara:

☐ Persona të rrezikuar ☐ Persona të evakuuar ☐ Persona të lënduar ☐ Banesa/objekte të dëmtuara ☐ Rrugë/akse të bllokuara ☐ Infrastrukturë kritike e dëmtuar ☐ Ndërprerje e furnizimit me ujë ☐ Ndërprerje e energjisë elektrike ☐ Tjetër: _____

Vlerësimi i shkurtër i situatës dhe nevojës:

_____
_____

VII. BOSHLLËKU I KAPACITETEVE

Kapaciteti që mungon dhe që nuk mund të sigurohet me burimet në dispozicion të Bashkisë:

_____

_____

_____

VIII. MBËSHTETJA E KËRKUAR

Nr.	Lloji i burimit/mbështetjes	Sasia	Specifikimi teknik/funksional	Vendi i përdorimit	Afati i nevojshëm

Kërkesa duhet të përcaktojë qartë llojin, sasinë dhe karakteristikat e burimit të nevojshëm.

IX. AFATI DHE PRIORITETI

Mbështetja nevojitet deri më: ____ / ____ / _____, ora _____

Kohëzgjatja e parashikuar e nevojës: _____

Prioriteti:

☐ **Urgjent** – nevojitet ndërhyrje e menjëhershme ☐ **I lartë** – nevojitet brenda _____ orësh ☐ **Normal** – nevojitet brenda _____ orësh

X. VENDI I MBËRRITJES DHE KOORDINIMIT

Vendndodhja ku kërkohet mbështetja:

_____

Pikë takimi/mbledhjeje: _____

Personi përgjegjës për pritjen dhe koordinimin:

Emër/Mbiemër: _____

Funksioni: _____

Telefon: _____

XI. DËRGIMI DHE REGJISTRIMI I KËRKESËS

Mënyra e dërgimit:

☐ Telefon ☐ E-mail ☐ Sistem/platformë elektronike ☐ Shkresë zyrtare ☐ Radio/komunikim operacional ☐ Tjetër: _____

Data/ora e dërgimit: _____

Personi që dërgoi kërkesën: _____

Implemented by giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MJEDISIT
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MBROJTJES

Aneks 5: Model shkrese për kërkesë për mbështetje

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA_____

Nr. _____ Prot. _____, më ____ / ____ / _____

Drejtuar: _____

Lënda: Kërkesë për mbështetje për përballimin e situatës _____

Në vijim të situatës së krijuar nga _____, në territorin e Bashkisë _____, bazuar në informacionin e disponueshëm dhe në vlerësimin e kryer nga strukturat përgjegjëse, është konstatuar se kapacitetet e disponueshme në nivel vendor nuk janë të mjaftueshme për përballimin e nevojave të evidentuara.

Nga vlerësimi i situatës rezulton se:

Zona e prekur: _____

Përshkrimi i situatës dhe pasojave:

_____

_____
_____

Kapacitetet e disponueshme të Bashkisë:

_____
_____
_____
_____
_____

Boshllëku i identifikuar:

_____
_____
_____
_____
_____

Për sa më sipër, kërkojmë mbështetjen tuaj për sigurimin e burimeve/kapaciteteve të mëposhtme:

Nr.	**Artikulli/Shërbimi i kërkuar**	**Njësia e matjes**	**Sasia**	**Përshkrimi/specifikimi**	**Vendi i përdorimit**	**Afati i nevojshëm**
	Gjenerator	cope	2	50 kVA, me karburant	Durrës zona x	2 ore

Mbështetja kërkohet të jetë e disponueshme, sipas mundësive dhe kompetencave tuaja, deri më **____ / ____ / _____, ora _____**, për një kohëzgjatje të parashikuar prej _____.

Pika e mbërritjes/koordinimit: _____

Personi i kontaktit në Bashkinë _____: _____

Funksioni: _____ **Tel.:** _____

Ju lutemi të na konfirmoni mundësinë e sigurimit të mbështetjes së kërkuar dhe, nëse është e mundur, kohën e parashikuar të mbërritjes.

Faleminderit për bashkëpunimin dhe mbështetjen.

KRYETARI I BASHKISË

Aneks 6: Skema e njoftimit dhe e lajmërimit në rast fatkeqësie



Aneks 7: Tabelat e kapaciteteve njerëzore dhe logjistike

Tabela e kapaciteteve, kategoria për akomodim

Nr.	Emri i subjektit	Lloji i Akomodimit/ Hotel/ apartament/shtëpi	Adresa/ Vendodhja	Numër dhomash	Numër krevatesh	Numër Telefoni	Adresa e-mail

Tabela e kapaciteteve, kategoria për akomodim

Nr.	Emërtimi i drejtorive, institucioneve dhe i ndërmarrjeve shtetërore që veprojnë në juridiksionin e bashkisë	Adresa	Drejtuesi	Numri i telefonit	Adresa e-mail	Emërtimi	Njësia e matjes	Sasia	Parametra teknike

Tabela e kapaciteteve, kategoria për akomodim – Ambjente të hapura

Nr.	Emri i subjektit /Shteteror ose privat	Lloji i Akomodimit/ Ambiente te hapura	Adresa/ Vendodhja	Siperfaqja	Numer Telefoni	Adresa e-mail
1						
2						

Tabela e kapaciteteve private që mund të angazhohen në parandalimin dhe përgjigjen ndaj emergjencave/fatkeqësive. Kategoria: Automjete

Nr.	Subjekti privat	Adresa	Drejtuesi	Numri i telefonit	Adresa e-mail	Emertimi i Automjetit	Lloji/ Kapaciteti	Targa	Parametrat teknik	Drejtuesi/ Perdoruesi i Mjetit	Numri i telefonit te Drejtuesi/ Perdoruesi i Mjetit

Tabela e kapaciteteve shtetërore që mund të angazhohen në parandalimin dhe përgjigjen ndaj emergjencave/fatkeqësive. Kategoria: Automjete

Nr.	Emërtimi i drejtorive, institucioneve dhe i ndërmarrjeve të bashkise	Adresa	Drejtuesi	Numri i telefonit	Adresa e-mail	Emërtimi i Automjetit	Lloji/ Kapaciteti	Targa	Parametrat teknik	Drejtuesi/ Përdoruesi i Mjetit	Numri i telefonit te Drejtuesi/ Përdoruesi i Mjetit
1											
2											
Nr.	**Emërtimi i drejtorive, institucioneve dhe i ndërmarrjeve shtetërore qe veprojnë në territorin e bashkisë**	**Adresa**	**Drejtuesi**	**Numri i telefonit**	**Adresa e-mail**	**Emërtimi i Automjetit**	**Lloji/ Kapaciteti**	**Targa**	**Parametrat teknik**	**Drejtuesi/ Përdoruesi i Mjetit**	**Numri i telefonit te Drejtuesi/ Përdoruesi i Mjetit**

Tabela e kapaciteteve që mund të angazhohen në përgjigjen ndaj emergjencave /fatkeqësive. Kategoria. Komunikimet

Nr.	Emërtimi i drejtorive, institucioneve dhe i ndermarrjeve shteterore qe veprojne ne juridiksionin e bashkise	Adresa	Drejtuesi	Numri i telefonit	Adresa e-mail	Emertimi	Njesia e matjes	Sasia	Parametra teknike

Tabela e kapaciteteve që mund të angazhohen në përgjigjen ndaj emergjencave/fatkeqësive. Kategoria – Komunikimet

Nr.	Emërtimi i subjektit privat.	Adresa	Drejtuesi	Numri i telefonit	Adresa	Emertimi	Njesia e matjes	Parametra teknike

Tabela e kapaciteteve që mund të angazhohen në përgjigjen ndaj emergjencave/ fatkeqësive. Kategoria – Ambientet

Nr.	Emërtimi i drejtorive, institucioneve dhe i ndermarrjeve shteterore qe veprojne ne territorin e bashkise	Ambientet	Adresa	Drejtuesi	Numri i telefonit	Adresa e-mail

Nr.	**Emërtimi i subjektit privat**	**Ambientet**	**Adresa**	**Drejtuesi**	**Numri i telefonit**	**Adresa e-mail**
Nr.	**Bashkia/Njësia administrative**	**Ambientet**	**Adresa**	**Drejtuesi**	**Numri i telefonit**	**Adresa e-mail**

Tabela e kapaciteteve që mund të angazhohen në përgjigjen ndaj emergjencave/fatkeqësive. Kategoria Personeli (Fuqia punëtore)

Nr.	**Kryqi i Kuq, OJF të ndryshme, të besimit/ fetare, etj.,**	**Adresa**	**Drejtuesi**	**Numri i telefonit**	**Adresa e-mail**	**Numri total i personelit**	**Nga numri total angazhohen në rast emergjence**	
							Drejtues ose menaxherë	**Personel reagues**

Implemented by giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MJEDISIT
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MBROJTJES

Nr.	Emërtimi i drejtorive, institucioneve dhe i ndërmarrjeve shtetërore që veprojnë në territorin e bashkisë	Adresa	Drejtuesi	Numri i telefonit	Adresa e-mail	Numri total i personelit	Nga numri total angazhohen në rast emergjence	
							Drejtues ose menaxherë	Personel reagues
Nr.	Emërtimi i drejtorive, institucioneve dhe i ndërmarrjeve të bashkise	Adresa	Drejtuesi	Numri i telefonit	Adresa e-mail	Numri total i personelit	Nga numri total angazhohen në rast emergjence	
							Drejtues ose menaxherë	Personel reagues
Nr.	Emërtimi i subjektit privat	Adresa	Drejtuesi	Numri i telefonit	Adresa e-mail	Numri total i personelit	Nga numri total angazhohen në rast emergjence	
							Drejtues ose menaxherë	Personel reagues

Tabela e kapaciteteve që mund të angazhohen në përgjigjen ndaj emergjencave/fatkeqësive. Kategoria. Furnizime dhe materiale të konsumit

Nr.	OJF te ndryshme, fetare, komunitare etj.	Adresa	Drejtuesi	Numri i telefonit	Adresa e-mail	Emërtimi i Artikullit	Njësia e matjes	Sasia
Nr.	**Emërtimi i drejtorive, institucioneve dhe i ndërmarrjeve të bashkisë**	**Adresa**	**Drejtuesi**	**Numri i telefonit**	**Adresa e-mail**	**Emërtimi i Artikullit**	**Njësia e matjes**	**Sasia**
Nr.	**Emërtimi i drejtorive, institucioneve dhe i ndërmarrjeve shtetërore që veprojnë në territorin e bashkisë**	**Adresa**	**Drejtuesi**	**Numri i telefonit**	**Adresa e-mail**	**Emërtimi i Artikullit**	**Njësia e matjes**	**Sasia**

Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MJEDISIT
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MBROJTJES

Nr.	**Emërtimi i Subjektit Privat**	**Adresa**	**Drejtuesi**	**Numri i telefonit**	**Adresa e-mail**	**Emërtimi i Artikullit**	**Njësia e matjes**	**Sasia**

Tabela e kapaciteteve që mund të angazhohen në përgjigjen ndaj emergjencave/ fatkeqësive. Kategoria Pajisje

Nr.	**OJF te ndryshme.**	**Adresa**	**Drejtuesi**	**Numri i telefonit**	**Adresa e-mail**	**Lloji i pajisjes/makinerisë**	**Njësia e matjes/ copë**	**Kapaciteti/parametra teknike**
Nr.	**Emërtimi i drejtorive, institucioneve dhe i ndërmarrjeve të bashkisë**	**Adresa**	**Drejtuesi**	**Numri i telefonit**	**Adresa e-mail**	**Lloji i pajisjes/makinerisë**	**Njësia e matjes/ copë**	**Kapaciteti/parametra teknike**

Nr.	**Emërtimi i drejtorive, institucioneve dhe i ndërmarrjeve shtetërore që veprojnë në territorin e bashkisë**	**Adresa**	**Drejtuesi**	**Numri i telefonit**	**Adresa e-mail**	**Lloji i pajisjes/makinerisë**	**Njësia e matjes/ copë**	**Kapaciteti/parametra teknike**
Nr.	**Emërtimi i Subjektit Privat**	**Adresa**	**Drejtuesi**	**Numri i telefonit**	**Adresa e-mail**	**Lloji i pajisjes/makinerisë**	**Njësia e matjes/ copë**	**Kapaciteti/parametra teknike**

Aneks 8: Pikat e grumbullimit dhe strehimet e propozuara

Kodet PG dhe ST përdoren në hartat 9.1–9.3 dhe në Aneksin 9, në njoftimet publike dhe në raportet e QOECB-së. Lista është kandidate dhe konfirmohet nga NjA-të pas verifikimit në terren të aksesit, sigurisë, ujit, ndriçimit dhe sanitareve. Kapacitetet janë orientuese dhe janë llogaritur sipas kritereve të seksionit 9.7. Hapësirat PG-08 dhe PG-16 ndodhen brenda PG-02 dhe nuk numërohen veçmas, prandaj kodet PG-01 deri PG-41 mbulojnë 39 hapësira të dallueshme.

Pikat e grumbullimit kandidate (hapësira publike sipas planit të përdorimit të tokës)

Kodi	NjA	Lloji	Vendndodhja	Sipërfaqja (m²)	Kapaciteti afatshkurtër	Kapaciteti për kamp	Kufizime
PG-01	Durrës	Hapësirë rekreative	zona Arapaj	174,503	52,350	3,870	Jo për cunami ose stuhi detare
PG-02	Durrës	Hapësirë rekreative	pranë shk. Naim Frashëri	77,461	23,200	1,720	-
PG-03	Durrës	Hapësirë rekreative	pranë shk. Met Hasa	58,804	17,600	1,300	-
PG-04	Durrës	Hapësirë rekreative	zona bregdetare	45,020	13,500	1,000	Jo për cunami ose stuhi detare
PG-05	Durrës	Hapësirë rekreative	zona e Ndërmarrjes Frutore	33,940	10,150	750	-
PG-06	Durrës	Hapësirë rekreative	zona Spitallë	33,761	10,100	750	Verifiko për përmbytje (EMSR856); Jo për cunami ose stuhi detare
PG-07	Durrës	Hapësirë rekreative	zona Spitallë	28,691	8,600	630	Verifiko për përmbytje (EMSR856)
PG-08	Durrës	Hapësirë rekreative	pranë shk. Leonik Tomeo	26,242	7,850	580	Brenda PG-02; kapaciteti nuk mblidhet veçmas
PG-09	Durrës	Hapësirë rekreative	pranë shk. Met Hasa	23,611	7,050	520	-
PG-10	Durrës	Hapësirë rekreative	pranë shk. 14 Nëntori	23,284	6,950	510	-
PG-11	Durrës	Arsim	zona Spitallë	22,742	6,800	500	Verifiko për përmbytje (EMSR856)
PG-12	Durrës	Arsim	zona e Ndërmarrjes Frutore	21,130	6,300	460	-
PG-13	Durrës	Hapësirë rekreative	zona bregdetare	17,666	5,250	390	Jo për cunami ose stuhi detare
PG-14	Durrës	Arsim	zona e Ndërmarrjes Frutore	16,501	4,950	360	-
PG-15	Durrës	Hapësirë rekreative	zona Spitallë	15,838	4,750	350	Verifiko për përmbytje (EMSR856)
PG-16	Durrës	Hapësirë rekreative	pranë shk. Leonik Tomeo	15,390	4,600	340	Brenda PG-02; kapaciteti nuk mblidhet veçmas
PG-17	Rrashbull	Aktivitete sociale	zona Maliq Muço	8,176	2,450	180	-
PG-18	Rrashbull	Arsim	pranë shk. Vëllezërit Haradinaj	5,097	1,500	110	-
PG-19	Rrashbull	Hapësirë rekreative	pranë shk. Besnik Hidri	5,094	1,500	110	-
PG-20	Rrashbull	Arsim	zona Shënavlash	4,874	1,450	100	-
PG-21	Rrashbull	Hapësirë rekreative	zona Maliq Muço	4,768	1,400	100	-

Kodi	NjA	Lloji	Vendndodhja	Sipërfaqja (m²)	Kapaciteti afatshkurtër	Kapaciteti për kamp	Kufizime
PG-22	Rrashbull	Arsim	pranë shk. Besnik Hidri	4,258	1,250	90	-
PG-23	Sukth	Hapësirë rekreative	pranë shk. Perlat	14,372	4,300	310	-
PG-24	Sukth	Hapësirë rekreative	pranë shk. Njazi Mastori	12,027	3,600	260	-
PG-25	Sukth	Hapësirë rekreative	pranë shk. Hamallaj	8,001	2,400	170	-
PG-26	Sukth	Arsim	pranë shk. Njazi Mastori	7,835	2,350	170	-
PG-27	Sukth	Aktivitete sociale	pranë shk. Vadardhë	6,999	2,050	150	-
PG-28	Sukth	Hapësirë rekreative	pranë shk. Perlat	6,973	2,050	150	-
PG-29	Katund i Ri	Hapësirë rekreative	zona Rinia	37,268	11,150	820	Verifiko për përmbytje (EMSR856)
PG-30	Katund i Ri	Hapësirë rekreative	pranë shk. Bisht Kamëz	12,076	3,600	260	-
PG-31	Katund i Ri	Hapësirë rekreative	pranë shk. Katund i Ri	11,798	3,500	260	-
PG-32	Katund i Ri	Arsim	pranë shk. Qerret	6,107	1,800	130	-
PG-33	Katund i Ri	Arsim	pranë shk. Rinia	6,071	1,800	130	Verifiko për përmbytje (EMSR856)
PG-34	Katund i Ri	Hapësirë rekreative	zona Sukth	5,730	1,700	120	-
PG-35	Manëz	Arsim	pranë shk. Armath	7,862	2,350	170	-
PG-36	Manëz	Hapësirë rekreative	pranë shk. Manëz	6,958	2,050	150	-
PG-37	Manëz	Arsim	pranë shk. Riza Shera Radë	4,505	1,350	100	-
PG-38	Manëz	Arsim	pranë shk. Manëz	4,379	1,300	90	-
PG-39	Ishëm	Arsim	pranë shk. Adem Gjeli	5,306	1,550	110	-
PG-40	Ishëm	Arsim	pranë shk. Xhelal Shtufi	3,032	900	60	-
PG-41	Ishëm	Arsim	pranë shk. Pren Simoni	2,625	750	50	-

Burimi: Plani i përdorimit të tokës së Bashkisë Durrës (kategoritë AR dhe AS); përpunim GIS, nëntor 2026.

Shkollat e propozuara si strehime të përkohshme

Kodi	NjA	Shkolla	Lokaliteti	Gjurma e godinës (m²)	Kapaciteti orientues (persona)	E përshtatshme për përmbytje	Kufizime
ST-01	Durrës	14 Nëntori, 9-vjeçare	Durrës	400	50	Po	-
ST-02	Durrës	Bajram Curri nr. 2, 9-vjeçare	Durrës	277	30	Po	-
ST-03	Durrës	Bajram Curri nr. 1, 9-vjeçare	Durrës	218	30	Po	-
ST-04	Durrës	Bedrie Bebeziqi, 9-vjeçare	Durrës	318	40	Po	-
ST-05	Durrës	Beqir Çela, e mesme e përgjithshme	Durrës	928	130	Po	-
ST-06	Durrës	Bernardina Qeraxhia, e mesme e përgjithshme	Durrës	1,593	220	Po	-
ST-07	Durrës	Demokracia, 9-vjeçare	Durrës	577	80	Po	-
ST-08	Durrës	E Re, 9-vjeçare	Durrës	949	130	Po	-
ST-09	Durrës	Eftali Koci, 9-vjeçare	Durrës	628	80	Po	-
ST-10	Durrës	Gjergj Kastrioti, e mesme e përgjithshme	Durrës	923	130	Po	-
ST-11	Durrës	Hajdar Dushi, 9-vjeçare	Durrës	582	80	Po	Afër rrëshqitjes
ST-12	Durrës	Hasan Koçi, 9-vjeçare	Durrës	619	80	Po	-
ST-13	Durrës	Hysen Çela, e mesme e përgjithshme	Durrës	1,102	150	Po	-
ST-14	Durrës	Isuf Ferra, 9-vjeçare	Durrës	415	50	Po	-
ST-15	Durrës	Jan Kukuzeli, e mesme e përgjithshme	Durrës	641	90	Po	-
ST-16	Durrës	Jusuf Puka, 9-vjeçare	Durrës	606	80	Po	-
ST-17	Durrës	Kushtrimi i Lirisë, 9-vjeçare	Durrës	1,028	140	Po	-
ST-18	Durrës	Leonik Tomeo, e mesme e përgjithshme	Durrës	1,007	140	Po	-
ST-19	Durrës	Marie Kaçulini, 9-vjeçare	Durrës	811	110	Po	-
ST-20	Durrës	Met Hasa, 9-vjeçare	Durrës	409	50	Po	-
ST-21	Durrës	Naim Babameto, 9-vjeçare	Durrës	561	80	Po	-
ST-22	Durrës	Naim Frashëri, e mesme e përgjithshme	Durrës	1,463	200	Po	-
ST-23	Durrës	Nënë Tereza, 9-vjeçare	Durrës	617	80	Po	-
ST-24	Durrës	Olsi Lasko, e mesme e përgjithshme	Durrës	665	90	Po	-
ST-25	Durrës	PLM, 9-vjeçare	Durrës	596	80	Po	-
ST-26	Durrës	Qemal Mici, 9-vjeçare	Durrës	643	90	Po	-

Kodi	NjA	Shkolla	Lokaliteti	Gjurma e godinës (m²)	Kapaciteti orientues (persona)	E përshtatshme për përmbytje	Kufizime
ST-27	Durrës	Shaqe Mazreku, 9-vjeçare	Durrës	692	90	Po	-
ST-28	Durrës	Vasil Ziu, 9-vjeçare	Durrës	617	80	Po	-
ST-29	Ishëm	Xhelal Shtufi, 9-vjeçare	Shkafanë	478	60	Po	-
ST-30	Ishëm	Adem Gjeli, 9-vjeçare	Kapidanaj	315	40	Po	-
ST-31	Ishëm	Bizë, 9-vjeçare	Ishëm	171	20	Po	-
ST-32	Ishëm	Fushë Draç, 9-vjeçare	Draç	85	10	Po	-
ST-33	Ishëm	Pren Simoni, 9-vjeçare	Draç	329	40	Po	-
ST-34	Ishëm	Rexhep Mezini , e mesme e përgjithshme	Kapidanaj	582	80	Po	Afër rrëshqitjes
ST-35	Ishëm	Rrotull, 9-vjeçare	Ishëm	133	10	Po	-
ST-36	Ishëm	Vat Bushi, 9-vjeçare	Lalëz	308	40	Po	-
ST-37	Katund i Ri	Bisht Kamëz, 9-vjeçare	Katund i Ri	187	20	Po	-
ST-38	Katund i Ri	Jubë, 9-vjeçare	Katund i Ri	513	70	Po	-
ST-39	Katund i Ri	Katund i Ri, e mesme e përgjithshme	Katund i Ri	345	40	Po	-
ST-40	Katund i Ri	Qerret, 9-vjeçare	Katund i Ri	519	70	Po	-
ST-41	Katund i Ri	Rinia, 9-vjeçare	Katund i Ri	437	60	Po	-
ST-42	Katund i Ri	Sukth, 9-vjeçare	Katund i Ri	772	110	Jo (zona e Erzenit)	-
ST-43	Manëz	Armath, 9-vjeçare	Manëz	473	60	Po	-
ST-44	Manëz	Hamallaj, 9-vjeçare	Manëz	232	30	Po	-
ST-45	Manëz	Hasan Gjyzeli, 9-vjeçare	Manëz	663	90	Po	-
ST-46	Manëz	Kuçok, 9-vjeçare	Manëz	246	30	Po	-
ST-47	Manëz	Manëz, e mesme e përgjithshme	Manëz	623	80	Po	-
ST-48	Manëz	Riza Shera Radë, 9-vjeçare	Radë	379	50	Po	-
ST-49	Rrashbull	Arapaj, 9-vjeçare	Rrashbull	423	60	Po	-
ST-50	Rrashbull	Besnik Hidri, e mesme e bashkuar	Shënavlash	727	100	Po	-
ST-51	Rrashbull	Manskuri, 9-vjeçare	Rrashbull	129	10	Po	-
ST-52	Rrashbull	Rromanat, 9-vjeçare	Rrashbull	631	90	Po	-
ST-53	Rrashbull	Shkallnur, 9-vjeçare	Rrashbull	431	60	Po	-
ST-54	Rrashbull	Stacioni Zooteknik , 9-vjeçare	Xhafzotaj	544	70	Po	-
ST-55	Rrashbull	Vëllezërit Haradinaj, 9-vjeçare	Rrashbull	476	60	Po	-
ST-56	Sukth	Shkolla e Roměve, 9-vjeçare	Kullë	131	10	Po	-
ST-57	Sukth	Hamallaj, 9-vjeçare	Sukth	502	70	Po	-
ST-58	Sukth	Hidrovori, 9-vjeçare	Hamallaj	73	10	Po	-
ST-59	Sukth	Kullë, 9-vjeçare	Sukth	241	30	Po	-
ST-60	Sukth	Kullë, e mesme e përgjithshme	Sukth	385	50	Po	-
ST-61	Sukth	Njazi Mastori, 9-vjeçare	Sukth	644	90	Po	-
ST-62	Sukth	Pal Zefi, 9-vjeçare	Rrushkull	450	60	Po	-
ST-63	Sukth	Perlat, 9-vjeçare	Sukth	210	20	Po	-
ST-64	Sukth	Sukth, e mesme e përgjithshme	Katund i Ri	618	80	Po	-
ST-65	Sukth	Vadardhë, 9-vjeçare	Sukth	361	50	Jo (zona e Erzenit)	-

Burimi: Baza GIS e objekteve arsimore; gjurmët e ndërtesave DR; përpunim GIS, nëntor 2026. Përdorimi pas tërmetit kërkon kontroll strukturor.

Aneks 9: Hartat operative

Hartat operative mbahen në QOECB në format të printuar A3 dhe në format dixhital në GIS-in e bashkisë. Ato përditësohen çdo vit para sezonit të zjarreve dhe të reshjeve, si dhe sa herë ndryshojnë hartat e rrezikut ose listat e pikave të grumbullimit dhe strehimeve. Hartat 3.1–9.3 jepen edhe si fletë të veçanta A3 (skedari "PVEC_Durres_hartat_A3.pdf"), me legjendë, shkallë grafike, drejtimin e veriut, sistemin e koordinatave KRGJSH-2010 (EPSG:6870) dhe burimin e të dhënave.

Lista e hartave të planit

Harta	Përmbajtja	Vendndodhja në plan
Harta 3.1	Përdorimi i tokës sipas PPV, njësitë administrative dhe rrjeti kryesor rrugor	Kapitulli 3.1
Harta 4.1	Zjarret, ndërfaqja pyll-vendbanim, rrëshqitjet dhe erozioni	Kapitulli 4.3
Harta 4.2	Ujërat, zonat RRP-N2, industria, zonat portuale dhe rreziku teknologjik	Kapitulli 4.3
Harta 9.1	Hapësirat kandidate për pika grumbullimi	Kapitulli 9.3
Harta 9.2	Hapësirat kandidate në qytetin e Durrësit, Rrashbull, Sukth dhe Katund i Ri	Kapitulli 9.3
Harta 9.3	Strehimet e mundshme në shkolla	Kapitulli 9.4
Harta A9.1	Përmbytjet, zona e planifikimit të evakuimit dhe objektet kritike	Aneksi 9
Harta A9.2	Rreziku gjeologjik dhe zjarret	Aneksi 9
Harta A9.3	Tërmeti, pikat e grumbullimit dhe strehimet e mundshme	Aneksi 9
Hartat e VRF-së	Hartat e rrezikut sipas rreziqeve dhe indeksi territorial i riskut	VRF Bashkia Durrës (nëntor 2026)
Për t'u përgatitur	Rrugët kryesore dhe alternative të evakuimit sipas NjA; pikat e ujit për zjarrfikje; zona e evakuimit për cunamin	Sektori i Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile, brenda 6 muajve

Burimi: PVEC Bashkia Durrës; përpunim GIS, nëntor 2026.



Përmbytjet

- Segment i Erzenit, risk i lartë
- Segment i Erzenit, risk i mesëm
- Segment i Erzenit, risk i ulët
- Zona e planifikimit të paralajmërimit dhe evakuimit (500 m)
- Zonë me rrezik të lartë përmbytjeje (RRP-N2) dhe sipërfaqe të përmbytura
- Argjinaturë
- Kolektor kullues
- Objekt shëndetësor
- Shkollë: strehim i mundshëm
- Shkollë brenda zonës së planifikimit
- Urë / mbikalim
- Kufiri i bashkisë
- Kufiri i NjA
- Ndërtesa
- Rrugë kryesore
- Rrugë lokale
- Kanale dhe përrenj

Burimi: Baza GIS DRR-Presentation (Qarku Durrës); Bashkitë_61; ndërtesat DR; përpunim GIS i grupit të punës, nëntor 2026.

Harta A9.1: Përmbytjet, zona e planifikimit të evakuimit dhe objektet kritike



Rreziku gjeologjik dhe zjarret

- Zonim gjeologjik: rrezikshmëri mesatare
- Zonim gjeologjik: rrezikshmëri e lartë
- Rrëshqitje dhe erozion i hartëzuar
- Pyje, shkurre dhe kullota (CORINE)
- Vatër zjarri e regjistruar (2019-2023)
- Objekt shëndetësor
- Kufiri i bashkisë
- Kufiri i NjA
- Ndërtesa
- Rrugë kryesore
- Rrugë lokale
- Kanale dhe përrenj

Burimi: Baza GIS DRR-Presentation (Qarku Durrës); Bashkitë_61; ndërtesat DR; përpunim GIS i grupit të punës, nëntor 2026.

Harta A9.2: Rreziku gjeologjik dhe zjarret



Tërmeti, pikat e grumbullimit dhe strehimi

- PGA 0.200 g
- PGA 0.225 g
- PGA 0.250 g
- Ndërtesë e shembur (2019)
- Ndërtesë e dëmtuar (2019)
- Objekt shëndetësor
- Shkollë: strehim i mundshëm (pas verifikimit strukturor)
- Pikë grumbullimi kandidate (PG)
- Kufiri i bashkisë
- Kufiri i NjA
- Ndërtesa
- Rrugë kryesore
- Rrugë lokale
- Kanale dhe përrenj

Burimi: Baza GIS DRR-Presentation (Qarku Durrës); Bashkitë_61; ndërtesat DR; përpunim GIS i grupit të punës, nëntor 2026.

Harta A9.3: Tërmeti, pikat e grumbullimit dhe strehimet e mundshme